

PROFIL

“Sfida” Xhafer Martini dhe (pa) urtia dibrane

Nga prof.dr. **BAJRAM XHAFA**

— Faqe 18

BOTIME

Prof. Nazmi Koçi, enciklopedi e stomatologjisë

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

— Faqe 25

KONCERT

Liri Rasha: “Kënga ime” në pesëdhjetë vite

Nga **HALIL RAMA**

— Faqe 19

IN MEMORIAM

Prof.dr. Ahmet Kamberi, ikja e një humanisti

Nga **NAZMI KOÇI**

— Faqe 39

SKAVICA, Gjykata Kushtetuese konstaton shkelje të së drejtës për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij

Janë shkelur të drejtat për informim, urdhërohen autoritetet të riparojnë shkeljet e konstatuara

VENDIMI I GJYKATËS KUSHTETUESE:

1. Konstatimin e shkeljes së të drejtës për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 56 i Kushtetutës, në procedurat e miratimit të ligjit nr. 38/2021.
2. Urdhërimin e autoriteteve publike për të riparuar shkeljen e konstatuar dhe për të garantuar të drejtën për informim gjatë fazës së parë të zbatimit të ligjit nr. 38/2021.
3. Detyrimin për marrjen parasysh në vijim të rezultateve të procesit të informimit për mbrojtjen e mjedisit, për aq sa është e mundur, në zbatim të nenit 8 të Konventës së Aarhusit.

— Faqe 2-3

Komiteti i Traktatit të Bernës do të monitorojë projektin e Skavicës për shkelje të mundshme: Shpresë për lumin e Drinit të Zi dhe speciet e rrezikuara



REPORTAZH

LLADIMERICA, e ndarë përgjysmë nga kufiri, feston

Nga **KADRI DAUTI** — Faqe 20-21

NË BRENDESI:

■ **Drini i Zi që zhyt e mbyt...** dhe Shushica që than tokë e djeg xhanë ■ **Çfarë është GARD**, Grupi i Aktivistëve Ruralë të Dibrës? ■ Në **Dibër të Madhe** shtohen bizneset, kontrast me realitetin në bashkitë kufitare të Shqipërisë ■ Dritë në tunelin kryesor të **Rrugës së Arbrit** ■ **Xhafer Martini** sfidoi epokën e lirisë ■ Në vend të fjalës falënderuese ■ Në **Xibër**, fshatin e harruar pas maleve ■ Një **libër diturie**, një libër shërbimi, një libër përvojë... ■ Avokat **Baftjar Rusi**, “Misionar i paqes botërore” ■ **Agron Tufa** fiton çmimin letrar “Vehxhi Buharaja” 2024 në gjininë e poezisë ■ **Ahmet Prençi**, një nga autorët shqiptarë më të lexuar të momentit. ■ “Dukuri, fenomene kulturore, profile krijuese” - disa nga risitë e librit të **Esat Rukës** ■ **Parmenda**, roli i saj në jetën e njeriut ■ Familja e madhe e **Gëzim Markes** ■ **Shaqir Kaloshi**, një njeri heroik dhe besnik ■ Çeta partizane e Gollobordës ■ **“Hasan Leka do të mbetet përherë mësues”** ■ “Po Demokracisë, Jo Demokaturës”, libri publicistik i prof. dr. Ahmet Kamberit...

DEBAT

Ndërtimi i Skavicës sjell dëme të pariparueshme për Dibrën dhe kombin

Nga prof.dr. **BASHKIM LLESHI**

— Faqe 4-5

Qeveria duhet t'i kthejë sytë nga Dibra e Skënderbeut, jo për ta mbuluar me ujë, por për ta “mbuluar” me investime

Nga prof. asoc. dr. **VESEL HOXHA**

— Faqe 6-7

Skavica, mes interesave kombëtare dhe shqetësimeve lokale

Nga **ROLAND MARKU**

— Faqe 10

REPORTAZH

Drini i Zi – bekim apo mallkim?

Nga **ELONA ELEZI, ESMERALDA TOPI**

— Faqe 8

Skavica, banorët u rikthehen protestave

Nga **ERISA KRYEZIU**

— Faqe 11

EKSKLUZIVE

Intervistë me **GËZIM ALPION**, profesor i asociuar i Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit në Mbretërinë e Bashkuar, i cili sapo është zgjedhur edhe si anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë



Mësimi më i madh nga Nënë Tereza: Të kemi më shumë respekt për njëri-tjetrin

Në kohën tonë, mësimi më i madh nga Nënë Tereza është të kemi më shumë respekt për njëri-tjetrin dhe veçanërisht për ata që shteti dhe shoqëria i ka lënë pas dore apo i trajton me përbuzje. Për Nënë Terezën, dinjiteti njerëzor ishte i shenjtë. Në këtë drejtim, më shumë se kushdo tjetër, Nënë Terezën duhet ta kuptojnë politikanët dhe pushtetarët që, ndërsa mburren vend e pa vend me këtë ikonë globale humanizmi dhe spiritualiteti, sillen si harbutër me njerëzit e thjeshtë për të cilët i zë ‘meraku’ vetëm gjatë zgjedhjeve, për t’ju marrë votat me hir ose pahir, veçanërisht në Shqipëri, ku Nënë Tereza akoma nuk ka ‘mbërritur’, megjithëse e vizitoi vendin për herë të parë në 1989.

Bloomsbury boton edicion të ri të librit për Nënë Terezën në përvjetorin e ditëlindjes së Gëzim Alpiion

Faqe 12-13



Gazetë e pavarur. Nr. 1 (201).
Janar - Maj 2024
Gazeta doli nga shtypi, 30 Maj 2024.
Gjendet në treg deri në fund muajit qershor 2024.

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtorët e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet refuzohen për botim vetëm në rast se merrni përgjigje me email. Për çdo rast tjetër shkrimet priten për botim në numrat e radhës.

Shkrimet në redaksi për numrin e radhës priten deri më datë 20 të muajit, përveç rasteve të bashkëpunëtorëve të regullit.

Gjithashtu, ju kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.

GJITHASHTU, KUJTOJMË SE ÇDO SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA TJETËR APO RRJETE SOCIALE NUK KA PËRPARËSI BOTIMI.

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

BOTUES:

Musa Riçku
Bujar Karoshi
Shaqir Skarra

Editor i faqes online: Agim Deva

Kontribuon për këtë numër: Abdulla Diku, Abdurahim Ashiku, Agron Tufa, Arben Çejku, Bajram Xhafa, Bashkim Lleshi, Elona Elezi, Erisa Kryeziu, Esmeralda Cenollari -Topi, Gëzim Alpion, Hajri Shehu, Halil Rama, Kadri Dauti, Marjo Kaca, Nazmi Koçi, Osman Xhili, Roland Marku, Sami Curri, Shaban Sinani, Tefta Cami, Vesel Hoxha, Xhafer Martini, Zabit Lleshi etj.

Falenderojmë z. **Nazmi Koçi** për ndihmën e dhënë financiare në botimin e këtij numri. Ju kujtojmë, se të gjithë ata që duan të kontribuojnë financiarisht për gazetën, të përdorin transfertat përmes numrit të llogarisë të shënuar më poshtë.

Të gjithë lexuesit që kanë pasur një pajtim të vlefshëm në gazetën *Rruga e Arbërit* gjatë vitit 2023, nuk do të bëjnë abonim të ri për vitin 2024. Për shkak të mos daljes së gazetës në versionin print për disa muaj, afati i pajtimit do të jetë i vlefshëm edhe gjatë vitit 2024.

KËRKOHEM KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE

Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në goftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën.
Të interesuarit të shkruajnë email në adresën <rrugaearberit@gmail.com> ose të telefonojnë në numrin 069 20 68 603.

Arkivi i gazetës është PA pagesë në faqen e internetit www.rrugaearberit.com.

Falënderojmë z. **AGIM DEVA** për kontributin e vazhdueshëm për mirëmbajtjen e faqes së gazetës në internet dhe arkivin online.

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.
Bëj pajtimin tënd me **PayPal** përmes emailit <rrugaearberit@gmail.com>

Një pajtim vjetor kushton: Në Shqipëri: 600 lekë. Në Europë: 10 Euro. Në SHBA dhe vende të tjera: 15 USD.
Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Për kontribute për gazetën mund të kontaktoni redaksinë ose mund t'i bëni ato përmes numrit të llogarisë më poshtë:

Raiffeisen Bank
Rruga e Arberit / NIPT: K820190025
Nr. llog. në lekë: 0010036640
IBAN: AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640

Adresa e gazetës:

Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
+355 69 20 68 603

E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

SKAVICA, GJYKATA KUSHTETUESE KONSTATON SHKELJE TË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë shpalli më 30 janar 2024 vendimin e shkurtuar mbi padinë e disa organizatave që kundërshtojnë ligjin nr. 8/2021, datë 23.03.2021, i cili i jep kompanisë "Bechtel International" ndërtimin e HEC Skavica - në dy faza.

Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi çështjen më 12 dhjetor 2023 dhe 10 janar 2024. Ajo mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 6 (Sh) 2023 të Regjistrat The-meltar, me kërkesë shoqatave "Për mbrojtjen e pronave dhe mjedisit të pellgut të Drinit të Zi" dhe "Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës" si dhe Komitetin Shqiptar i Helsinkit, me objekt: "Shfuqizimi i ligjit nr. 38/2021, datë 23.03.2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International Inc.", për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës", si i papajtuësishëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjen e Stabilitizimit-Asocimit.

Gjithashtu, paditësit kishin kërkuar edhe shfuqizimin e vendimit nr. 485, datë 30.07.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kontratës së fazës së parë "Kontratë për shërbime teknike - projekti hidroenergetik i Skavicës" ndërmjet KESH sh.a. dhe Bechtel Limited", si i papajtuësishëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Marrëveshjen e Stabilitizimit-Asocimit. Pëzullimi i zbatimit të ligjit nr. 38/2021, datë 23.03.2021 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negociimin dhe ekzekutimin e kontratës me shoqërinë "Bechtel International Inc.", për projektimin dhe ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës" dhe të vendimit nr. 485, datë 30.07.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e kontratës së fazës së parë "Kontratë për shërbime teknike - projekti hidroenergetik i Skavicës" ndërmjet KESH sh.a. dhe Bechtel Limited", derisa vendimi përfundimtar i Gjykatës Kushtetuese të hyjë në fuqi".

Në njoftimin paraprak të Gjykatës Kushtetuese thuhet se:

"Gjykata Kushtetuese, e mbledhur më 30.01.2024, pasi mori në shqyrtim kërkesën dhe pretendimet e parashtruara nga kërkuessit, si dhe prapësimet e subjekteve të interesuara, vlerësoi se:

Gjykata ka juridiksion për të shqyrtuar pajtuësishmërinë me Kushtetutën të ligjit nr. 38/2021 dhe nuk ka juridiksion për vendimin nr. 485, datë 30.07.2021 të Këshillit të Ministrave, pasi ky vendim nuk përbën akt me karakter normativ.

Duke pasur parasysh se ligji e rregullon projektin e Skavicës në dy faza dhe faza e dytë fillon vetëm nëse finalizohet faza e parë, Gjykata vlerësoi se kërkuessit legjitimohen vetëm për pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit për çështjet mjedisore.

Në lidhje me themelin, Gjykata vlerësoi se ligji nr. 38/2021 ka të bëjë dhe sjell ndikim, ndër të tjera, edhe në çështjet e mjedisit. Gjatë procesit gjyqësor nuk u provua se Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave, para miratimit të ligjit, të kenë zbatuar të drejtën e informimit për gjendjen e mjedisit dhe për mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 56 i Kushtetutës. Po kështu, këto subjekte nuk kanë kryer procese konsultative me publikun dhe nuk kanë garantuar pjesëmarrje efektive që në fazën e hershme të hartimit të projektligjit, ku të gjitha alternativat të ishin të hapura dhe komuniteti i zonës (me statusin e publikut të ndikuar) të mund të merrte pjesë sipas detyrimeve të Konventës së Aarhusit.

Për sa më lart, Gjykata vlerësoi se, duke qenë se ligji ndodhet akoma në fazën e parë të zbatimit të tij, shkeljet e konstatuara para miratimit të ligjit mund të riparohen ende përmes ndërmarrjes së hapave konkretë për

Gjykata urdhëron autoritetet publike për të riparuar shkeljen e konstatuar dhe për të garantuar të drejtën për informim gjatë fazës së parë të zbatimit të ligjit nr. 38/2021 si dhe detyrimin për marrjen parasysh në vijim të rezultateve të procesit të informimit për mbrojtjen e mjedisit, në zbatim të Konventës së Aarhusit.



Në foto: Avokati Dorian Matlija duke mbrojtur padinë në Gjykatën Kushtetuese. Foto nga Ëeb.

përfshirjen e publikut në informacion dhe vendimmarrje.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, Gjykata, njëzëri,
Vendosi:

1) Konstatimin e shkeljes së të drejtës për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 56 i Kushtetutës, në procedurat e miratimit të ligjit nr. 38/2021.

2) Urdhërimin e autoriteteve publike për të riparuar shkeljen e konstatuar dhe për të garantuar të drejtën për informim gjatë fazës së parë të zbatimit të ligjit nr. 38/2021.

3) Detyrimin për marrjen parasysh në vijim të rezultateve të procesit të informimit për mbrojtjen e mjedisit, për aq sa është e mundur, në zbatim të nenit 8 të Konventës së Aarhusit.

Vendimi përfundimtar i arsyetuar i gjykatës u shpall më 29 shkurt 2024, vendim të cilin gazeta do ta botojë të plotë.

BECHTEL INTERNATIONAL NUK PARAQITET NË GJYKATË

Në gjykimin e kësaj çështje ishin të pranishme edhe përfaqësues nga palët e interesuara: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Min-

DEKLARATË E PËRBASHKËT PËR SHTYP:

Gjykata urdhëron autoritetet publike për të riparuar shkeljen e konstatuar dhe për të garantuar të drejtën për informim gjatë fazës së parë të zbatimit të ligjit nr. 38/2021 si dhe detyrimin për marrjen parasysh në vijim të rezultateve të procesit të informimit për mbrojtjen e mjedisit, në zbatim të Konventës së Aarhusit.

Kjo deklaratë për shtyp ka të bëjë me ankesën tonë zyrtare pranë Byrosë së Komitetit të Përhershëm të Konventës për Ruajtjen e Kafshëve të Egra dhe Habitaveve Natyrore Evropiane (Konventa e Bernës) në lidhje me Projektin e Hidrocentralit të Skavicës (HEC). Konventa e Bernës është një traktat për të mbrojtur florën dhe faunën e egër dhe habitatet e tyre natyrore.

Pas një vizite të thelluar në zonën e prekur të projektit dhe konsultimit me palët e interesuara të projektit, ne paraqitëm një ankesë zyrtare pranë Konventës së Bernës. Ankesa jonë pohon se HEC-i i Skavicës shkatërron habitatet e mbrojtura dhe, më konkretisht, shkel nenet 2, 3.1, 3.2., & 4.1 dhe 10.1 të Konventës së Bernës.

Në ankesën tonë, ne ofrojmë prova të shumta se si autoritetet, në lidhje me këtë projekt, kanë dështuar të ndërmarin veprimet e nevojshme administrative për të mbrojtur speciet dhe habitatet (të renditura në Shtojcat I dhe II dhe Rezolutat nr. 4 [1996] & nr. 6 [1998]), dhe për faktin se lumi Drin i Zi duhet të shpallet një vend Emerald sipas Seminarit Biogeografik 2011.

Na vjen mirë që, pas shqyrtimit të komenteve të marra nga qeveria shqiptare dhe koalicioni ynë i OJQ-ve gjatë janarit 2024, Konventa e Bernës, në mbledhjen e saj të prillit 2024, ka vendosur të monitorojë HEC-in e Skavicës dhe të kërkojë nga qeveria Shqiptare t'i përgjigjet shqetësimeve të përbashkëta të mëposhtme:

- HEC-i i Skavicës në lumin Drini i Zi mund të prekë një zonë të mundshme të Rrjetit Emerald dhe gjithashtu specie të shumta të mbrojtura në Konventën e Bernës, të cilën Shqipëria e ka ratifikuar në ligj.

- Shqetësimi i veçantë është për Rrëqebullin e Ballkanit të rrezikuar në mënyrë kritike dhe korridoret e tij migratore. Konventa e Bernës ka theksuar se projekti i HEC-it të Skavicës bie ndesh me Projektin e Rimëkëmbjes së Rrëqebullit, në të cilin Shqipëria ishte propozuesi kryesor për renditjen e rrëqebullit të Ballkanit si një specie rreptësisht e mbrojtur.

- Byroja e Konventës së Bernës theksoi gjithashtu se projekti mund të prekë tre liqene të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë liqenet e Ohrit dhe të Shkodrës.

- Një çështje që kërkon monitorim të ngushtë është përpilimi i Vlerësimit të Ndikimit Mjedisor dhe Social për HEC-in e Ska-

Byroja Konventës së Bernës u kërkoi autoriteteve shqiptare të sigurojnë masat paraprake dhe të mos zhvillojnë projekte, të cilat mund të ndikojnë negativisht në habitatet dhe speciet në territorin e Shqipërisë

SË DREJTËS PËR INFORMIM PËR GJENDJEN E MJEDISIT DHE MBROJTJEN E TIJ

Janë shkelur të drejtat për informim, urdhërohen autoritetet të riparojnë shkeljet e konstatuara

istrave dhe KESH. Ndërsa përfaqësuesit e kompanisë Bechtel International nuk ishin të pranishëm, megjithëse sipas kryetares së gjykatës, “ishin vënë në dijeni më datë 5 tetor 2023 dhe nuk kanë paraqitur shkaqe për mungesën dhe as parashtrime”.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe shoqatave “Për Mbrojtjen e Pronave dhe Mjedisit të Pellgut të Drinit të Zi” përfaqësoheshin në këtë seancë nga avokatët Erida Skëndaj, Julian Mërtiri, Vladimir Meçi dhe Dorian Matlija, ndërsa shoqata “Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës” përfaqësohej nga avokatët Baftjar Rusi dhe Jordan Daci.

Dy nga paditësit i kishin paraqitur gjykatës edhe një kërkesë për një opinion “Amicus curiae” nga Fondacioni EuroNatur, CEE Bankwatch Network dhe River-Watch, por që gjykata, me shumicë votash, në fund të kësaj seance, vendosi të mos e marrë parasysh.

Avokatët e të dyja palëve, përmes parashtrimeve të tyre dhe përmes pyetjeve dhe përgjigjeve, argumentuan se ligji 38/2021, “Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe ekzekutimin e kontratës me kompaninë “Bechtel International Inc”, për projektimin dhe ndërtimin e Hidrocentralit të Skavicës” është i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe marrëveshjeve ndërkombëtare që Shqipëria ka nënshkruar, ndaj kërkojnë anulimin e tij, dhe rrjedhimisht, edhe vendimet e Këshillit të Ministrave që bazohen mbi këtë ligj.

Përfaqësuesit e institucioneve paraqiten një mbrojtje të mangët gjatë seancës, duke

VENDIMI

1. Konstatimin e shkeljes së të drejtës për informim për gjendjen e mjedisit dhe mbrojtjen e tij, të garantuar nga neni 56 i Kushtetutës, në procedurat e miratimit të ligjit nr. 38/2021.
2. Urdhërimin e autoriteteve publike për të riparuar shkeljen e konstatuar dhe për të garantuar të drejtën për informim gjatë fazës së parë të zbatimit të ligjit nr. 38/2021.
3. Detyrimin për marrjen parasysh në vijim të rezultateve të procesit të informimit për mbrojtjen e mjedisit, për aq sa është e mundur, në zbatim të nenit 8 të Konventës së Aarhusit.

u bazuar më shumë mbi vendimet politike që qeveria ka marrë në lidhje me këtë çështje, si dhe duke u fshehur pas synimeve që ka shprehur qeveria mbi strategjitë energjetike në vend.

PROTESTË PARA KRYEMINISTRISË 2 DITË PËRPARA GJYKATËN KUSHTETUESE

Dhjetra qytetarë u mblodhën përpara Kryeministrisë, të dielën, datë 10 dhjetor 2023, në një protestë duke kundërshtuar vendimet e qeverisë shqiptare në planet e saj për të ndërtuar Hidrocentralin e Skavicës. Me thirrjet “Po Dibrës, Jo Skavicës”, “Mbroje lumin Drin” etj., protestuesit me pankarta në duar udhëtuan nga monumenti i Skënderbeut në qendër të Tiranës, deri te sheshi para kryeministrisë, duke bërë thirrje për të ndaluar ndërtimin e hidrocentralit.

Kjo protestë ishte dy ditë para se Gjykata Kushtetuese të vendosë në lidhje me ligjin special nr. 38/2021, me anë të të cilit

i është dhënë e drejta shoqërisë “Bechtel International” të projektojë dhe të ndërtojë hidrocentralin e Skavicës.

KONVENTA E BERNËS: JEMI TË SHQETËSUAR PËR PLANET PËR ZHVILLIMIN E HIDROCENTRALIT TË SKAVICËS

Në prill të këtij viti, Byroja e Komitetit të Përhershëm të Konventës së Bernës, shqyrtoi ankesën e ardhur nga disa organizata ku pretendohet shkatërrim i habitatit për shkak të ndërtimit të Hidrocentralit të Skavicës (HEC Skavica) në lumi Dri.

Në vendimin e saj, Byroja e Konventës së Bernës theksonte se “Byroja është e shqetësuar për planet për zhvillimin e hidrocentralit të Skavicës (HEC) në lumin Drin i Zi, i cili mund të prekë një kandidat të mundshëm të rrjetit Emerald (Emerald Network site), ku përfshihen një sërë specimesh të shumta të mbrojtura nga rezolutat e Konventës, veçanërisht Rrëqebulli i Ballkanit, i rrezikuar në mënyrë kritike dhe korridoret e tij migratore”. Byroja

vuri në dukje se projekti mund të prekë tre liqene të rëndësishme të Ballkanit Perëndimor, dy prej të cilave janë objekt i dosjeve të tjera (Ohri dhe Shkodra).

Byroja rikujtoi se Shqipëria ka qenë një nga propozuesit kryesorë të listimit të Rrëqebullit të Ballkanit si një specie rreptësisht e mbrojtur. Por ky projekt dukshëm e kundërshton këtë nismë dhe punën e mirë në Programin e Rimëkëmbjes së Rrëqebullit të Ballkanit. Duket që ky projekt të ketë ndikime të mundshme negative në këtë dhe specie të tjera... Duke marrë parasysh gjithçka, të dyja palëve u kërkua të paraqesin progresin në raportet e tyre për mbledhjen e Byrosë në vjeshtë 2024. Autoriteteve në veçanti iu kërkua që të raportojë mbi ndikimet e pritshme në biodiversitetin e projektit të HEC-it dhe për të ofruar rezultatet të gjetjeve të VNMS dhe Gjykatës Kushtetuese, si dhe çdo përditësim tjetër përkatës. Ndërkohë, Byroja u kërkoi autoriteteve shqiptare të sigurojnë masat paraprake dhe të mos zhvillojnë projekte, të cilat mund të ndikojnë negativisht në habitatet dhe speciet në territorin e Shqipërisë dhe të Konventës së Bernës në tërësi.

Ankesa në Konventën e Bernës ishte bërë nga disa organizata të huaja: Earth Laë Center – SHBA & Earth Thrive – Britani e Madhe, në emër të disa organizatave nga Shqipëria, si Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës (OSD), Grupi i Aktivistëve Ruralë Dibra -GARD), Shoqata North Green dhe GLV Integrimi. Përgatiti: BUJAR KAROSHI

KOMITETI I TRAKTATIT TË BERNËS DO TË MONITOROJE PROJEKTIN E SKAVICËS PËR SHKELJE TË MUNDSHME

Shpresë për lumin e Drinit të Zi dhe speciet e rrezikuara

vicës që është ende i pa finalizuar,

- Së fundi, Byroja vuri në dukje mbrojtjen e kafshëve mishngrënësve të mëdhenj, të cilët gjithashtu preken nga HEC-i i Skavicës.

Konventa e Bernës i ka kërkuar Shqipërisë të zbatojë parimin e parandalimit gjatë fazës së parë aktuale të projektit. Kjo do të thotë të mos zhvillohen projekte që mund të ndikojnë negativisht në habitatet dhe speciet e Shqipërisë dhe të territorit të Konventës së Bernës.

Ne do të monitorojmë nga afër zhvillimin e projektit dhe do t'i ofrojmë informacion Konventës së Bernës deri në korrik 2024, siç kërkohet.

“Ne duhet të largohemi nga nocioni i rremë se hidroenergjinë është energji “e rinovueshme” duke qenë se shkatërron përgjithmonë ekosistemet e ujërave të ëmbla dhe sjell dëme të konsiderueshme mjedisore për të gjithë jetën, duke përfshirë njerëzit”, tha Grant Eilson, Drejtor Ekzekutiv, Qendra Ligjore e Tokës. “Ne jemi të kënaqur që Byroja e ka marrë seriozisht ankesën tonë dhe ne veçanërisht përshëndesim mbështetjen e tyre për parimin e parandalimit në përditësimin e tyre të fundit.”

“Ne gjithashtu dëshirojmë të theksojmë se nuk mund të sakrifikojmë natyrën dhe ekosistemet për zgjidhje të rreme, siç është diga në Skavicë, në emër të shpëtimit të së njëjtës natyrë nga kriza klimatike, e shkatëruar kryesisht nga vetë shkatërrimi i ekosistemeve - që diga do të sillte. Ne duhet të kërkojmë zgjidhje që i shërbejnë dhe ruajnë gjithë jetën dhe jo krijojnë zona sakrifi-



Një pjesë e zonës që do të përmytet nga hidrocentrali i Skavicës. Foto: Andrey Ralev (Bankatch).

cash”, thotë Zoe Lujic, Drejtore Ekzekutive e Earth Thrive.

“Ka pasur një kundërshtim në rritje ndaj Digës së Skavicës, një lëvizje për të mbrojtur lumin Drin, florën, faunën, sepse jeta dhe jetesa jonë varet nga ekzistenca e lumit Drin i Zi. Protestat për mbrojtjen e Drinit të Zi dhe Dibrës do të vazhdojnë, pasi ne vazhdojmë luftën tonë ligjore për të mbro-

jtur të drejtat e komunitetit të Dibrës në të njëjtën mënyrë luftojmë për të mbrojtur të drejtat e Drinit të Zi. Shkenca ka vërtetuar se hidrocentralët shkatërrojnë ndryshimet fizike të lumit, duke rezultuar në habitate të fragmentuara, biodiversitet të reduktuar, popullatë të rrezikuara të peshqve, ruan sedimentet dhe ushqimet që janë thelbësore për shëndetin e ekosistemit në rrjedhën e

poshtme dhe përkeqësojnë ndryshimet klimatike. Ne i bëjmë thirrje ligjvënësve dhe komunitetit shkencor të gjejnë burime alternative, duke përfshirë energjinë diellore dhe energjinë e erës,” thotë Ferzileta Gjika, themeluese e lëvizjes Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës.

Së fundmi, dëshirojmë të shprehim angazhimin tonë për të mbrojtur natyrën dhe komunitetet vendore në Dibër, në bashkëpunim me një koalicion më të madh njerëzish dhe aktorë të shoqërisë civile. Inkurajojmë të gjitha autoritetet, përfshirë Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe pushtetin vendor në Dibër, të shqyrtojnë me kujdes informacionin e projektit dhe aplikimet që do t'u dërgohen për këtë projekt.

I bëjmë thirrje vendim-marrësve që të kuptojnë sa më parë ndikimet shkatërruese negative të HEC-it të Skavicës dhe të anulohen këtë projekt të dëmshëm para se të jetë tepër vonë, si për habitatet ashtu edhe për njerëzit.

Kontakt:

Earth Law Center, SHBA

Website: www.earthlawcenter.org

Earth Thrive - Britani e Madhe

Website: <https://earth-thrive.org/about-us/>

“Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës” - Shqiperi

Website: www.stopskavica.org

Grupi i Aktivistëve Rurale-GARD - Shqiperi

Email: gardactivist@gmail.com

Shoqata North Green - Shqiperi

Email: info@northgreen.org

Ëbsite: <https://www.northgreen.org/>

Shoqata GLV Integrimi - Shqiperi

Email: integrimi2016@yahoo.com

Disa nga arsyet pse nuk duhet ndërtuar hidrocentrali i Skavicës

Ndërtimi i HEC Skavica sjell dëme të pariparueshme për Dibrën dhe kombin

Nga prof. dr. ing. BASHKIM LLESHI

Deja e ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës është hedhur para viteve '90, kur është studiuar e gjithë kaskada e lumit Drin nga hyrja në kufirin me Maqedoninë deri në derdhjen në detin Adriatik, me projektimin dhe ndërtimin e HEC-eve të Vaut të Dejës, Komanit, Fierzës e Bushatit. Në fund u la të ndërtohej HEC i Skavicës, jo vetëm si rregullator për të mbajtur gjatë gjithë vitit në punë hidrocentralet e mësipërm, por edhe për të prodhuar energji me pjesën e mbetur të ujit. Për ndërtimin e tij ka patur kundërshtime prandaj u la në fund, bile pavarësisht se kishte përfunduar studimi gjeologo-inxhinierik i vendit ku do ndërtohej diga në luginën e Skavicës nga ndërmarrja Gjeologji-Gjeodezi e Ministrisë së Ndërtimit, në fillim të viteve '90 nuk filloi ndërtimi i HEC Skavicës, por filloi ndërtimi i HEC-eve të Bushatit afër Shkodrës dhe Banjës afër Gramshit në lumin e Devollit.

Në fund të viteve '80, pas përfundimit të ndërtimit të HEC-it të Komanit, në rast se qeveria e sistemit të kaluar do të fillonte ndërtimin i HEC-it të Skavicës, komuniteti dibran nuk mund t'a ndalonte, sepse toka ishte kthyer pronë e shtetit, ashtu siç nuk ndaloj HEC-in e Fierzës që përmblyti qytetin e vjetër të Kukësit dhe ndërtoi qytetin e ri. Ndërsa në kohën e sotme, duke menduar se nuk jemi në diktaturë, por në demokraci, ndërtimi i këtij HEC-i nuk mund të bëhet pa pëlqimin e komunitetit dibran, që jetojnë në ato troje dhe janë pronarë të tokave bujqësore, kullotave e pyjeve të asaj krahine. Në këto kushte të reja, për një investim strategjik, duhet bërë bilanci, se çfarë fitojmë dhe çfarë humbim si komb, në rast se vendoset kryerja e këtij investimi.

Nga qeveria është thënë se kryerja e këtij investimi strategjik ka këto avantazhe:

1. Gjysma e rezervave të ujit që do ketë kupa e rezervuarit të Skavicës do të shërbejë si rregullator për prodhimin e energjisë elektrike gjatë gjithë vitit në HEC-et e Fierzës, Komanit dhe Vaut të Dejës.

Problemi për të krijuar këtë rezervë uji për të punuar pa ndërprerje HEC-et poshtë Skavicës, është i zgjidhshëm teknikisht duke ndërtuar dy diga me lartësi më të vogël, njëra në grykën e Skavicës, ku studimi gjeologo-inxhinierik është i kryer, të lartë aq sa niveli i sipërm i kupës së rezervuarit të mos përmblytë pjesën e poshtme të Fushë-Alies dhe një digë tjetër mbi urën e telit të Katundit të Ri në grykën poshtë fshatrave Hoteshe e Selane, ku nga ana gjeologo-inxhinierike mund të jetë vendi më i përshtatshëm për ndërtimin e një dige jo të lartë, me lartësi të kupës së rezervuarit deri në këmbët e Urës së re të Rrugës së Arbërit në fund të Gjoricës së poshtme, që përmblyt vetëm pak toka në fund të fshatrave Hoteshe e Selane, lagjen e Gradecit poshtë Dovolanit dhe shumë pak tokë në fundin e fshatrave Grazhdan e Kovashicë të Maqellarës në afërsi të luginës së Drinit, pa çenuar pjesën fundore të kalasë së Grazhdanit, e cila duhet ti nënshtrohet restaurimit si një ndër kalatë më të vjetra të vendit tonë. Me këto dy kupa rezervuarësh zgjidhet problemi i rezervës së ujit për HEC-et e mëposhtme dhe, në kohë të përshtatshme, po të përdoret uji me kujdes, mund edhe të përdoret edhe për të prodhuar një pjesë të energjisë elektrike.

Me shfrytëzimin e parqe foto voltaike, burmin e erës për energji elektrike, si dhe derdhjen e përrrenjve në Drinin e Zi për shtimin e energjisë elektrike, tejkalohej sasia e prodhimit të energjisë që do jepte HEC-i i Skavicës, do të plotësohejshin të gjitha kërkesat për energji në shkallë kombëtare dhe mund të dilnim edhe në eksport të energjisë në disa shtete të Ballkanit. Me këto masa do shpëtonte dhe Dibra nga përmblytja.

2. Me pjesën tjetër të ujit do të prodhohet energji elektrike.

Një pjesë e energjisë elektrike do të prodhohet nga dy HEC-et e vegjël të propozuara më sipër, ndërsa pjesa tjetër e energjisë elektrike e cila mund të kalojë edhe sasinë e energjisë që do prodhonte HEC i madh i Skavicës, mund të përfitohet si më poshtë:

Së pari: Prodhimi i energjisë duke ndërtuar parqe foto voltaike në të gjithë territorin e Dibrës, duke përdorur një pjesë të tokave kodrinore me rendiment të ulët për ndërtimin e këtyre parqeve, të cilat janë me shumicë në të dy anët e brigjeve të lumit të Drinit të Zi dhe në krahina të tjera të Dibrës nga Klenja e Stebleva në jug deri në Kala të Dodës, Reç e Lurë në veri. Këtë nismë e ka filluar Bashkia e Bulqizës, e cila në shkurt të këtij viti (2024) ka dhënë leje për ndërtimin e dy parqeve fotovoltaike në fshatrat Okshatinë e Gjoricë, duke mos zënë tokë bujqësore me rendiment të lartë. Këtë shembull duhet ta vazhdojë edhe Bashkia e Dibrës, ku mundësitë për ndërtimin e parqeve fotovoltaike janë shumë më të mëdha.

Së dyti: Shfrytëzimi i erës për prodhimin e energjisë elektrike. Në se do të përdoreheshin burimet e erës për prodhim të energjisë, mundësitë në zonën e Dibrës janë të pafundme. Lugina e bukur e Dibrës në të dy krahët e saj lindor e perëndimor rrethohet në lindje nga vargmalet e Kërçinit, Deshatit e Korabit dhe në perëndim nga masivët e Bulqizës dhe Lurës, me lugina, gryka e shpate të panumërta për vendosjen e impi-

anteve të erës, si në zonën Fush Studën-Steblevë-Klenjë, Qaf Buall- Bulqizë-Zerqan, në luginën e Drinit nga Gjorica e Maqellara deri në Kala e Dodës, Reç e Dardhë, në shpatet e Deshatit e Korabit, në Prat-Selishtë-Qaf Murrë, Borije Lurë-Lurë-Lurë e Vjetër, në fushën e Krej Lurës, etj.

Së treti: Duhet studiuar të gjitha derdhjet e përrrenjve e gjurrave që derdhen në të dy krahët e lumit të Drinit, të cilat mbajnë ujë gjatë gjithë vitit, ku ka mundësi të ndërtohen HEC-e të vegjël, duke mos prekur në verë sasinë e ujit për vaditjen e tokave bujqësore dhe zbatuar me rigorozitet kërkesat mjedisore dhe, jo të veprohet në shkatërrimin e luginave turistike, si në rastin e HEC-it në luginën e bukur të përroit të Setës. Për këto mund të studiohen Gjurrat e Mazhicës, Hoteshit e Muhurrit dhe pjesa e poshtme e Mollës së Lurës në krahun perëndimor dhe përrrenjt e Llixhave, Bahutes, Gramës e Veleshicës në krahun lindor të luginës së Drinit të zi.

Me shfrytëzimin e këtyre tre mundësive për shtimin e energjisë elektrike, tejkalohej sasia e prodhimit të energjisë që do jepte HEC-i i Skavicës, do të plotësohejshin të gjitha kërkesat për energji në shkallë kombëtare dhe mund të dilnim edhe në eksport të energjisë në disa shtete të Ballkanit. Me këto masa do shpëtonte dhe Dibra nga përmblytja.

3. Ndërtimi i HEC-it të Skavicës do shpëtojë Shkodrën nga përmblytja

Koha ka treguar se Shkodrën nga përmblytja nuk e shpëton ndërtimi i HEC-it të Skavicës, por mirëmenaxhimi i ujit në liqenet e Vaut të Dejës, Komanit e Fierzës. Këtë fakt e dinë mirë shkodranët dhe gjithë shqiptarët. Edhe shkodranët, po t'i pyesësh sot a janë dakord të përmblytet e shuhet Dibra, nuk do të jenë dakord, sepse ato nuk mund të harrojnë varret e dibranëve të vrarë për të mbrojtur Shkodrën nga pushtuesit e huaj, ku shkruhet se: "Çidhën e Grykë e Vogël, janë vlla me Shkodër". Por dibranët nuk kanë luftuar vetëm në Shkodër për mbrojtjen e trojeve shqiptare, por në të gjithë krahinat ku ka shqiptarë, nga Janina, Çamëria e Vlora deri Kosovë e Mal të Zi. Për këtë arsye edhe miku i Dibrës me origjinë nga Vlora me banim në Kaliforni prof. E.Ymeri shkruante: "Populli dibran, në qoftë se do të jetë i bashkuar, nuk do ta lejojë Skavicën. Unë shpresoj shumë te dibranët se ata janë pasardhës të trimit legjendar Elez

Isufi, i cili, Drinin e Zi e pati mbushur me kufoma ushtarësh të vrarë serb, ç'ka Beogradit e kujton me tmerr edhe sot e kësaj dite." (E.Ymeri 14 mars 2022". Cituar nga A.Ashiku më 18 mars 2022).

Ndërsa intelektual i dibran prof. dr. Nazmi Koçi shkruan: "Sot nuk ka nevojë të luftojmë me pushkë, por të luftojmë deri në fund, me çdo mjet demokratik, papërgjegjshmërinë e mendjelehtësinë e atyre që na thonë merrni plaçkat e ikni, "se ne do shpëtojmë Shkodrën". Të luftojmë se "na ka ardhë radha", për të ardhmen e fëmijëve tonë" (Nazmi Koçi, mars 2022).

DËMET QË SJELL PËR DIBRËN DHE MBARË KOMBIN NDËRTIMI I HEC SKAVICA:

1. Nga ana ekonomike, ndërtimi i HEC-it të Skavicës përmblyt fushën më pjellore të luginës së Dibrës, duke shpërngulur mbi 35 fshatra, me mbi 20 000 banorë, nga trojet e tyre shekullore. Lugina e Dibrës ndahet në dy pjesë, duke mbytur zonën më pjellore dhe duke ngelur vetëm fundet e shpateve malore në lindje e perëndim. Përmblytet zemra e Dibrës dhe ndahet në dy pjesë. Dëmi që i shkaktohet ekonomisë së vendit tonë është shumë më i madh se energjia elektrike që do prodhohet, e cila me rrugët që u treguan më sipër plotësohet e tejkalohej. Rrugë e Arbërit u ndërtua për zhvillimin ekonomik të krahinës së Dibrës dhe për vënien në lëvizje dhe rritjen, jo vetëm të pasurive nëntokësore, por edhe të prodhimeve të bollshme bujqësore e blegtorale të kësaj treve, të cilat tani, për një orë mund vijnë dhe plotësojnë nevojat e tregut të Tiranës dhe qyteteve të tjera. Me ndërtimin e rrugës të rinjtë që kanë emigruar kanë filluar të kthehen dhe të ndërtojnë shtëpi të reja. Në gjithë luginën e Drinit tani nuk gjen parcela toke të papunuara duke filluar nga Gjorica e Shupenza deri në Katundin e Ri, Brezhdan, Muhur, Kastriot, Fush Alie deri në Zall Dardhë.

2. Ndërtimi i HEC-it të Skavicës me një digë të lartë varros historinë e lavdishme të kësaj krahine, brez pas brezi që në lashtësi. Dibranët, në shekuj, nuk kanë luftuar vetëm me turqit, por edhe me serbët, bullgarët, gjermanët, italianët etj. Në luginën e Dibrës vetëm gjatë kohës së Skënderbeut janë zhvilluar 19 beteja kundër pushtuesve osmanë. "Që në kohën e Skënderbeut më 1444 e deri në çlirimin nga pushtuesit na-



Lugina e Dibrës ndahet në dy pjesë, duke mbytur zonën me pjellore... Përmbytet zemra e Dibrës... Dëmi që i shkaktohet ekonomisë së vendit tonë është shumë më i madh se energjia elektrike që do prodhohej.. Rruga e Arbërit u ndërtua për zhvillimin ekonomik të krahinës së Dibrës dhe për vënien në lëvizje dhe rritjen, jo vetëm të pasurive nëntokësore, por edhe të prodhimeve të bollshme bujqësore e blegtorale të kësaj treve, të cilat tani, për një orë mund vijne dhe plotësojnë nevojat e tregut të Tiranës dhe qyteteve të tjera. Me ndërtimin e rrugës të rinjtë që kanë emigruar kanë filluar të kthehen dhe të ndërtojnë shtëpi të reja.

zifashistë më 1944 dibranëve u është imponuar një luftë në çdo 10 vite" (Moisi Murra 2018).

Dibra, nga Qafa e Buallit, në kufi me Matin e deri në Qafë Draç e Kala e Dodës, në kufi me Kukësin, është pëllëmbë e historit. Sapo të kalosh Qafën e Buallit të del përpara Vajkali, Gurët e Skënderbeut, Ura e Qytetit pranë qytetit të Valikardhës, të njohura për betejat e Skënderbeut kundër pushtesve osmanë. Çdo toponim ka një histori më vete. Në vazhdim të dalin përpara e qytezat e hershme të Krajkës e Sofraçanit (I. Kaca 2003, A. Bunguri 2010), dhe më tutje të shfaqet lugina e bukur e Drinit të Zi, ku të del përpara Meja e Kalasë, përballë Gjoricës dhe ku është bërë Xhelisi i Gjoricës, Vau i Drinit, ku ra heroikisht patrioti e atdhetari Cen Leka, bashkë me të birin në luftë kundër Hajredin Pashës më 1844 dhe Guri i Shpuar afër Bllatës, ku krerët e Dibrës, me në krye Sali Marken, çarmatosën dhe përzunë nga Dibra Hysni Pashën më 1856 (Munir Shehu, 2010).

Po të vazhdosh udhëtimin poshtë Peshkopisë dhe të shkosh në Kastriot apo në Çidhën, në çdo vend, lagje përrua, zabel apo kodër ka një ngjarje historike. Shumë shtete të Europës, në kryeqytetet dhe qytetet e mëdha të tyre, kanë ngritur buste ose kanë emërtuar sheshe me emrin e heroit tonë legjendar, Skënderbeut, bile ka shtete pranë nesh që edhe përpiqen ta bëjnë të tyrin, ndërsa Dibra, vendlindja e Skënderbeut, përveç bustit të ngritur në vitin 2010, në qytetin e Peshkopisë, me nismën dhe kontributin e biznesmenit dibran Zaim Korsi, sot nuk ka as edhe muze, se edhe ai i ashtuquajtur muze i ngritur në Sinë para viteve nëntëdhjetë, vetëm një muze për Skënderbeun nuk mund të ishte (një ndërtesë e vogël një katëshe), dhe që u abandonua pas viteve nëntëdhjetë. (Bashkim Lleshi 2009,2023)

Në gazetën "Rruga e Arbërit" të muajit mars 2011, dr. Selman Mëziu, përshkruan deri në detaje toponimet e vjetra si: Ferra e Pashës, Përroi i Kastriotit, Bregu i Mullirit, Guri i Luftës, Mazreka, Troja, Kisha e Gjonit, Ara e Gjegjës, Ograja e Gjonit, Gjurrët e Zes, Zabeli i Gjegjës, Zabeli i Kukës, Kulla e Gjonit, Hambarët e Skënderbeut, pranë Arës së Trojës etj., ndodhet një kompleks muzeal natyral i "varrosur" që duhet "zhvarrosur" dhe aty ku ka qenë Kisha e Gjonit, të ndërtohet një Kishë muze, dhe tek vendi ku janë shenjat e murit të trashë me gurë të mëdhenj të Kullës së Gjonit, të ndërtohet një kullë me gurë të gdhendur të paktën dy katëshe dhe kjo të shërbejë si Kulla muze e Kastriotëve (Sel-



man Mëziu, 2011).

Le të shërbejnë përpjekjet e mërgimtarit dibran I. E. Ndreu (nipit të luftëtarit të madh, gjeneralit të pamposhtur popullor, heroit, E.Isufi) me shokë, për ti vënë emrin e Skënderbeut një sheshi në Paris, me rastin e 100 vjetorit të lindjes së tij, të cilën e realizuan para 31 vjetësh, shkruara në artikullin "Takim me Isa Elez Ndreun" (K.Zharkalli 2011), thirrja e dr.S.Mëziut "Të gjallët grishin gërmadhat" (Selman Mëziu, mars 2011) dhe dy përmendoret e dy ngjarjeve historike në Macukull të Matit, si një mesazh që na bëhet gjithë intelektualëve dibranë, për ti "zhvarrosur gërmadhat", për të mbështetur përpjekjet këmbëngulëse të intelektualit A.Ashiku ("Po Dibrës!, Jo Skavicës!"; 2009-2010), historianit e gjuhëtarit A.Hoxha me "Shoqatën për mbrojtjen e pellgut të Drinit të Zi", për të mos e varrosur më tej historinë e Dibrës (Bashkim Lleshi, 2011,2023).

3. Ndërtimi i HEC-it të Skavicës varros burimet e pasura arkeologjike të kësaj treve, të cilat vetëm sa janë gërvishur. Arkeologu i shquar dibran Akademik Adem Bunguri në veprën e tij "Prehistoria e Dibrës", na jep një pasqyrë të qartë për burimet arkeologjike të varrosura të kësaj lugine, të cilat vetëm sa janë gërvishur. Ai përshkruan vendbanimet e hershme të Burimit, Topojanit, Pesjakës, Cetushit etj. (Adem Bunguri 2010).

Rruga automobilistike për në Peshkopi kalon mbi themelet e Kalasë së Grazhdanit, një nga më të mëdhatë e vendit tonë, e pa zbuluar plotësisht për shkak të punimeve të pakta të kryera deri tani, por askund nuk gjejmë të shkruar asnjë rresht, as për kalanë dhe as për qytetin e hershëm të Grazhdanit. Me pak punime që janë kryer vitet e fundit kufijtë e saj janë zgjeruar poshtë duke iu afruar lumit të Drinit.

Në mars të vitit 2013, B. Lleshi boton artikullin "Fisi i Gropajve të Dibrës së Epërme mund t'a ketë origjinën nga "Gropa" e Zogje në Grykë të Vogël" mbështetur në toponimet e gjetura në këtë zonë (Bashkim Lleshi 2013, 2023), ndërsa në prill të vitit 2021 prof.dr. A. Bunguri botoi artikullin "Stema e Gropajve në Maqellarë të Dibrës së Epërme" ku njofton se: "gjatë punimeve bujqësore në vitin 1970 në vendin e quajtur "Ara e Kazanit" në zonën e Maqellarës u gjet stema e gurtë e kësaj familje të fuqishme feudale" (Adem Bunguri 2021).

Në vitin 2023 u dha njoftimi i zbulimit të vendbanimit më të hershëm, disa mijëra vjeçar të Linit, në breg të liqenit të Ohrit nga buron lumi i Drinit të Zi që përshkon Dibrën nga jugu në Veri. Kushtet për vendbanime të hershme në luginën e Dibrës kanë qenë më të mira prandaj, gjithçka të vjetër të varrosur, duhet ta zhvarrosim dhe toponimet e shumta sllave, pas dyndjes së tyre në drejtim të jugut mbi vendbanimet e hershme ilire, si Grazhdan, Vojnik, Kovashicë, Kosovo, Novoselë etj., duhet t'i

zëvendësojmë me toponimet e hershme ilire, jo vetëm në Dibër, por në të gjithë territorin Dardan e Ilir.

Kolegu im prof.as.dr. Vesel Hoxha në shkrimin me titull: "Mjaft me "Gogolin Skavica", me projekte zhvillimore për Dibrën", midis të tjerave ka nënvizuar: Prania e disa tektonikave ndërformacionale, bazuar në njohjen që kemi për ndërtimin gjeologjik të zonës së digës, dukurive karstike, rrudhosjeve të formacioneve mesozoike e paleozoike, prania e disa rrëshqitjeve të shpatëve etj., jo vetëm që nuk flasin në favor të ndërtimit të HEC-it të ashtuquajtur Skavica, por përkundrazi, paralajmërojnë dukuri natyrore me pasoja katastrofike, për të mos thënë apokaliptike, me rrezik kombëtar e ndërkombëtar.

Është momenti i duhur për anulimin e këtij projekti ogurzi me shumë pasoja negative e komplekse, duke qetësuar një herë e mirë popullatën vendase dibrane dhe opinionin e gjerë që të mos largohet nga ajo trevë nga frika e "Gogolit Skavica", duke i kërkuar publikisht qeverisë shqiptare, që jo vetëm të anulojë punimet për ndërtimin e hidrocentralit, por të ndërroj kursin 1800 shkallë, duke i kthyer sytë nga Dibra e Skënderbeut, jo për ta mbuluar me ujë, por për ta "mbuluar me investime" për zhvillimin e saj, duke e parë atë si themel i shtetformimit, si vendbanim i Kastriotëve dhe vendlindje e të madhit Skënderbe.

Në përfundim, mendoj se të gjithë dibranët duhet të dëgjojnë e mbështesin Abdurahim Ashikun, Adem Bungurin, Ali Hoxhën, Mustafa Tolën, Vesel e Munir Hoxhën, Fazilete Gjickën, Zenel Hoxhën, Nazmi Koçin, Selman Mëziun, Bujar Karoshin e shumë dibranë e jo dibranë të tjerë, pa harruar studiuesin e pasionuar prof. Sazan Guri, i cili ka qenë gjithmonë në krah të dibranëve për mbrojtjen e Dibrës.

Duhet të kujtojmë luftën e të parëve tonë për t'i mbrojtur këto troje, që nga koha e Skënderbeut në luftë kundër osmanllinjëve e deri në vitet e para të shekullit të XX në luftërat kundër serbëve e bullgarëve dhe luftëtarëve kundër nazifashistëve italianë e gjermanë në vitet e LANÇ. T'a mbrojmë me këmbëngulje Dibrën e kuvendeve historike, e prijësve popullorë, e heronjve legjendarë, t'a kthejmë në një muze natyror historik e turistik, ku vizitorët të njihen jo vetëm me historinë e saj të lavdishme, por edhe me bukuritë e natyrës së kësaj lugine të mrekullueshme.

Tiranë, më 5 mars 2024

Referimet:

- Abdurahim Ashiku, Po Dibrës, jo Skavicës, Botimet M&B, Tiranë, 2010.
- Adem Bunguri, Prehistoria e Dibrës. Botimet M&B, Tiranë 2010.
- Adem Bunguri, Argumentet pse kundërshtoj ndërtimin e H/C -it të Skavicës. Gazeta "Rruga e Arbërit" nr. 6 (168), qershor 2020.
- Adem Bunguri, Stema e Gropajve në Maqellarë të Dibrës së Epërme. Gazeta "Rruga e Arbërit" nr. 4 (176). Tiranë, prill 2021.
- Bashkim Lleshi, Macukulli fshati i historisë së vjetër dhe investimeve të reja. Gazeta "Rruga e Arbërit" nr. 6(62), qershor 2011.
- Bashkim Lleshi, Fisi i Gropajve në Dibër të Epërme mnd ta ketë origjinën nga "Gropa" e Zogje në Grykë të Vogël", Gazeta "Rruga e Arbërit" nr. 3, maj 2013.
- Bashkim Lleshi, Një jetë maleve, kujtime 4. Botimet M&B Tiranë, dhjetor 2020.
- Bashkim Lleshi, Një jetë maleve, kujtime 5. Botimet M&B, Tiranë, shkurt 2023.
- Vesel Hoxha, Mjaft me "Gogolin Skavica", me projekte zhvillimore për Dibrën. (Artikull).
- Iljaz Kaca, Rrugët e vjetra të Dibrës. Albpaper, Tiranë, 2003.
- Kristo Zharkalli, Takim me Isa Elez Ndreun". Gazeta "Rruga e Arbërit" nr. 3, mars 2011.
- Moisi Murra, Dibra nga antikiteti në Monarki. Botimet M&B Tiranë, dhjetor 2017.
- Munir Shehu, Dibra në vitet 1840-1860. Botimet M&B, Tiranë, 2010.
- Nazmi Koçi, Diga që ndan dhe shkatërron. Tiranë, mars 2022.
- Selman Mëziu, Të gjallët grishin gërmadhat. Gazeta "Rruga e Arbërit" nr. 3, mars 2011.

Çfarë është GARD, Grupi i Aktivistëve Ruralë të Dibrës?

Grupi i Aktivistëve Ruralë të Dibrës (GARD) është qendra e parë komunitare në Dibër.

E krijuar për t'i ardhur në ndihmë komunitetit rural dhe mbështetur nga European Endowment for Democracy, ka si qëllim të forcojë rolin e shoqërisë civile në vendimarrjen publike, advokacinë, qeverisjen e mirë, ndërgjegjësimin dhe pjesëmarrjen aktive të rinisë dibrane. Evidentimin e problematikave të komunitetit dhe ndihmesën për një zhvillim të qëndrueshëm të këtij rajoni. Gjithashtu, është një qendër në shërbim të individëve, organizatave lokale dhe kombëtare, të cilat mund të kryejnë aktivitetet e tyre në ambientet e GARD.

Dibra është një rajon me shumë potencial dhe tradita. Por me një shoqëri civile jo shumë aktive. Përpos sfidave që shoqëria dibrane ka hasur këto 30 vite tranzicion, prej disa vitesh përballen me sfidën më të madhe: rrezikun e ndërtimit të Hec Skavica.

Kjo jo vetëm i shkundi dibranët, por një pjesë të mirë e ndërgjegjësoi se çfarë i priste. Pati shumë nga ata që nisën të jenë më aktivë dhe të duken në media e terren. Ndërkohë që grupi i aktivistëve prej 20 vitesh vijonin luftën e tyre kundërshtuese.

Të gjithë këta aktorë nisën të krijonin lidhjet mes tyre për të vijuar një kauzë të fuqishme përballë një qeverie dhe një propagande mediatike tepër e fuqishme duke përdorur edhe krizën energjetike të vitit 2022.

Pa hyrë në detaje, mund të themi që ky rretëzim nisi të krijonte shqetësimet e para dhe vijuan kështu ndasitë dhe "lufta" për udhëheqje.

Pavarësisht përpjekjeve të njëpasnjëshme dhe bashkëpunimeve edhe me organizata ndërkombëtare, sërish uniteti ishte jo ai i duhuri. Përpos kësaj, një tjetër fakt që na e bënte këtë bashkim edhe më të vështirë, ishte mospasja e një hapësire tonën ku të mblidheshim dhe të diskutonim mbi idetë e përbashkëta, ndasitë, qoftë për çështjen Skavica, por edhe për problematika të tjera.

Prandaj, pasi u diskutua gjatë mes një pjese prej nesh, u vendos që duhej bërë i mundur ky ambient, për t'u dhënë mundësinë të gjithëve të bëheshin pjesë e një grupi me të drejta të barabarta.

Pas ndihmës që na dha European Endowment for Democracy me qendër në Bruksel, zyra e GARD u bë e mundur të hapet me 1 Mars 2023.

Përzgjedhja e emrit "Grupi i Aktivistëve Ruralë të Dibrës", nuk është i rastësishëm, por ka për qëllim ftesën ndaj të gjithë atyre që duan të kontribuojnë për vendlindjen e tyre. Dhe, mbi të gjitha, për të gjithë ata që jetojnë në zonat rurale dhe nuk kanë pasur diçka që t'u përkasë atyre.

GARD është një Qendër Komunitare, në shërbim të shoqërisë civile dibrane dhe OJQ-ve, të cilat bëjnë një punë të pandalshme me komunitetin.

Pjesë e këtij grupimi aktivistësh janë organizata të ndryshme dhe aktivistë të pavarur, që janë aktivë në kundërshtimin e projektit Skavica, përfshirë këtu edhe Shoqatën për Mbrojtjen e Pellgut të Drinit të zi, si një ndër zërat kyç në këtë çështje. Mjediset e GARD nuk do të jenë gjithmonë të hapura për ta, për të gjithë gjithë kontributin e tyre për më shumë se 20 vite në mbrojtje të Dibrës.

GARD nuk mban qëndrime politike. Mjediset e saj u përkasin të gjithëve, pa dallim. Zyra e GARD, në fund të rrugës Mith'hat Ademi, pas shkollës "Demir Gashi, është e hapur çdo ditë, ndërsa në fundjavë organizohen edhe takime me numër të madh pjesëmarrësish.



MJAFT ME "GOGOLIN SKAVICA", ËSHTË KOHA E PROJEKTEVE ZHVILLIMORE PËR DIBRËN.

analizë

Qeveria duhet t'i kthejë sytë nga Dibra e Skënderbeut, jo



Nga
prof. asoc. dr.
ing. VESEL HOXHA

P prej shumë dekadash Skavica është bërë "gogoli i dibranëve" nga të gjithë krahët e politikës, sa herë ato kanë ardhur në pushtet, të majta apo të djathta. Parlamenti dhe qeveria, nga tribuna të shpresës, janë kthyer në sytë e popullit në arena zëniesh, sharjesh e fyerjesh në maksimumin e mundshëm, duke na qeverisur me platforma politike dhe ekonomike të paqëndrueshme, pa u fokusuar në investimet prodhuese. Mungon një sistem pagash i studiuar dhe i mirëshkallëzuar, bazuar në merita dhe në produktin e punës. Akoma nuk kemi të miratuar një ligj për minimumin jetik, dhe kjo është me shumë rëndësi. Nuk e kuptoj mosdakordësinë për një parlament me numër të vogël deputetësh të zgjedhur direkt nga populli, pra deputet për popullin jo deputet për partinë. Një vend i vogël si ne, mundet me përballuar një qeveri të vogël me pak ministri dhe nëpunës. Kemi nevojë për një ndarje territoriale afatgjate me rreth 30 bashki, me organika të studiuar në varësi të problematikave, popullsisë dhe shtrirjes hapsinore (nga 26 rrethe në kohën e monizimit). Na duhet një administratë gjithashtu e vogël dhe e aftë, operative e pa struktura të tepërta, që të mos pengojë zhvillimin ekonomik të vendit, me shpërdorimin e parave të taksapaguesve shqiptarë, të këtij populli të shumëvujtur e të vjedhur.

Në shekullin e XXI, kur shkenca ka ofruar alternativa të tjera e të reja për prodhimin e energjisë, nuk kemi arsye që të mbulojmë (mbysim) me ujë tokën bujqësore dhe të zhdukim trojet e banuara në mjëvjeçarë.

Shumë është shkruar për "të ashtuquajturën Skavicë" dhe shumë do të shkruhet sa duket edhe në vitet në vijim, pasi ndërtimi i saj përbën një problem madhor kyç e jetik për Dibrën, problem që lidhet me egzistencën ose jo të saj. Nga ana tjetër, zhvillimi i këtij projekti shikohet si fitimprurës për firmat ndërtuese e shfrytëzuese ndonëse, që në emërtimin e këtij hidrocentrali është gabuar, dhe emri Skavicë ka marrë dhenë.

Vendi ku kohët e fundit janë kryer punimet e studimet për digën, nuk është pjesë e territorit të fshatit Skavicë, pra e bashkisë Kukës, por është pjesë e fshatit Qafë Draj, Njësia administrative e Reçit, dhe e ka emërtimin Suka e Trocit apo Shullani i Trocit. Kjo nënkupton se leja për të kryer punimet duhet të jetë lëshuar nga bashkia Dibër. Përshtjellimi që ka krijuar emri Skavicë lë të kuptohet se HC-i do të ndërtohet në territorin e bashkisë së Kukësit dhe jo në territorin e bashkisë Dibër.

Gjerë më tani, punimet e studimet për digën po realizohen në territorin e Dibrës dhe përmbytja do të ndodhë tërësisht në territorin e saj. Kjo duhet të jetë e qartë për të gjithë.

Tashmë ky emër është shndërruar realisht në një "Gogol të Madh" pse jo dhe në një friksim të madh, prej më se gjashtë dekadash. Duke qenë një kundërshtar i digave të mëdha, para shumë viteve (nga dëshpërimi dhe zemrimi se mund të ndërtohej hidrocentrali në fjalë sipas parashikimeve qeveritare), iu kundërpërgjigja në shtypin e kohës këtyre varianteve me diga të tilla.

Qeveritarët parashikonin ndërtimin e



PËRMENDORJA E FAMILJES SË
KASTRIOTIT, NGRITUR NË
FSHATIN KASTRIOT



NGRITUR NË RRËZË TË KODRËS
SË HANEVE, FSHATI LAÇES
PËRMENDORJA E BETEJËS SË TORVIOLLIT
DHE LUFTRAVE PËR LIRI E PAVARËSI



PËRMENDORJA NË KEPIN E
XHITIT PËR MASAKRËN E
ÇIDHNËS, VITI 1466.

Është momenti i duhur për anulimin e këtij projekti ogurzi me shumë pasoja negative e komplekse, duke qetësuar një herë e mirë popullatën vendase dibrane dhe opinionin e gjerë që të mos largohet nga ajo trevë nga frika e Gogolit Skavica, duke i kërkuar publikisht qeverisë Shqiptare që jo vetëm të anulojë punimet për ndërtimin e hidrocentralit, por të ndërroj kursin 180° shkallë, duke i kthyer sytë nga Dibra e Skënderbeut jo për ta mbuluar me ujë, por për ta "mbuluar" me investime për zhvillimin e saj, duke e parë atë si themel i shtetformimit, si vendbanim i Kastriotëve dhe vendlindje e të madhit Skënderbe.

Këto investime do frenojnë pikësëpari largimin e të rinjve nga vendlindja dhe boshatisjen e fshatit, një dukuri negative që mund të shdërrohet në tragjedi po nuk u morën me kohë masat e duhura në investime. Dhe kjo nuk është pak, por një hap vendimtar e me rëndësi, drejt përparimit e prosperitetit të zonës.

hidrocentralit në fjalë, në njerin nga tre variantet e më poshtme të paraqitura në kuota absolute për pasqyrën e ujit të liqenit të ardhshëm: 445m, 465m dhe 485m.

Si kundërpeshë ndaj këtyre varianteve ogurzeza për Dibrën e dibranët, pata propozuar fillimisht, në një artikull të botuar në shtypin e kohës, tri diga të vogla, ku më vonë fiksova vetëm dy prej tyre, duke u bazuar edhe në konsultime me specialistë të fushës dhe me studimet e firmave të ndryshme vendase e të huaja, që kërkonin të ndërtojnë vepra hidroenergetike në këtë lum.

Digën e parë e pata propozuar dy km poshtë digës së "të ashtuquajtur Skavicë", në vendin e quajtur Përroi i Tushes - përballë fshatit Tejdri (bashkia Kukës), me një lartësi dige 60 m. Niveli maksimal i pasqyrës së liqenit do të ishte rreth 5 m

vertikalisht mbi pikëtakimin e përroit të Veshicës me Lumin Drini i Zi. Do shkaktonte përmbytje minimale kryesisht në zonat Zall Reç e Draj Reç të Njesisë administrative të Reçit, si dhe dëme të vogla në periferi të fshatit Lugje dhe afër qendrës së Njesisë administrative të Zall Dardhës.

Po ashtu pata propozuar edhe digën e dytë po në lumin Drini i Zi, aty ku fillon ngushtimi i grykës së lumit në fjalë, mbi Urën automobilistike që lidh fshatin Katund i Ri me pjesën matanë lumit, diku në afërsi të fshatit Selane. Kjo propozohej të ndërtohej me një lartësi dige 30 - 35m. Niveli i liqenit nëse do ndërtohej, ashtu si dhe ai i digës së Tejdri, shkaktonte dëme të vogla, në rrethinat e fshatit Gradec të Njesisë administrative Maqellarë.

Megjithatë, pata theksuar në artikull, edhe pse dëmet do të ishin minimale në raport me dëmet katastrofike që do të shkaktonin digat e larta që propozonte qeveria e asaj kohe (të cilat do të zhduknin Dibrën duke e mbuluar me ujë mbi 80 % të "hambarit të saj"), këto variante nuk duhej të miratoheshin as të zbatoheshin, pa u kryer më parë studimet përkatëse komplekse shkencore etj. Po ashtu nënvizoja dakordësinë me popullatën e zonave që do të përmbyteshin, duke e mbyllur shkrimin: Ilogaritë për ndërtimin e dy HC-ve në fjalë duhet të bëhen me "hanxhinë", jo pa u pyetur atë, pra jo pa u marrun vesh me të zotët e tokës.

Edhe për këto variante që publikova në shtypin e kohës, u përballa me kritika të ashpra e të shumta, sidomos nga disa specialistë e gazetarë shumë të njohur të trevës së Dibrës. Më duhet të theksoj se unë, vite më vonë, fillova të reflektoj dhe të ndërroj mendje duke përkrahur alternativat e reja të prodhimt të energjisë elektrike. Arritjet e shkencës dhe përlllogaritjet shkencore ekonomike, duhet të prevalonin mbi interesat e çastit në zhvillimin e vendit, që nguten të programojnë qeveritë e rradhës të sapo ardhura në pushtet.

Pas përfundimit të rrugës së Arbërit deri në qytetin e Peshkopisë dhe asaj të Lurës deri tek lidhja me Varrezat e Arrasit, në pranverën e vitit 2025, siç është thënë e deklaruar në media nga ministria e linjës, qeveria duhet t'i kthejë sytë nga Dibra.

Jo të ndërtojë hidrocentralin dhe të vazhdojë ti mbajë në ankth e frikë banorët me "Gogolin Skavica" në mënyrën më të padrejtë, duke ju mohuar ardhmërinë dhe liritë themelore të jetës, duke ju mbuluar

me ujë vendlindjen dhe vendbanimet e tyre mijravjeçare.

Ajo duhet të bëjë të kundërtën, të jetë prezente me programe e projekte zhvillimore, të mirëstudiuara e të konsultuara me specialistët më të aftë në zonë dhe në vend, për krijimin e kushteve të mira për jetesë. Të paraprijë me investime prodhuese, me krijimin e kushteve të përshtatshme për një turizëm malor, kulturor e historik gjithëvjetor; me vepra të tjera infrastrukturore të nevojshme e të domosdoshme; me investime urgjente në bujqësi për të cilat ka aq shumë nevojë ajo trevë e lënë pas dore, për fat të keq edhe në vitet e demokracisë (ish pararoja e frutikuturës, misrit, patates, blegtorisë etj., në gjithë vendin).

Kështu mund të përmendim rikonstrukcionin dhe asfaltimin e rrugës për në Zall Dardhë e Reç dhe, vazhdimin e saj deri në Gjurrë Reç, Arrëmollë, Pregjë e Krejë Lurë, për tu lidhur me rrugën e re Përlat - Lurë, një rrugë e cila pritet të përfundojë në fundin e vitit 2024 dhe që do ketë ndikim të jashtëzakonshëm në rigjallërimin e jetës në ato treva.

Po ashtu rikonstrukcionin e asfaltimin e rrugës nga Muhurri për Selishtë e fshatrat për rreth saj si dhe, lidhjen me zonën e Lisit të Burrelit, një rrugë e hapur që në kohën e mbretit Zog.

Këto janë investime jo të kushtueshme sipas meje, nuk janë autostrada, as nuk kanë dimensionet e rrugës së Arbërit. Përgjithësisht ato janë rikonstrukcione rruge me gjërësi nga 4 - 4.5 m, të cilat do të kenë impakt të madh në zhvillimin ekonomik të zonave rurale të Dibrës, duke gjallëruar edhe kërkimin dhe shfrytëzimin e pasurive minerale të kromit, mermereve etj. për të cilat i ka tërhequr vëmendjen kohët e fundit vendit tonë edhe Bashkimi Evropian.

Jo më kotë shprehja "rruga sjellë zhvillim" tashmë është një aksiomë. Këto investime do frenojnë pikësëpari largimin e të rinjve nga vendlindja dhe boshatisjen e fshatit, një dukuri negative që mund të shdërrohet në tragjedi po nuk u morën me kohë masat e duhura në investime. Dhe kjo nuk është pak, por një hap vendimtar e me rëndësi, drejt përparimit e prosperitetit të zonës.

Nga ana e qeverisë shqiptare është shpallur me bujë e krenari se ndërtimi i hidrocentralit në fjalë do të sjellë "një sërë të mirash për Shqipërinë dhe për Dibrën", pasi ta mbulojë atë me ujë. Ajo vazhdon të mos jetë transparente me popullatën e zonave që do të përmbytet, krahinë ku ka rrënjët, ka lindur dhe është rritur edhe heroi ynë kom-

Arritjet e shkencës dhe përlogaritjet shkencore ekonomike, duhet të prevalonin mbi interesat e çastit në zhvillimin e vendit, që nguten të programojnë qeveritë e radhës të sapo ardhura në pushtet.

për ta mbuluar me ujë, por për ta "mbuluar" me investime

Vendi ku kohët e fundit janë kryer punimet e studimit për digën, nuk është pjesë e territorit të fshatit Skavicë, pra e bashkisë Kukës, por është pjesë e fshatit Qafë Draj, Njësia administrative e Reçit, dhe e ka emërtimin Suka e Trocit apo Shullani i Trocit. Kjo nënkupton se leja për të kryer punimet duhet të jetë lëshuar nga bashkia Dibër. Përshtjellimi që ka krijuar emri Skavicë lë të kuptohet se HC-i do të ndërtohet në territorin e bashkisë së Kukës dhe jo në territorin e bashkisë Dibër.

bëtar, Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Unë nuk dua të bëj historianin, dhe as nuk marrë përsipër gjëra që nuk i di, por shenjat për këtë hero që i kalon kufijtë e kombit tonë, nuk duken në terren ose e thënë ndryshe pothuajse mungojnë nga qeveria qendrore. Ato pak përmendore të ngritura në disa vende të spikatura, janë shënuar në terren falë kontributit të shoqatave të ndryshme atdhetare, individëve apo disa drejtuesve të qarkut dhe bashkisë, po jo nga qeveria qendrore apo ministritë e linjës.

Nuk e kuptojmë indiferentizmin rreth vendlindjes së heroit tonë kombëtar!

Këtë dua ta them me aq zë të lartë, sa të dëgjohet nga Çidhna e deri në sheshin Skënderbeu në Tiranë.

Kur ishte ministere kulture znj. Mirela Kumbaro, çdo dy ditë e shikonim në televizion të krenohej për restaurimet që bëheshin në disa zona në Libohovë, në Gjirokastrë apo gjetkë. Dhe bënte mirë. Nuk di a ka dhënë ndonjë fond asokohe edhe për restaurimet në Dibër, por dimë se nuk ka dhënë asgjë sa lidhet me historinë e Dibrës...

I vetmi investim për tu shënuar në këto afro 80 vite, ishte Muzeu i Kastriotëve në Sinë, por edhe ky i realizuar në kohën e monizmit! Mendoj se jemi të vonuar për të bërë më shumë në këtë drejtim, duke filluar me kompozimin e një kompleksi historik në zonën në fjalë me qendër në Arras (Kompleksi historik i Arrasit, shiko grafikët dhe fotot që shoqërojnë shkrimin), me që rruga e ndërtuar e favorizon një gjë të tillë. Propozimi i z. A. Ashiku vite më parë, një gazetar i mirënjohur në Dibër e më gjërë, duhet vlerësuar e mbështetur, për të ngritur një shtatore të Skënderbeut mbi kal, iden si në qendër të Tiranës, në majën e Thekanushit me naltësi 517m mbi nivelin e detit. Nga kjo kodër e rrumbullakosur e strategjike duket pothuajse gjithë Dibra, dhe shtatorja do ketë përballë si fshatin Kastriot ashtu dhe fshatin Sinë, dy vendbanimet e familjes së madhe të Kastriotit. Nga Varrezat e Arrasit e deri tek monumenti i shtatores nuk është më shumë se 400 m rrugë për tu rikonstruktuar dhe asfaltuar, me gjërësi rreth 4m dhe me sistem shkallor ngjitje, aty ku ndalon rruga e makinës e deri tek monumenti i ardhshëm i heroit legjendar në majën e kodrës në fjalë, i cili duhet të shikohet edhe nga sateliti. Rrugës nga Peshkopia për në fshatin Arras, në mesin e saj në të djathtë, në fshatin Kastriot është ngritur një përmendore kushtuar familjes së Kastriotëve, në nderim të Gjergj Kastriot Skënderbeut. Në vijim, pa kaluar urën mbi Lumin Drini i Zi, në rrëzë të Kodrës së Honeve, në fshatin Laçes, ngjitur me rrugën (afër xhamisë së fshatit), përballë me Majën e Thekanushit ku propozohet vendosja e shtatores së heroit tonë kombëtar, është ngritur një tjetër kompleks – një përmendore e madhe në përkujtim



të Betejës së Torviollit (i ideuar nga piktori dhe ekonomisti i njohur Huzri Hoxha) dhe luftrave për liri e pavarësi (shiko grafikun ilustrues).

Nga Arrasi e deri tek Muzeu i Kastriotëve në Sinë mund të rikonstruktoret dhe asfaltohet rruga për rreth dy km gjatësi dhe gjërësi 3-4m me asfalt, për ta bërë lehtësisht të vizitueshme në çdo kohë për turistët vendas dhe të huaj (këtu dua të rikujtoj se ka një vendim të qeverisë Rama të vitit 2018 për ta asfaltuar rrugën nga Arrasi deri tek Muzeu në fjalë në Sinë të Poshtme, por akoma nuk është bërë realitet).

Një lapidar tjetër mendoj se duhet vendosur aty ku fillon ndarja e rrugës automobilistike Arras Lurë me Rrugën e Rinisë Peshkopi - Kukës, në përkujtim të Fillimit të Kryengritjes së Përgjithshme në datat 26 dhe 27 mars, të vitit 1912, nën udhëheqjen e atdhetarëve të mirënjohur Selman Alia dhe Elez Isufi, kundër garnizonit të Perandorisë Osmane, i stacionuar në Çukë të Lushës në fshatin Arras, në afërsi të fshatit Kodër Leshe,

Po në këtë zonë, mund të rikonstruktoret një rrugë makine apo këmbësore rreth 200 m për tu vizituar ndërtesa ku ka patur selinë Qeveria e Arrasit në vitin 1920 (në Kullën e atdhetarit Riza Vesel Lusha, e cila ka nevojë që të rindërtohet e të kthehet në një muzeum për zhvillimet e kohës.

Para ka kohësh, më tërhoqi vëmendjen një koment në rrjetet sociale i ish ministrit të brendshëm gjeneralit Sandër Lleshi, në lidhje me restaurimin e Kullave në Shqipëri.

Jo të ndërtojë hidrocentralin dhe të vazhdojë ti mbajë në ankth e frikë banorët me "Gogolin Skavica" në mënyrën më të padrejtë, duke ju mohuar ardhmërinë dhe liritë themelore të jetës, duke ju mbuluar me ujë vendlindjen dhe vendbanimet e tyre mijravjeçare.

Ajo duhet të bëjë të kundërtën, të jetë prezente me programe e projekte zhvillimore, të mirëstudiuara e të konsultuara me specialistët më të aftë në zonë dhe në vend, për krijimin e kushteve të mira për jetesë. Të paraprijë me investime prodhuese, me krijimin e kushteve të përshtatshme për një turizëm malor, kulturor e historik gjithëvjetor; me vepra të tjera infrastrukturore të nevojshme e të domosdoshme; me investime urgjente në bujqësi për të cilat ka aq shumë nevojë ajo trevë e lënë pas dore, për fat të keq edhe në vitet e demokracisë (ish pararoja e frutikuturës, misrit, patates, blegtorisë etj., në gjithë vendin).



MUZEU I KASTRIOTËVE – SINË E POSHTME

GJONI, PALI DHE GJERGJ KASTRIOTI

ngritur me nisëativën e z. Mustafa Tola në kohën e monizmit që në vitin 1987, por që ka nevojë për rikonstrukcion.

Pa folur për monumentet e natyrës në lumin e Setës si Gryka e Setës, Burimin, Shpellën dhe Ujëvarën e Sopanikës, Burimin e Resnës, etj. Me mjaftë interes e shikoj propozimin e vendasve për ndërtimin e një teleferiku nga Çidhna e Poshtme (Shtegu i Nuses në hyrje të Gjalicave), për në Qafë Kala (vendi ku ndodhet Kalaja e fshehtë e Skënderbeut).

Ndërtimi e sistemin i një rruge të shkurtër këmbësore nga fshati Çidhën në fshatin Gur Lurë, dhe më tej ndërtim i një teleferiku deri tek qendra e 14 Liqeneve akullnajorë të Masivit Ultrabazik të Lurës (7 janë në këngët popullore).

Kështu ai vend historik dhe strategjik do të rilind dhe, do të kthehet në një atrakcion turistik gjithëvjetor të pa parë në vendin tonë, falë favorizimeve të relievit madhështor e klimës, bukurive të rralla natyrore e peisazheve tejet të veçanta mahnitëse, monumenteve të shumta natyrore e Parkut Kombëtar Lurë-Dejë, që premtojnë mundësi shumë të mëdha për zhvillimin e turizmit malor, historik e kulturor. Nga 12 shtigje turistike që ka gjithë bashkia e Dibrës, 3 të tilla kalojnë në rajonin Arras-Lurë, sipas një harte të publikuar për këtë bashki nga USAID (2018).

Në një artikull të profesor Sazan Gurit botuar në gazetën *Telegraf*, midis njëzet arsyeve pse Skavica nuk do të ndërtohet, përmenden dhe arsyet gjeologjike që kundërshtojnë ndërtimin e kësaj veprë. Në një intervistë dhënë nga ana ime për televizionin gjerman DV-le para disa muajsh, midis të tjerave, kam theksuar disa arsye pse nuk duhet ndërtuar diga gjigande e Skavicës.

Mund të lidhen fort brigjet e gëlqerorëve të Trias-Jurës gjatë ndërtimit të saj, por anë e tjera të digës në vazhdimësinë dyanësore të saj janë tejet të pa sigurta, pa u futur në hollësira profesionale. Prania e disa tektonikave ndërformacionale, bazuar në njohjen që kemi për ndërtimin gjeologjik të zonës së digës, dukurive karstike, rrudhosjeve të formacioneve mesozoike e paleozoike, prania e disa rrëshqitjeve të shpateve etj, jo vetëm që nuk flasin në favor të ndërtimit të HC-it të ashtuquajtur Skavica, por përkundrazi, paralajmërojnë dukuri natyrore me pasoja katastrofike, për të mos thënë apokaliptike, me rrezik kombëtar e ndërkombëtar. Është momenti i duhur për anulimin e këtij projekti ogurzi me shumë pasoja negative e komplekse, duke qetësuar një herë e mirë popullatën vendase dibrane dhe opinionin e gjerë që të mos largohet nga ajo trevë nga frika e Gogolit Skavica, duke i kërkuar publikisht qeverisë Shqiptare që jo vetëm të anulojë punimet për ndërtimin e hidrocentralit, por të ndërroj kursin 180° shkallë, duke i kthyer sytë nga Dibra e Skënderbeut jo për ta mbuluar me ujë, por për ta "mbuluar me investime" për zhvillimin e saj, duke e parë atë si themel i shtetformimit, si vendbanim i Kastriotëve dhe vendlindje e të madhit Skënderbeu.

Unë parashtrua disa mendime tejet të përgjithshme e modeste në lidhje me sa trajtuam më sipër, por vendimtare do të jenë veprimet konkrete të bashkisë së Dibrës, e cila në bashkëpunim me qeverinë qendrore, fondin shqiptar të zhvillimit dhe organizma të tjera apo fondacione të ndryshme, duhet të paraprijë e të përgatisin projekte të shumta zhvillimore që ajo i gjykon të nevojshme e të dobishme për zhvillimin e Dibrës dhe përmirësimin e jetës së banorëve të saj, duke stimuluar investimet prodhuese dhe punësimin.

Cfarë e pengon qeverinë që të vijë të bëjë dëgjesa publike, para se të mbarojë studimet mjedisore? Ne, në këtë situatë, edhe po paragjykojmë studimin mjedisor, por ne kemi të gjithë të drejtën ta paragjykojmë përderisa askush nuk merr përsipër t'i dëgjojë këta banorë. Qeveria po shikon vetëm interesat e saj dhe investitori po shikon vetëm interesat e tij...

reportazh

Drini i Zi – bekim apo mallkim?

Banorët e Luginës së Drinit të Zi kundërshtojnë prej vitesh ndërtimin e hidrocentralit të Skavicës. Nëse ky projekt do të realizohej, do të fundoste mbi 30 fshatra e do të izolonte dhjetëra të tjerë.

Nga ELONA ELEZI dhe
ESMERALDA CENOLLARI -TOPI,

Fushë-Alia është një ndër fshatra më pjellorë të Luginës së Drinit të Zi, në Dibër. Por tokat bujqësore me prodhim të bollshëm drithërash, frutash dhe perimesh, rrezikojnë fundosjen nga ujërat e lumit të Drinit të Zi. Në rast se do të ndërtohej hidrocentrali i Skavicës, ai do të zhdukte nga harta dhe do të izolonte gati 40 fshatra të këtij rajoni. “Kjo ka të bëjë me shpërngulje masive të popullatës, jo tri shtëpi, jo katër shtëpi, jo një fshat por mbi 30 fshatra që do të shpërngulen. Problemi më i keq i mundshëm është problemi psiko-social i njeriut. Njerëzit mendojnë: kush isha, çfarë isha, si e kisha ndërtuar jetën dhe ku përfundova tani. Pa folur edhe për anën ekonomike, që është shumë e rëndësishme. Këtu kanë jetuar, kanë banuar, kanë ndërtuar paraardhësit tanë. Edhe unë kam punuar një jetë të tërë, kam ndërtuar shtëpinë nga bujqësia, ndërsa tani... asgjë. Është një lloj sikur i vë flakën, u dogj, nuk ka asgjë” – thotë Dalip Alia, banor i fshatit.

Në rastin më të mirë, ndërtimi i Skavicës nënkupton zhvendosjen e më shumë se 8000 banorëve të zonës, pasi uji do të përpinte një sipërfaqe prej 52 km/katror. Madje, përveç fshatrave që do të fundoseshin, dhjetëra të tjerë do të izoloheshin e do të vuanin pasojat të rënda. Një prej tyre do të ishte edhe Çidhna. Për Selim Dacin, rritës bletësh dhe agronom, në rast ndërtimi të Skavicës, ai do ta linte gjithashtu fshatin e tij. “Këtu



Ndërtimi i Skavicës do të sjellë shpërngulje masive të popullatës. Fotografi: Kristi Çavo

mjegulla ka shumë vite që zgjat 8-9 ditë, ose 10 ditë, gjatë një periudhë të pandërprerë. Duke ardhur edhe Skavica, mjegulla do të shtohet. Duke u shtuar, bujqësia bie në zero. Pra, fillojnë e prishen perimet, prishen vreshtat, prishen mollët, kumbullat... prishen dhe bletët. Edhe nëse do të ngjiteshim në mal, edhe atje prishen, edhe atje dëmtohen” – shprehet i shqetësuar.

SKAVICA, ENDE NJË “ËNDËRR”

Skavica gjendet në qarkun e Kukësit, por pasojat e hidrocentralit që planifikohet të ndërtohet atje, mbi lumin Drin, do të ndihen në Dibër, qarkun me të cilin kufizohet. Fillimisht projekti u mbështet nga Fondi i Investimeve të Ballkanit Perëndimor (ËBIF) dhe këto ishin dy skenarët që ju prezantuan publikut: Skavica e madhe do të kushtonte 510 milionë euro, me një lartësi dige 443 metra mbi nivelin e detit, ose versioni tjetër do të ishte në vlerën 308 milionë euro, me një lartësi dige 388 m mbi nivelin e detit. Më 3 qershor 2020, gjatë një prezantimi të projektit fillestar, ministrja e Infrastrukturës dhe Energjisë, Belinda Balluku, shprehej shumë entuziaste për projektin. “Në 2017 qeveria shqiptare aplikon në ËBIF, për fondin e ËBIF për

të bërë një studim të mirëfilltë të këtij projekti. Duke na dhënë sot një rezultat në duart tona, fazën e parë të këtij projekti i cili na ofron disa nga skenarët për realizimin e kësaj ëndrre të madhe.”

Por ëndrra që nisi nga Europa, papritmas përfundoi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Vjeshtën e vitit 2020, qeveria nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me amerikanët e kompanisë “Bechtel” për Skavicën. Në marrëveshje, Bechtel angazhohej të gjente financimin e një linje kredie e cila më pas do të paguhej nga KESH. Dalja në skenë e amerikanëve, shkaktoi pakënaqësi në Bruksel. Në janar të 2021 Bashkimi Europian u tërhoq zyrtarisht nga financimi i Skavicës, ndonëse kishte dhënë 1.5 milionë eurot e para në formën e një granti nga Fondi i Investimeve të Ballkanit Perëndimor. Dy vite më pas, një zëdhënës i Komisionit Europian iu përgjigj kështu interesit tonë: “Projekti i hidrocentralit të Skavicës, i cili është duke u përgatitur, pritet që ketë një ndikim madhor në mjedis dhe në situatën socio-ekonomike të zonës. Projekti ndikon gjithashtu tek popullatat e rreqebullit të Ballkanit, i cili e përdor këtë korridor për të migruar mes Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut.”

Por qeveria asokohe dukej e pashqetësuar dhe vijoi planin e

Skavicës me amerikanët. Verën e vitit 2021, Bechtel firmos një kontratë të miratuar me procedurë të veçantë nga Kuvendi, por pa garë me Korporatën Elektroenergjetike Shqiptare. Qeveria dhe amerikanët zgjodhën skenarin e Skavicës së madhe, me një lartësi dige 443 metra mbi nivelin e detit dhe kosto totale 510 milionë euro.

Inxhinieri gjeolog, Vesel Hoxha, thotë se mundësia më e mirë do të ishte që diga të mos ndërtohet, pasi nuk jep siguri. “Qeveria po punon për digën 443 metër. Edhe pse nuk ka fare transparencë. Edhe pse unë jam një specialist shumë i njohur me zonën, nuk e di dhe unë me saktësi ku është diga. Sepse nuk e jep, nuk e jep askush. Nuk ka koordinata, që të thonë: “Diga do të ndërtohet në këtë vend”. Por nisur nga punimet që janë kryer në terren, për kuriozitet kam vajtur disa herë, dhe nga ajo mësoj se ku mund të ndërtohet diga. Nisur nga këto rrethana konkrete dhe nga vrotimet që kam bërë në terren, mund të them që zona ku ata parashikojnë të ndërtojnë digën, është një zonë e rrezikshme nga ana gjeologjike. Jo vetëm që nuk garanton siguri, por është një zonë me shumë tektonika. Mundësia që diga të çahet, nga presioni i madh i liqenit të ardhshëm që do të krijohet, është shumë e madhe. Gjëja kryesore e një dige të hidrocentralit është siguria. Nëse diga nuk ka siguri, hidrocentrali nga një prodhues i energjisë elektrike dhe fitimprurës, kthehet në një tragjedi. Në të gjithë kaskadën e Drinit ndodh efekti domino. Po u çahet e Skavicës, për pasojë të gjitha digat e tjera shembin njëra-tjetrën dhe krijohet një rrezik jo vetëm kombëtar, por dhe ndërkombëtar” – argumenton inxhinieri Hoxha.

KUSH FITON DHE KUSH HUMBET?

Për Bujar Karoshin, gazetar dhe botues i gazetës lokale “Rruga e Arbërit”, edhe banorët po përballeshin me terr informativ, me të cilët nuk janë bërë ende dëgjesa publike. “Një nga arsyt se pse nuk janë bërë dëgjesa publike, thotë qeveria, është se ‘ne nuk i kemi mbaruar studimet tona mjedisore dhe kur ne t’i mbarojmë studimet tona mjedisore, do të



MAJLINDA HOXHA, aktiviste: “Përveçse kemi humbur, nuk kemi fituar deri tani. Nuk kemi fituar as energji elektrike, me thënë të drejtën. Sepse nëse më herët ka pasur gjithmonë shkëputje, se dihet si ka qenë historia e Shqipërisë pas viteve ‘90, në Dibër vazhdon akoma që të ketë herë pas here shkëputje të energjisë elektrike. Kështuqë nuk jemi ne ata të parët të cilët përfitojmë nga këto hec-e. Ato që përfitojnë janë thjesht korporatat, kompanitë të cilat ndërtojnë dhe e përdorin këtë energji elektrike për tregti, për shitblerje, duke shfrytëzuar natyrën edhe resurset që kemi ne.

vijmë të bëjmë dëgjesa publike’. Po mirë, çfarë e pengon qeverinë që të vijë të bëjë dëgjesa publike, para se të mbarojë studimet mjedisore? Sepse ndoshta nga këto dëgjesa publike do të dilte e nevojshme që studimet mjedisore të merrnin konkluzionet e duhura. Ne, në këtë situatë edhe po paragjykojmë studimin mjedisor, por ne kemi të gjithë të drejtën ta paragjykojmë përderisa askush nuk merr përsipër t’i dëgjojë këta banorë. Pra është një proces që duhet krijuar hap pas hapi dhe i gjithanshëm. Qeveria po shikon vetëm interesat e saj, dhe investitori po shikon vetëm interesat e tij” – argumenton ai.

Të njëjtin mendim ka edhe Majlinda Hoxha, aktiviste prej rreth 3 vitesh e kauzës. Ajo ka qenë dëshmitare se si burimet hidrike të fshatit ku u lind dhe rrit, janë shfrytëzuar gjithmonë nga biznese vendase dhe të huaja për përfitime madhore, ndëkohë që dibranët kanë mbajtur mbi supe vetëm pasojat negative. “Përveçse kemi humbur, nuk kemi fituar deri tani. Nuk kemi fituar as energji elektrike, me thënë të drejtën. Sepse nëse më herët ka pasur gjithmonë shkëputje, se dihet si ka qenë historia e Shqipërisë pas viteve ‘90, në Dibër vazhdon akoma që të ketë herë pas here shkëputje të energjisë elektrike. Kështuqë nuk jemi ne ata të parët të cilët përfitojmë nga këto hec-e. Ato që përfitojnë janë thjesht korporatat, kompanitë të cilat ndërtojnë dhe e përdorin këtë energji elektrike për tregti, për shitblerje, duke shfrytëzuar natyrën edhe resurset që kemi ne.

Por kauza e ka shënuar fitoren e parë. Gjykata Kushtetuese ka pranuar padinë e shoqatave “Për

“Anëtarësimi në Bashkimin Europian nuk është i mundur nëse një shtet nuk aplikon kriteret europiane... Në rastin e Skavicës shohim një sërë shkeljesh të ligjit kombëtar por edhe ligjit të BE-së... Qeveria shqiptare po injoron në mënyrë të dukshme një rekomandim të qartë dhe të fuqishëm të Konventës së Bernës. Dhe nëse një vend kandidat për në BE, haptazi injoron rekomandimet e një traktati ndërkombëtar, atëherë kjo është një përgjigje edhe për politikëbërësit në Bashkimin Europian, dhe unë mendoj që është mungesë besimi se qeveria shqiptare nuk ka vullnetin për të pranuar rregullat europiane. Pra, jam absolutisht i bindur: ka një ndikim madhor në rrugën e mëtejshme të anëtarësimit të Shqipërisë” – argumenton Gabriel Schäderer, Drejtor Ekzekutiv i EuroNatur.



Organizatata mjedisore duke protestuar. Fotografi: Elona Elezi

debat



Inxhinieri gjeolog, VESEL HOXHA:

“Qeveria po punon për digën 443 metër. Edhe pse nuk ka fare transparencë. Edhe pse unë jam një specialist shumë i njohur me zonën, nuk e di dhe unë me saktësi ku është diga. Sepse nuk e jep, nuk e jep askush. Nuk ka koordinata, që të thonë: “Diga do të ndërtohet në këtë vend”. Nga vrojtimit që kam bërë në terren, mund të them që zona ku ata parashikojnë të ndërtojnë digën, është një zonë e rrezikshme nga ana gjeologjike. Jo vetëm që nuk garanton siguri, por është një zonë me shumë tektonika. Mundësia që diga të çahet, nga presioni i madh i liqenit të ardhshëm që do të krijohet, është shumë e madhe. Gjëja kryesore e një dige të hidrocentralit është siguria. Nëse diga nuk ka siguri, hidrocentrali nga një prodhues i energjisë elektrike dhe fitimprurës, kthehet në një tragjedi.”

Mbrojtjen e Pronave dhe Mjedisit të Pellgut të Drinit të Zi” dhe “Kundërshtimi ndaj Digës së Skavicës”, për rishqyrtimin e ligjit për ndërtimin e hec-it të Skavicës nga kontraktori amerikan “Bechtel”. Të mbështetur nga një sërë organizatash vendase si dhe nga organizatat ndërkombëtare mjedisore CEE Bankatch dhe EuroNatur, paditësit pretendojnë se projekti shpërfill ndikimet në mjedis dhe është anashkaluar konkurrenca e hapur dhe procedura e prokurimit.

PARASHIKIMET PËR TË ARDHMEN

Kushtetuesja nuk është e vetmja fitore e këtyre njerëzve. Projekti i prezantuar me pompozitet, e ka humbur shkëlqimin e tij. Skavica po shoqërohet me zvarritje dhe shkelje afatesh. Plani i qeverisë për të hapur kantierin e punimeve këtë nëntor ka dështuar. Koorporata Elektroenergjitike Shqiptare dhe Kompania Bechtel ende nuk

kanë bërë publik studimin e fizibilitetit, çka nënkupton se në 3 vite nuk është përmbyllur ende faza e parë e projektit. Asnjë prej palëve përgjegjëse nuk l është përgjigjur kërkesave tonë për informim. Por burime nga KESH pranojnë se Skavica ka mbetur në vend numëro për shkak të kostove të kripura. Në një përllogaritje paraprake, amerikanët e Bechtel e kanë dyfishuar koston nga 510 milionë euro në 1 miliardë euro.

Organizatat mjedisore ndërkombëtare e shohin mjedisin të rëndësishëm edhe për fatin e anëtarësimit të vendit në BE. “Anëtarësimi në Bashkimin Europian nuk është i mundur nëse një shtet nuk aplikon kriteret europiane. Kapitulli i Mjedisit, Kapitulli 27, është një ndër më të vështirët për t’u përmbushur nga vendet candidate. Dhe nga ajo çfarë shohim me Shqipërinë është se nuk është e vështirë që direktivat mjedisore të përgatiten, zbatohen etj, por gjithçka lidhet me sundimin e ligjit. Dhe ajo çka shohim në rastin e Skavicës, ku shohim një sërë shkeljesh të ligjit kombëtar por edhe ligjit të BE-së, po ndodh edhe me aeroportin e Vlorës. Edhe në këtë rast shohim që qeveria shqiptare po injoron në mënyrë të dukshme një rekomandim të qartë dhe të fuqishëm të Konventës së Bernës. Dhe nëse një vend kandidat për në BE, haptazi injoron rekomandimet e një traktati ndërkombëtar, atëherë kjo është një përgjigje edhe për politikëbërësit në Bashkimin Europian, dhe unë mendoj që është mungesë besimi se qeveria shqiptare nuk ka vullnetin për të pranuar rregullat europiane. Pra, jam absolutisht i bindur: ka një ndikim madhor në rrugën e mëtejshme të anëtarësimit të Shqipërisë” – argumenton Gabriel Schäderer, Drejtor Ekzekutiv i EuroNatur.

Banorët nuk e humbin shpresën se do ta fitojnë këtë betejë. “Unë e shikoj gjithmonë optimiste sepse nëse do ta shikoja pesimiste, nuk do të isha këtu. Dhe optimizmin kryesor ma japin banorët e fshatrave, se kur shikoj se sa vulnerabël janë, që duan të flasin, duan t’u dëgjohet zëri, por duan të kenë dikë që të konsultohen, të organizohen për të gjetur mënyrën e duhur. Dhe Drinin ne e kemi pasur gjithmonë bekim dhe besoj që do të vazhdojë të jetë bekimi i dibranëve dhe gjithë zonës së Dibrës” – përfundon Majlinda Hoxha.

Marrë nga Deutsche Ëelle në shqip. Ky hulumtim u realizua nga gazetaret Elona Elezi dhe Esmeralda Cenollari -Topi, me mbështetjen e Journalismfund Europe.

Editor: Pandeli Pani
Për të ndjekur videon e plotë ndiq linkun më poshtë ose skano:

<https://www.facebook.com/dw.shqip/videos/631725785838598/>



MEDITIM

Drini i Zi që zhyt e mbyt... dhe Shushica që than tokë e djeg xhanë



Në një tubim partiak në Athinë, drejtuesi i një partie që aspirojnë se “Shqipëria bëhet” foli për Lumin e Vlorës me pasion...

I thashë ngre zërin për Skavicën përndryshe hap vend për 35 mijë familje që do të mbërrijnë pas katastrofës dibrane siç mbërrijnë kur u dëbuan me dhunë barbare nga serbi në vitin 1913-1922.

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Në Shqipëri ka rënë kolera e ndërtimeve e shkatërtimeve.

Nga Veriu në Jug, nga Lindja në Perëndim.

Po nuk u bënë bashkë shqiptarët...

Edhe për Shushicën,

Edhe për Valbonën,

Edhe për Drinin,

Edhe për Dibrën,

Edhe për bregdetin,

Edhe për hidrocentralët në rrjedhën e një “çezme”

Edhe për tokën...

“Murtaja” do të trokasë në çdo shtëpi...

Në çdo individ...

Një miku im i mërgimit: universitar në letërsi, mësues në shkollën e mesme në Shqipëri, poet, shkrimtar, publicist, dhulos në Greqi, (si dhe unë), lindur në një fshat të Lumit të Vlorës, në muzeun e të cilit shkruhet se “Tërbaçi e ka origjinën nga fshati Tërbaç i Dibrës”, më ishte qepur fort me komente në shkrimet e mia të shumta (dhe me një libër) për mbytjen e Dibrës.

Si një refren kënge të gjithë komentet e tij në thelb ishin një:

“Le të mbytet Dibra që të marrë dritë Shqipëria”.

Unë e pyesja:

“Çfarë do të thuash ti sikur në Brataj të Lumit të Vlorës të ngrihet një digë e lartë dhe uji të mbyset gjithë luginën (edhe Tërbaçin tënd) e pasqyra e liqenit të ketë breg kulmor Kuçin?”

Nuk përgjigjej.

Edhe unë nuk do t’i përgjigjesha...

Shuarja nga robi (jo nga Zoti) i vendit të lindjes, vendit ku ecur zbathur, të janë mbushur këmbët me gjemba, ke mësuar gërmat e para të gjuhës së nënës, vendi që një ditë e le për të mësuar dhe çdo kthim të zgjon kujtime të bukura, të dhemb kur dikush donë të ta marrë, të ta mbyset, fytyrën të ta thajë...

Por ja që Edi Rama “nip në Vuno” – (titull i një shkrimi tim) – nuk ka plan ta mbyset luginën e bukur të Lumit të Vlorës, luginë që e kam jetuar në verën e vitit 1962, fshat më fshat, në studim të tokave acide të Shqipërisë, e që ruaj kujtime të bukura.

Edi Rama e ka mendjen, jo ta mbyset, por ta thajë: “Jeto tokë çarë e buzë tharë...Unë do ta marr ujën për “dajat” e mi në Vuno paçka se do të ndezë etjen e dhive dhe deleve, të pulave e lopëve, ta thajë e bëjë “kashtë e koqe”, misrin, grurin, pemët, perimet...”

Unë Dibrën e kam mbrojt dhe do ta mbroj deri sa të jem gjallë edhe pse nuk më mbytet asnjë pëllëmbë truall i paraardhësve të mi.

Edhe pse eshtrat e të parëve të mi nuk do t’i lëvizë kush nga trojet e veta.

Për mua është krimi më i madh që i bëhet një treve të lashtë, që zhyt e mbyt përgjithmonë vlera të tilla që do ta bënin krenar çdo komb të botës, vlera që janë të lidhura me Gjergjin e Gjon Dibranit – Skënderbeun.

Vlera të pa llogaritshme të lidhura me ekonominë, bujqësinë, blegtorinë, kulturën, artin, të kaluarën e

largët, të tashmen...

Kjo, për mos me folë për 65 kilometra katrorë tokë nga më pjelloret e vendit e mërgimin si “Çifutët në shkretëtirë” të dhjetëra mijëra banorëve...

E patën provuar egërsisht dibranët dhunën shkombëtarizuese serbe në vjeshtën e vitit 1913 kur kaluan Drinin futur fëmijët dy nga dy në koshat e kalit (sipas një interviste) e u vendosën në trojet bujare të Tiranave.

E provuan kur, siç më shkruante Argëtim Fida, kryetar i komunës së Dibrës në Maqedoni... “... nga ndërtimi i liqenit artificial të Dibrës dhe hidrocentralit të Shpiles nuk panë asgjë të mirë për këto 40 vjet pas humbjes të rreth të 5000 hektarë të tokës më pjellore dhe që vaditej nga dy lumenj, burimi kryesor i ekzistencës të numrit më të madh të familjeve dibrane.

Sot të mirat nga prodhimi i rrymës përfitohen vetëm nga qeveria maqedone që nuk do të ja dijë nëse këto familje u detyruan të largohen në Turqi ose ShBA për të siguruar ekzistencë.”

Nuk dua që Lumi i Vlorës të thahet...

Nuk dua që në çdo “çezmë” të vihen tuba e të ngrihet një hidrocentral duke tharë toka e çarë buzë njerëzore për një pikë uji në zhegun e vapës.

Nuk dua që natyra e bukur e Shqipërisë, që nga bregdeti në majën e Korabit të shkatërrohet.

Bollë e shkatërruam vendin, boll i premë dhe shkullëm pyjet, pemët, bregdetin, fushat, malet...

Në një tubim partiak në Athinë, drejtuesi i një partie që aspirojnë se “Shqipëria bëhet” foli për Lumin e Vlorës me pasion...

Ishte nga jugu ekstrem i Shqipërisë...

I thashë ngre zërin për Skavicën përndryshe hap vend për 35 mijë familje që do të mbërrijnë pas katastrofës dibrane siç mbërrijnë kur u dëbuan me dhunë barbare nga serbi në vitin 1913-1922.

Nuk i ngjiti fjala në vesh...

Më shko mendja tek një mesele e njohur...

“Thonë që dikur në vend ra një murtajë që po shuante masivisht jetë njerëzish...

Njerëzit thanë:

Ishalla nuk bie në vendin tim...

Ra duke marrë jetë njerëzore.

Ishalla nuk bie në fshatin tim- vazhduan

Ra në fshatin e tyre...

Ishalla nuk bie në familjen time – tha

Ra në familje...

Ishalla nuk më bie mua...”

Në Shqipëri ka rënë kolera e ndërtimeve e shkatërtimeve.

Nga Veriu në Jug, nga Lindja në Perëndim.

Po nuk u bënë bashkë shqiptarët...

Edhe për Shushicën,

Edhe për Valbonën,

Edhe për Drinin,

Edhe për Dibrën,

Edhe për bregdetin,

Edhe për hidrocentralët në rrjedhën e një “çezme”

Edhe për tokën...

“Murtaja” do të trokasë në çdo shtëpi...

Në çdo individ...

Figure 1: Simulim i projektit të Skavices me dy nivele dige, 385 meter blu e theksuar dhe 450 blue e hapur. Burimi : <https://bankëatch.org/project/skavica-hydropoëer-plant-albania>, parë për herë të fundit më 08/04/2024



Nga ROLAND MARKU*

Ndërsa bota kërkon zgjidhje për të ulur emetimet e gazrave me efekt serë dhe për t'ju përgjigjur kërkesës në rritje për energji, projektet hidroenergjetike shihen gjithnjë e më shumë si një alternativë premtuese. Sidoqoftë, këto projekte nuk janë pa kundërshtime kur preken në mënyrë të drejtpërdrejt interesat e komuniteteve lokale, siç është rasti me projektin e HEC-it të Skavicës në Shqipëri. I planifikuar në lumin Drin, në zonën e Dibrës, ky projekt sjell shumë pikëpyetje në lidhje me, së pari, mungesën e transparencës në proceset e vendimmarrjes dhe së dyti, ndikimin e tij socio-ekonomik dhe mjedisor.


ANALIZË MBI EFEKTET SOCIALE, EKONOMIKE DHE MJEDISORE

Skavica është promovuar shpesh nga autoritetet publike si projekti me përfitime shumë të larta në prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe në krijimin e vendeve të punës. Megjithatë, ky investim i mundshëm lidhet gjithashtu me efekte mjaft negative si në aspektin mjedisor ashtu edhe në atë social. Këtu përfshihen: humbja e tokave bujqësore dhe zonave pyjore, prishja e ekosistemeve ujore, kërcënimi i specieve në rrezik dhe më e rëndësishmja, pasojat sociale që kanë të bëjnë kryesisht me eksodin rural dhe humbjen e formave tradicionale të jetesës. Kjo e fundit nënkupton fshirjen përfundimtare të trashëgimisë kulturore dhe historike, thënë ndryshe, gjurmët e të shkuarës do të jenë të zhdukura përgjithmonë për komunitet e prekura.

Në terma shifrash, sipas Majlinda Hoxhës, anëtare e shoqatës GARD (Grupi i Aktivistëve të Dibrës), "ndërtimi i këtij HEC-i do të çonte në përmbajtjen e rreth 35 fshatrave, në të cilët gjenden përafërsisht 5 mijë shtëpi".

Këto komunitete, të shpërngulur me forcë, do të linin pas banesat e tyre, tokat mjaft pjellore dhe burimet e tjera të jetesës, duke pasur një ndikim socio-ekonomik të jashtëzakonshëm. Ky tranzicion do të shkaktonte trauma dhe çrregullime të marrëdhënieve shoqërore, të cilat janë ndërtuar prej shumë dekadash.

Këto çështje u trajtuan me emocione të forta gjatë një proteste të mbajtur më 20 mars 2024 në fshatin Laçës. Shpëtim Buci, banor i fshatit Fushë-Allie, thekson se realizimi i HEC-it të Skavicës, nënkupton humbjen e identitetit duke u shprehur kështu: «Nëse detyrohem të shpërngulem, nuk jam më dibran. Nuk jam shqiptar nëse më përzë nga këtu. Vendlindja më bën dibran, më bën shqiptar». Ndërsa Halil Zhuka, avokat dhe anëtar i shoqatës GARD, parashikon zhdukjen përfundimtare të zonës së ulët të Dibrës: «33 fshatra të kësaj zone mbulohen me ujë dhe mbi 33 të tjerë bëhen të pa aksesueshëm, duke u detyruar të largohen, përmbysat 1/3 e tokës prodhuese dhe në këtë mënyrë shpopullohet rreth 40% e Dibrës. Kjo do të thotë zhdukje e traditës, kulturës, historisë dhe varreve të të parëve». Nga ana tjetër, Bujar Karoshi, aktivist dhe botues, mendon se vënia në jetë e këtij projekti është një strategji e paramenduar: «Që prej 10 vjetësh nuk bëhen fare investime në



MES INTERESAVE KOMBËTARE DHE SHQETËSIMEVE LOKALE:

Debati rreth projektit të HEC-it të Skavicës

bujqësi, që lidhet me ndërprerjen e burimeve ujore për vaditjen e tokave, mungesën e tregun bujqësor dhe investimeve në infrastrukturë për punimin e tokës. Qëllimi është largimi gradual në mënyrë që të ngelën sa më pak njerëz, dhe ato më të pamundurit, të cilët do ta kishin të vështirë të parandalonin këtë projekt».

PIKAT KRYESORE TË DEBATEVE RRETH KËTIJ PROJEKTI

Debatet rreth Skavicës kanë shfaqur gjithmonë tensione mes objektivave të zhvillimit ekonomik dhe nevojave për ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve lokale. Ndërsa qeveria shqiptare dhe mbështetësit e projektit prezantojnë përfitimet e mundshme ekonomike dhe energjetike, kundërshtarë, të nxitur edhe nga GARD, theksojnë rreziqet për mjedisin dhe komunitetet lokale, si dhe mungesën e transparencës në proceset vendimmarrëse.

Kontestimet kanë çuar në veprime ligjore dhe shqyrtime juridike të projektit, duke nxjerrë në pah të metat në procesin e vendimmarrjes dhe duke vënë në pikëpyetje legjitimitetin e marrëveshjes së nënshkruar me kompaninë ndërkombëtare Bechtel1. Shqetësimet kanë të bëjnë me mungesën e konsultimeve publike dhe mos pjesëmarrjen e të interesuarve lokalë në vendimmarrje, duke theksuar nevojën për një qeverisje më transparente dhe gjithëpërfshirëse në planifikimin dhe zbatimin e këtij projekti.

PROCESI VENDIMMARRËS DHE IMPLIKIMET POLITIKE

Financimi dhe realizimi i projektit të Skavicës nga ndërkombëtarët sjell pikëpyetje për sovranitetin dhe pavarësinë vendimmarrëse të Shqipërisë në fushën e zhvillimit energjetik. Ndërsa disa e shohin partneritetin me kompaninë Bechtel, si një mundësi për të modernizuar infrastrukturën energjetike të vendit dhe për të stimuluar rritjen ekonomike, të tjerë frikësohen se kjo do të sjellë një varësi të tepërt ndaj interesave të huaj dhe do të komprometojë sovranitetin kombëtar.

Sipas të dhënave të disponueshme, kostoja totale e projektit llogaritet të jetë mbi një miliard euro, duke e bërë një nga inves-

timet më të mëdha në sektorin energjetik të Shqipërisë. Megjithatë, financimi nuk është ende i siguar, duke ngritur dyshime për qëndrueshmërinë ekonomike të projektit në terma afatgjatë dhe për shpërndarjen e përfitimeve dhe kostove mes palëve të interesuara.

VLERËSIMI I RREZIQEVE DHE ALTERNATIVAVE

Një vlerësim i thellë i rreziqeve mjedisore, sociale dhe ekonomike lidhur me Skavicën është i domosdoshëm për të marrë vendime më të qarta për të ardhmen e këtij projekti. Kjo përfshin një analizë të alternativave përsa i përket energjisë së qëndrueshme, si për shembull, energjia diellore dhe ajo e erës, rinovimi i hidrocentraleve ekzistuese, të cilat mund të ofrojnë zgjidhje më të qëndrueshme për t'ju përgjigjur nevojave energjetike të vendit pa dëmtojt biodiversitetin dhe mënyrën e jetesës së komuniteteve lokale. Në këtë kontekst, drejtori i EuroNatur2, Gabriel Schädler mendon se një vend si Shqipëria që aspiron të bëhet vend anëtar i BE (Bashkimit Europian), nuk mund të implementojë projekte që janë në kundërshtim me rregullat e BE ose siç quhen «acquis communautaire». Sipas tij: «Anëtarërimi në BE nuk është i mundur nëse një shtet nuk aplikon kriteret europiane. Kapitulli i Mjedisit, Kapitulli 27, është një ndër më të vështirët për t'u përmbushur nga vendet kandidatë. Dhe ajo çfarë shohim me Shqipërinë në rastin e Skavicës lidhet me një sërë shkeljesh të ligjeve kombëtare, por edhe të ligjeve të BE-së, siç po ndodhë edhe me aeroportin e Vlorës duke injoruar sinjalet e BE. Dhe nëse një vend kandidat për në BE, injoron haptazi rekomandimet e një traktati ndërkombëtar, atëherë kjo është një përgjigje edhe për politikëbërësit në BE dhe jam i bindur se duke mos pranuar rregullat e BE, procesi i anëtarësimit të Shqipërisë do të zgjatej».

PËRFUNDIM

Rasti i projektit të HEC-it të Skavicës në Dibër, Shqipëri, nxjerr në pah sfidat dhe dilemat e lidhura me zhvillimin e projekteve hidroenergjetike në një kontekst të tranzicionit global drejt energjisë së rinovueshme. Ndërsa këto projekte shpesh paraqiten si zgjidhje për t'ju përgjigjur ndaj nevojave

■ Në kuadër të anëtarësimit në BE, Shqipëria disponon mjaft mekanizma financimi për të zhvilluar kapacitetet e saj në fushën e energjisë së rinovueshme, në mënyrë që ky tranzicion energjetik të mos ketë kaq pasoja negative. Autoritetet kombëtare dhe lokale duhet të marrin informacion nga BE në lidhje me mundësitë e financimit, në mënyrë që të vënë në jetë projekte alternativ

energjetike në rritje duke luftuar kundër ndryshimeve klimatike, ato gjithashtu sjellin pikëpyetje të rëndësishme për impaktet mjedisore, drejtësinë sociale dhe qeverisjen demokratike. Është e rëndësishme të theksohet se ekzistojnë alternativa të qëndrueshme për prodhimin e energjisë së rinovueshme, që nuk kanë pasojat që të dëmshme për mjedisin dhe për komunitetet.

Në kuadër të anëtarësimit në BE, Shqipëria disponon mjaft mekanizma financimi për të zhvilluar kapacitetet e saj në fushën e energjisë së rinovueshme, në mënyrë që ky tranzicion energjetik të mos ketë kaq pasoja negative. Autoritetet kombëtare dhe lokale duhet të marrin informacion nga BE në lidhje me mundësitë e financimit, në mënyrë që të vënë në jetë projekte alternative. Është e rëndësishme të përdoret një qasje e ekuilibruar dhe gjithëpërfshirëse, që merr parasysh interesat dhe shqetësimet e ndryshme të palëve të interesuara, ndërsa eksploron zgjidhje alternative për të garantuar një zhvillim energjetik të qëndrueshëm dhe të drejtë për të gjithë.

1. Bechtel Corporation është një kompani ndërtimi dhe inxhinierie me seli në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Ajo është një nga kompanitë më të mëdha në botë në fushën e inxhinierisë, ndërtimit dhe menaxhimit të projektit. Bechtel është e specializuar në projektet e mëdha infrastrukturore, duke përfshirë autostrada, tunele, rafineri naftë, projekte hidroenergjetike dhe shumë më tepër. Kompania ka qenë e përfshirë në projekte të rëndësishme në të gjithë botën dhe ka një histori të gjatë dhe të respektuar në fushën e inxhinierisë dhe ndërtimit.

2. EuroNatur është një organizatë jo-qeveritare (ONG) me seli në Gjermani, e cila është e përkushtuar për mbrojtjen e natyrës në Evropë. E themeluar në vitin 1987, EuroNatur punon për mbrojtjen e peizazheve natyrore, ruajtjen e biodiversitetit dhe promovimin e një bashkëjetese të qëndrueshme midis njeriut dhe natyrës në të gjithë Evropën.

* **ROLAND MARKU** është doktorant në gjeografi, ekonomist dhe specialist i politikave publike në fushën e bujqësisë dhe zhvillimit rural në Shqipëri. Pas studimeve në ekonomi në Universitetin Europian të Tiranës dhe punës si ekonomist për një periudhë të shkurtër në Shqipëri, Roland Marku u specializua në çështjet e zhvillimit rural duke ndjekur masterin 2 "Menaxhimi i Bujqësisë dhe Territoreve" në Institutin Agronomik Mesdhetar në Montpellier. Në vitet 2016-2017, ai kreu një master kërkimor mbi analizën statistikore dhe hartografike të zhvillimit të sektorit të kafshës në Shqipëri që nga viti 1990.

Aktualisht është doktorant-kërkues në Gjeografi dhe Menaxhim Hapësinor në Universitetin Paul Valéry të Montpellier III, ku vazhdon analizën në sektorin bujqësisë në Shqipëri duke u interesuar veçanërisht për ndërtimin dhe adaptimin e instrumenteve të politikave publike në kuadër të anëtarësimit në BE, dhe për evolucionet e dinamikave territoriale - veçanërisht në rajone pastorale.

“Mua po më hoqe prej aty, unë nuk jam dibran, nuk jam shqiptar, shkel flamurin me këmbë po më përzure nga këtu. Unë kur jam këtu jam dibran, jam shqiptar”,- u shpreh SHPËTIM BUCI, banor i fshatit Fushë-Allie.

“E zhduk Dibrën”, banorët i rikthehen protestave kundër Skavicës

Nga ERISA KRYEZIU / Citizens Channel

20 MARS 2024 - Banorët e Dibrës vijojnë rezistencën ndaj projektit që do të zhysë nën ujë 33 fshatra të zonës. Duke e konsideruar një projekt që “zhduk” Dibrën, dhjetra banorë u tubuan në Laçes, pranë urës së Drinit, kundër ndërtimit të hidrocentralit të Skavicës.

“Mua po më hoqe prej aty, unë nuk jam dibran, nuk jam shqiptar, shkel flamurin me këmbë po më përzure nga këtu. Unë kur jam këtu jam dibran, jam shqiptar”,- u shpreh Shpëtim Buci, banor i fshatit Fushë-Allie.

Prej 30 vitesh ky projekt lakohet nga partitë që vijnë në pushtet, mirëpo banorët akuzojnë se me miratimin e ligjit të posaçëm së fundmi ka mungesë transparence. Për ta, pasojat që do të ketë ndërtimi i këtij hidrocentrali, do të vënë në diskutim ekzistencën e Dibrës.

“Kjo është ta zhdukësh përfundimisht. 33 fshatra të kësaj krahine mbulohen me ujë, mbi 33 të tjerë që ngelen përtej Drinit dhe bëhen të paaksesueshëm për Dibërën. Mbytet 1/3 e tokës prodhueset. Do të mungojë nesër në treg 1/3 e prodhimit. Banorët që mbeten përtej Drinit, janë të detyruar dhe të destinuar të largohen. Në këtë mënyrë Dibra shpopullohet me 40% të paktën”, -argumenton Halil Zhuka, banor e aktivist i zonës.

Për banorët zhdukja e tokave nën ujë, është rrëmbimi i së ardhmes së fëmijëve të tyre.

“Po pse s’më dhemb shpirti? Na përmbayten krejt. Me tokat, me gjënë e gjallë merremi. Kam dy kalamaj, më shumë për ta. Po u ndërtu, s’kemi më asgjë”,-shprehet Zenepja, banore e fshatit Laçes.

Janë 33 fshatra që preken nga ndërtimi i Skavicës. Banorët shprehen se ky është akti i fundit i kryer ndaj Dibrës, përpos politikave shkreteuese ndër vite.

“Banorëve çdo ditë e më shumë, sidomos 10 viteve të fundit ju është prerë mundësia për të jetuar. Nuk kanë burime ujore, nuk vadin dot tokat, nuk kanë ujë të pijshëm, nuk kanë investime në infrastrukturë për të punuar tokat e tyre. Nuk kanë treg. Pra i kanë detyruar në njëfarë mënyrë të largohen nga vendi për të jetuar ose për të mbijetuar. Po e shkretton”, - shprehet Bujar Karoshi, banor e njëkohësisht botues i gazetës “Rrugat e Arbërit”.

“Qeveria duhet menjëherë të anulohet koncesionin për Skavicën dhe ti nisë punët nga e para. Sepse nuk ka fuqi ekonomike në fushën energjetike duke shkelur dhe nëpërkëmbur të drejtat e banorëve”,- pohon më tej ai.

Për Majlinda Hoxhën, një nga banoret dhe aktivistet e zonës, ndërtimi i kësaj veprë i pamundëson rikthimin në vendlindje.

“E gjitha kjo që na ka përkthyer dikur dhe ka qenë një vend që ne jemi ndër të lirë, tashmë rrezikon që të mos ekzistojë më. Edhe pse këtu ndodhemi aktualisht afër vendlindjes së Skënderbeut në Sinë, edhe kjo pjesë deri në një përmasë shumë të madhe do të jetë e përmblytur nga Skavica”, - thotë Majlinda.

“Në njëfarë mënyrë të vetmin vend që ne mund të promovojmë, që mund të zhvillojmë turizmin historik, trashëgimisë kulturore, që mund të organizojmë dhe tu tregojmë të huajve edhe për kulturën dhe për historikun tonë rrezikohet shumë shumë rëndë nga Skavica”,- shprehet Majlinda.

Për qytetarët që e kanë parë Dibërën si atraksion turistik, Skavica do të sjellë heqjen e Dibrës nga harta e turizmit në Shqipëri.



“Kjo është ta zhdukësh përfundimisht. 33 fshatra të kësaj krahine mbulohen me ujë, mbi 33 të tjerë që ngelen përtej Drinit dhe bëhen të paaksesueshëm për Dibërën. Mbytet 1/3 e tokës prodhueset. Do të mungojë nesër në treg 1/3 e prodhimit. Banorët që mbeten përtej Drinit, janë të detyruar dhe të destinuar të largohen. Në këtë mënyrë Dibra shpopullohet me 40% të paktën” - HALIL ZHUKA, avokat, aktivist dhe banor i zonës.

Banorët thonë se ndikimet negative do të prekin edhe zonat përreth hidrocentralit, për shkak të ndryshimit të klimës dhe teritorit.

“Ky projekt e zhduk Dibërën, pjesën më pjellore të tokës me 33 fshatra i mbyti. Jo vetëm se mbulohet Dibra, por edhe pjesa që do t’i shpëtojë përmblytjes në fakt është e pavlerë sepse do të ndryshojë edhe klima këtu. Do katandiset Dibra e papërshtatshme për zhvillimin e bujqësisë, pemtarisë, blegtorisë. Do të ngelet një vend i varfër”, -shprehet Hajri Begu, ish-arsimtar në zonë.

Beteja ligjore dhe qytetare
Në vitin 2021 kaloi ligji nr. 38/2021 që i jep të drejtë kompanisë amerikane “Bechtel” të projektojë dhe ndërtojë hidrocentralin e Skavicës.

Po ashtu me një vendim të Këshillit të Ministrave nr. 485, datë 30.07.2021 u miratua kontrata e fazës së parë për shërbime teknike.

Në korrik të vitit 2021 Korporata Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) nënshkroi kontratën me kompaninë amerikane “Bechtel” për të ndërtuar hidrocentralin Skavica me kapacitet 210 megavat. Sipas KESH-t, kjo vepër do ta kthejë Shqipërinë në vendin lider në rajon të energjisë elektrike.

Në prill të vitit 2022, dhjetëra dibranë



“Subjektet që i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese tashmë e kanë ezauruar rrugën e brendshme, kanë shteruar pra ankimin e brendshëm dhe kanë të drejtën të shkojnë në Gjykatën e Strasburgut për të mbrojtur të drejtat që garanton Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, siç është e drejta e mjedisit, e konsultimit etj. parime që mbrohen nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut”, - SHAQIR MANJAN, avokat.

protestuan përballë kryeministrit kundër Skavicës, duke e cilësuar si një projekt që fundos Dibërën dhe historinë e këtij rajoni.

Në shtator të vitit 2022, dibranët protestuan në fshatin Fushë-Allie dhe adresuan mungesën e informacionit dhe neglizhimin e komunitetit nga ana e institucioneve shtetërore. Ata pohuan se kanë dëgjuar për këtë projekt vetëm në media, por nuk kishin dijeni rreth planit të zhvendosjes dhe dëmshpërblimit.

Në tetor 2022, anëtarë të grupimit “Opposition to Skavica Dam” protestuan në Londër kundër ndërtimit të hidrocentralit Skavica në lumin Drin i Zi. Tubimi u mbajt përballë ndërtesës ku po zhvillohej një panna për përzgjedhjen e nënkontraktorëve nga kompania “Bechtel”.

Në 11 dhjetor 2023 dhjetëra banorë të Dibrës protestuan në Tiranë para Kryeministrit kundër hidrocentralit mes thirrjeve: “Jo Skavica! Rroftë Dibra!”

Ndërsa u zhvilluan protesta, çështja po gjykohej në Gjykatën Kushtetuese, ku më 30 janar 2024 Gjykata u shpreh se Kuvendi dhe Këshilli i Ministrave nuk kanë kryer si duhet konsultimin me publikun dhe nuk kanë garantuar pjesëmarrje efektive të komunitetit në fazën e hartimit të projektligjit.

Mirëpo, në asnjë rast gjykata nuk hodhi

“Banorëve çdo ditë e më shumë, sidomos 10 viteve të fundit ju është prerë mundësia për të jetuar. Nuk kanë burime ujore, nuk vadin dot tokat, nuk kanë ujë të pijshëm, nuk kanë investime në infrastrukturë për të punuar tokat e tyre. Nuk kanë treg. Pra i kanë detyruar në njëfarë mënyrë të largohen nga vendi për të jetuar ose për të mbijetuar”

“Qeveria duhet menjëherë të anulohet koncesionin për Skavicën dhe ti nisë punët nga e para. Sepse nuk ka fuqi ekonomike në fushën energjetike duke shkelur dhe nëpërkëmbur të drejtat e banorëve”

- BUJAR KAROSHI, gazetar

poshtë ligjin e posaçëm që lejon ndërtimin e hidrocentralit.

Sipas avokatit Shaqir Manjani, vendimi i Gjykatës Kushtetuese në fakt është anti-kushtetues.

“Ky vendim është një vendim nën trysni, qartësisht duket që ka pasur një trysni Gjykata Kushtetuese dhe nga ndarja e votave përse i takon themelit të çështjes lidhur me shfuqizimin e ligjit të objekt gjykimit, ligjit të Skavicës, pra ndarja e votave është pesë me katër, në disfavor të Dibrës dhe pro Skavicës, në thelb të gjykimit. Ndërkohë pra ka një pranim të shkeljes së një të drejte themelore të parashikuar nga neni 56 i kushtetutës, e cila është e drejtë për informim e qytetarëve dhe banorëve të Dibrës, për tu informuar rreth projektit, për të dhënë miratimin ose jo, si banorë, për tu kryer konsultimi publik si detyrim kushtetues dhe ligjor, komfort ligjit për konsultimet publike”,-argumenton avokati Manjani.

Sipas tij, tanimë e vetmja gjë që mbetet është ti drejtohen institucioneve ndërkom-betare të drejtësisë.

“Subjektet që i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese tashmë e kanë ezauruar rrugën e brendshme, kanë shteruar pra ankimin e brendshëm dhe kanë të drejtën të shkojnë në Gjykatën e Strasburgut për të mbrojtur të drejtat që garanton Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, siç është e drejta e mjedisit, e konsultimit etj. parime që mbrohen nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut”,-përfundon Manjani.

Njoftim për shoqata dhe organizata joqeveritare

Redaksia e gazetës vendos në dispozicion të shoqatave me fokus Dibërën dhe organizatave joqeveritare hapsira për botimin e veprimtarive apo studimeve të tyre. Redaksia vendos staf që ju ndihmon në shkrimin e kronikave, reportazheve, fotografive dhe teksteve të ndryshme për publikim në media dhe rrjetet sociale etj.

Tarifat e botimit për shoqata dhe OJQ-të janë me kostot preferenciale.

Për më shumë informacion telefononi në numrin **0692068603** ose shkruani emailit: **rrugaearbërit@gmail.com**

Bloomsbury boton edicion të ri të librit për Nënë Terezën në përvjetorin e ditëlindjes së Gëzim Alpiion

intervistë

Mësimi më i madh nga Nënë Tereza: **Të kemi më shumë respekt për njëri-tjetrin**

Monografia “Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj” (*Mother Teresa: The Saint and Her Nation*) i Dr. Gëzim Alpiion, Profesor i Asociuar i Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit është vlerësuar në Amerikë me ‘Çmimin e Ekselencës në Botime’ për vitin 2023 në kategorinë e ‘biografisë’ nga Shoqata e Botuesve Katolikë, *Association of Catholic Publishers (ACP)*.

Libri ofron një portret të detajuar të misionares shqiptare dhe përqendrohet në rrethanat familjare të Nënë Terezës, kontekstin e saj etnik, kulturor dhe shpirtëror, traumat, sprovat dhe arritjet e saj si individ dhe misionare publike, si dhe besimin e saj të ndërlukuar.


Botuar nga *Bloomsbury Academic*, libri është vlerësuar gjerësisht nga ekspertë të fushave të ndryshme. Menjëherë pas botimit, revista ndërkombëtare katolike *The Tablet* në Londër i dedikoi librit kopertinën e numrit të gushtit 2020. Ndërsa në 2022, revista *LIFE* në Nju Jork botoi një shkrim të posaçëm për këtë vepër dhe studimet e tjera të Alpiion për Nënë Terezën.

Pas botimit të librit, Dr. Alpiion u ftua të flasë për librin në disa vende, ndërsa në SHBA ai zhvilloi ligjërata vitin që kaloi në Universitetet e Harvardit dhe Georgetownit. Muajin e fundit Alpiion udhëtoi në Singapor, Chennai e Nju Delhi ku mbajti disa leksione të hapura mbi temat: “Nënë Tereza dhe Multidisiplinarteti: Një qasje gjeopolitike ndaj një personaliteti kompleks”; “Nënë Tereza dhe çështja e vlerave në shkencat shoqërore” dhe “Nënë Tereza: Shenjtore e Indisë dhe Shenjtore për Botën”.

I specializuar në disa aspekte të sociologjisë si feja, nacionalizmi, fama, mediat dhe autorësia, Alpiion është përqendruar në figurën e Nënë Terezës për më shumë se 20 vjet. Ai është vlerësuar nga kritika botërore si “një ndër njohësit më inteligjentë dhe më të mprehtë të kulturës shqiptare”, si “studiuuesi më autoritar në gjuhën angleze i Shën Nënë Terezës” dhe si “themeluesi i Studimeve për Nënë Terezën”.

Në vitin 2019, Kryeministri i Shqipërisë i akordoi Dr. Alpiion çmimin “Ambasador i Kombit”.

Në vitin 2021, Dr. Alpiion u nderua nga Presidenti i Shqipërisë me ‘Medaljen Nënë Tereza’ në shenjë mirënjohjeje për “kontributin e tij të çmuar akademik në studimin e plotë të jetës dhe veprës së Shën Nënë Terezës, si dhe promovimin e saj si përfaqësuese e vlerave të kombit shqiptar”. Në vitin 2022 i akordohet në Angli titulli Anëtar i Lartë i Akademisë së Arsimit Universitar (*Senior Fellow of Higher Education Academy*). Në 2023 monografia e tij ‘Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj’ nderohet në Amerikë me çmimin e Ekselencës nga Shoqata e Botuesve Katolike (ACP). Ndërsa në prill 2024, Alpiion u zgjodh anëtar i jashtëm i Akademisë së



Kopertina e librit *Mother Teresa - The Saint and Her Nation*, botim i vitit 2023

Personalitete si Nënë Tereza nuk janë ‘rastësira’. Ata sintetizojnë një traditë të lashtë dhe mund të kuptohen më mirë po qe se studiohet në kontekstin e rrënjëve, origjinës, familjes, krahinës, etnicitetit dhe kombit të tyre.

Shkencave të Shqipërisë.

Studimi i ri i Prof. Alpiion për ‘natën e errët të shpirtit’, që ai argumenton se Nënë Tereza e vuajti nga fëmijëria deri sa ndërroi jetë, do të botohet këtë muaj në Amerikë në revistën shkencore ‘*Critical Research on Religion*’ (SAGE).

Për të gjitha këto, ne zhvilluam një intervistë ekskluzive për lexuesit e gazetës sonë.

Pyetje: Veprimtaria juaj shkencore vazhdon të vlerësohet në botë. Vitet e fundit keni marrë vlerësime edhe nga shteti shqiptar. Pas Çmimit të Ekselencës për Botimet që morët vitin e kaluar nga Shoqata e Botuesve Katolikë,

për monografinë “Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj”, ju u zgjodhët së fundmi edhe si anëtar i Jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Çfarë do të thotë kjo për ju dhe punën tuaj akademike?

G.Alpiion: Puna shkencore kërkon dekada të vlerësohet në mënyrë objektive. Vlerësimi në vendin tënd është gjithmonë i veçantë. Pranimi në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, jam shprehur edhe kur u njoftova për vendimin, për mua është nder, privilegj dhe përgjegjësi.

Pyetje: Nga recencat e botuara nga studiues të huaj, ju po sillni një lloj ‘biografie të munguar’ të Nënë Terezës. Çfarë ofron libri juaj rreth jetës së saj, që nuk është përmendur më përpara? Ose nuk ka qenë e njohur më përpara?

G.Alpiion: Monografia ime e fundit Nënë Tereza: Shenjtorja dhe Kombi i Saj (*Mother Teresa: The Saint and Her Nation*), botuar nga Bloomsbury në 2020, si dhe libri im i parë akademik Nënë Tereza: Shenjtore apo e Famshme? (*Mother Teresa: Saint or Celebrity?* - Routledge 2007) nuk janë ‘biografi’. Unë nuk jam biograf i Nënë Terezës.

Nënë Tereza ishte një shpirt i trazuar, që arriti ta kthejë në diçka pozitive përvojat e hidhura që përjetoj në Shkup, veçanërisht në 1919, kur babai i saj u helmua nga qarqe ultra-nacionaliste sllave, ka shumë të ngjarë si rezultat i aktivitetit të tij patriotik, dhe kur pas pak muajsh përjetoj shuarjen pothuajse të plotë të familjes së dajës së saj, si rezultat i Gripit Spanjoll të viteve 1918-20. Po qe se i kushtohet më shumë rëndësi kësaj periudhe kaq të rëndësishme në jetën e saj, ne do të kemi një ide më të qartë se sa vendimtare janë përvojat e viteve të para në formimin e figurave të njohura dhe kuptojmë më mirë se çfarë i motivon ata.

Si sociolog, duke parë mangësitë e dukshme në biografite të shumta që janë botuar për të, në studimet e mia i kushtoj rëndësi të veçantë momenteve më të rëndësishme në jetën e saj, veçanërisht viteve të hershme. Kjo, mendoj unë, është e domosdoshme për të kuptuar dhe analizuar objektivisht kompleksitetin e saj si njeri dhe misionare, që nuk janë të ndara nga njëra-tjetra.

Materiali i ri biografik që kam gjetur në 20 vitet e fundit më ka ndihmuar të kuptoj dhe shpjegoj se si u shndërruar ‘njerëzorja’ Gonxhe Agnes Bojaxhiu në ‘hyjnoren’ Nënë Tereza.

Pyetje: Cilat janë disa prej paraleleve që keni gjetur mes natyrës së besimit të Nënë Terezës dhe rrënjëve të saj shqiptare?

G.Alpiion: Qëllimi im kryesor kur fillova hulumtimet në 2011 për këtë monografi nuk ishte fakti që të theksoj se Nënë Tereza është shqiptare. Këtë e ka bërë të qartë vetë Nënë Tereza kur mori çmimin Nobel për Paqen në 1979.

Ndërsa në librin e parë synova të analizoj, ndër të tjera, rolin e Nënë Terezës në konstruktimin e imazhit të saj publik, kryesisht nëpërmjet angazhimit të saj direkt me mediat, që në fillim të aktivitetit të saj si misionare e pavarur në vitin 1949, në librin e ri nxjerr në pah se si rrënjët etnike dhe tradita kulturore-shpirtërore sendërtuan botëkuptimin e saj shpirtëror dhe humanizmin që ajo aplikoi me sukses në krye të urdhrit të saj Misionaret e Bamirësisë.

Në monografinë e dytë, Nënë Tereza ka edhe një funksion tjetër të rëndësishëm: nëpërmjet saj unë kam dëshifruar enigmën e mbi-jetesës së kristianizmit, veçanërisht të katolicizmit, në trojet shqiptare, kryesisht në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni, që lidhen direkt me origjinën dhe familjen e Nënë Terezës, pavarësisht kushteve historike jo të përshtatshme që nga pushtimi romak, dyndjet barbare dhe sllave, pushtimi i stërzgatur otoman dhe së fundmi, persekutimi komunist.

Pyetje: Çfarë nxit, sipas mendimit tuaj, jeta e Nënë Terezës të shqiptarët e sotëm? Çfarë duhet të marrim në konsideratë si komb,

si mësim prej Nënë Terezës?

G.Alpiion: Në përgjithësi ne, shqiptarët, nuk e njohim si dhe sa duhet jetën e Nënë Terezës, veçanërisht 18 vitet që ajo kaloi në Shkup që, për mendimin tim, ishin vendimtare në formimin e saj, si dhe rolin tyre në aktivitetin e saj bamirës. Kjo si rezultat i dobësive të theksuar që kemi në studimin e figurave të shquara kombëtare, ku vëmendja përqendrohet jo në fëmijëri dhe rini.

Në rastin e Nënë Terezës, ne jemi ndikuar edhe nga literatura, kryesisht hagiografike (dedikuar shenjtorëve), kushtuar asaj ku rëndësia e rrënjëve etno-shpirtëror vazhdon të anashkalohet edhe sot. Nënë Tereza ishte një shpirt i trazuar, që arriti ta kthejë në diçka pozitive përvojat e hidhura që përjetoj në Shkup, veçanërisht në 1919, kur babai i saj u helmua nga qarqe ultra-nacionaliste sllave, ka shumë të ngjarë si rezultat i aktivitetit të tij patriotik, dhe kur pas pak muajsh përjetoj shuarjen pothuajse të plotë të familjes së dajës së saj, si rezultat i Gripit Spanjoll të viteve 1918-20. Po qe se i kushtohet më shumë rëndësi kësaj periudhe kaq të rëndësishme në jetën e saj, ne do të kemi një ide më të qartë se sa vendimtare janë përvojat e viteve të para në formimin e figurave të njohura dhe kuptojmë më mirë se çfarë i motivon ata.

Në kohën tonë, mësimi më i madh nga Nënë Tereza është të kemi më shumë respekt për njëri-tjetrin dhe veçanërisht për ata që shteti dhe shoqëria i ka lënë pas dore apo i trajton me përbuzje. Për Nënë Terezën, dinjteti njerëzor ishte i shenjtë. Në këtë drejtim, më shumë se kushdo tjetër, Nënë Terezën duhet ta kuptojnë politikanët dhe pushtetarët që, ndërsa mburren vend e pa vend me këtë ikonë globale humanizmi dhe spiritualiteti, sillen si harbutër me njerëzit e thjeshtë për të cilët i zë ‘meraku’ vetëm gjatë zgjedhjeve, për t’ju marrë votat me hir ose pahir, veçanërisht në Shqipëri, ku Nënë Tereza akoma nuk ka ‘mbërritur’, megjithëse e vizitoi vendin për herë të parë në 1989.

Pyetje: Nga buron natyra e diskriminimit të shqiptarëve, në kontekstin e diskriminimit të përmendur në libër të vetë Nënë Terezës, në fillimet e aktivitetit të

ekskluzive

Së shpejti do të botohet në gjuhën shqipe nga Botimet M&B drama “Sikur të vdekurit të dëgjonin” (*If Only the Dead Could Listen*), përkthyer në shqip nga Geron Kamberi



Në foto: Gëzim Alpion, profesor i asociuar i Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit në Mbretërinë e Bashkuar.

Gëzim Alpion zgjidhet anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë

Më 22 prill 2024 u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Akademisë së Shkencave të Shqipërisë. Në këtë mbledhje të asamblesë, në sallën “Aleks Buda”, u pranuan anëtarët e rinj të Akademisë së Shkencave, mes të cilëve z. Gëzim Alpion, profesor i asociuar i Sociologjisë në Universitetin e Birminghamit në Mbretërinë e Bashkuar.

Një profil i shkurtër për Alpion u prezantua nga akad. Skënder Gjinnushi, Kryetar i ASHSH.

“Dy anëtarë të Asamblesë, akademikët Arben Merkoçi e Adem Bunguri, njohës të veprimtarisë së tij shkencore e universitare, janë rekomandues për kandidimin; përveç letrës së referencës nga imzot George Frendo, arkiveshkv i mëparshëm i Durrësit dhe Tiranës; si dhe vlerësimit zyrtar me shkrim nga profesor Nicola Gale, drejtor i Shkollës së Politikës Sociale dhe Shoqërisë në Universitetin e Birminghamit dhe Stephen Nash, CMG, ish-ambasador i Britanisë së Madhe në Gjeorgji, Shqipëri dhe Latvia, aktualisht, kryetar i Shoqatës Angli-Shqipëri”, tha mes të tjerash Gjinnushi në prezantimin e kandidatit për Anëtar të Jashtëm të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Gëzim Alpion ka mbrojtur doktoratën në filozofi, është profesor në Universitetin e Birminghamit; profesor i ftuar në disa universitete të Botës; autor i shtatë veprave monografike si autor i vetëm dhe i disa të tjerave si bashkautor; i njohur si biografi më i besueshëm për Nënë Terezën, vepër e përkthyer dhe botuar mbi 15 herë; autor i 17 artikujve shkencorë dhe kritikë të pranuar me konkurrim; shkruar libra artistikë dhe disa dhjetëra artikuj në shtyp e media. Veprat e tij janë të recensiuara në më shumë se 100 raste.

Mban tituj nderi e merite, mirënjohje dhe dekorata nga shteti shqiptar dhe nga vende të tjera.

Në kohën tonë, mësimi më i madh nga Nënë Tereza është të kemi më shumë respekt për njëri-tjetrin dhe veçanërisht për ata që shteti dhe shoqëria i ka lënë pas dore apo i trajton me përbuzje. Për Nënë Terezën, dinjiteti njerëzor ishte i shenjtë. Në këtë drejtim, më shumë se kushdo tjetër, Nënë Terezën duhet ta kuptojnë politikanët dhe pushtetarët që, ndërsa mburren vend e pa vend me këtë ikonë globale humanizmi dhe spiritualiteti, sillen si harbutër me njerëzit e thjeshtë për të cilët i zë ‘meraku’ vetëm gjatë zgjedhjeve, për t’ju marrë votat me hir ose pahir, veçanërisht në Shqipëri, ku Nënë Tereza akoma nuk ka ‘mërritur’, megjithëse e vizitoi vendin për herë të parë në 1989.

përvjetorin e ditëlindjes time.

Botimi i ri është i destinuar veçanërisht për Azinë. Pas akordimit të çmimit të ekselencës në Amerikë dhe njoftimit të Bloomsburit për botimin e tretë, më erdhën ftesa nga disa universitete në Singapor, Manila dhe tre shtete në Indi për të folur për librin. Për arsye kohe dhe nga angazhime të tjera, këtë radhë në turneun e leksioneve në Azi pata mundësi të përfshij ligjërata në Universitetin Shtetëror të Singaporit (NUS), Institutin Indian të Teknologjisë Madras (IITM) në Chennai dhe Kolegjin Jezusi dhe Maria (Universiteti i Delhit). Leksionet u pritën me interes nga studiues dhe mediat. Në Singapor, tre akademikë nga Parisi, Singapor dhe Manila, moderatori dhe dy diskutantët, bënë një analizë të konkluzioneve të botimeve të mia akademike për Nënë Terezën në dy dekadat e fundit.

Siç u shpreha për gazetën indiane ‘The Telegraph’, gjatë vizitës së fundit në Indi, vura re se Nënë Tereza vazhdon të ketë përkrahës edhe kritikët e saj, por tani akademikët dhe personat fetarë nuk hezitojnë si më parë të shprehin më lirshëm dhe hapur mendimet e tyre. ‘Vlerësimet’ dhe ‘kritikat’ për Nënë Terezën këtë radhë, ndryshe nga çfarë vura re gjatë vizitave që bëra në Indi në Kalkuta, Shantani-keta dhe Neë Delhi në vitin 2005

dhe 2013, dëgjoheshin me durim dhe respekt nga të pranishmit, edhe kur nuk ishin dakord me diskutantët.

Pyetje: Çfarë mësojnë Shqiptarët prej librit tuaj që nuk e dinë, ose mendoni se keqinterpretohet më shpesh?

G.Alpion: Megjithëse për Nënë Terezën kam botuar rregullisht studime në revista shkencore dhe tre libra që nga viti 2003, për të cilat mediat në Shqipëri, Kosovë dhe troje të tjera shqiptare dhe mediat e diasporës kanë shkruar gjerësisht, veçanërisht për t’i bërë jehonë reaguesve pozitive nga kritika dhe mediat botërore, vepra ime studimore 20-vjeçare për Nënë Terezën njihet pak nga akademikët shqiptarë dhe lexuesi i gjerë. Kjo pasi veprat e mia janë botuar në gjuhën angleze dhe një monografi është botuar në Romë nga Salerno Editrice në italisht në 2008. Kur librat të botohen në shqip edhe angazhimi i lexuesve dhe studiuesve mendoj se do të rritet.

Kohët e fundit është shtuar numri i bashkathetarëve që më shkruajnë se i kanë lexuar librat e mi. Për librin e fundit janë botuar edhe disa recenca serioze. Mund të veçoj 3 recenca nga dr.Ridvan Peshkopia, i cili ka zbrëthyer në mënyrë origjinale disa nga mesazhet që përçoj në këtë vepër.

Si sociolog, duke parë mangësitë e dukshme në biografite e shumta që janë botuar për të, në studimet e mia i kushtoj rëndësi të veçantë momenteve më të rëndësishme në jetën e saj, veçanërisht viteve të hershme. Kjo, mendoj unë, është e domosdoshme për të kuptuar dhe analizuar objektivisht kompleksitetin e saj si njeri dhe misionare, që nuk janë të ndara nga njëra-tjetra.

Materiali i ri biografik që kam gjetur në 20 vitet e fundit më ka ndihmuar të kuptoj dhe shpjegoj se si u shndërruar ‘njerëzorja’ Gonxhe Agnes Bojaxhiu në ‘hyjnoren’ Nënë Tereza.

saj fetar?

G.Alpion: Shkurtimisht mund të them se motrat që drejtonin urdhërin e Loretos në Kalkutë nuk mund ta honepsin që një murgeshë, nga një komb për të cilin nuk dinin asgjë, t’ju mëson-te se çfarë duhet të bënin ata në Indi për t’i shërbyer Krishtit dhe të varfërve, veçanërisht në një moment kyç në historinë moderne të Indisë, ku pas shpalljes së pavarësisë nga Britania e Madhe, misionarët nuk ishin shumë të dëshiruar dhe pati edhe thirrje nga nacionalistët hinduiste me influencë që të përziheshin ose t’u kufizoheshin aktivitetet.

Megjithatë, murgeshat irlandeze të Loretos nuk duhen gjykuar shumë ashpër, pasi kishin një ar-

sim të cinguar, që nuk përfshinte njohuri për kombin tonë të eklipsuar nga obskurantizmi otoman, më shumë se çdo komb tjetër nën kontrollin e Portës së Lartë, me një traditë kristiane apostolike, pra më të hershme se çdo komb tjetër evropian, përfshirë irlandezët.

Pyetje: Nuk duket sikur keni shkruar thjesht një biografi rreth Nënë Terezës. Por ofroni detaje të jetës së saj, në kontekstin e kombësisë së saj. Çfarë mësojnë të huajt që do të lexojnë librin rreth Nënë Terezës dhe Shqiptarëve?

G.Alpion: Ndër objektivat kryesore në këtë libër mund të përmend dy. Së pari, kam theksuar se personalitete si Nënë Tereza nuk janë ‘rastësira’. Ata sintetizojnë një traditë të lashtë dhe mund të kuptohen më mirë po që se studiohet në kontekstin e rrënjëve, origjinës, familjes, krahinës, etnicitetit dhe kombit të tyre.





Së dyti, qëllimi im ishte të argumentoj se civilizimi modern perëndimor nuk është vetëm me themele greko-romake, por iliro-greko-romake.

Pyetje: Libri duket se po merr vlerësime, siç është vlerësimi nga Shoqata e botuesve katolikë, në kategorinë Biografi. Si ndiheni për këto vlerësime?

G.Alpion: Për çdo autor, është kënaqësi kur një libër vlerësohet nga kritika, aq më tepër kur bëhet fjalë për një vepër studimore. Bloomsbury dhe unë e pritëm me kënaqësi çmimin që ju akordua librit në Amerikë.

Bloomsbury ka bërë punë të shkëlqyer për ta promovuar librin, gjë që shihet edhe nga fakti që deri tani është botuar tre herë: në 2020, 2022 dhe së fundi me 10 tetor 2023, që përkon edhe me

DISA BOTIME NGA G.ALPION



Recencat e dr. Peshkopisë janë botuar në revista prestigjioze akademike në Perëndim. Po kështu, edhe z. Arben Çokaj ka botuar një recencë të detajuar, ku theksin e ve në temat kryesore të librit të fundit.

Pyetje: Po në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut kur do ta prezantoni librin?

G.Alpion: Ftesa e parë nga Shqipëria për të folur për librin e ri erdhi nga Universiteti i Shkodrës dhe vizita u realizua në vitin 2021. Kam marrë ftesa nga disa Universitete në Kosovë dhe Universiteti Nënë Tereza në Shkup. Së shpejti, besoj, do të flas për librin në Tiranë dhe në disa universitete në Ballkan.

Intervistoi: BUJAR KAROSHI

Familja e madhe e Gëzim Markes

Nga **OSMAN XHILI**

Gëzim Markja është një nga filizat e shëndoshë të fisit të Salë Markes, aq të përmendur në historinë e Dibrës. Stërgjyshi i tyre pati gjashtë çifligje, atë të Bomovës, Prilepit dhe Reshanit. Pjesëtarët e këtij fisi u shtuan dhe u shumuan, por përsëri përpigën t'i njohin rrënjët e hershme dhe t'i ruajnë deri diku dhe lidhjet mes tyre. Kulla e Salë Markes në Zogje, dhe sot e kësaj dite, qëndron si monument madhështor, si dëshmitar i një historie të lavdishme.

Të parët e Gëzimit jetuan për shumë kohë në çifligun e Bomovës në Dibër të Madhe. Mungesa e ujit e bënte disi të vështirë jetesën aty, ndaj menduan të zhvendosen në Reshan, ku uji ishte i bollshëm e terreni mjaft i përshtatshëm. Gjashtë vëllezërit ndërtuan një ekonomi të fuqishme për tu patur zili. Blloqe të bukura me mollë, 500 kokë të imta, dhjetëra kokë gjedh, 200 koshere me bletë ishin disa tregues, që shumëkush do ti lakmonte ti kishte. Kush që ai njeri që kaloi aty pranë dhe nuk e njohu nga afër bujarinë e kësaj familje? Kush që ai udhëtar që nuk piu një kafe, nuk hëngri një drekë, apo një pjatë me mjaltë nga këto njerëz bujarë?

Aty hëngrën bukë i huaji dhe vendasi, partizani e nacionalisti, por për ironi të fatit, kulla dhe çifligu u dogjën, të paktën tre herë. U dogjën dhe u persekutuan dhe nga regjimi komunist, ku dhjetëra partizanë ishte ulur në sofrën bujare të këtyre njerëzve, si në shtëpinë e tyre.

U duk se çifligu i Reshanit u shkretua, për të mos u ngjallur më kurrë. Disa u larguan e vetëm Gëzimi, djali i Jasharit mbeti aty, si një pemë e brishtë, që erërat e fuqishme e hedhin sa nga njëra anë në tjetrën. Ai nuk kishte shumë miq e shokë, nuk kishte zanat e shkollë, por kishte ndershmërinë dhe përkushtimin për familjen. Aty rriti katër fëmijët e tij, tre djemtë dhe vajzën, Merjemen.

Më i vogli i djemve quhet Jashar, në emër të gjyshit, si për të treguar se kjo familje është e shëndoshë e vitale, për ti rezistuar kohës dhe shekujve. Fëmijët u bënë krahë të fuqishëm, u bënë burra dhe krijuan familjet e tyre. Nga një shtëpi e vogël dhe e vetmuar, sot aty po krijohet një lagje e re, sikur po ringjallet çifligu i dikurshëm.

RAHIMI, DJALI I DYTË I GËZIMIT

Rahimi, pasi punoi disa vite në kurbet, mendoi se do të ishte më mirë të krijonte follenë e re, aty në vendlindje. E ndanë me kujdes atë pronë që kishin mes vëllezërve, por jo dashurinë dhe respektin për njëri-tjetrin, apo ndihmesën për vëllain, sa herë që ajo ishte e nevojshme. Edhe pse janë në fillimet e rritjes së tyre, rezultatet janë vërtet befesuese. Ata mbollën, si familje, rreth dy hektarë me misër, duke marrë 140 quintal prodhim dhe 13 quintal fasule. Vetëm Rahimi prodhoi gjashtë quintal fasule, duke siguruar 2400 euro në total.

Rahimi pati në pranverë një tufë modeste prej 25 delesh, të cilat dhanë gjithsej 33 qengja. Duke qenë se çmimi i të imtave këtë vit ishte mjaft i favorshëm, në pranverë ai i shiti secilin prej tyre me një mesatare prej 190 mijë lekësh, pra me një çmim total prej gjashtë mijë eurosh. Këtu nuk kemi llogarit qumështin e dheneve gjatë pranverës dhe verës, duke e konvertuar atë me shpenzimet e bëra gjatë vitit për to. Rahimi ka tetë qingja nga gjashtë dhen, që gati po arrijnë fazën e këputjes nga nënat e tyre. Nëse dikujt i duken shifra të fryra këto tregues, unë e ftoj t'i verifikojë nga afër dhe të bindet plotësisht për realitetin.

Rahimi po hedh sytë dhe nga frutikultura. Ai ka mbjellë tre dynymë me arra të shartu-

Familja e madhe e Gëzim Markes ka në përdorim gati 100 dynym tokë, të cilën e mbjell me kultura të ndryshme bujqësore. E mbushur me pleh organik, me ujëra të bollshëm për vaditje dhe shërbime intensive njerëzore, rezultatet e marra janë vërtet mbresëlënëse.

ara dhe që këtë vit ai ka marrë një prodhim modest. Vitet në vazhdim ky bllok i ri do të jetë një mbështetje e fuqishme e ekonomisë familjare.

JASHARI ME EMRIN E GJYSHIT

Jashari është më i vogli, i cili mbann emrin e gjyshit. Ai është po aq punëtor sa ç'ka qenë i pari. Jashari ka pasion të madh blegtorinë dhe së bashku, si familje e madhe, ata po bëjnë gati njëqind krerë. Jashari i ka gati dyfishuara rezultatet që kishte Rahimi, meqë tufa e tij është më e madhe. Ai e di cila kullotë është më e mirë dhe cila jo, kur

duhet të dalin delet në kullotë e kur është më mirë të qëndrojnë brenda. Jo vetëm kaq, por kur dhentë kanë vështirësi në lindje, Jashari ndërhy plot kompetencë e rezultat. Në rastet e sëmundjeve në dhen, sidomos gjatë verës, ai di ti kurojë e të shmangë pasojat negative të sëmundjes, shkurt, një mjeshtër i vërtetë. Njëherë kishte peshuar qengjin e sapolindur të një runxe, meqë ishte dukur shumë i madh. Plot pesë kilogramë ishte pesha e tij, kur ata zakonisht nuk janë më shumë se 3,5 kilogram. Ata po zgjedhin çdo vit runxa të reja për ta shtuar tufën akoma më shumë. Mos ndoshta do ta çojnë në pesqind numrin e të imtave, sa



ç'ka patur çifligu i tyre dikur?!

Familja e madhe e Gëzim Markes ka në përdorim gati 100 dynym tokë, të cilën e mbjell me kultura të ndryshme bujqësore. E mbushur me pleh organik, me ujëra të bollshëm për vaditje dhe shërbime intensive njerëzore, rezultatet e marra janë vërtet mbresëlënëse.

Bedriu ishte djali më i madh i Gëzimit dhe i familjes Markja të Reshanit. Themi ishte, pasi para pak kohësh humbi jetën tragjikisht tek vendi ku punonte për të mbajtur familjen. Ishte vetëm 35 vjeç, me një trup të gjatë e të fuqishëm. Shumë njerëz u mblodhën ditën e varrimit dhe pse koha ishte me shi e shtrëngata. Miq e shokë i falën xhenazen dhe i dhanë lamtumirën e fundit. Babai i tij, Gëzimi u mbajt fort dhe pse dhimbja ishte e madhe. Ai është besimtar i devotshëm dhe e di mirë se ne, të Allahut jemi dhe tek Ai do të shkojmë. Ai u mbajt fort edhe për një arsye tjetër. Gëzimi sapo ka mbushur 60 vjeç është bërë gjysh plot 13 herë. Zoti na mëson se pas çdo fatkeqësie zbret një mirësi. Nuk ishin mbushur akoma vetëm dy ditë nga vdekja e Bedriut, kur nusja e tij shtatzënë lindi një djalë. Nuk do të kishte emër më të mirë e më të bukur për ti vendosur, se sa emrin e babait të tij. Kështu e mbylli plagën e momentit familja Markja, për të vazhduar e shëndetshme në rrjedhat e kohës dhe historisë.

NJOFTIME

- Njoftojmë lexuesit dhe të gjithë ata që kanë ndihmuar ose dëshirojnë të ndihmojnë me donacione, se e vetmja mënyrë që **KONTRIBUTET TUAJA TË NJIHEN** janë pagesat **PËRMES BANKËS**. Për të dhënat bankare shihni njoftimin më poshtë ose në faqen 2.
- Kujtojmë bashkëpunëtorët tanë se çdo **SHKRIM I BOTUAR NË NJË MEDIA** tjetër apo rrjete sociale **NUK KA PËRPARËSI** botimi, përveç rasteve kur kjo është konfirmuar më parë me redaksinë!
- **KËRKOHEN KORRESPONDENTË NË PESHKOPI DHE DIBËR TË MADHE**. Të interesuarit për korrespondentë/menaxherë duhet të kenë pasion gazetarinë. Përbën avantazh përvoja në shtypin e shkruar ose në qoftë se kanë mbaruar studimet për gazetari dhe letërsi / marketing. Të jenë të angazhuar për punën në grup dhe të jenë të pavarur politikisht gjatë kohës që bashkëpunojnë me gazetën. Të interesuarit të komunikojnë me redaksinë.

REKLAMO BIZNESIN TËND

Një faqe e plotë me ngjyra kushton 15000 lekë

Me 1000 lekë mund të rezervosh një reklamë gjatë gjithë vitit në format kartvizite (8x5cm)

NE JEMI GAZETË E LIRË DHE E PAVARUR NGA NDIKIMI POLITIK. PAVARËSIA DHE LIRIA JONË GARANTOHET VETËM NGA MBËSHTETJA E LEXUESVE... BËJ PAJTIMIN TËND!

Një pajtim vjetor kushton: **600 lekë**. Në Europë: **10 Euro**.

Në SHBA dhe vende të tjera: **15 USD**. Pajtimi në Europë dhe SHBA është vetëm në versionin PDF.

Botimi i gazetës është punë vullnetare, ndaj çdo pajtim vjetor ose dhurim, është i mirëpritur.

Dhurimet pranohen **VETËM PËRMES LLOGARISË BANKARE** që gjendet më poshtë dhe për çdo rast ai do të bëhet publik.
Raiffeisen Bank, Rr. Kavajës, Tiranë.
SWIFT code: **SGSBALTX.**
IBAN(ALL): **AL44 2021 1219 0000 0000 1003 6640**

aktualitet

■ Tubin kryesor lidhen me tubin e emergjencës përmes 11 nyjeve lidhëse, 3 prej të cilave janë më të gjëra dhe kanë mundësi shkëmbimi. Gjatësia e këtij tuneli është 3789 metra, ndërkohë e tunelit ndihmës 3781 metra. Lartësia e tunelit kryesor është 6.8 metra, ndërkohë që tuneli ndihmës është 4.2 metra.

Më 21 dhjetor 2023 punëtorët e kompanisë që punojnë brenda Tunelit të Murrizit panë dritë në anën tjetër. Duartrokitje, gëzime të ligjshme, shtrëngim duarsh dhe përqafime mes njëri - tjetrit. Një video e shkurtër e çastit mbërriti në adresën e redaksisë sonë. Por, burimi ynë brenda kompanisë, pak minuta pasi na përcolli videon, na kërkoi të mos e përmendnim, pasi kishin marrë urdhër që lajmi të mos bëhej i ditur.

Më 22 dhjetor 2023, në faqen e Facebook të gazetës dhamë lajmin e mirë për të gjithë: "Dritë në tunelin kryesor të Rrugës së Arbrit".

"Ky çast është pritur prej kohësh, por lajmet për problematika gjatë punimeve, që autoritetet i kanë cilësuar si "gjeologjike", kanë sjellë vonesë në punimet e rrugës. Burime nga fronti i punës thonë për gazetën "Rruga e Arbërit" se kishte dyshime se bashkimi do të kishte probleme, për shkak të terrenit të vështirë, por gjithçka shkoi sipas parashikimit. Duartrokitjet e momentit priten të bëhen publike së shpejti", thuhej në lajmin e asaj ditë të redaksisë sonë.

Kompania ndërtues e rrugës së Arbrit nuk i ka zakon informacionet në faqen e saj mbi ecurinë e punimeve, por si rrallë herë, ajo e përgënjeshtroi lajmin e dhënë, duke e quajtur të pavërtetë.

"Duke marrë shkas nga një lajm i shpërndarë në rrjetet sociale, ku thuhet që tuneli i Murrizit është hapur, dëshirojmë të ju bëjmë me dije se: Tuneli i Murrizit ende nuk është hapur. Por, jemi në hapat e fundit ku po bëhen përfundimet e nevojshme për të bërë të mundur sigurimin e kantierit dhe të stafit. Në ditët në vijim do të ketë një prezantim publik të hapjes përfundimtare".

Por vetëm pak ditë më pas, pasi kompania bëri "përfundimet e nevojshme për të bërë të mundur sigurimin e kantierit dhe të stafit", në tunelin e Murrizit ishte Kryeministri Edi Rama dhe Ministria e Infrastrukturës Belinda Balluku, të cilët panë nga afër "shembjen" e murit ndarës mes dy anëve të tunelit.

"Sot jemi në fazën finale, praktikisht, - tha Balluku. Kemi nisur nga e premija e shkuar që të shohim dritë nga ana tjetër dhe sot është përfundimi. Këtu hapet, dhe mbarojmë përfundimisht me gërmimet", thekson Ministria e Infrastrukturës në lidhje me punimet në tunel.

Balluku gjatë këtij inspektimi vuri në dukje disa nga parametrat teknikë të tunelit të Murrizit.

"Ky është një tunel i përbërë nga dy tuba. Ndodhemi në tubin kryesor, ndërkohë që tubi tjetër është tubi ndihmës, lidhen me njëri tjetrin me 11 nyje lidhëse, 3 prej të cilave janë më të gjëra dhe kanë mundësi shkëmbimi. Gjatësia e këtij tuneli është 3789 metra, ndërkohë e tunelit ndihmës 3781 metra. Lartësia këtu është 6.8 metra, ndërkohë që tuneli ndihmës është 4.2 metra", tha Balluku.

Ministria nuk harroi të ripërsëriste edhe njëherë disa nga shkaqet që çuan në vonesën e punimeve në këtë tunel.

"Ka qenë një vepër me infrastrukturë jashtëzakonisht sfiduese, - theksoi Balluku. - E kemi nisur këtë tunel në maj të vitit 2019, ndërkohë tunelin ndihmës e kemi nisur në korrik të 2019. Na është dashur të përballemi me shumë sfida, pasi gjeologjia

Dritë në tunelin kryesor të Rrugës së Arbrit

Rruga e Arbrit është ideuar që të lidhë dy kryeqytetet e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, të lidhë Tiranën me Shkupin, jo Tiranën me katundet e Dibrës.

është totalisht e paqëndrueshme dhe volumet e kërkimit kanë qenë të mëdha. Janë përdorur më shumë se 26 ton hekur, pasi ka qenë shumë e nevojshme që të strukturoren në mënyrë të tillë për të qëndruar. Ka patur një angazhim shumë të madh nga të gjitha grupet që kanë qenë duke punuar. Kemi patur katër fronte që kanë qenë duke punuar dhe nga përllogaritja na janë dashur më shumë se 1400 ditë për tunelin e vogël dhe më shumë se 1600 ditë për këtë tunel. Sot jemi në fazën finale praktikisht. Kemi nisur nga e premija e shkuar që të shohim dritë nga ana tjetër dhe sot është përfundimi dhe këtu hapen dhe mbarojmë përfundimisht gërmimet." - tha zëvendëskryeminstria Balluku.

Kryeministri Edi Rama, i pranishëm në këtë bashkim të dy anëve të tunelit, tha se kjo "ishte një shenjë e mirë".

"Ishte një shenjë e mirë që u hap para se të mbarojë viti se këtë ne nuk e prisnim. Ishte përshpejtim! Thjeshtë ta mbarojmë me kulmin e cilësisë, pastaj kur të mbarojë të mbarojë. Brenda viti tjetër s'diskutohet, por le t'ia lëmë dhe pak fatit këtu se këtu çfarë s'kemi parë. Tani gjithësi është më në kontroll puna", tha kryeministri Rama.

Përfaqësuesit e qeverisë për të justifikuar vonesat e punimeve në Rrugën e Arbërit, i kanë krahasuar shpesh ecurinë e punimeve me Tunelin e Llogarasë.

"Ky tunel ka nisur në 2019 dhe do të përfundojë në 2024, ndërsa tuneli i Llogarasë, i cili përfundon në qershor 2024 ka nisur shumë më vonë se sa ky, por duke pasur një gjeologji shumë më të favorshme në Llogara, e njëjta kompani ecën me rreth 20m në ditë, ndërkohë që në Murriz përparon me afro 2m në ditë", shkruante Balluku më 26 dhjetor në faqen e saj zyrtare në Facebook, në videon përcjellëse të ceremonisë së bashkimit të dy anëve të tunelit.

"Gjithësesi, më e keqja ka kaluar dhe tanimë drita e sotme është një arsye e fortë për të besuar që 2024 do ta vulosë edhe fundin e kësaj veprë kaq sfiduese", mbyll postimin në Facebook Balluku.

Punimet në Rrugën e Arbrit kanë nisur në pranverën e vitit 2018 dhe, zyrtarisht parashikohet të hapen plotësisht për qarkullimin e mjeteve në prill të vitit 2025. Në ceremoninë e dhjetor u përmend si afat "fundi i vitit 2024", por tashmë, duke parë së premtimet për afate nuk janë mbajtur asnjëherë, zërat pesimistë e çojnë nisjen e trafikut për më vonë. Njerëz të afërt me qeverinë dhe Partinë Socialiste thonë se "qarkullimi mund të hapet me 28 nëntor të këtij viti ose në prag të Krishtlindjeve". Kjo mbetet për tu parë në muajt në vazhdim.

■ Të gjithë zyrtarët që vizitojnë kantierin e rrugës Maqellar-Peshkopi e vënë theksin se ky segment rrugor është "pjesë e Rrugës së Arbrit". Në fakt, ky segment nuk është pjesë e Rrugës së Arbrit, por është një degëzim i saj që të çon në Peshkopi.

Tuneli i Murrizit është vepra kryesore e Rrugës së Arbrit. Me një gjatësi prej afro 3.8 km, ai pritet të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në qarkullimin e automjeteve. Vënia në funksionim e tij pritet të sjellë një rritje të qarkullimit në këtë aks rrugor që, që jo vetëm shkurton distancën mes qarkut të Dibrës dhe Tiranës, por shkurton me afro 100 km edhe distancën Tiranë-Shkup.

Tani puna në tunel vazhdon me proceset e betonimit, gërmimet, vendosja e pajisjeve elektromekanike etj.

PROBLEMATIKAT

Ndërkohë në segmente të tjera të Rrugës së Arbrit janë kryer punime të shtrimit të shtresave finale të asfaltit dhe punime që rrisin sigurinë rrugore. Nga Tuneli Qafës së Buallit deri të Tuneli mbi fshatin Fshat në Klos, janë hedhur shtresat finale ta asfaltit si dhe janë vendosur vijëzimet e bardha. Një segment në Planin e Bardhë nuk ka mbaruar akoma, për shkak të punimeve përfunduese të bazamentit të rrugës. Punime të ngjashme po kryhen edhe në grykën e Tujanit, kur muajt e fundit ka pasur problematika të tjera, rënie gurësh.

Qarkullimi në këto segmente, gjatë kohës që janë hedhur shtresat asfaltike, është ndërprerë nga ora 8 e mëngjesit deri në orën 18 pasdite.

Në afërsi të Shkallës së Tujanit, në fund të shkurtit 2024 u bllokua për disa orë qarkullimi, pas pati rënie gurësh nga një gurore mbi rrugë. Kompania e përjashtoi veten nga përgjegjësia, por edhe sot e kësaj ditë, në atë segment vazhdon të hidhen gurë dhe një pjesë e rrugës është e bllokuar nga mbrojtëse betoni.

Kohët e fundit janë shtuar aksidentet në këtë aks, sidomos në rrugën që kalon nga Qafa e Murrizit. Në këtë aks shpeshherë bllokohet qarkullimi për shkak aksidentesh, por kohët e fundit është vënë re edhe vaj në rrugë - dyshohet e qëllimshme, e cila sjell ngadalësim të qarkullimit dhe bllokime të rrugës. Para pak ditësh një mikrobus i linjës u përmbys para tunelit të Murrizit dhe në videon që qarkulloi u vu re mungesa e parmakëve mbrojtës anës rrugës.

"Rruga e Arbrit ngelet një ndër rrugët më problematike sot në Shqipëri me aksidentet të pafundme dhe me pasoja vdekje, ajo nuk po mbaron, sepse nuk punohet, nuk do qeveria e rilindjes", shkruante në lidhje me këtë ngjarje, Xhelal Mziu, deputet i Dibrës.

Ekspertë të sigurisë rrugore kanë konstatuar se në shumë raste nuk janë marrë parasysh standardet e sigurisë, sidomos në rastet e projektimit të hyrjeve dhe daljeve në rrugë. Vetëm në një segment rrugor, nga Shupenza deri në Maqellarë ekspertët kanë evidencuar se paku katër hyrje dhe dalje në rrugë, që nuk përmbushin elementët e sigurisë.

SEGMENTI MAQELLARË-PESHKOPI NUK ËSHTË PJESË E RRUGËS SË ARBRIT

Në gusht të vitit 2023 kanë nisur punimet edhe në rrugën Herebel-Peshkopi.

"Nis në terren puna për rehabilitimin e plotë të segmentit rrugor Maqellarë - Peshkopi, pjesë e Rrugës së Arbrit", shkruante ministria Balluku më 8 gusht 2023 në faqen e saj në FB.

Rruga e re për në Peshkopi e shkurton distancën nga Maqellara me 2.4 kilometra si dhe rrit parametrat e sigurisë rrugore dhe shpejtësinë e lëvizjes.

Këtë kantier e vizitoi edhe kryeministri Rama në nëntor 2023.

"Me Kryeministrin, Edi Rama në kantierin e segmentit Maqellarë - Peshkopi, ku punimet po ecin me ritme të shpejta, me synimin që ky segment, pjesë e Rrugës së Arbrit, të jetë gati për qarkullimin e automjeteve përpara afatit të parashikuar", shkruante Balluku në atë kohë.

Të gjithë zyrtarët që vizitojnë kantierin nuk harrojnë të vënë theksin se ky segment rrugor është "pjesë e Rrugës së Arbrit". Por në fakt, ky segment nuk është pjesë e Rrugës së Arbrit, por është një degëzim i saj që të çon në Peshkopi.

Rruga e Arbrit është ideuar që të lidhë dy kryeqytetet e Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut, të lidhë Tiranën me Shkupin, jo Tiranën me katundet e Dibrës. Por duket se projektuesit financuesit e Rrugës së Arbrit, në këtë rast Qeveria Shqiptare, nuk janë të shqetësuar për ndërprerjen e vazhdimin të ndërtimit të Rrugës drejt Shkupit. Rruga e Arbrit mbyllet të rrethrotullimi në Maqellarë, i cili ngjan me një nyje trafiku të një province të vogël, jo me një nyje të një aksi të rëndësishëm kombëtar. Parametrat e rrugës që të çojnë në Doganën e Bllatës janë të një kategorie më të vogël se parametrat e projektimit të Rrugës së Arbrit.

BUJAR KAROSHI

Në foto: Bashkimi i dy anëve të tunelit, dhjetor 2023. Foto: MIE



Xhafer Martini sfidoi epokën e lirisë Më 30 tetor 2023 në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u mbajt një sesion jubilar për krijimtarinë e Xhafer Martinit.

Më datë 30 tetor 2023, në kuadrin e Muajit të Letërsisë dhe Arteve, në mjediset e Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, u mbajt një sesion jubilar për krijimtarinë e Xhafer Martinit.

Veprimtaria u organizua nga Lidhja e Intelektualëve Dibranë në bashkëpunim me Akademien e Shkencave të Shqipërisë.

Në këtë veprimtari, përveç anëtarëve të shoqatës, ishin të pranishëm edhe deputetët e Dibrës, Xhelal Mziu dhe Lavdrim Krrashi, si dhe akademikë dhe personalitete.

Takimi u moderua nga Elsa Bitri, nënkryetare e Shoqatës LID dhe punonjëse në Bibliotekën Kombëtare të Shqipërisë.

“Është nder dhe një privilegj për mua që të moderoj këtë veprimtari mbi krijimtarinë e Xhaferit Martinit”, tha ajo në fillim të takimit në sallën “Aleks Buda” të mbushur plot miq dhe lexues të Xhafer Martinit.

Në fillim, përshëndeti kryetari i LID, prof. asoc.dr. Shpëtim Cami, i cili bëri një panoramë të shkurtër të veprimtarive të shoqatës dhe veçmas, mbi organizimin e kësaj veprimtarie.

Më pas, sekretarit shkencor i Akademisë së Shkencave, akademik Shaban Sinanin, mbajti një fjalë përshëndetëse në emër të Akademisë, si dhe mbajti referimin me titull “Për Xhafer Martinin dhe veprën e tij krijuese e shkencore”.

“Xhafer Martini është një prej të paktëve shkrimtarë që vinte nga një kohë tjetër dhe sfidoi epokën e lirisë, përkundër shumicës së tyre, që u mbeti liria në dorë e nuk dinin ç’të bënin me të. Në të kundërtën, Xhafer Martini, me çfarë ka krijuar e botuar gjatë tri dekadave të fundme, është dëshmia e gjallë se çfarë roli ka disiplina e çfarë roli liria në art e dije”, tha akademik Sinani mes të tjerash në fjalën e tij.

Duke iu referuar botimeve të Xhafer Martinit, ai shënoi një lidhje të fortë mes krijimtarisë dhe vendlindjes.

“Xhafer Martini është i rrallë sa i takon lidhjes me vendlindjen, dashurisë për Dibrën dhe ndjenjës së autopërgjegjësive për t’i përruar vlerat dhe visaret e saj në të gjitha format e mundshme: prej jetëshkrimeve monografike deri tek historikët e institucioneve”.

Në fund të fjalës, akademik Sinani tha se “emri dhe vepra e Xhafer Martinit, sidomos kërkimet e studimet e tij, por edhe burimet jo pak, me kohë kanë shtegtuar e janë bërë pjesë e bibliotekave albanologjike në botë. Ai është prej më se dy dekadash një pikë reference për studiuesit e huaj”.

Në referimin e prof. Vesel Hoxhës, e cila u lexua nga Zabit Lleshi, u vu theksi te diapazoni krijues si poet, prozator, tregimtar, novelist, romancier, kritik letrar, mbledhës

dhe studiues i kulturës popullore, publicist dhe analist politik. “Por, - veçohej në referimin e Hoxhës, - Xhafer Martini si studiues është i rrallë në vendin tonë, sidomos në studimet shteruese për Alegorinë dhe Kanunin” (Fjalën e plotë do ta lexoni në numrat e ardhshëm).

Takimi pati shumë surpriza për të pranishmit, edhe për autorin, njëra prej të cilave ishte fjala e dërguar prej larg e shkrimtarit dhe poetit Agron Tufa. Referimi i tij, “Xhafer Martini - Portret shkrimtari sipas përvojës sime” e lexoi për pjesëmarrësit botuesi Bujar Karoshi.

Tufa theksoi lidhjen e tij me shkrimtarin Martini si një lidhje mes nxënësit dhe mësuesit. “Pa këtë lidhje, kushedi s a

unë, nxënësja e profesorit, më erdhi dita të redaktoj e botoj librat e profesorit, pra, të shtoj emrin tim krahas emrit të tij. Kjo është jeta dhe kjo i ka ndodhur edhe të tjerëve madje edhe vetë Xhafer Martinit...”, tha botuesja e librit, Miranda Goleci. Ajo bëri një paralelizëm, të treguar prej Xhaferit, mes tij dhe mësuesit të njohur, Maliq Bitri, mbi nxënësit e tyre Shaban Sinani, tashmë sekretar shkencor i Akademisë së Shkencave.

“Xhafer Martini është një studiues i mirëfilltë, një shkencëtar në kuptimin e plotë të termit. Brezat e tanishëm, por edhe të ardhshëm do t’i jenë falënderues për punën e palodhur që ka bërë ndër vite, me mbledhjen dhe kodifikimin e “Kanunit të Dibrës” dhe jo vetëm. Ai është një shkollë më

vete. Për mua është kënaqësi bashkëbisedimit me të. Duke e dëgjuar, ti mençurohesh, emancipohesh, bëhesh më shumë njeri. Çdo fjalë e nxjerrë prej tij është e thënë bukur, çdo histori e treguar prej tij të mban të ngërthyer në tregim, çdo personazh i treguar latohet me aq bukur, ashtu siç ka skalitur personazhet e të gjithë librave. Xhafer Martini është një figurë shumëdimensionale, një tregimtar i mrekullueshëm, një prozator i fuqishëm, shkrimtar, një enciklopedi e vlerave kulturore dhe njerëzore të Dibrës dhe më gjerë”, tha botuesja Goleci.

Miranda Goleci, së bashku me piktorin Zaim Elezi, zbuluan edhe librin e botuar posaçërisht me këtë rast, “Të tjerët për Xhafer Martinin”. Ilustrimi i kopertinës ishte përgatitur nga Zaim Elezi, dhe iu bë dhuratë autorit në këtë veprimtari.

Për Xhafer Martinin ishte surprizë edhe vlerësimi që mori nga Federata e Paqes Universale Shqipëri, e cila përmes sekretarit të saj, z. Gani Roshi, e vlerësoi me Certifikatën “Ambasador i Paqes”.

Gjithashtu, kryetari i LID, prof. asoc. dr. Shpëtim Cami i dha edhe një Certifikatë Mirënjohjeje në emër të shoqatës. Ndërsa dy biznesmenët, Latif Miha dhe Musa Riçku, nënkryetarë të LID, i dhuruan autorit një çek simbolik.

Këngëtarja Liri Rashë përshëndeti të pranishmit me një nga këngët e saj.

Në hollin e Akademisë ishte vendosur edhe një ekspozitë me të gjithë krijimtarinë e Xhafer Martinit, ndërsa të ftuarit shfrytëzuan çastet e koktejt për biseda të lira dhe foto me njëri-tjetrin.

Xhafer Martini pati shumë emocione gjatë kësaj mbrëmjeje, ndaj nuk mundi ta mbante fjalën e tij përshëndetëse. Ai e ka sjellë me shkrim atë, dhe ne do ta botojmë këtë numër, ndërsa në numrat e gazetës në vazhdim, do të botojmë edhe referimet e tjera të sjella posaçërisht për këtë veprimtari. / Korresp.Rr.A.



“Gjithçka për mua qe surprizë. Nuk dija se në takimin tim do të merrte pjesë akademiku Shaban Sinani, për më tepër, nuk dija që ai do të fliste; as që ma merrte mendja që Agron Tufa do të dërgonte nga Zvicra një shkrim filozofik, por me fjalë të ngrohta e miqësore për mua dhe për krijimtarinë time; nuk dija që Miranda Goleci kishte përgatitur për mua librin e “Të tjerët për Xhafer Martinin”; nuk dija që piktori i talentuar Zaim Elezi do të bënte një portet timin, nuk dija që në takim do të këndonte Liri Rasha, nuk dija që vajza e Hasan Lekës, në mirënjohje për mua, do të më dhuronte një tufë me lule e të tjera. Prandaj u ndodha i befashuar dhe i surprizuar sa më pushtuan emocionet e fjalën s’e mbajta dot. Qe planifikuar ta bëja me gojë, tani po e bëj me shkrim....”



Nga XHAFER MARTINI

Në takimin me mua si shkrimtar që u organizua nga Shoqata e Intelektualëve Dibranë, në sallën e Akademisë së Shkencave, me datë 30 tetor 2023, kishte edhe një pikë të programit që nuk u realizua, dhe pikërisht Fjala e Falënderuese e Shkrimtarit. Kjo ndodhi për faktin se unë në fund të takimit nuk u ndjeva dhe aq mirë fizikisht, ndoshta prej atyre emocioneve të jashtëzakonshme që provova nga fjalët e mrekullueshme që u thanë për mua.

Gjithçka për mua qe surprizë. Shaqir Skara që mbante lidhjet me mua, nuk më tregonte asgjë. Nuk dija se në takimin tim do të merrte pjesë akademiku Shaban Sinani, për më tepër, nuk dija që ai do të fliste; as që ma merrte mendja që Agron Tufa do të dërgonte nga Zvicra një shkrim filozofik, por me fjalë të ngrohta e miqësore për mua dhe për krijimtarinë time; nuk dija që Miranda Goleci kishte përgatitur për mua librin e “TË TJERËT PËR XHAFER MARTININ”; nuk dija që piktori i talentuar Zaim Elezi do të bënte një portet timin, nuk dija që në takim do të këndonte Liri Rasha, nuk dija që vajza e Hasan Lekës, në mirënjohje për mua, do të më dhuronte një tufë me lule e të tjera. Prandaj u ndodha i befashuar dhe i surprizuar sa më pushtuan emocionet e fjalën s’e mbajta dot. Por organizimi i shkëlqyer, fjalët e mbresëlënëse të të tjerëve, nuk u cënuan aspak nga mungesa e falënderimit tim. Por unë nuk mund të rrija pa e bërë atë falënderim. Qe planifikuar ta bëja me gojë, tani po e bëj me shkrim, ashtu si e konceptova dhe ashtu si e mendova gjatë kohës që zhvillohej takimi:

Falënderimi i parë i takon Shoqatës së Intelektualëve Dibranë për këtë takim me mua si shkrimtar. Falënderoj zotin Shpëtim Cami për këtë organizim të shkëlqyer.

Para se të flasë për ata që u morën me këtë punë, dua t’u shpreh mirënjohjen gjithë

Në vend të fjalës falënderuese

pjesëmarrësit në këtë takim, duke filluar me ata që nuk njihesha e duke vazhduar me miqtë e dashamirët, me akademikët e me profesorët, me deputetët, me të gjithë ata intelektualë që më nderuan.

Falënderoj në mënyrë të veçantë ata që punuan që ky takim ta dalë sa më mirë.

Po e filloj me moderatore Elsa Bitri, e cila solli energji të reja dhe freski me mënyrën e paraqitjes që bëri. Por ajo ka shumë për të mësuar. Po ku do t'i marrë këto mësimë? Shkollë e kurse, të paktën në vendin tonë, nuk ka për këtë profesion. Moderatorë dhe moderatore ka shumë, por prej tyre nuk ke çfarë mëson. Kur janë vajza dhe gra, duan të venë në dukje bukurinë e tyre, lukun, siç thonë; kur janë burra, duan të venë në dukje mençurinë e tyre. Ata që ftohen prej tyre për t'u dhënë mend shqiptarëve, grinden e shahen me fjalë rrugaçerore. Nuk merret vesh ku ndodhesh, në një përleshje bandash, apo në një televizion publik.

Por, për të mësuar gjithnjë gjendet një vend, një kohë dhe një mënyrë sjelljeje. Ky vend është në Dibër, në ato kuvendet dhe mexheliset e saj, kur fjala ishte e mençur, e urtë, plot domethënie, me ndjenjë respekti për tjetrin, bashkëbiseduesin. Kjo ndodhte se këto kuvende dhe mexhelise moderoheshin nga burra të shquar që dinin ta kalonin fjalën, mendimin, problemin nga njeri tek tjetri, por në mënyrë aq mjeshitore sa të pranishmin nuk kuptonin se po mësoheshin dhe po drejtoheshin. Për të mos vdekur kjo mënyrë të foluri, unë kam shkruar romanin: "Kur vdiste kanuni" (2012) ku jam përpjekur t'i bëj një autopsi të plotë jetës së dibranëve të hershëm në shekullin e tetëmbëdhjetë, kur jeta ishte rregulluar në bazë të kanunit. Në roman ka shumë ngjarje interesante dhe komplekse, mbi të gjitha ka urtësi e mençuri, konkretizim të funksionimit të odave dhe të mexheliseve, ku rriheshin mendimet për probleme nga më të rëndësishme dhe ku aktivizohej aq bukur fjala e lirë, por e rrafshët dhe e mençur, e organizuar dhe e drejtuar nga moderatorët popullorë. Por nuk është vetëm ky libër. Kanë shkruar edhe të tjerët, dikush më shumë e dikush më pak, për ato zhvillime pozitive në jetën e njeriut shqiptar. Në qoftë se Elsa, do të mësojë prej kësaj përvojë, do të bëhet moderatore ndryshe, pra një moderatore e shkëlqyer.

Akademiku shumë i merituar Shaban Sinani foli për profilin tim si intelektual dhe si shkrimtar. Përçoi përmes fjalës së tij dije e mençuri që vetëm ai mund t'i përçojë. Për shembull, unë nuk e dija se jam i njohur në shumë vende si kanunolog, qoftë edhe për referencë. Këtë e mësova nga akademiku që ka një fushëpamje gjithëpërfshirëse. Kam mësuar prej tij dhe prej librave të tij si të gjithë ata që i kanë lexuar. Librat e tij kanë peshë të madhe në kulturën tonë. Nga Shabani mësova edhe për Migjenin që e kam shkrimtarin tim të dashur. Kisha lexuar, natyrisht, të gjitha librat që janë shkruar për Migjenin, por shumë gjëra nga krijimtaria e



Në foto: Akademik Shaban Sinani, shkrimtari e studiuesi Xhafer Martini (në mes) dhe prof. asoc.dr. Shpëtim Cami, kryetar i LID. Çast nga vlerësimi i krijimtarisë së Xhafer Martinin me mirënjohje nga LID.

Nuk do të kisha dashtë analizë më të plotë dhe më të saktë të personalitetit tim se sa ai që e bën Agron Tufa; nuk do ta kisha dashur vlerësim më të lartë se sa ai i bën krijimtarisë sime. Ai e shkruajti monografinë për mua dhe unë e lexova sa jam gjallë. Tani, nëse ndodh që dikush mbas shumë vjetësh merrret me mua, e ka shumë të lehtë se Agron Tufa më ka siguruar një njohje të imët, në kufijtë maksimal të shprehjes, më ka pasqyruar botën e brendshme dhe shprehjen e jashtme me kaq vërtetësi, pasion dhe kulturë sa nuk mund të bëjë kurrë ndonjë tjetër sado i aftë dhe i talentuar të jetë.

tij mbeteshin të pasqaruara. Shaban Sinani e ndriçoi Migjenin, e futi në shtratin e vet Ballkanik, e vuri përkrah poetëve të tjerë të mëdhenj të asaj kohe si poetët sllovenë, kroatë, boshnjakë, malazesë, serbë, maqedonas dhe bullgarë. Migjenin ishte zëri shqiptar në këtë kor të mrekullueshëm dhe të veçantë të poetëve të këtij pellgu. Nuk mund të kuptohej dhe të shpjegohej Migjeni pa këtë shtrat Ballkanik. Kjo tregon se kulturat interferojnë me njëra-tjetrën, kulturat bashkojnë dhe afrojnë popujt. Shabani në një libër të tij i referohet edhe një vargu të famshëm të eposit tonë se "Unë Tanushën e kam pa, kur e kishim mirë me krali", çka tregon se popujt ballkanas kanë shkruar dikur mirë. Shaban Sinani është nga ata intelektualë që ndezin zjarre për t'i ngrohur popujt duart e mardhura, kurse politikanët ndezin zjarre për t'i djegur popujt. Sa më shumë të kemi intelektualë si Shaban Sinani, aq më shumë do t'i afrohem të mirës së përgjithshme.

Nuk e mendoja gjithashtu që shkrimtari i talentuar Agron Tufa do të sillte një mesazh aq të ngrohtë dhe aq të fuqishëm prej atij vendi të largët. Depërtimi i tij i thellë në

shpirtin e njeriut, analiza frojdiane, mënyra e shprehjes cvajgiane, përfytyrimet kafkiane, autoriteti sartian, metamorfoza dostojevskiane, mirësia dikensiane, janë grumbulluara të gjitha tek ky autor dhe janë bërë pasuri e shprehjes së tij. Metaforat dhe simbolet, asociacionet dhe shoqërimet e ideve, janë një gjë e zakonshme në shkrimet e tij, por në shkrimin për mua, ato janë në gradën më të lartë. Nuk do të kisha dashtë analizë më të plotë dhe më të saktë të personalitetit tim se sa ai që e bën Agron Tufa; nuk do ta kisha dashur vlerësim më të lartë se sa ai i bën krijimtarisë sime. Ai e shkruajti monografinë për mua dhe unë e lexova sa jam gjallë. Tani, nëse ndodh që dikush mbas shumë vjetësh merrret me mua, e ka shumë të lehtë se Agron Tufa më ka siguruar një njohje të imët, në kufijtë maksimal të shprehjes, më ka pasqyruar botën e brendshme dhe shprehjen e jashtme me kaq vërtetësi, pasion dhe kulturë sa nuk mund të bëjë kurrë ndonjë tjetër sado i aftë dhe i talentuar të jetë. Të faleminderit Agron! Më ka marrë malli personalisht, na ka marrë malli të gjithëve. Flas për atë pjesë të kombit që të don. Nuk është thjesht një mall i zakonshëm njerëzor, por një mall që buron nga dalëzotësia që na jepje, nga mbrojtja që na bëje, se, edhe kur ndiheshim të rrezikuar, edhe kur ndiheshim të pashpresë, mendonim se kishim Agronin. Tani të kemi larg dhe malli është përtej njerëzores. Është një mall atdhetar, nëse shprehmi me figurë. Po figurat nuk dalin gjithnjë të goditura. Ka disa vargje të famshëm De Rada:

"Meqë, bir, ke për t'u nisur,
larg mërguar vaft si ylli
që dritën udhës nuk e humb!"

Kudo që të jesh, Agron, ndritsh si ylli sipas konceptit Deradian.

Unë vetë konstatova, por edhe të tjerët ma thanë se kjo veprimtari ka qenë e ideuar dhe e realizuar në praktikë nga çifti Miranda dhe Bujar Karoshi, natyrisht edhe me ndihmën e të tjerëve. Bujari dhe Miranda kanë mbi njëzet vjet që po bëjnë shumë për kulturën dibrane në veçanti, por edhe për kulturën kombëtare. Se kultura, kur është e tillë si ka emrin, është e të gjithëve, bëhet pjesë e kulturës botërore. Botimet e tyre janë të kontrolluara në kuptimin e cilësisë. Nuk mund të botosh tek Bujari e Miranda vepra që nuk e plotësojnë kriterin e cilësisë. Paranë e duan se për atë punojnë, por jo në dëm të artit dhe të kulturës. Dallojnë fort mirë librin nga jolibri. Janë shtëpi botuese me korrektor, me redaktor. Këto dy punë i bën Miranda fort mirë si rrallë kush tjetër. Këtë e dëshmon edhe libri "Të tjerët për Xhafer Martinin" ku janë botuar fjala e akademik Shaban Sinanit, mesazhi filozofik i Agron Tufës, analiza konstruktive e prof. të asoc. dr. Vesel Hoxhës, shkrimi i dr. Fejzulla Gjabrit, analiza e romanit dhe tregimeve të mia nga shkrimtari Ramiz Gjini, fjala plot peshë dhe domethënie e Bujar

Edhe një herë u falënderoj të gjithëve, pa asnjë përjashtim; falënderoj ata që folën, por edhe ata që nuk folën, falënderoj ata që erdhën, por edhe ata që kishin dëshirë të vinin, por nuk mundën. Por unë dua të bëj edhe një falënderim të fundit. Nuk di si do ma merrni, por besoj se, si gjithmonë, do të mirëkuptohemi... Dua të them se unë çfarë kam arritur, e kam arritur se kam pasur në krah Humën: Ajo më ka krijuar të gjitha kushtet dhe është sakrifikuar që unë të jem i lirë vetëm për të shkruar dhe studiuar.

Karoshit, dhe plot shkrime të tjera që e bëjnë këtë libër një monografi të plotë e shkencore për mua. Libri është sponsorizua nga shtëpia botuese M&B, siç janë sponsorizua koketejli dhe një bonus për shkrimtarin nga Latif Miha dhe Musa Rriçku.

Ka shumë vjet që Bujari boton gazetën "Rruga e Arbërit", me sponsorizim të Musa Rriçkut. Gazeta është serioze, autoritare dhe ka ngritur shumë probleme të mprehta me karakter rajonal (për Dibrën), por edhe të karakterit kombëtar. Gazeta dhe Shoqata, si shembull, nuk e ndërtojnë dot "Rrugën e Arbërit", por ato kanë ndikuar shumë që kjo rrugë të ndërtohet. Me gjithë ndërhyrjet e shumë specialistëve për të respektuar projektin fillestar, ky projekt ka pësuar vazhdimisht ndryshime; sot nuk është ajo rrugë që do të dëshironim të ishte. Por mbase nuk do të ishte fare pa ato organizime dhe botime që ka bërë gazeta "Rruga e Arbërit" dhe Shoqata e Intelktualëve Dibranë.

Më impresionoi dhe më la pa mend jo vetëm skicë-portreti im nga piktori Elezi, por edhe fjala e tij e ngrohtë, miqësore dhe pikante për mua. Zëri i bukur i Liri Rashës i dha nota të reja dhe e elektrizoi atmosferën e takimit. Të gjitha qenë të bukura dhe me vend dhe unë ndjehem shumë i respektuar dhe i nderuar.

Edhe një herë u falënderoj të gjithëve, pa asnjë përjashtim; falënderoj ata që folën, por edhe ata që nuk folën, falënderoj ata që erdhën, por edhe ata që kishin dëshirë të vinin, por nuk mundën. Por unë dua të bëj edhe një falënderim të fundit. Nuk di si do ma merrni, por besoj se, si gjithmonë, do të mirëkuptohemi.

Burrat e suksesshëm kanë pasur në krah gra të mrekullueshme: Marksi një tip shumë i vështirë kishte në krah Zhenin e mrekullueshme që u sakrifikua për të; Linkolini - Merin, Kenedi - Zhaklinën, Bushi i Parë - Barbarën, Klintoni - Hillarin, Gorbaçovi - Larisën, Ahmet Zogu - Geraldinën. Nuk besoj të ketë njeri që të mendojë se unë dua ta krahasoj veten me këta burra të mëdhenj, por, për analogji historike, dua të them se unë çfarë kam arritur, e kam arritur se kam pasur në krah Humën: Ajo më ka krijuar të gjitha kushtet dhe është sakrifikuar që unë të jem i lirë vetëm për të shkruar dhe studiuar. Ishte nuse dhjetëditësh kur më lejoi të shkoja në shkollë të lartë. Qëndroi pa mua pesë vjet në kushte të vështira familjare në fshat, në një punë shumë raskapitëse sepse, si mami, përgjigjej për lindjet në shtatëmbëdhjetë fshatra, malorë e kodrinorë, mjaft larg njeri-tjetrit. Partia e Punës kështu vepronte: disa i mbyste me punë, kurse disa i linte të livadhisnin dhe të tundnin zinxhirin. Kur unë mbarova shkollën dhe na dhanë një furrik në Peshkopi, kishim tre fëmijë. Ta fillosh jetën me tre fëmijë me ato rroga të vogla që kishim, ishte një gjë shumë e vështirë. Ajo nuk m'ia ka shkruar librat, por ka krijuar të gjitha kushtet që ato libra t'i shkruaja unë. Prandaj një falënderim i fundit i takon asaj. Burrat, sidomos malësorët, nuk i lavdërojnë gratë, por ne të dy tani jemi në një moshë ku na lejohet edhe një gjë e tillë...



Në foto: Dr. Elsa Bitri, Nënkryetare e LID duke moderuar veprimtarinë

Xhaferi me veprën e tij e ngritit lart, shumë lart Dibrën: Këtë filozofi të popullit të vet ai e materializoi në veprën e vet dhe në formën më të mirë. Duke bashkëjetuar me filozofinë popullore, me mendimin filozofik e juridik të popullit, që nuk i len asgjë mangut filozofisë së kultivuar, prof. Xhaferi e ngren lart edhe popullin e vet; e ngren atë në shkallën e aristokracisë së qytetëruar evropiane.

“Sfida” Xhafer Martini dhe (pa)urtia dibrane

Nga **BAJRAM XHAFA***

Jam shumë i gëzuar që sot marr pjesë në këtë veprimtari që i kushtohet shkrimtarit dhe kulturologut të mirënjohur dibran profesor Xhafer Martinin. Ajo bëhet për të vlerësuar dhe nderuar punën e gjithë jetës së tij të shumanëshme si shkrimtar, studiues dhe hulumtues, krijues, mbledhës dhe konservues vlerash njerëzore të historisë e të kulturës, të mendimit juridik e filozofik të traditës dibrane e shqiptare, gjë e cila, mesa di unë, nuk është çmuar sa duhet deri më sot. Me këtë veprimtari, më duket sikur u çliruar nga një peng a kompleks faji për “borxhin” e pashlyer. Urime e përgëzime për organizatorët, Lidhjen e Intelektualëve Dibrane dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë.

Kur mbaroi Pedagogjiken e Peshkopisë më 1960, ashtu siç pritej, Xhaferi u caktua mësues në fshat. Përveç punës si një mësues i kualifikuar, ai u muar edhe me krijimtari artistike dhe hulumtime nëpër fshatrat e zonës, si punë e dytë. Pas pesë vjetësh, ai fitoi një bursë studimi në Universitetin për gjuhë-letërsi. Vetëm me meritat e punës e të talentit të vet, pa i hyrë në “borxh” ndokujt. E kapërceu edhe peshën e rëndë të biografisë që vinte nga emri i fshatit: Fushë Alijen e kishin bërë fushë lemerije.

Nuk di se çfarë angazhimesh të tjera ka marrë e çfarë barrësh ka mbajtur, por objektivat e tij ishin sa të larta, aq edhe realiste e të mundshme. Një bisedë e rastësishme e me ogur me prof. Çabejn, i vlejti si ato këshillat providenciale që tregohen në përrallat për rrungun e fatit. Ato fjalë pa vrug ideologjik të Çabejt i çmoi si ylli i sabahut. Shkoi përsëri në fshat ku mblodhi ajkën e mendimit juridik e filozofik të dibranëve, kur shumëkush nga kolegët e tij zbrazte lodhjen përmbi filxhanin e kafes dhe gotën e raisë. “Ora et labora!” – lutu dhe puno, ishte motoja e tij (marrë nga frazeologjia kishtarë).

Nuk e di nëse Profesor Xhaferi lutet apo jo, (me veprën e tij studimore do ta kishte merituar plotësisht prej kohësh këtë titull akademik), por, që punon, shihet nga rezultati. Dhe punon fort e me ngulm, me sistem, stil e metodë, pa u ndalë, gjithë jetën. “Facta loquuntur” – faktet flasin. I përmbahet maksimumshtet me burim fetar, puna është “ibadet” (barazohet me lutjen, farzin-faljen e detyrueshme). Vetë protagonistin ynë nuk lëvdohet.

Edhe tani që sapo i ka kaluar të tetëdhjetat, ai nuk i ndahet punës, nuk prânë. Don të jetojë, të jetojë si njeri, si luftëtar, si artist, si krijues, me dëshira, me aspirata, me vullnet, me krijimtari; don të vrasë vdekjen. Dhe e vret atë bukur mirë, si ma i miri. Lakmi për ta pasur.

Sot Profesi ka në aktivin e tij të punës një kolanë të tërë librash, letrare e shkencore sugjestionuese: “Kanuni i Dibrës – trashëgimi etnojuridike” Tiranë, M&B 2016, (botim i tretë-478 faqe; botim i dytë 2007-640 faqe); “Gjakmarria” (1999), “Pajtimi

Kanuni i Dibrës gjeti njeriun e duhur, në kohën e duhur. Qe një dhuratë nga Lartë. Çdo të ishte bërë sot me atë kanun, po të mos ishte bërë kjo punë nga Xhafer Martini? Ai e mbërriti të jetojë me brezin e fundit që kishte aplikuar dhe njohur Kanunin e Maleve të Dibrës. Nuk i la pleqtë dhe të urtët e fshatit të ikin nga kjo botë duke marrë në varr edhe Kanunin. Do ta kishte mbuluar dheu përgjithmonë. Për politikën e Partisë dhe shtetit ideologjik shqiptar, kanuni do të ishte varrosur përgjithmonë, ashtu siç u varros çdo trashëgimi pozitive e traditës. Puna që bëri Prof. Xhaferi ishte një veprimtari e shenjtë, misionare, kombëtare, e paçmueshme. Dhe vepra që doli nga duart e tij është një vepër misionare, e shenjtë, atdhetare, e paçmueshme. Ç’mund të themi përveçse: “Rroftë djali i Dibrës!”. Të tillë lindin rrallë.

në traditën popullore” (2001), “Perlat e Dibrës (Studim)” (1999), “Metaforat e Dibrës”, “Kanun” Tiranë, 2013, “Shekspiri dhe Kanuni” studim, “Enja”, 2015 etj. prodhime të mirëfillta shkencore të shkrimtarit dhe studiuesit tonë, dibranit Xhafer Martini.

Tre herë radhazi e ka botuar dhe përpunuar “Kanunin e Dibrës”. Është njohës i shkëlqyer i të Drejtës Dokësore shqiptare. “Kanuni i Maleve të Dibrës” i Xhafer Martinin, shkruan shkrimtari dhe kulturologu i shquar dibran Agron Tufa në Parathënien e librit, ka të përbashkëta dhe dallime me “Kanunin e Lekë Dukagjinit” dhe “Kanunin e Skënderbeut”: 1. Mospërfshirjen e institucioneve fetare (kishës dhe xhamisë), duke mos privilegjuar e favorizuar në sanksionet kanunore as klerin. 2. Kanuni i Dibrës sipikat për një elasticitet më human e vetpërmbajtje më të thellë në shumë çështje “të nxehta” si “Gjakmarria”, “Hakmarria”, “Gjaku”, “Xhipi” etj. 3. Kanuni i Maleve të Dibrës është dëshmia monumentale e asaj “Atlantida” civilizimi të kredhur në memorien e dibranit.

Në Hyrje të veprës, vetë autori çmon vështirësinë për “mbledhjen dhe kodifikimin e kanunit, për origjinalitetin dhe pasurinë e madhe të Kanunit të Dibrës, i cili ndryshonte shumë në dukuritë më themelore nga Kanuni i Lekë Dukagjinit e Kanuni i Skënderbeut”. Aty autori analizon me thellësi, saktësi e përgjegjësi të lartë shkencore 14 raste të këtyre dallimeve.

Mbledhja e Kanunit është një gjë e mundimshme, shkruan ai. Po aq i vështirë është edhe hartimi i neneve. Një punë të mundimshme prej skllavi. Vetëm një vullnet i fortë, një energji dhe entuziazëm rinor, një dashuri e madhe e një përkushtim vetmohues për njerëzit e vendin e tij - Dibrën dhe për tematikën që trajton, kanë bërë të mundur realizimin e saj. Nesot kemi në dorë një vepër të kompletuar edhe shkencërisht edhe artistikisht. Ashtu si “Gremina ndjell greminën” - “Abyssus abyssum vokat!” (latine) edhe “Maja sjell majën”. Pikërisht majën ka arritur me mbledhjen, kodifikimin, studimin e Kanunit të



Në foto: Prof. dr. Bajram Xhafa

Dibrës.

Anatol Fransi thoshte: “Njohuritë që marrim, që të tregohen, duhet të hahen me shije”. Ato japin informacion nëpërmjet një stili, i cili nuk lë pas dore asnjë nga mjetet letrare që mbajnë pezull vemendjen e lexuesit. Duke bashkuar kështu kureshtjen e shkencës me joshjen e artit, ato tejkalojnë shpesh herë popullaritetin e veprave të letërsisë artistike. Xhafer Martini i zotëronte të dyja këto dhunti: edhe formimin shkencor edhe priirjen letrare. Kanuni i Dibrës gjeti njeriun e duhur, në kohën e duhur. Qe një dhuratë nga Lartë. Çdo të ishte bërë sot me atë kanun, po të mos ishte bërë kjo punë nga Xhafer Martini? Ai e mbërriti të jetojë me brezin e fundit që kishte aplikuar dhe njohur Kanunin e Maleve të Dibrës. Nuk i la pleqtë dhe të urtët e fshatit të ikin nga kjo botë duke marrë në varr edhe Kanunin. Do ta kishte mbuluar dheu përgjithmonë. Për politikën e Partisë dhe shtetit ideologjik shqiptar, kanuni do të ishte varrosur përgjithmonë, ashtu siç u varros çdo trashëgimi pozitive e traditës, Puna që bëri Prof. Xhaferi ishte një veprimtari e shenjtë, misionare, kombëtare, e paçmueshme. Dhe vepra që doli nga duart e tij është një vepër misionare, e shenjtë, atdhetare, e paçmueshme. Ç’mund të themi përveçse: “Rroftë djali i Dibrës!”. Të tillë lindin rrallë.

Kanuni duhet të shoqërohet me praktikën kanunore, ato që në terminologjinë juridike quhen kazuse (shembuj të zgjidhjes së çështjeve në konflikt), gjë që kanunet e tjera nuk e kanë. Edhe e historinë lindjes dhe zgjidhjes së konfliktit si ta tregon njëri nuk ta tregon tjetri. Vetë mbledhja nga

pleqtë e historisë së ngatërresave, gjykimit të tyre, kërkon një durim kali a maceje, një radhë variantesh për ta shkruar. Pastaj stili, gjuha: standarde apo dialektore, dibranishtje a mikrokrahinore, mali a fushe etj. Kazuset dhe ndodhitë jetësore janë modele skicash e tregimesh të shkurtëra, janë esse të vërteta që nuk ngopesh kurrë sa herë që t’i lexosh. Proveni vetë t’ia tregoni ndokujt pasi ta keni lexuar nëse do mund ta thoni pa e deformuar. Sa mund dhe kualifikim i lartë kërkohet për t’i prurë në gjendjen ekzistuese të fiksuar në Kanun. Unë nuk mund të them se sa përqind zë puna “mundi i popullit” dhe “mundi i mbledhësit, kodifikuesit, sistemuesit të Kanunit në gjendjen që është sot. Në fund të Hyrje-s, autori shkruan me të drejtë dhe me shumë fisnikëri: “Kanuni nuk është libri im, por i popullit. Unë jam mbledhësi dhe kodifikuesi i tij i mundimshëm. Nëqoftëse Kanuni pritet mirë, merita është e popullit. Po nuk ndodhi kështu, dështimi është imi”. Mendoj se kjo “deklaratë” duhet marrë me kushtëzim “Pronësia” e Kanunit vërtetë është e popullit i cili nga ana e tij është anonim. Mbledhësi, kodifikuesi, bashkë me kazuset, praktikën juridike e rastet jetësore etj. duhet pranuar se janë “në bashkpronësi” me autorin.

Stilus virum arguit – Lapsi (shkrimi) e bën burrin (= njeriun) të njohur. Boja e shkrimit e dijetarëve krahasohet me gjakun e shehidëve, boja e dijetarëve vjen më e rëndë” thotë Hasan Basriu, dijetar islam i shekullit X.

Xhaferi me veprën e tij e ngritit lart, shumë lart Dibrën: Këtë filozofi të popullit të vet ai e materializoi në veprën e vet dhe në formën më

të mirë. Duke bashkëjetuar me filozofinë popullore, me mendimin filozofik e juridik të popullit, që nuk i len asgjë mangut filozofisë së kultivuar, prof. Xhaferi e ngren lart edhe popullin e vet; e ngren atë në shkallën e aristokracisë së qytetëruar evropiane. Aristokracia = fisnikëria (aristokratllëku) qëndron në radhë të parë në mënyrën e të menduarit; në mendimin filozofik e juridik, në ligjet e formuluar, në kanune, në këngë, valle e histori, në kulturë, në zgjidhjet e aplikuar, në jetën e ndërtuar aty ku jeton. Aty është edhe Seneka edhe Dekarti, edhe Spinoza, edhe Sartri etj. Në këtë kuptim, vetë Xhaferi është një aristokrat i vërtetë. Kanuni është një monument urtësie juridike, filozofike e kulture në të cilin profesori ynë fisnik është “bashkautor”, “bashkëpronar”.

Peshkopia në fillim të shek. XX nuk ishte veçse një fshat mbështetur në një brinjë, por prof. Xhaferi e përshkroi si një kasaba të vërtetë tek libri “Pedagogjika & Personalitete”. Një kërrhlla (kazermë) ka pas në fund të shek XIX. Qytetaria e Sheh Besimit dhe e familjeve të tjera qytetare të Peshkopisë përshkruhen ashtu siç thotë Mehmet Akif në “Safahat”: “Ç’popull i lartë qemë, ajme, ti erdhe e na mjerove”. Qytetaria dhe pastërtia shembullore dibrane, për të cilën në Shkodër flasin me emocion dhe superlativa, Xhaferi i përjetësoi një një vepër studimore dhe artistike njëkohësisht.

Prof. Xhaferi! Kur ishe në Pedagogji si nxënës dhe student, ishe i pashëm, serioz e krenar. U bërë burrë i përformuar, mjeshtër në zanatin tënd, bërë vepra mbushur plot me dije, kulturë dhe kompetencë dhe, tashmë,... plak i hijshëm, i urtë e me mustak, si shqiptarët e motit, si burrat e vaktit. Me atë kapital krijimtari që ngrite dhe gëzon sot, vënë me mundin zotësinë tënde, ç’mund t’i kërkosh më tepër Zotit? Vërtet Partia dhe Pushteti të la gjithë jetën në 8-vjeçare me rrogën e mësuesit duke bërë edhe punën e shkrimtarit e të shkencëtarit, si e punë e dytë, e tretë, e... pa shpërblim para së cilës, puna “e shpërblyer” është krejt, krejt minore por, fundja ky ishte risku yt: baj venë e pi ujë.

Dy mendime të urta që mendoj se do t’i shkonin rastit të jetës suaj. Njëri i shkrimtarit amerikan Mark Tëin kur thotë se “është më mirë t’i meritoni nderet dhe të mos i gëzoni ato, se sa t’i gëzoni dhe të mos i meritoni”. Mendimi tjetër: “Kjo botë është vend për të punuar. Paga e kësaj pune bëhet në ahiret” ka thënë Immam Rrabani. A nuk punuat edhe ju i shtyrë nga ky vokacion? Allahu qoftë i kënaqur me punën tuaj!

Tiranë, 30 tetor 2023

Shënim. Fjalën time nuk arrita ta këndoja në veprimtarinë solemne për shkak se nuk ishte planifikuar dhe të ndonjë keqkuptimi. E po, thashë me vete, le t’i mungojë profesor Xhaferi edhe kjo bjerrije aksidentale të fatësisë, me kusht që të mos i shtohet pjesës së qëllimshme a virtuale të pafatësisë së organizuar.

Liri Rasha: "Kënga ime" në pesëdhjetë vite

Mbi 700 artdashës nga Lezha, Dibra, Tirana, Prishtina e trojet shqiptare ndoqën drejtpërdrejtë koncertin recital "Kënga ime" të artistes së madhe Liri Rasha, ku përfshihej repertori artistik i 50 viteve jetë artistike

Nga: Halil RAMA – Mjeshtër i Madh

Pesëdhjetë vjet të jetës së saj artistike, Liri Rasha – e dekoruar me titujt "Artiste e Merituar", "Mjeshtër i Madh", "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut"; "Qyetare Nderi e Dibrës" dhe "Nderi i kulturës dibrane", si dhe me disa certifikata e trofe për çmime të para në dhjetëra festivale kombëtare e ndërkombëtare, i ka finalizuar me koncertin recital "Kënga ime", në sallën e madhe të Pallatit të Kulturës "Dedë Ndue Lazri", Lezhë.

Artistja famoze që me zërin brilant e performacën e shkëlqyer artistike ka ngritur peshë zemrat e artdashësve në skenat e mëdha të Parisit, Berlinit, Brukselit, Zyrihut, Stambollit e Nju Jorkut, jo rastësisht zgjodhi Lezhën në këtë jubile të jetës së saj artistike. Sepse këtu jeton një komunitet i madh artdashës, jo vetëm lezhjanë e dibrane, por edhe nga trevat e tjera të veriut, që e duan dhe e respektojnë Liri Rashën, si pasaportën artistike të Dibrës.

Të ftuar në këtë mbrëmje të madhe ishin edhe Ilir Shaqiri – Nderi i Kombit, humoristët e mirënjohur Behar Mera e Genc Lleshi, këngëtarja Ingrid Jushi, të cilët ia rritën madhësinë me interpretimet e tyre këtyre koncertit recital.

Ky event i veçantë kulturor ishte ideuar dhe u moderua mjeshtërisht nga Defrim Methasani.

Protagonistja Liri Rasha s'kishte pse të "zhgënjehet", kur mbi 700 artdashës ndoqën me interesim të veçantë koncertin e saj recital me titullin kuptplotë "Kënga ime". Mbretëresha e këngës popullore dhe qytetare dibrane prezantoi biografinë e saj krijuese, jo vetëm si këngëtare e shumëtalentuar, por edhe si kantautore, me repertorin e saj mjaft të pasur.

Në pesë dekada të jetës së saj artistike, Liri Rasha ka formuar profilin e një artisteje profesioniste, duke interpretuar, fillimisht në moshën rinore, 13 vjeç, me ansamblin e Zall-Dardhës, e më pas në Peshkopit, deri në Festivalin Folklorik të Gjirokastrës (1978), për të vijuar për 40 vjet edhe në skena të mëdha botërore.

Koncertin recital e moderoi Defrim Methasani – Mjeshtër i Madh, i cili, fill pas një performace të shkëlqyer të grupit të valltarëve të Ansambllit Artistik "Hazis Ndreu" – Nderi i Kombit, e ftoi artisten në skenë, mes duartrokitjeve të artdashësve të shumtë.

Kënga e saj e parë në këtë recital ishte kolazhi i përzgjedhura në "100 këngët e shekullit", me "Oj fusha e Korabit", për të vijuar me "Vijnë pamporrat" të të madhit Hazis Ndreu.

Me zërin e saj unik, Liri Rasha interpretoi në këtë koncert recital edhe këngët: "Liqenet e Lurës", "Amaneti", "Ndalshkja me m'shkel në prag", "Na çeli prapë thana", "Cucë dibrane" etj., duke dëshmuar se me emrin e saj është e lidhur kënga lirike e njëjës nga trevat më të pasura artistike të kulturës popullore dhe folkut shqiptar. Kjo për faktin se, në rrugëtimin e saj skenik, ajo asnjëherë nuk ka deformuar këngën e bukur popullore.

Kësisoj, nëse të "7 liqenet e Lurës" duket sikur sjell, jo vetëm freskinë dhe bukurinë e tyre të rrallë natyrore, por edhe jehonën e qëndrës së lurjanëve ndaj okupatorëve të



ILIR SHAQIRI: LIRI RASHËS I BURON MAGJI ARTISTIKE TËRË QËNIA E SAJ

PAK BIOGRAFI: JETA ARTISTIKE E LIRI RASHËS

Liri Rasha - Jushi u lind në një familje me tradita dhe talent muzikor. Shkollën fillore e kreu në fshatin e saj, Lashkizë, ndërsa të mesmen në Peshkopit. Ka mbaruar shkollën pedagogjike dhe specializimin për kanto. Talentin e saj e zbuloi mësuesi i matematikës, kur ishte vetëm 13 vjeç, teksa ajo këndonte në shtëpinë e saj. Më pas u shfaq si dritë shkëlqimtare në skenën e Shtëpisë së Kulturës "Haki Stërmilli" Peshkopit dhe si profesioniste me Estradën Profesioniste të këtij qyteti, ku vijoi për afro dy dekada, që nga viti 1973.

Në Festivalin e Gjirokastrës të vitit 1978 ka kënduar këngën "Oj syzeza vetull hollë".

Pas disa vitesh karrierë në skenë, rreth viteve të '80, ka edituar një album me titull "Këngë të zgjedhura nga Liri Rasha", dhe një album tjetër në vitin 2001, me titull "Nusja me të bardha".

Në vitin 1988 ka marrë titullin "Artiste e Merituar". Në vitet 2013 dhe 2020, dekorohet nga Presidenti i Republikës, përkatësisht me titujt "Mjeshtër i Madh" dhe "Kalorës i Urdhërit të Skënderbeut".

Liri Rasha njihet edhe për talentin e saj krijues, ndaj dhjetëra këngë të saja, tekstin e ka shkruar vetë, si p.sh.: "Nusja me të bardha", "Oj zogo", "Oj syzeza vetullhollë", "Cucë dibrane" etj.

Ka marrë pjesë me disa kolazhe në "Këngët e Shekullit". Ajo ka dy fëmijë: një vajzë e një djalë. Vajza e saj, Ingrid Jushi, ka talent për të kënduar këngën popullore dhe bashkë me të Lirien kanë punuar disa kolazhe. Aktualisht jeton në Tiranë, ku mban koncerte e manifestime të ndryshme familjare.

Më 20 mars 2018, me bashkëpunim me Blerina Braka publikojnë videoklipin "Le të tundet vendit". Videoklipin "Ndalshkja me m'shkel në prag" e publikoi më 24 prill 2023, me tekst, muzikë dhe orkestrim nga Naim Gjoshi. Katër ditë më vonë, në bashkëpunim me këngëtarin Hysni Hoxha publikojnë videoklipin "Labinot, si ti s'ka tjetër", kompozuar nga Hysni Hoxha, me orkestrim nga Luan Dagistani. "Shqiptari, ja sot, ja kurrë", me muzikë dhe orkestrim nga Naim Gjoshi e publikoi më 7 qershor 2023, ndërsa "Cucë dibrane", me orkestrim nga Alfred Qemalja e publikoi më 1 tetor 2023. Në fillim të këtij viti, më 7 shkurt 2024, Liri Rasha publikon videoklipin "Loti i vetmisë", ku muzika dhe teksti janë të vetë këngëtares, ndërsa për aranzhimin muzikor u kujdes Alfred Qemalja. Të gjitha videoklipet janë prodhuar nga kompania "Domi Production".

huaj, me interpretimin e vargjeve: "Ky liqeni luleve nën malet me borë, dëshmorëve të Lurës ju qëndron kurorë..."; tek "AMANETI" identifikohet si "zëri i lavdisë shekullore shqiptare", duke përcjellë mesazhin e bashkimit. Kështu zëri i saj kumbon fuqishëm në refrenin "Ju që vini nëpër breza, vit për vit e mot për mot/ Ju bekoftë Nënë Tereza, / Ju bekoftë i madhi Zot...".

Të gjitha këngët e kënduara prej saj janë bërë hite dhe kanë udhëtuar e udhëtojnë me kujtesën e njerëzve, që e duan këngëtares dhe shquar dhe impresionohen nga magjia e shpirtit të saj të bukur artistik, që dallohet jo vetëm në interpretimin e lirikave dibrane, por duke u shfaqur në këtë skenë edhe si orteku i këngës epike me vargjet e këngës: "Ndalshkja me m'shkel në prag/ Ti je serb e unë jam arb".

ILIR SHAQIRI – NDERI I KOMBIT: LIRI RASHËS I BURON MAGJI ARTISTIKE TËRË QËNIA E SAJ

Këngëtarja Ilir Shaqiri ka udhëtuar qindra kilometra që nga Prishtina, për të respektuar ftesën e Liri Rashës, që të përshëndeste në koncertin e saj recital. Këngëtarja, i cili mban edhe titullin Nderi i Kombit, para se të niste këngën, është shprehur se "Liri Rashës i buron magji artistike tërë qenia e saj.

"Liri Rasha është një zë brilant dhe interpretuese e talentuar e këngës popullore e qytetare. Këngët e saj janë të veçanta në shumë segmente krijuese dhe interpretuese. Ajo i përket plejadës së artistëve të mëdhenj të vendlindjes së saj Zall-Dardhës, si: Muharrem Xhediku e Hazis Ndreu, me të cilët ndjehet krenare, sepse kanë bërë

Të gjitha këngët e kënduara prej saj janë bërë hite dhe kanë udhëtuar e udhëtojnë me kujtesën e njerëzve, që e duan këngëtares dhe shquar dhe emocionohen nga magjia e shpirtit të saj artistik, që dallohet jo vetëm në interpretimin e lirikave dibrane, por duke u shfaqur në këtë skenë edhe si orteku i këngës epike shqiptare.

historinë e këngës popullore shqiptare. Ajo dallohet për originalitetin e këngës së saj, që është tej mase i veçantë, qoftë me zërin brilant, të lindur apo të trashëguar (por edhe të kultivuar), qoftë me përzgjedhjen e këngëve, qoftë me forcën e brendshme shpirtërore, mobilizuese, që iu ka dhënë këngëve", - shprehet Ilir Shaqiri.

Ndaj dhe me të drejtë në këtë event Liri Rasha shpallet "Krenaria e Ansambllit Artistik 'Hazis Ndreu' - Nderi i Kombit" nga Presidenti i këtij ansambli Muharrem Gjoka – Mjeshtër i Madh dhe "Qytetar Nderi" i Qarkut Dibër.

"Udhëtimi drejt këngës së këngëtares së mirënjohur dibrane Liri Rasha është një udhëtim drejt një magjie, që sa më shumë të shtyesh në morinë e tingujve dhe trajtave të saj, aq më shumë ndihesh i pushtuar nga magjia e një arti muzikor elitare. Me emrin e këngëtares së shquar dibrane Liri Rasha është e lidhur kënga lirike e njëjës nga trevat më të pasura artistike të kulturës popullore dhe folkut shqiptar. Fuqia e mesazhit të saj, tonaliteti i spikatur lirik, ëmbëlsia dhe finesa e një zëri unik, magjia e një interpretimi të thjeshtë dhe komunikues gjer në detajet më të imëta, e bëjnë atë një këngëtare të preferuar jo vetëm në trevat e Dibrës dhe të veriut, por në gjithë Shqipërinë, në Kosovë, Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi, në gjithë hapësirat etnike shqiptare, si dhe në diasporën e vjetër dhe të re", shprehet Muharrem Gjoka, i cili nuk e fshihet krenarinë si nip i familjes Rasha të Zall Dardhës.

(Vijon në faqen 29)

LLADIMERICA, e ndarë përgjysmë nga kufiri, feston



Pamje nga fshati i Lladimericës - Foto: Kadri Dauti

Banorët mbledhin 40 mijë euro kontribute për investime në fshat. Me to u bënë punime në fshat: u sistemuan varrezat e reja, u hap dhe u shtrua rruga e re për të shkuar makina brenda varrezave, u rrethuan me gardh me tela dhe u vendos porta metalike, u vendosën çezma uji për njerëzit etj.; me financimet e tyre Mufit Halili me vëllezërit e tij rindërtuan çezmën e fshatit me gurrë të punuar bukur të sjellë nga Tirana; u rrafshuan dhe zgjeruan rrugët e brendshme të fshatit.

Nga: **KADRI DAUTI**

Më datë 11 maj 2024, Lladimerica e Kalabardhës ishte në festë. Banorët e saj kishte kohë që përgatiteshin për këtë festë të bukur, që organizohet për të dytin vit radhazi. Vitin e kaluar, pas një komunikimi të gjatë në internet mes bashkëfshatarëve kudo që jetojnë e punojnë, u vendos

fshatçe që të mblidhen një herë në vit, të shtunën e dytë të muajit maj, në fshat dhe të festojnë së bashku. Qëllimi është të ruhen traditat e vyer që kanë banorët e fshatit: dashurinë për vendlindjen, lidhjet vëllazërore, harmonia dhe marrëdhëniet e mira, respekti për të parët e tyre dhe tu transmetohen brezave identiteti dhe kujtesa historike. Dhe mbi të gjitha, të mbahet gjallë jeta në fshat e të mos braktiset.

Më 13 maj 2023, me masa të mira organizative, për herë të parë u organizua festa e Lladimericës, në të cilët morën pjesë gjithë banorët e fshatit dhe shumë familje të ardhura posaçërisht nga qytetet brenda vendit dhe vendet e huaja: Greqi, Kroaci, Itali, Gjermani, Francë, Angli etj. Për organizimin e festës, nën kujdesin e drejtpërdrejtë të birrit të këtij fshati, Sadet Dauti, u ngrit komisioni i festës nën drejtimin e kryeplakut të fshatit, Haxhi Manaj, i cili mori masat e duhura për caktimin dhe përgatitjen e vendit të zhvillimit të festës, sigurimin e orkestrës dhe pajisjeve të nevojshme për uljen e njerëzve etj. Gjithashtu, u caktua një llogari bankare dhe iu bë thirrje gjithë bashkëfshatarëve, veçanërisht atyre që jetojnë e punojnë jashtë vendit, të kontribuonin financiarisht për disa punime infrastrukture në fshat. Si rezultat u grumbulluan rreth 40 mijë Euro, me të cilat u bënë punime në fshat: u sistemuan varrezat e reja, u hap dhe u shtrua rruga e re për të shkuar makina brenda varrezave, u rrethuan me gardh me tela dhe u vendos porta metalike, u vendosën çezma uji për njerëzit etj.; me financimet e tyre Mufit Halili me vëllezërit e tij rindërtuan çezmën e fshatit me gurrë të punuar bukur të sjellë nga Tirana; u rrafshuan dhe zgjeruan rrugët e brendshme të fshatit.

Këto punime e shtuan shumë gjallërinë e fshatit dhe shtuan besimin te banorët e Lladimericës që jeta këtu bëhet e bukur, jeta këtu në këtë fshat do vijojë. E rëndësishme është të mos braktiset fshati në këtë situatë të mungesës së dorës së shtetit dhe të vështirësive të social-ekonomike që po kalojnë mbi 40 familjet e banorëve rezidentë të përhershëm, siç po ndodh në krahinën tonë dhe në shumë fshatra të Shqipërisë, ku janë braktisur dhe po zhduken edhe fshatra të tërë. Se do të vijë dita, do të merren, padyshim, disa masa social-ekonomike që ky fshat të ketë zhvillim e gjallëri, edhe në sajë të pasurive të saj. Një ditë do të asfaltohet rruga nacionale e ndër-

tuar që në fillim të viteve 30 të shekullit të kaluar; do të rihapet dhe ish-pika doganore në Miresh, që banorët e zonës të mos jenë të ndaluar të shkojnë lirshëm në kryeqytetin e tyre, Dibrën e Madhe; do të merren të paktën në përdorim tokat e lladimericasve në anën tjetër të kufirit duke iu krijuar mundësia për përfitime ekonomike etj.

Edhe sivjet, të shtunën e 11 majit, që në orët e para të mëngjesit, në rrugën nacionale Shupenzë - Librazhd udhëtonin shumë makina që i drejtoheshin fshatit Lladimericë. Ishin bijtë e bijat e këtij fshati të vogël piktoresk që shkonin në vendlindje të përmalluar. Sepse aty është vendlindja, aty kanë të parët e tyre, rrënjët e tyre, ajo tokë është e tyre dhe çdo gjë është e lidhur me këtë hapësirë të bukur e të pasur me plotë burime natyrore për jetesë.

Takoheshin me njëri-tjetrin vëlla me vëlla dhe motër, kushërinj e kushërirra, nipër e mbesa, miq e shokë dhe fytyrat u qeshnin. Gëzoheshin për lajmet e mira por edhe ndjenin keqardhje edhe për ndonjë lajm jo të mirë, se jeta i ka të gjitha, gjithësi. Por kur ke pranë dhe ngushëllohesh me njerëzit e tu, me njerëzit e dashur, të gjitha kalohen më lehtë, ndjehesh e vlerësuar dhe mbështetur, për të cilat kemi shumë nevojë të gjithë.

Vendi për festën është zgjedhur një livadh pak para se të në hyrje të fshatit, në anë të rrugës nacionale Shupenzë - Librazhd, në buzë të kufirit politik Shqipëri-Maqedoni e Veriut të caktuar padrejtësisht në 1913, i cili kalon përmes përroit të fshatit dhe ndanë territorin e fshatit tonë, Lladimericës në dy gjysma, duke ndikuar shumë në rënimin e ekonomisë së fshatit. Aty ku në vitet e sistemit socialist,

për shkak të regjimit kufitar, nuk mund të qëndroje vetëm dhe vrojtoheshe pandërprerë nga ushtarët e kufirit, që qëndronin te pika e vrojtimit në kodrën verilindore. Por sot, falë kalamit në sistemin demokratik, kufiri këtu është inekzistent, nuk gjendet asnjë shenjë kufiri shtetëror, si në vitet 1948-1992. Ndonëse lladimericasit e shkulën vetë kufirin dhe klonin sipër fshatit në 1991, që të fitonin të drejtën e lëvizjes si autokton që janë, të shkonin te tokat e tyre në anën lindore të kufirit deri te lumi Drin i Zi si pronë e lladimericasve, të cilën askush nuk mund ta prek, ndonëse është në shtetin politik Maqedon.

Nga komisioni i festës ishin marrë masa të plota organizative për zhvillimin sa më të mirë të saj. Ishin porositur dy restorante për tu shërbyer pjesëmarrësve me ushqime dhe pije, ishin sjellë tavolina dhe karrige, ishte stolitur vendi me flamuj kombëtar, që valëviteshin nën puhizën e lehtë pranverore. Në saj të kontributit financiar të djemve lladimericas në emigracion janë është bërë rrethimi i vendit të festës, është ndërtuar fasada e hyrjes me murr dhe portë metalike, janë ndërtuar dy tualete, janë instaluar disa çezma uji të pijshëm etj., që pjesëmarrësit të festonin sa më mirë.

* * *

Në hyrje të vendit të festës i priste bashkëfshatarët e tij kryeplaku i fshatit, Haxhi Manaj, si gjithmonë i mirësjellshëm, qetë dhe i qeshur me të gjithë dhe u uronte mirëseardhjen.

Erdhën për të gëzuar së bashku me vëllezërit e motrat e tyre në këtë festë të bukur pranverore nga Tirana, Maminasi, Sukthi, Durrësi, Fushë Kruja, Mamurasi, Elbasani etj.



Pamje nga festa në Lladimericë
Foto: Kadri Dauti

Do të vijë dita, do të merren, padyshim, disa masa social-ekonomike që ky fshat të ketë zhvillim e gjallëri, edhe në sajë të pasurive të saj. Një ditë do të asfaltohet rruga nacionale e ndërtuar që në fillim të viteve '30 të shekullit të kaluar; do të rihapet dhe ish-pika doganore në Miresh, që banorët e zonës të mos jenë të ndaluar të shkojnë lirshëm në kryeqytetin e tyre, Dibrën e Madhe; do të merren të paktën në përdorim tokat e lladimericasve në anën tjetër të kufirit, duke iu krijuar mundësia për përfitime ekonomike etj.

shumë burra dhe gra, bijë e bija të këtij fshati me nur e me emër në Kalabardhë: Skënder Halili me të bijën e tij ish-deputeten e Parlamentit Shqiptar, Majlindën, Destan Lika, Sabedin Bala, Veis Bala, Kadri Dauti, Ruzhdi Dauti, Isuf Halili, Fiqiri Dauti, Bedri Dauti familjarisht, Haxhi Sahiti, Bukurosh Halili etj. Erdhën familjarisht apo personalisht Sadet Dauti, Adriatik Dauti, Festim Halili nga Anglia; Dashamir Dauti, Ndrëçim Dauti, Servet Dauti, Ndrëçim Adili nga Italia; Polikron Dauti nga Gjermania; Vladimir Sahiti dhe Shkëlzen Dauti nga Kroacia etj. Kishin ardhur shumë nga bijat e fshatit të martuara në fshatrat fqinje e kudo. Kishin ardhur plotë miq e të afërm të tjerë nga fshatrat e tjerë fqinj, nga zona, por edhe nga Tirana. E të gjithë, lladimericasit me shpirt kanë dashur të ishin këtu në këtë festë, bashkë me vëllezërit e motrat e tyre, por ja që të tilla i kanë rrethanat që nuk mund të vinin sivjet, por me siguri do të vijnë vitin që vjen, më 10 maj 2025. Dhe këtë hijeshi dhe harmoni në këtë festë i kemi dhuratë të bukur nga të parët tanë, që kanë pasur një solidaritet dhe bashkëjetesë vërtet vëllazërore si fshat.

Grupi muzikor "Kodra", tashmë i mirënjohur i krahinës, me djemtë e hijshëm e të talentuar, kishte zënë vend në anë të sheshit të kërcimit. Këngët e kënduara nga zëri i ëmbël i këngëtarit të mirënjohur të krahinës sonë Kalabardhës, Hajredin Gjeta, i dhanë atmosferë hareje dhe gëzimi festës.

Festa u hap me vallen e vajzave të fshatit, veshur gjithë me kostumin tradicional të zonës, të cilët me bukurinë koreografike dhe elegancën e tyre shkëlqyen më shumë nga rrezet e arta të diellit pranveror që rrezatonin mbi qilimin e gjelbër në tokën përreth.

Vallet e stërzgatura me nga 50-60 veta a më shumë, me flamurin në krye të valles, si dikur kur stërgjyshërit e gjyshërit tanë shkollonin luftë me flamurin kuq e zi që u printe, dhe këngët lirike e patriotike nuk mbaruan deri në orët e vona të pasdites. Nën qiellin e kaltër, nën rrezet e arta të diellit, në petkun e gjelbër të natyrës, përzier me cicërimat e zogjve të shumë nëpër pemët përreth kërcenit dhe këndonin bashkë vëllazërisht lladimericasit, si s'ka më bukur, në një harmoni të

mrekullueshme. Se harmona dhe bashkëjtesa me njëri-tjetrin është traditë fisnike dhe e vyer e lladimericasve, ku historikisht në ka sunduar respekti dhe dashamirësia për njëri-tjetrin. Lladimericasit nuk e kanë njohur kurrë hasmërinë, vëllavrasjen, përkundrazi.

Në këtë atmosferë gëzimi nuk mund të rinin pa kërcyer edhe të moshuarit. Destan Lika, në moshë të thyer, nuk duroi më dhe i ndihmuar edhe nga djemtë e rinj kërceu bukur vallet e burrave që e kanë traditë dibranët, duke na kujtuar burrat e moçëm të fshatit, veshur me kostumin tradicional dibran, me qeleshen e bardhe në kokë, që kërcenin bukur, me elegancë valle të rëndë burrash nëpër dasma e gëzime. Ndërsa pëllumbat dhe pëllumbeshat, fëmijët si engjëj të lladimericasve, me brishtësinë fëmijërore dhe dëshirën e madhe gëzonin, kërcenin nëpër vallet dhe vraponin duke tundur flamuj nëpër duar. Ata që nuk kishin, përiqeshin tua rrëmbenin flamurin nga duart të tjerëve që edhe ata të kërcenin me flamur në dorë.

Kur u këndua kënga himn e Dibrës, e Hajredin Pashës, siç është bërë stil tani, u mblodhën gjithë djemtë e rinj lladimericas bashkë dhe ulur në rreth përtokë e me shishe a gota rakie në duar këndonin e brohorisin gëzueshëm, rrethuar nga burra e vajza tek i gëzoheshin haresë dhe hijeshisë së këtij çasti dhe mundoheshin të fiksonin në aparatet e tyre çdo moment. Në mes qëndronte flamuri kombëtar kuq e zi, siç e kanë traditë dibranët kur shkonin në luftë dikur. E ku kish më bukur ku të gjithë si në një korr këndonin me sa zë kishin për të kujtuar me krenari e dhimbje bashkë luftërat dhe sakrificat e të parëve për lirinë e trojeve të tyre. Për të nderuar gjakun e derdhur kundër serbëve, bullgarëve, osmanëve, italianëve e gjermanëve që kanë ardhur këtu për t'i vrrarë, masakruar,



Pamje nga festa në Lladimericë - Foto: Kadri Dauti

grabitur e djegur. Këngët dibrane e patriotike të këngëtarëve të mirënjohur dibran Hazis Ndreut, Lirie Rashës, Vera Laçit, Qerim Sulës, Dritan Jasharit apo Hajredin Gjetës, nuk rreshtën së kënduari.

E s'ka se si të mungonin edhe ushqimet bio të fshatit të përgatitura nga amvisat duararta, që mbushnin plotë tavolinat, aq sa nuk kishe edhe ku t'i vendosje. Shumë bashkëfshatarë, që vinin nga jashtë, kishin porositur pronarin e restorantit të bukur të fshatit, Vinar Sahitin, që tu gatonte shumë ushqime, veçanërisht mish qengji apo keci në hell. E shikoje Vinarin duke vrapuar dhe çuar në tava, tepsia apo tenxhere ushqimet e porositura në çdo tavolinë. Dhe kur e pyesnin sa kushtojnë, u përgjigjej, ju bëftë mirë e mos u mërzisni për koston.

Festonin kështu dikur lladimericasit, gjithë së bashku. Ne fëmijët i prisnin me shumë gëzim, sepse na vinin edhe prindërit tanë kur-

betçinj të gëzonin me ne dhe të na sillin rroba të reja. Festa më e bukur në fëmijërinë tonë ishte ajo e politike e 1 Majit apo ajo pagane e Shën Gjergjit (6 Maj), dhe kjo festë e sotme ngjan më madhështore se atëherë.

* * *

Të gjithë dëshironin që kjo ditë, kjo festë të mos mbaronte kurrë. Por ja që koha ikën, por dhe vjen. Sepse kjo festë kaq e bukur, që po kthehet në traditë, dhe do të vijë kjo ditë vitin tjetër përsëri. Dhe kjo festë flet shumë, flet se lladimericasit janë vërtetë të lidhur shpirtërisht me vendlindjen, me fshatin e tyre të bukur, të traditave më të mira dibrane dhe shqiptare.

Të gëzon vërtet fakti që lladimericasit nuk do e braktisin vendlindjen. Do ta mbajnë dashurinë për të dhe do kujdesen dhe investojnë që infrastruktura e fshatit të përmirësohet nga viti në vit. Lladimericasit, megjithëse nuk

Vendi për festën është zgjedhur një livadh pak para se të në hyrje të fshatit, në buzë të kufirit politik Shqipëri-Maqedoni e Veriut, të caktuar padrejtësisht në 1913, i cili kalon përmes përroit të fshatit dhe ndanë territorin e fshatit tonë, Lladimericës në dy gjysma, duke ndikuar shumë në rrënimin e ekonomisë së fshatit. Sot, falë kalimit në sistemin demokratik, kufiri këtu është inekzistent, nuk gjendet asnjë shenjë kufiri shtetëror, si në vitet 1948-1992. Lladimericasit e shkulën vetë kufirin dhe klonin sipër fshatit në 1991, që të fitonin të drejtën e lëvizjes si autokton që janë, të shkonin te tokat e tyre në anën lindore të kufirit deri te lumi Drin i Zi si pronë e lladimericasve, të cilën askush nuk mund ta prekë...

janë besimtarë fanatikë, kanë xhaminë e tyre të re, me arkitekturë të kohës, kanë një objekt të ri për shërbime të mjekësore, por nuk kanë një shkollë të mirëfilltë, bashkëkohore, për të cilën po interesohen vetë banorët dhe presin investime nga shteti. Sepse fëmijët e Lladimericës dhe të fshatrave përreth e duan dijen e kulturën, e duan progresin shoqëror dhe duan të jenë qytetarë të denjë për vendin e shoqërinë.

Të jesh lladimericas është krenari. Të jetosh në këtë fshat është shëndet e kënaqësi. Ta dash vendlindjen tënde është fisnikëri shpirti, është atdhedashuri, është detyrim moral.

Vendlindja gjithnjë të thërret e të pret krahëhapur!

HOTEL CAMI

HOTEL CAMI

Shijoni magjinë e Dibrës

Për rezervime
 +389 (0) 70 241 205
 +389 (0) 46 841 555
 hotelcami@hotmail.com
 Dibër, Maqedonia e Veriut

HOTEL CAMI

hotel_cami

BASHKËPUNIM EKONOMIK



Dibra e Madhe, Maqedonia e Veriut. Foto: Sami Curri

Në Dibrë të Madhe shtohen bizneset, kontrast me realitetin në bashkitë kufitare të Shqipërisë

www.bulqizaime.al

Numri i kompanive tregtare në Dibrë të Madhe të Maqedonisë së Veriut, vazhdon të ketë rritje. Markat më të rëndësishme ndërkombtare, por edhe vendase kanë hapur pikat e tyre të shitjes, kryesisht në produktet e ndërtimit, por edhe të konsumit të përditshëm. Për ekonomistët në Dibrë, shtimi i kompanive që hapin pikat e tyre të shitjeve në këtë zonë, nuk e shohin vetëm nga konsumatorët lokal, por edhe me konsumatorët e shumtë nga bashkitë Dibrë dhe Bulqizë, në brezin kufitar me Shqipërinë.

Përfaqësuesit e tregtarëve në Dibrë të Madhe, tregojnë se afërsia me Shqipërinë është faktori kyç për hapjen e pikave të shitjes nga kompanitë e mëdha. Kjo pasi qytetarët nga bashkitë në anën tjetër të kufirit gjejnë produkte me çmim shumë më të arsyeshëm. Ata shprehen të kënaqur me volumin e tregtisë në zonë, ndërkohë që vlerësojnë fuqinë blerëse të komunës së Dibrës, duke përfshirë edhe numrin e madh të mërgimtarëve.

Afrim dhe Nazmie Asani janë dy banorë nga Shqipëria, që jetojnë në një fshat kufitar. Si ditë e shtunë ata po blejnë produkte ushqimore në një market të Dibrës së Madhe. Të mbushura plot me produkte, Afrimi i vendos në makinë. "Vizitojmë Dibrën çdo të shtunë për të blerë ushqime. Çmimet janë shumë më të lira këtu se në vendin tonë, dhe gjithashtu furnizohemi edhe me naft me çmim shumë më të ulët", tha Afrimi. Kjo praktikë ndiqet prej shumë vitesh edhe nga banorët e tjerë të Shqipërisë që bëjnë blerje të produkteve ushqimore dhe jo vetëm në Dibrë të Madhe. Valoni, 43 vjeç, jeton në një lagje të Dibrës së Madhe. Ai vlerëson se hapja e marketeve nga kompanitë e mëdha ka bërë që çmimet në marketet lokale të bien. "Konkurrenca në treg është pozitive. Është mirë që tani kemi mundësi të zgjedhim mes opsioneve dhe të gjejmë produkte me çmime më të përballueshme", tha ai.

Anëtarët të odave ekonomike që veprojnë në Dibrë të Madhe, thonë se hapja e marketeve pothuajse nga të gjithë kompanitë e fuqishme të vendit, është një dukuri pozitive për dibranët. Nga Oda Ekonomike thuhet se pozicionimi i Dibrës pranë kufirit me Maqedoninë e Veriut dhe Shqipërinë ka qenë një faktor kyç për interesin e kompanive të mëdha për hapjen e marketeve. Fuqia blerëse e shumë shtetasve shqiptarë në Dibrë është vlerësuar si një stimul për këtë zhvillim tregtar. Rritja e frekuencave në vendkalimet kufitare Bllatë dhe Xhepishë nga shtetasit shqiptarë ka theksuar rëndësinë e kësaj zone si destinacion blerjesh, duke përfshirë jo vetëm artikuj ushqimorë, por edhe atyre teknologjik dhe produkteve industriale. Me shtimin e konkurrencës në tregun e Dibrës dhe rritjen e fuqisë blerëse nga zonat kufitare, pritet që biznesi në këtë zonë të zhvillohet edhe më shumë.

SITUATA NË BASHKITË KUFITARE TË SHQIPËRISË, DËSHPËRUESE

Në anën tjetër të kufirit, në Shqipëri, situata nuk është e njëjtë. Vetëm 5 kilometra

Fuqia blerëse e shumë shtetasve shqiptarë në Dibrë është vlerësuar si një stimul për këtë zhvillim tregtar. Rritja e frekuencave në vendkalimet kufitare Bllatë dhe Xhepishë nga shtetasit shqiptarë ka theksuar rëndësinë e kësaj zone si destinacion blerjesh, duke përfshirë jo vetëm artikuj ushqimorë, por edhe atyre teknologjik dhe produkteve industriale. Me shtimin e konkurrencës në tregun e Dibrës dhe rritjen e fuqisë blerëse nga zonat kufitare, pritet që biznesi në këtë zonë të zhvillohet edhe më shumë.

larg nga Dibra e Madhe, në Maqellarë, një pronar biznesi në tregtimin e karburantit, që preferoi të mbetet anonim, shprehet se blerjet në anën tjetër të kufirit i kanë vendosur në vështirësi: "Ne kemi vite që tregtojmë naftë dhe benzinë. Jemi afër pikëkalimit kufitar. Thjesht punojmë e paguajmë detyrimet, asgjë më shumë. Njerëzit si në Maqellarë, Gjoricë e Bulqizë, por edhe në Dibrë, furnizimin me naftë e bëjnë në Dibrë të Madhe. Nuk ke se çfarë ju thua. Shkon deri në 60 lekë për litër më lirë. Gjithashtu edhe me një rrugë që mund të bëjnë furnizohen por edhe marrin furnizim me ushqime. Ku edhe aty i ke më lirë. Të paktën gati 20% më lirë se tek ne në Shqipëri as që bëhet fjalë."

Dibra, Kukësi dhe Elbasani janë qarqet me aktivitetin më të dobët ekonomik në Shqipëri. Sipas të dhënave të INSTAT, këto zona regjistrojnë nivelin më të ulët të Prodhimit të Brendshëm Bruto për frymë, që varion nga 327 mijë deri në 389 mijë lekë. Këto shifra janë ndjeshëm nën mesataren e vendit me 540 mijë lekë për frymë.

Kjo shpërndarje e dobët e peshës së ekonomisë tek këto tre qarqe përkthehet në më pak investime, më pak vende pune, më pak fuqi blerëse, e rrjedhimisht më shumë varfëri. Kjo mbështetet edhe nga shifrat e tjera të INSTAT, si numri i familjeve që përfitojnë nga ndihma ekonomike.

Rënia e konsumit lidhet me tkurrjen e rëndë të popullsisë në qarkun Dibrë të Shqipërisë, duke u ulur me 16 mijë banorë në 5 vitet e fundit. Gjatë vitit 2022, qarku Dibrë përbëhej nga vetëm 109,585 banorë. Largimet janë përfshirë si migracione brenda vendit ashtu edhe emigracione jashtë tij.

Përpos largimeve, mungesa e fuqisë punëtore është kthyer në një shqetësim jo vetëm për bizneset vendase, por edhe për të huajt që vijnë dhe investojnë në Shqipëri. Në një anketë të kryer nga Shoqata e Investitorëve të Huaj gjatë vitit 2024 vihet re se akcësi i grupeve të interesit në fuqinë punëtore të kualifikuar gjatë këtij viti është përkeqësuar, duke reflektuar kështu vështirësinë që ata kanë për të gjetur punonjës të zotë.



Nga ABDULLA DIKU

Çështja e mbijetesës në zona të tilla si Xibër (Mat) kanë qenë edhe në shumicën e zonave malore të Shqipërisë. Por, me siguri çdo zonë ka patur veçantitë e sajë sa i përket mundësive apo vështirësive. Unë po flas për Xibrin, ato gjëra që di dhe të tjera që mi kanë treguar ato që i kanë jetuar.

DJE

Duket që jeta në Xibër nisi të vështirësohet shumë pas ngritjes së kooperativave dhe kolektivizimit. Një zonë aq shumë malore, do të duhej të barazohej me një zonë fushore sa i përket normave të punës. Ose më saktë, rendimenti do të përcaktonte pagesën që merrje prej punës në kooperativë. Një kanal ujitës 18 km i gjatë, që ri-hapej me krahë çdo vit, i gjithi prej dheu, nuk mjaftonte aspak për nevojat e zonës (njëjtë dhe sot).

Që këtu filloi pabarazia e madhe në zonat fshatare në Shqipëri. Për një punë që bënte një person në Xibër p.sh., paguhej 10-20 herë më pak se për të njëjtën punë në një zonë fushore.

Dita e punës fillimisht ishte vetëm 0.4 lek, ose sa një kuti shkrepe. Më vonë u rrit e u bë 0.7 lek, aq sa kushtonte një kokërr vezë. Pra, do punoje gjithë ditën për të fituar mbase, një kokërr vezë (nëse bëje normën). Dita e punës nuk ishte kurrë 8 orë. Zgjaste aq sa ishte dita, pra nga mëngjesi e deri në darkë. Shumica e personave nuk e bënin dot normën, pasi kohë pas kohe ajo rritej. Zonë malore, vështirë të bëhej norma në një tokë të pjerrët e gjithë gurë. Edhe skllëverit fitonin më shumë, me siguri. Ose dhe nëse nuk fitonin gjë, barkun e kishin të ngopur ama, ndërsa neve nuk na u nda skamja. Dhjetë vitet e fundit të sistemit, pagesa për ditë pune vajti 3 lek (aq sa një bukë misri) dhe ndonjëherë edhe 4 lek (aq sa një bukë gruri). Buka them, e cila nuk ishte asnjëherë e mjaftueshme. Buka e misrit nuk na ndahej për 9-10 muaj, e mezi prisnim 2-3 muajt e verës për pak bukë gruri (më shumë ngjante si baltë e ishte plot hala që të ngelnin në fyt), por më e mirë se e misrit ishte, gjithsesi. Lufta kryesore e banorëve të zonës ajo ishte, të siguronte bukën për familjen. Vetëm atëherë shpirti merrte pak qetësi, aty mes malesh.

Duhet të shkojnë njerëzit tek buka, e jo të çosh bukën tek njerëzit - thonin, por bëhej ndryshe në vendin e harruar. Ecja me thesin e miellit në shpinë ishte bërë ritual shekullor tashmë. Më të vjetrit mbanin mend mirë kohën e zisë së bukës dhe makthi i sajë po ju kthehej dekada më vonë. "Buka është armë" - ka thënë Stalini, dhe në fakt është më shumë se aq.

Një shoku im tregonte: Çova nënën për vizitë te mjeku. Ka diabet, - i tha doktori, - dhe i bëri një listë të gjatë me ushqimet që nuk duhej të hante. Nuk më duhet lista - i kishte thënë nëna. Kam nejt boll pa ngrënë në monizëm. Dua të vdes e ngopur, - tha. Dhe ashtu ndodhi...

Nuk po përmend këtu edhe ushqimin, i cili kishte mangësi më të mëdha (kolektivizimi kishte bërë që qumështi të përpuqej e shkonte drejt qyteteve apo ndërmarrjeve shtetërore si minierat psh.). Ishim keq me bukën, dhe akoma më keq me ushqimin.

Ngjarjet dhe jeta e asaj kohe duken si një film bardh e zi, ndërsa në memorien e banorëve që e jetuan atë kohë ka mbetur vetëm e zeza, ngjyra e skamjes.

Domatet piqeshin vonë, kryesisht në shtator. Bulmet nuk kishte asnjëherë mjaftueshëm. Një litër vaj luledielli (shumicën e rasteve që skuqej lëshonte një erë të tmerrshme) në muaj kishim, gjashtë a tetë persona në familje. Edhe helm të ishte aq pak sa konsumonim ne, asgjë nuk të bënte.

Tregonin për njërin në fshat që thoshte: 'Po të kem bukë, bëj përsesh...por s'kam kos'. Nuk kishim, pra, as njërin e as tjetrën.

Makaronat ishin 'luksi' i ushqimit për ne. Ujin me të cilin ziheshin makaronat e bënim supë. Nuk tepronte asgjë. Luteshim të vinte ndonjë mik, të hanim dhe ne fëmijët makaronat me atë rast (nëse do tepronte gjë). Ne ishim fëmijë e nuk e dinim se duheshin sëpaku dy ditë pune që prindërit të punonin e rropateshin nga mëngjesi e deri në darkë për të blerë një pako makarona. Zot na fal!

Po nënat?!

I rritën fëmijët duke i mbajtur në djep, nëpër arat apo vendet ku punonin për kooperativën. Për to ishte vetë ferri. "Do ja tregoj natës së varrit" - thotë nëna ime edhe sot. S'ka nevojë për shpjegime të tjera...

Nuk kishte të dielë, nuk kishte kurrë ditë pushimi.

Fëmijët u rritën duke punuar, të gjithë, pa përjashtim. Fëmijë pa fëmijëri!

E kur nuk kishte lek mjaftueshëm për bukën, si do kishte, fjala bie, për rroba.

Punonim për të mbledhur bimë mjekësore çdo pranverë-verë dhe ja dilnim disi. Një palë rroba laj e thaj gjithë vitin. Nuk kishte ndonjë dallim të madh mes fëmijëve të familjeve lidhur me veshjen. Ndoshta ndryshonin paska vetëm format e arnave që ishin bërë si harta në rrobat tona. Të mëdhenj e të vegjël me arna ishim. Ndonjë që merrte rrogë shteti kishte pantallona teritali e ne e shihnim me lakmi të madhe...

Shisnim ndonjëherë në pazarin e Klosit ndonjë produkt (patate, vezë a ndonjë punim druri) e në këmbim për të blerë diçka të domosdoshme. Vetë pazari më së shumti ishte i palejuar dhe duhej të bëje kujdes prej të plotfuqishmit-polic, se të merrte e ti shkatërronte ato që kishte për të shitur, e ktheheshe akoma më i varfër nga sa ishte nisur në mëngjes. Sa shfaqej polici, njerëzit merrnin dhenë.

Nuk kishim lek për makinë (një kamion i vogël që e quanin Zis) jo vetëm që nuk bënte rrugë për udhëtarë si ne, por nuk kishim as lek për të, ndaj bënim 4-5 orë rrugë në këmbë, vajtje-ardhje. Ato të fshatit Ketë bënin dhe një a dy orë më shumë se ishin akoma më larg.

Ashtu të veshur si mos më keq, ecnim baltrave të fshatrave të Klosit. Të veshur keq dhe të baltosur, dukeshim si "nëna e drejt" - na thonin, na bullizonin. Binim menjëherë në sy, megjithëse puna e parë që bënte gjithkush prej nesh ishte një 'larje' në lumin e Matit

Çështja e mbijetesës në zona të tilla si Xibri (Mat) kanë qenë edhe në shumicën e zonave malore të Shqipërisë. Por, me siguri çdo zonë ka patur veçantitë e sajë sa i përket mundësive apo vështirësive

Në Xibër, fshatin e harruar pas maleve

Rruga e Arbrit rikthehet të ringjallë zonën. Është bekim për Xibrin, në krejt kuptimin e fjalës. Nëse do më pyeste njeri mua, Xibrin do e bashkoja tani me Tiranën. Meqenëse Tirana po merr (pa pyetur fare) edhe ujin e Gurrave të Gurit të Bardhë, pse të mos i shkojmë mbrapa ujit? Detin e kemi më larg, ndërsa 'mbretin' më afër.

(dimër e verë), sa për të hequr baltën e madhe. Aty poshtë, në zonën e Klosit veçanërisht, kur përmendej Xibri a një banor i Xibrin, për to ishte sinonimi i së keqes. Edhe emrin e zonës nuk na e shqiptonin mirë. Xepri - thonin për Xibrin, duke nënkuptuar zonën më të mbaruar të botës, sipas tyre. Bark-bosh - na thonin. Skuqeshim nga turpi se vërtet ishim të tillë, por jo për fajin tonë. Më keq e kishin ato nxënës të zonës që ndiqnin shkollën e mesme në Klos. Nëse nuk ishin të shkëlqyer në mësim, do e kishin keq me talljen...

Me zonën e Klosit që kemi më afër - nuk kishim shumë lidhje miqësie (përrashtuar disa raste të rralla). Nuk jepnin vajza tek ne, e po ashtu nuk merrnin. Kush mund të sillte vajzën në një zonë që ishte në kufijtë e skamjes?!

Ishim të huaj pra, ngado që shkelnim, veçanërisht aty ku nuk duhej të ishim, në Mat.

I vetmi burim punësimi ishte kooperativa bujqësore. Fare pak njerëz patën mundësinë të punojnë në minierë a ndonjë ndërmarrje shtetërore. Këta ishin njerëzit më me fat. Ndonjë prej tyre kishite dhe radio, ne tjerët dëgjonim kur komshiu i ngrinte zërin, kur i pëlqente ndonjë këngë. Televizor kishim vetëm një në fshat dhe ai ishte në lagjen tonë. Shkonim dhe shihnim dhe ne 2-3 orë natën e vitit të ri. Na rrinte në kujtesë gjithë vitin. Na dukej se kishim parë botën...

Ndonjëherë shihnim dhe filmin që vinte në fshat. Ndodhte shpesh që përfundimin e filmit e shihnim në fillim (ngatërroheshin pa dashje pllakat), por ishte ngjarje e veçantë ama.

Nuk kishim asnjë nga zona jonë që të ishte në organet drejtuese të rrethit (komiteti i partisë apo ai ekzekutiv). Nuk na ndihmonte askush pasi as njihnim e as na njihnin. Ne nuk ekzistonim gjëkund për drejtuesit. I vetmi person që njihnim në ato zyra ishte roja e objekteve në fjalë.

Njerëz punëtorë e fjalëpak ishin ato të zonës sonë. Kush arrinte të kishte fat e të "arritisej" në ndonjë ndërmarrje shtetërore, dëgjonim vetëm fjalë të mira për të. Ne të tjerët i gëzoheshim mjerimit, dhe ndërtonim socializmin e Xibrin.

Të drejtat e studimit ishin problem i madh. Përherë vinin më pak nga sa kishte kërkesa. I merrnin të tjerët, ato që vendosnin atje në 'qendër', fare larg nesh, të harruarve.

Erdhi dhe radha ime për në shkollë (rezultatet i kisha maksimale). U bë mbledhja në fshat. Tre të drejta studimi ishin, mua më ngeli për pyje. Por kishte një 'kleçkë' puna ime. Gjyshi i arratisur në vitin 1949 figuronte akoma në listën e armiqve të partisë. Mbjaj mend nënën që e vajtonte gjithmonë, pa e ditur nëse kishte vdekur apo ishte ende gjallë (as sot nuk dimë gjë për të). Qanim dhe ne bashkë me nënën, se na dhimbsej nëna, por dhe gjyshi që nuk e kishim njohur. Me shumë peripeci, dhe me ca ndere (por jo lek ama se s'kishim), njolla e biografisë u "fshi" për pak kohë. Shpëtova un, por kishte plot të tjerë fare



Në foto: Pamje nga Xibri. Foto. A.Diku

pa fat. U bënë kooperativistë, skllevër.

Çuditë ende kur thotë ndonjëri që kam qenë i internuar, në Lushnjë a në ndonjë zonë tjetër fushore e kodrinore të vendit.

- Ku, ku?! Në Lushnje i internuar?! Zot na ruaj!

Ne, as me mik, nuk na qasin deri në ndonjë kooperativë aty poshtë në Mat, jo më në Lushnjë.

Po hajde jeto në Xibër, siç jetuam ne! Për të thyer bukën e misrit duhej motsharra. Ndodhte që na binte nga dora (buka e rrumbullakët) e merrte tatpjetë kodrës. Bënte 30-40 metra deri në përrua e buka nuk thyhej. Nuk e gjente asgjë. Vetëm qulloset pak kur binte në ndonjë hurdhë uji. Ne e hanim se s'kishim tjetër.

Tregonin në një fshat të ngjashëm si Xibri: Një fshatar i kërkoi sekretarit të partisë që misrin, me të cilin ushqeheshin derrat, ta hanin njerëzit (se ishte më i butë) e derrat të hanin misrin që gatuhej për njerëzit. E sikterosën të ngratin. Do që të na helmosh derrat, - i thanë...

Një rrugë makine copë-copë e kishim, por asnjëherë lek për të udhëtuar me të. Iknim në këmbë deri në Klos (duheshin 2-3 orë rrugë

në këmbë për tu bërë deri atje). Opsioni tjetër ishte Tirana. Për Tiranën duheshin rreth 7 orë rrugë në këmbë për tu bërë. Rrobat lageshin e thaheshin prej shiut 2-3 herë deri në Tiranë. Unë e bëra për 9 vjet atë rrugë, dhe do e bëja sërish me qejf. Nuk na bezdiste njeri... Ndoshta e dinin se ne vinim e shkonim drejt askundit.

Po përse nuk ikët nga Xibri?

Po si të ikje, me duar në xhepa?!

Duheshin lek, duhet të blije një copë shpi a strehë diku. Leku ishte njëri problem i madh. Nga do i bëje lekët kur dita e punës shpërblehej sa një kokërr vezë?!

Partia nga ana tjetër nuk të linte të ikje. Kush do punonte në kooperativë pastaj - thonin.

Si ja bënin ato të zonave të tjera që iknin ama?! Ato i lejonte e njëjta parti, neve jo!

Kishim dhe ne anëtarë partie në zonë. Dhe ata, të varfër si ne tjerët. Nuk po them se ishin të këqinj këta anëtarë, por ato që merrnin vendime për zona të tilla si Xibri ishin një lloj si ato të gestapos gjermane ndaj çifutëve, pa asnjë lloj dyshimi. Si mund të lihen njerëzit ashtu, në ato kushte mizerabiliteti jetese?!

Zot mos e sill më atë kohë...!



Po lidhjen me Zotin?!

Ashtu si në shumicën e vendit, njerëz besimtarë. Barkun bosh por agjëronin. Vinin këta të partisë ndonjëherë e i provokonin duke ju dhënë ujë, për t'ju prishur agjërimin. Kush nuk e pinte ujin, do e pinte e zeza...

E thash dhe më sipër, nuk është se zona të tjera nuk kanë vuajtur si ne, por në rrethin e Matit ne ishim tërësisht të harruar, me dashje, kuptohet. Ishin me fat ato që jetuan në qytet (kishin bukë gruri përherë), e nuk rropateshin si ne atje, shkrepave në Xibër. Ishin me fat të gjitha zonat fushore e me tokë të mjaftueshme, por jo ne. Ishin me fat kush punonte në ndërmarrjet bujqësore apo shtetërore, apo ata që kishin gjetur një mënyrë për të ikur. Ne ishim të harruar nga shteti (dhe partia) e mbase për pak desh na harroi dhe vetë Zoti.

Ngjarjet dhe jeta e asaj kohe duken si një film bardh e zi, ndërsa në memorien e banorëve që e jetuan atë kohë ka mbetur vetëm e zeza, ngjyra e skamjes.

SOT

Fat i madh që sistemi ra, e tani secili në punën e vet. Kush ka krahtë për të punuar e mend në kokë, ka mundësi sa të duash. Kanë ikur plot njerëz nga zona. Vendi ka filluar të ringjallet (ka më pak blegtori tani).

Investimet në zonë?!

Asgjë serioze lidhur me gjërat jetike; veçanërisht uji dhe rrugët.

Ama, rruga e Arbrit rikthehet sërish, ashtu si qindra e mijëra vite më parë, të ringjallë zonën.

Është bekim për Xibrin, në krejt kuptimin e fjalës.

Nëse do më pyeste njeri mua, Xibrin do e bashkoja tani me Tiranën.

Ngahera jemi ndërë mirë me Tiranën. Meqenëse Tirana po merr (pa pyetur fare) edhe ujin e Gurrave të Gurit të Bardhë (e çfarë uji se...!), pse të mos i shkojmë mbrapa ujit?

Detin e kemi më larg, ndërsa 'mbretin' më afër. Është e mundur, them.

Koha e duhur për të vendosur njëherë e mirë, për të mos u harruar më!

Promovohet në Akademinë e Shkencave libri i prof. Nazmi Koçi
"Stomatologjia në Shqipëri" - 2 vëllime.

veprimtari

Një libër dhuratë për stomatologjinë shqiptare...

Botimi i librit "Stomatologjia në Shqipëri - 2 vëllime" është sponsorizuar nga Klinika Evident, Brunilda e Ervin Koçi, si "dhuratë për stomatologjinë shqiptare, siç ka qenë e gjithë jeta ime dhe e pasardhësve të mi në shërbim të saj".

Në sallën "Aleks Buda" në Akademinë e Shkencave të Shqipërisë u mbledhën më 21 nëntor 2023 kolegë, studentë, miq dhe të ftuar të prof. as. dr. Nazmi Koçi, i cili prezantoi librin voluminoz në 2 vëllime, "Stomatologjia në Shqipëri".

Veprimtaria ishte e organizuar nga Komisioni i Shëndetësisë pranë Akademisë së Shkencave dhe botimet Mediaprint.

Prezantimin e librit e hapri prof. Fejzi Keraj, i cili ia dha fjalën e hapjes, akademik Gëzim Hoxhës. Në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Shkencave Albanologjike pranë Akademisë së Shkencave (ASH), Hoxha përshëndeti pjesëmarrësit, duke vënë theksin në bashkëpunimin që ASH i ka dhënë institucioneve dhe autoriteteve shkencore për prezantimet e librave dhe botimeve shkencore.

Akademik Shaban Sinani, njëherazi edhe njëri nga recenzentët e librit, nuk mund të ishte i pranishëm, ndaj fjalën e tij rreth librit "Stomatologjia në Shqipëri", i cili është botuar në dy vëllime, ku i pari përfshin një historik të shërbimit stomatologjik nga lashtësia deri në vitet 1990, kohë kur ky shërbim i privatizua; ndërsa vëllimi i dytë përfshin periudhën nga vitet '90 deri në ditët e sotme, e lexoi akademik Adem Bunguri.

"Askush nuk mund të garantojë se duke qenë edhe dëshmitar, edhe shkruar i historisë, mund t'ia dalë të jetë i baraslarguar prej ngjarjeve. Një gjë është e qartë: vëllimi që i kushtohet në pjesën e katërt shërbimit stomatologjik të dekadave të fundme të shekullit XX në Shqipëri nuk ka të bëjë me ndonjë favorizim subjektiv, por me diferencat që ka bërë vetë historia. Kjo është periudhë e themelive" - citoi Bunguri pjesë nga fjala e Sinanit.

"Unë besoj - shkruan akademik Shaban Sinani, - se duke shkruar këtë libër Nazmi Koçi, profesor, mjek, njeri i shërbimit, ia ka arritur të realizojë atë që latinët e shprehnin me një idiomë të mirënjohur: Corona opus finis - t'i vësh veprës kurorë." (Fjalën e plotë të Akademik Shaban Sinanit do ta lexoni në këtë numër)

PROF. FEJZI KERAJ: "STOMATOLOGJIA NË SHQIPËRI", NJË PORTRET I BUKUR STOMATOLOGJISË.

"Sot për stomatologët është një ditë e shënuar se promovohet historia e stomatologjisë Shqiptare", - tha në fillim të fjalës së tij prof. Fejzi Keraj, i cili në këtë takim ishte edhe moderatori. "Me një përkushtim disaveqar, duke lënë pas dore shumë probleme personale, familjare dhe profesionale, kolegu ynë prof. Nazmi Koçi na ngriti lartë, na bëri me histori, që shumë fusha të tjera do ta kishin zili", tha ai.

Prof. Keraj nuk i kurseu lavderimet për librin dhe punën e prof. Nazmi Koçi.

"Me dy librat e tij "Stomatologjia në Shqipëri", prof. Nazmiu ka ndikuar, jo vetëm në stomatologji, por dhe në historinë e Shqipërisë dhe popullit shqiptar. Ai meriton një vend të veçantë në historinë shqiptare, si historianët e tjerë që kanë kontribuar në fusha të ndryshme", vlerësoi prof. Keraj.



Në foto: Pamje nga veprimtaria. Majtas, ballinat e librit "Stomatologjia në Shqipëri".

PROF. FEJZI KERAJ: "Prof. Nazmi Koçi i ka bërë një portret të bukur stomatologjisë, hartoi një historik që i mungonte, pasuroi literaturën stomatologjike shqiptare... Puna e shkëlqyer e prof. Nazmiut do të mbetet në historinë stomatologjike si një realizim dinjitoz profesional. Këto dy vëllime, me mbi 1000 faqe, kanë sjellë portretin e plotë historik të stomatologjisë shqiptare. Përfaqëson një material të studiuar bibliografik me vlera të veçanta në literaturën shqiptare".

Keraj, duke u bazuar mbi atë çfarë përfshijnë dy vëllimet e librit, vlerësoi kohën që i është dashur autorit të librit të mbledhte materialet, duke trokitur në dyert institucioneve dhe arkivash, duke mbledhur "pjesëza të historikut stomatologjik".

"Vetëm prof. Nazmi Koçi mund ta realizonte një historik të tillë, duke harruar interesat vetjake e familjare, për të na dhuruar një punim dinjitoz me shumë vlera".

Prof. Keraj vlerësoi se "ky historik duhet të jetë pjesë e programit të studimit në të gjithë fakultetet e stomatologjisë, pasi libri tejkalon punimin e një disertacioni".

"Kolegu i ka bërë një portret të bukur stomatologjisë, hartoi një historik që i mungonte, pasuroi literaturën stomatologjike shqiptare. Për gjithë këtë kontribut të autorit, po marr përsipër dhe në emër të shumë kolegëve, me përvojë të gjatë në profesion, ta falenderojmë dhe ta vlerësojmë punën e shkëlqyer të prof. Nazmiut, e cila do të mbetet në historinë stomatologjike si një realizim dinjitoz profesional. Këto dy vëllime, me mbi 1000 faqe, kanë sjellë portretin e plotë historik të stomatologjisë shqiptare. Përfaqëson një material të studiuar bibliografik me vlera të veçanta në literaturën shqiptare", mbylli fjalën e tij prof. Fejzi Keraj.

PROF. ERDA QORRI: DY VËLLIME QË PËRSHKRUAJNË HISTORINË E ZHVILLIMIT TË STOMATOLOGJISË SHQIPTARE

Në emër të Komisionit të Shëndetësisë pranë ASH, e mbajti referimin prof. Erda Qorri.

"Kam kënaqësinë të jem sot këtu, me ju në prezantimin e dy vëllimeve "Stomatologjia në Shqipëri", shkruar nga prof. asoc. dr. Nazmi Koçi. Sikurse thoshte dhe Heminguej: "Nuk ka shok më besnik se një libër", por sot janë dy! Janë dy libra të shkruar me kujdes, pasion, sinqeritet dhe me merak nga një profesionist, i cili që në

moshë djalosare ushqente një dashuri për profesionin e stomatologut. Dashurinë e tij për profesionin e ndjen sa herë që të jepet mundësia të ulësh e të flasësh me të. Është një tregimtar, i cili të le në memorie historitë, ngjarjet e ndodhitë profesionale, pasi zotëron artin e komunikimit, ndërthurur me pasionin dhe dashurinë për stomatologjinë, të cilat do të keni mundësinë t'i gjeni të renditura në faqet e këtyre librave, - tha në fillim të fjalës së saj, prof. Erda Qorri.

"Janë dy vëllime që përshkruajnë historinë e zhvillimit të stomatologjisë shqiptare ndër shekuj. Them ndër shekuj, sepse dr. Nazmiu ka hulumtuar çdo arkivë, shkresë, letër a dokument, i cili ka pasur të shkruar e të dokumentuar në të fillimet e zhvillimit të stomatologjisë shqiptare... Këto vëllime kanë renditur në mënyrë kronologjike fakte reale dhe jo thjesht kujtime profesionale, edhe pse në to do të gjeni të përmendur jo pak nga emrat, fotot apo aktet zyrtare të themelimit apo funksionimit të stomatologjisë në vendin tonë", nënvizoi prof. Erda Qorri.

Duke vazhduar me recensën e saj, profesresha e Albanian University nënvizoi faktin se "dr. Nazmiu sjell një libër, i cili do t'i shërbejë çdo stomatologu të njohë rrugëtimin e profesionit të zgjedhur, një aset i cili mund të përdoret nga pedagogët në auditoret e universiteteve për të prezantuar sadopak nga zanafillat e lashta që ka ky profesion në vendin tonë, ashtu sikurse dhe vendet e tjera të botës, pjesë e të cilës kemi qenë dhe jemi dhe ne".

Prof. Erda Qorri e vuri theksin shkurtimisht te elementët thelbësorë të librit, sipas pjesëve të ndara prej autorit. Ajo vë në dukje në pjesën e parë të librit "ndihmën ndaj problemeve dentare që datojnë që në parahistori dhe Shqipëria, si pjesë e pandarë nga ajo e vendeve të tjera, na përcillet nga autori me historikun e vet, nëpërmjet zbulimeve interesante të mjekut studiues prof. dr. Flamur Tartari në bashkëpunim me

arkeologun Fatos Tartari. Në fakt, të dhënat e gjetura sillnin profilin e një mjekeje ilire në shekullin e II-I p.e.s., dhe libri e historia e tregojnë se sa e vështirë ka qenë përfshirja e femrave në stomatologji".

Prof. E. Qorri vlerësoi se prof. Nazmi Koçi "vazhdon të mbajë gjallë dëshirën për të lexuar, duke përpirë çdo informacion të shkruar në libër, duke filluar nga dentisti i parë shqiptar, shkoderani Hasan Kaduku, i cili ushtronte këtë profesion që nga viti 1896 dhe dentistja e parë Theodita Naçi në Tiranë".

"Zakonisht thuhet se niveli i zhvillimit të shoqërisë përcaktohet prej kujdesit shëndetësor apo kulturës së shëndetit oral, dhe të dhënat e sjella nga autori na bëjnë të shohim realitetin e asaj periudhe, e cila me sa duket, bazuar në raporte e botime artikujsh të dentistëve nëpër gazeta paraqesin ekspertiza dhe thirrje për ngritjen e vëmendjes në këtë aspekt, duke sjellë kështu fakte reale të situatës, ashtu siç ajo ka qenë", citojmë prof. Erda Qorri.

Në recensën e saj, prof. Qorri vuri në dukje se në këtë libër janë të vlefshme edhe informacionet që sjell autori për "decentralizimin e shërbimit dentar, periudhën e shtetëzimit të stomatologjisë, si shërbim me status ligjor, ku merr kuptim theksimi i faktit të kalimit prej subjektivitetit profesional në subjektivitet ligjor, me marrjen e përgjegjësisë nga shteti".

"Dr. Nazmiu na paraqet në libër një panoramë të gjerë të dekadave që i ka njohur vetë, falë faktit se ai ka punuar jo vetëm në Tiranë, por edhe në rrethe, duke qenë vetë pjesë e historisë, ose duke e njohur historinë e këtij shërbimi përmes profesorëve të tij, kolegëve me të cilët ka folur gjatë, kujtimet dhe mendimet e të cilëve përbëjnë një bazë të pasur materiale në këtë libër".

Erda Qorri vuri në dukje edhe informacionet që përcillen në botim në pjesën e katërt të librit, që ka të bëjë me historikun që nga hapja e degës së Stomatologjisë pranë Fakultetit të Mjekësisë në vitin 1959

stomatologji

PROF. ERDA QORRI:

“Janë dy vëllime që përshkruajnë historinë e zhvillimit të stomatologjisë shqiptare ndër shekuj. Them ndër shekuj, sepse dr. Nazmiu ka hulumtuar çdo arkivë, shkresë, letër a dokument, i cili ka pasur të shkruar e të dokumentuar në të fillimet e zhvillimit të stomatologjisë shqiptare... Këto vëllime kanë renditur në mënyrë kronologjike fakte reale dhe jo thjesht kujtime profesionale, edhe pse në to do të gjeni të përmendur jo pak nga emrat, fotot apo aktet zyrtare të themelimit apo funksionimit të stomatologjisë në vendin tonë”.

dhe diplomimin e studentëve të parë në vitin 1964.

Në vëmendjen e recenës së Qorrit ishte edhe shërbimi dentar pas viteve 1990, ku sistemi i stomatologjisë shqiptare kalon në shërbim privat.

“Të mos harrojmë, ky ishte ishte një moment sakrificash të mëdha, përfshi këtu dhe ato ekonomike, por pasioni dhe dashuria për profesionin bëri që profesionistët të rrisnin nivelin e shërbimeve dentare në mënyrë graduale, por të sigurt”.

Në fund të recenës së saj në emër të Komisionit të Shëndetësisë së ASH, prof. Erda Qorri nuk i kurseu fjalët e mira për autorin e librit, prof.as.dr. Nazmi Koçi”.

“Ju ja dolët më së miri në misionin tuaj, “qëmtuat” me durim çdo të dhënë të mundshme që patët në dispozicion, radhitët faktet në një “varg” kronologjik, ashtu si ju ditët më mirë, u mbështetët në këtë rrugëtim nga njerëz të dashur si familja apo miq të mirë që ju rrethuan. Ju jo vetëm u përpoqët, por ia keni dalë të vendosni një “gur në murin e ngrehinës sonë të përbashkët”. Ju keni lënë një trashëgimi për brezat e ardhshme të stomatologjisë në Shqipëri dhe jo vetëm, ju na lini dhe një detyrë, një përgjegjësi, që këtë rrugëtim nga ju të filluar të ketë një vazhdimësi! Ju na treguat si ishte dhe me sa sakrificë shkencë e stomatologjisë u zhvillua në vendin tonë për të ardhur deri këtu”, theksoi Qorri.

NAZMI KOÇI: NJË LIBËR DHURATË PËR STOMATOLOGJINË SHQIPTARE

Autori i librit, prof. Nazmi Koçi, në fund mbajti një fjalë falënderimi, të cilën e nisi nga nëna dhe babai i tij.

“Jam shumë i lumtur që ndodhem sot midis jush, në një moment gëzimi për stomatologjinë shqiptare dhe për mua, si një nga ushtruesit e saj, por do të kisha dashur që sot në këtë sallë plot të kisha edhe disa të tjerë: Nënë time, nga dera e Hoxhë Muglicës, që dinte shkrim e këndim; Babain tim, që më mësoi të ec dhe më mësoi alfabetin e na shkolloi gjashtë fëmijëve; mësuesen time kujdestare të shkollës së mesme, që më mësoi të shkruaj bukur fjalën shqipe dhe ishte prind i dytë për mua”, tha Nazmi Koçi në fillim të përshëndetjes së tij.

Më pas, Nazmi Koçi i nisi falënderimet me lexuesit e parë: Abdurahim Ashiku, akademik Shaban Sinani, profesorët Fejzi Keraj e Pandeli Gole etj. Ai falënderoi të gjithë institucionet që mundësuan sigurimin e dokumentacionit, kolegët në Tiranë e në rrethe për bashkëpunimin, personelin e qendrës shëndetësore dhe popullin e Shupenzës ku punoi 16 vjet, kolegët dhe personelin shëndetësor të rrethit të Dibrës; Fakultetin e Mjekësisë ku ka dhënë mësim më shumë se 20 vjet; Institucionet e Arsimit të Lartë Privat, ku ka punuar e drejtuar; Ministrinë e Shëndetësisë, Shërbimin stomatologjik të Tiranës dhe ASHR, Ministrinë e Arsimit dhe



Në foto: Abdurahim Ashiku dhe Nazmi Koçi pas ceremonisë së prezantimit të librit “Stomatologjia në Shqipëri”.

ASCAL etj.

“Nëse kam harruar ndonjë - më falni, por i përmenda të gjithë këto sepse këta bënë autorin dhe unë bëra një libër”, tha profesor Nazmi Koçi.

Një falënderim i veçantë shkoi për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë; Komisionin e Shëndetësisë, të cilët morën përsipër organizimin e kësaj ceremonie promovimi; ç’ka është vlerësim i punës sime dhe i Stomatologjisë Shqiptare.

Gjithashtu, autori falënderoi edhe “Ilir Dobin, drejtorin e përgjithshëm i kompanisë “Algrafika” si dhe drejtorin e shitjeve, z. Enrik Koçi, për ndihmën e dhënë për sigurimin e letrës së nevojshme për botimin e librit si dhe kujdesin e tyre për të gjetur një bashkëpunëtor tjetër të kujdesshëm dhe serioz në këtë proces, shtëpinë botuese “Mediaprint” dhe znj. Anila Bisha; e cila u kujdes që libri të botohej me shpejtësi dhe me cilësinë e duhur”.

“Përpara se të shkonim të botimi, dua të falënderoj miqtë e mi, Miranda Goleci dhe Bujar Karoshi, me të cilët kemi kaluar një periudhë të gjatë pune: korrigjime, redaktime, faqosje deri te realizimi final i materialit për botim”, tha autori i librit prof. Nazmi Koçi.

Në fund, autori i librit, falënderoi fëmijët e tij, Brunilda - njëherazi edhe redaktorja rigoroze e dy librave, dhe Ervinin (bashkëpunëtor); bashkëshortët e tyre, Fatosi dhe Eva, të cilët i kanë qëndruar hap pas hapi në këtë proces, për të shkruar një libër të denjë për shërbimin e stomatologjisë shqiptare; kolektivin e klinikës “Evident” për gjithë ndihmën e dhënë, si dhe bashkëshorten e tij, Vjollcën, për sakrificat gjatë jetës, në mënyrë që doktor Nazmiu t’i përkushtohet sa më shumë këtij profesioni.

Në promovimin e librit folën edhe botuesja e Mediaprint, znj. Anila Bisha, e cila e vlerësoi librin si një nga botimet më të arrira në këtë fushë, duke ftuar lexuesin ta bëjë pjesë të bibliotekave të tyre.

Më pas përshëndetën edhe Pavli Kongo, Abdurahim Ashiku, Nikolla Bushi, Ramazan Buci, të cilët vlerësuan punën e Nazmi Koçit, jo vetëm librin, por sollën edhe detaje nga bashkëpunimi me të.

Botimi i librit “Stomatologjia në Shqipëri - 2 vëllime” është sponsorizuar nga Klinika Evident, Brunilda e Ervin Koçi, si “dhuratë për stomatologjinë shqiptare, siç ka qenë e gjithë jeta ime dhe e pasardhësve të mi në shërbim të saj”.

Përgatiti: **BUJAR KAROSHI**

Nazmi Koçi - enciklopedi e stomatologjisë shqiptare

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Endej veten të gëzuar që sot jam mes jush. Mes jush pas 27 vjet larg, në troje të huaja, larg, shumë larg, atje ku “çilen e mëshilen malet”... Janë 27 vjet malli e dashurie, mungese të vendeve ku u rrita dhe punova, mungese të njerëzve me të cilët jetova. Janë 27 vjet të humbura. Është një ndjenjë që mërgimtarin kur kthehet në vendlindje, të kapërthen dhe të zë në grykë... Nuk e lëshon... E kupton vetëm ai që e ka jetuar, dhe e jeton.

Nuk kam ndejë duarkryq. Punova kopshet e grekëve, në vend të kopshëve të atdheut tim. Nuk e lash penën të ndryshket. Përcolla në katër vëllime, një mrekulli: Mësuesit vullnetar të gjuhës shqipe në Greqi... RILINDËS TË KOHËS SONË i quajti Dritëro Agolli. Dibrën e kisha në shtëpi, nga mëngjesi në mëngjes. Më mbajti gjallë, në jetë të vërtetë...

Erdha sot nga Athina t’ju dëshmoj pak fjalë e shumë ndjenja e respekt për sebebin e këtij tubimi, Nazmi Koçin, doktor, profesor, studiues, befasia e të cilit më ka hyrë në gjak e është bërë pjesë e qarkullimit të madh e të vogël...

Pata fatin që të jem i pari lexues i një ENCIKLOPEDIË STOMATOLOGJIKE me autor Nazmi Koçin.

Mbase e vetmja e kësaj shkence në botë. E lexova në gjuhë, në fjalë, në fjali, faqe pas faqeje, në mbi të tetëqindat e saj.

Është me të vërtetë një ENCIKLOPEDI, shkruar rrjedhshëm, me një gjuhë të pastër shqipe, e kuptueshme për çdo lexues.

Kur ia përcolla në adresën e tij elektronike, pas falënderimit, më kërkoi të shkruaj parathënien.

U zura ngushtë. Nuk kisha kulturën mjekësore që të gjeja gurët e përshtatshëm që të zinin vend në atë qoshe kulle ku Nazmiu i kishte vënë aq sa mes tyre nuk futej as brisku.

Bëra kompromis me veten dhe i përcolla bisedën që kishim bërë bashkë, bisedë me titull: NUK E KISHA NJOHUR NAZMI KOÇIN E SHKENCËS.

E filloja...

Nuk e kisha njohur Nazmi Koçin

Fotografia e parë që mbushi ekranin e kompjuterit ishte fotografia e Nazmi Koçit tek mjekonte një ushtar në klinikën e tij në Shupenzë, që e kishte pajisur me dashurinë e një njeriu të punës e sakrificës.

Kisha njohur... Një fëmijë dhjetë vjeç, me një çantë bezeje varur krahaqafë, në një udhëtim pesë orë në këmbë për të ndezë në shpirt një dritë, dritën e dijes.

Kaq ishte rruga këmbësore ngjitu e zbrit nga Prodan në Ostren.

Udhëtim në këmbë; në shi, në dëborë, në vapë, udhëtim si në legjenda.

Në këmbë do të udhëtonte Nazmi Koçi fëmijë, i ri, burrë, prind...një jetë të tërë.

Vazhdon të ecë në këmbë... Udhëtim në rrugë pa rrugë, rrafsh e me gropa...

Me Nazmi Koçin kam një kujtim të bukur, kujtim që më duket si një mrekulli hyjnore.

Kur ika një ditë korriku 1996 për ti shpëtuar kosës që kisha mbi qafë jo vetëm unë por tërë familja ime, rastësisht, në një qese të madhe kisha marrë me vete një grumbull negativash fotografikë. Për vite të tërë i përcillja me bezdi sa në njërin dollap të shtëpisë në tjetrin. Në një moment thashë ti hedh në plehra. Nuk e di pse në atë çast nuk i hodha, por mendjen atje e kisha.

Tek pinim kafe me Nazmiun në Tiranë ia thashë dilemën time. Më tha: mos i hidh. Dhe nxori nga xhepi 150 euro dhe më tha “blej një skaner dhe zbardhi. Do të jetosh një mrekulli të jetës tënde”

Filmat ishin të periudhës të viteve 1964 - 1996...

Dhe ndodhi ajo që edhe sot pyes veten e nuk marr përgjigje; ishte një mrekulli apo një rastësi domethënëse?

Fotografia e parë që mbushi ekranin e kompjuterit ishte fotografia e Nazmi Koçit. Një fotografi tek mjekonte një ushtar në klinikën e tij në Shupenzë, atë klinikë që e kishte ndërtuar dhe pajisur me dashurinë e një njeriu të punës e sakrificës.

Ishte e para fotografi në dhjetëmijë që zbardha ditë pas dite, fotografi që mbushin arkivin tim. Malli dhe dashuria ime për Dibrën...

I kam negativët, në dilemën “T’i hedh apo t’i mbaj”

Ishte ky një detaj i përkushtimit shkencor të Nazmi Koçit që e bëri Atë të krijojë një ENCIKLOPEDI profesionale që askujt nuk i ka rënë në mend ta bëjë në profesionin e vet.

Nazmi Koçi kishte udhëtuar “jo pesë orë në këmbë”, por një jetë në këmbë.

Kishte udhëtuar maleve të Dibrës, qyteteve të Italisë, mërgimtar që bashkoi llaçin e mjeshtërive ndërtues të Gollobordas me amalgamën e profesionit e punëtor i palodhur për bukën e ditës dhe ngritjen në profesionit e tij...

Nuk e njihja atë anë të jetës profesionale të Nazmi Koçit, dashurinë e jashtëzakonshme për dhëmbëtarinë, stomatologjinë, dashurinë për njerëzit në përmasat e jetës së tij të vrullshme.

E njoha në librin e tij: ZHVILLIMI I STOMATOLOGJISË NË SHQIPËRI...

E njoha si djallë SHQIPËRIE që vazhdon të udhëtojë me vrap, vrap që e gjen në çdo faqe, në çdo dokument, në çdo portret shkencëtarësh e kolegësh që bënë histori në një profesion...

Një punë voluminoze, zëri i të cilës më vjen nëpërmjet një bibliografie me 498 autorë, nëpërmjet dokumenteve arkivore ku gjeti dyert e mbyllura në Arkivin e Shtetit derisa një herë nuk ishte përmbajtur dhe u kishte përplasë:

“Ju duhet të më ndihmoni, pasi do të kalojë shumë kohë sa të gjendet një budalla tjetër si unë që të lërë klinikën dhe paratë atje dhe të vijë të rrëmojë mbi këto dokumente, një pjesë e të cilëve janë në prag të asgjësimit fizik dhe do të bëhen në të ardhmen të pa përdorshme”.

(Vijon në faqen 26)

“Unë besoj se duke shkruar këtë libër Nazmi Koçi, profesor, mjek, njeri i shërbimit, ia ka arritur të realizojë atë që latinët e shprehin me një idiomë të mirënjohur: *Corona opus finis* - t’i vësh veprës kurorë”.

Një libër diturie, një libër shërbimi, një libër përvoje...

Nga SHABAN SINANI, Akademik

Librin e Nazmi Koçit, mjek dibran me një përvojë që ka kaluar me se gjysmë shekulli, e mora për ta lexuar nxitur prej respektit që rrethonte figurën e tij në një periudhë të shkurtër që kalova në Dibër si nxënës në shkollën e mesme pedagogjike. Atëherë ai ishte *doktori i sëmundjeve të gojës dhe të dhëmbëve*, që duhej t’u bënte derman të gjithëve, por që gjithnjë e më shumë i përmendej emri me lëvdim, krahas me emrin e Rrahim Gjickës, Basri Nezirrit, Sheza Balliut, Qemal Çadrit. Në Dibër ka pasur një nderim të shenjtë për doktorët, nuk e di nëse ruhet ende. Sot Nazmi Koçi është profesor, është doktor për herë të dytë (me doktoratë të mbrojtur), është edhe autor i një libri, të titulluar *Stomatologjia në Shqipëri (nga lashtësia deri në ditët tona)*, të cilin fillimisht e përftova në mendje si një libër përvoje. Por, shumë shpejt, ende pa kaluar në fletët e para, mora njoftimin se botimi i këtij libri ishte miratuar nga Këshilli Kombëtar i Urdhrit të Mjekëve Stomatologë më 2018. Mirë ka bërë Nazmi Koçi me këtë paralajmërim, që na bën të jemi të vetëdijshëm se s’kemi të bëjmë me një rikapitullim dijesh e eksperiencash, që shumë *bjerraditës* ia japin vetes si një luks të merituar.

Stomatologjia në Shqipëri (nga lashtësia deri në ditët tona) është strukturuar sipas një mënyre bashkëkohore, duke ndërthurur metodologjikisht parimin e periudhizimit (kronologjisë) dhe parimin tematologjik. Thënë më shkurt, sistematik e tematik njëherësh, shenjë tjetër paralajmëruese se në vijim do të kemi rastin të takohemi me njeriun e dijës dhe jo thjesht të kujtimeve profesionale, të cilat, sado të bukura të jenë, kanë për shoqërim atë pyetje djallëzore të thënies së të vërtetës.

Dibranët nuk e kanë së brendshmi të shprehur me thjeshtësi. Ndoshta jo vetëm dibranët, mundet gjithë shqiptarët, ballkanasit, njerëzimi. Sidomos ata që kryejnë punë intelektuale. Sepse puna intelektuale është më egoiste se çdo punë tjetër. Është provuar se autorësi kolektive nuk ka. Madje, ndoshta, as në folklor. Mirëpo ja ku vjen Nazmi Koçi, mjek me emër, me një karrierë formimi e riformimi shumë të denjë, që e ka parë botën nga lart dhe nga themelet, dhe na bën një paralajmërim të dytë fisnik: *Nuk e di në i solla ndonjë gjë të re stomatologjisë, por unë i fala asaj çdo gjë të shtrenjtë që kisha, i fala jetën dhe pasardhësit e mi.*

Unë nuk kam njohuri në mjekësi, shpeshherë më është dashur t’i them vetes ndal. Shumë vite më parë, duke shfletuar një tekst të *psikologjisë mjekësore* (kështu quhej atëherë psikanaliza apo psikiatria, s’jam i sigurt), m’u mbush mendja me tmerr se i kisha të gjitha simptomat e një të sëmurë. Dhe e lashë tekstin e mikut tim bashkëstudent mënjanë me betimin për të mos e hapur më. Por kjo nuk më pengon të shpreh disa mendime jashtë urdhrit për librin e Nazmi Koçit. Zakonisht libra të tillë quhen *libra jete*. Mirëpo ky përkufizim sikur e shtije në pranga veprën e Nazmiut tonë. Sepse, përveçse libër jete, në kuptimin *libër misioni*, vepra që ka përgatitur Nazmi Koçi është dhe një *libër shërbimi* dhe për më tepër një *tekst universitar*. Ndoshta sot për sot historia e stomatologjisë nuk zhvillohet si lëndë më vete në formimin universitar, por, sidoqoftë, cilido që do të dëshironte të kalonte në një formim të specializuar në shkollën master e më tej do ta kishte një portë dinjitoze për t’u vetëshërbyer me dije.

Për fushën time të ekspertizës, pjesa e parë e librit, që i kushtohet *parahistorisë së mjekësisë stomatologjike*, që zgjatet në gati dymijë vjet, prej *kulturës së Komanit* e më herët, dhe vjen më këndeje edhe në kohën



Prof. Nazmi Koçi, duke mbajtur fjalën falenderuese gjatë promovimit të librit

e xherahëve, në periudhën otomane, përfaqëson një studim më vete, që u mundëson antropologëve të nxjerrin të dhëna e të bëjnë krahasime për dallimin midis *shërimit*, si kompetencë e lartë hyjnore, dhe *trajtim-it*, si shërbim mjekësh profesionistë. Jam i bindur se do të ketë studiues të shkencave vertikale, siç quhen dijet albanologjike në tërësi, që do ta kenë të nevojshme të këshillohen me këtë pjesë të librit, jo vetëm për të dhënat, por në mënyrë të veçantë për atë pjesë të informacionit që syri i arkeologut apo i historianit s’e sheh direkt.

Vite më parë kam pasur mundësi të njihem me librat e Teki Selenicës dhe të Haxhi Shkozës, që përbëjnë paraqitjet më të statistikuara të zhvillimeve të përgjithshme shoqërore dhe ekonomike në Shqipëri në gjysmën e parë të shekullit XX. Ndoshta kam qenë i pavëmendshëm ose jo aq i interesuar, por s’e kisha vërejtur që shërbimi stomatologjik ishte ndarë prej atij të mjekësisë së përgjithshme në fillim të shekullit XX dhe qysh në vitet 1930 kishte ekzistu-

ar edhe një federatë *dentistësh*. Zakonisht thuhet se niveli i zhvillimit të shoqërisë përcaktohet prej kujdesit për dhëmbët apo kulturës së gojës. Të dhënat që na sjell autori Nazmi Koçi na bëjnë ta shohim me një mënyrë tjetër të vlerësuar atë periudhë, e cila, me sa duket, vetëm në këtë mënyrë, porë prej ekspertizash profesionale, mund të shfaqet siç mund të ketë qenë.

Në pjesën e tretë të librit, që synon të rindërtojë historinë e fillimeve të stomatologjisë si shërbim me status ligjor, megjithëse kufijtë e periudhizimit janë marrë prej historiografisë politike-shtetërore, merr kuptim theksimi i faktit të kalimit prej subjektivitetit profesional në subjektivitetin ligjor, me marrjen e përgjegjësisë nga shteti dhe me krijimin e disa kushteve që mundësojnë kalimin prej disiplinave në nëndisiplina.

Dhe ja ku vjen koha që studiuesi Nazmi Koçi të hyjë në *oqeanin e vet*, të navigojë lirisht nëpër dekadat që ai i ka njohur ose drejtpërsëdrejti, ose përmes profesorëve

■ Askush nuk mund të garantojë se duke qenë edhe dëshmitar, edhe shkruar i historisë, mund t’ia dalë të jetë i baraslarguar prej ngjarjeve. Një gjë është e qartë: vëllimi që i kushtohet në pjesën e katërt shërbimit stomatologjik të dekadave të fundme të shekullit XX në Shqipëri nuk ka të bëjë me ndonjë favorizim subjektiv, por me diferencat që ka bërë vetë historia. Kjo është periudhë e themelive.

të tij (më vonë edhe përmes studentëve të tij). Kjo është koha kur pavijoni dhe katedra bashkohet e ndahen, klinikat dhe fakultetet janë dy dhe një, shërbimi dhe studimi kushtëzohen, del në pah qartësisht që kujdesi për shëndetin shprehet edhe në shkallën infra. Dhe në fakt kujdesi për shëndetin është edhe shprehje kujdesi për jetën. Nuk e di a mund të thuhet nëse shërbimi stomatologjik ka ndikuar që jetëgjatësia e njeriut gjatë asaj periudhe gati u dyfishua. Po ashtu, nuk më duken me rëndësi bindjet qytetare të autorit. Me rëndësi është që këto bindje nuk e kanë ndikuar as për nënçmim, as për mbicim në vlerësimin e periudhës që i është kushtuar. Sido që, edhe po të ishte përfshirë emocionalisht në këtë pjesë të librit, do të ishte krejt e mirëkuptueshme, sepse ai është gjithsesi *brenda*. Askush nuk mund të garantojë (këtu edhe shkruar i këtyre radhëve është vetvetiu i përfshirë) se duke qenë edhe dëshmitar, edhe shkruar i historisë, mund t’ia dalë të jetë i baraslarguar prej ngjarjeve. Një gjë është e qartë: vëllimi që i kushtohet në pjesën e katërt shërbimit stomatologjik të dekadave të fundme të shekullit XX në Shqipëri nuk ka të bëjë me ndonjë favorizim subjektiv, por me diferencat që ka bërë vetë historia. Kjo është periudhë e themelive. Ashtu siç ishte kohë themelish për kardiokirurgjinë, për shërbimet e diferencuara simetrikisht me anatominë e trupit njerëzor dhe të brendësisë së tij.

Unë besoj se duke shkruar këtë libër Nazmi Koçi, profesor, mjek, njeri i shërbimit, ia ka arritur të realizojë atë që latinët e shprehin me një idiomë të mirënjohur: *Corona opus finis* - t’i vësh veprës kurorë.

Nazmi Koçi - enciklopedi e stomatologjisë shqiptare

(Vijon nga faqja 25)

Lexuesi i thjeshtë, brezi im, me siguri do të gjej vetveten, qytetin e tij të vogël që në fëmijërinë e tij as emrin nuk ia kishte dëgjuar profesionit të stomatologut...

Unë fletëve të librit gjeta diçka nga femijëria ime, Zyberin, nallbanin që mbathte kuaj e mushka. Zyberi i Brezhdanit kishte edhe një darë të vjetër, shkulte dhëmbët e bashkëfshatarëve të mi...

Do të shohë si u hapën shkollat, kur dolën dentistët e parë, do ti lexojë edhe emrat dhe shohë fotografitë e tyre përcjellë me nderim e respekt nga autori.

Do të shohë se si shërbimi stomatologjik, hap pas hapi, mbushi qytetet duke u ngjitur edhe në qendrat e fshatrave të bashkuar thellë maleve të Shqipërisë.

Autori rrëfenjën modeste për shërbimin stomatologjik nga “Lashtësia në ditët tona” e ktheu me punë të palodhur, me kërkime të thella shkencore, në një ENCIKLOPEDI...

Gjuha e pastër e bën atë të këndshëm në lexim për të gjithë.

Dokumentet dhe konkluzionet shkencore e bëjnë librin “ZHVILLIMI I STOMATOLOGJISË NË SHQIPËRI” një

libër klase, banche për studentët e mjekësisë, një libër klinike për mjekët stomatologë anë e mbarë vendit.

Dhe më gjerë...

Në fund shënimet e mija modeste për këtë Maratonmak të stomatologjisë shqiptare po i mbyll me një merak të tij...

“Dhe tani më thoni, unë që isha bashkudhëtar për një kohë të gjatë në këtë rrugëtim të saj, a nuk kam të drejtë ta ftoj për një kafe këtë zonjë të rëndë, pse jo t’i bëj dhe një portret, apo një historik modest asaj? Sigurisht që po, edhe pse kjo është një detyrë e vështirë për mua.

Më në fund do të kisha një kërkesë për lexuesit e këtij materiali.

Më parë lexojeni atë.

Nëse keni të dhëna të tjera që i konsideroni të rëndësishme për historikun e shërbimit tonë, mund t’i dërgoni në adresën që do të gjeni në fund të librit, me dëshirën e mirë që në një punim të mëvonshëm ato të jetësohen në përmbajtjen e tij pasi kjo nuk është vepër e një individi, por e një shërbimi të tërë dhe siç e ngritëm atë së bashku, po ashtu duhet ta pasqyrojmë realisht së bashku për t’u lënë një material të shkruar e serioz brezave që vijnë në të ardhmen.

Në këto shkrime jam përpjekur të jem maksimalisht i singertë dhe objektiv, pasi unë do të preferoja që më mirë të më kritikojnë si i paditur se sa si i padrejtë e i pasingertë. Koha është gjyqtari më i mirë për ata që kritikojnë dhe për ata që kritikohen.”

Dhe me një zotim...

“Në paçim jetë e shëndet më duhet të bëj edhe një volum tjetër për vitet e demokracisë. Nuk desha që t’i përziej rreshtat, më mirë veçan...”

Dhe e mbajti fjalën. Sot kemi përpara dy vëllime të një pune që e ngrenë atë në nivelin e enciklopedistëve të mëdhenj të vendit tonë. Pse jo, edhe më gjerë.

Nazmi Koçi vazhdon udhëtimin e tij, udhëtim “pesë orë në këmbë”, simbolikë e jetës së tij... Rrugë e krijimtari të mbarë miku im, miku i të gjithëve!

Dhe në fund një vërejtje shoqërore: NAZMI! TI JE NJË TREGIMTAR I MREKULLUESHËM... Do të desha që rrëfenjat e tua plotë jetë e art, një pjesë e vogël e të cilave janë në arkivin tim, t’i shikoja në një botim luksi. Do të isha i lumtur të jem lexuesi i parë i tyre.

Athinë - Tiranë, 21 nëntor 2023

Misioni diplomatik "Paqe dhe Prosperitet" dhe partnerët e tij ndërkombëtarë amerikanë dekoron një emër të madh në radhët e drejtësisë shqiptare

Avokat Baftjar Rusi, "Misionar i paqes botërore"

I vlerësuar me titujt "Misionar i Paqes Botërore", "Ambasador Nderi", si dhe me Medaljen e Artë "Urdhëri i Misionarit të Paqes Mahatma Gandhi", Baftjar Rusi qëndron stoik në vitalitetin e dibranit, njeriut me vlera të larta morale të integruar në jetën moderne, të një njeriu që shpreh pa droje pozicionin e tij të pandarë nga historia jonë e përbashkët e një tranzicioni social - psikologjik ende të pambyllur

Nga: HALIL RAMA

Në fund të viteve 1980, kur sapo ishte diplomuar për gjuhë-letërsi, erdhi që nga Saranda mësues në gjimnazin e Bulqizës, publicisti dhe prozatori Shefki Hysa. Këtu, të parët që do ta mbështesnin mësuesin jabanxhi, qenë vëllezërit nga Homeshi, Demir e Baftjar Rusi, njëri shef i Shtëpisë së Ushtrakëve Bulqizë dhe tjetri sekretar i Komitetit të Rinisë të rrethit Dibër. Dy vëllezërit, që kishin bërë emër edhe si gazetarë e poetë, mbështetjen për Shefkiun e patën të pakushtëzuar e të pakushtyer edhe për faktin se, me reportazhet e tij në gazetën "Zëri i Popullit" dhe "Zëri i Rinisë", sarandioti i miqësuar shumë shpejt me bulqizakët, po pasqyronte më së miri jetën dhe problematikën e qytetit minoritar të Bulqizës. Dhe, kjo miqësi e pandarë, midis tyre do të farkëtohej në vite e dekada, kur të tre, Shefki, Demiri dhe Baftjari bënë emër edhe në metropolin shqiptar, jo vetëm si poetë, publicistë e prozatorë, por edhe në profesionet e tyre të mirëfillta.

I vendosa këto radhë si hyrje për të mbërritur te ngjarja kulmore e miqësisë së tyre. Misioni Diplomatik "Paqe dhe Prosperitet" dhe partnerët e tij ndërkombëtarë amerikanë - një institucion prestigjioz ndërkombëtar ky me president Shefki Hysën, nderoi avokatin e mirënjohur Baftjar Rusi me titujt "Misionar i Paqes Botërore", "Ambasador Nderi", si dhe me Medaljen e Artë "Urdhëri i Misionarit të Paqes Mahatma Gandhi".

NJË KARRIERË E SHKËLQYER

Në ceremoninë e organizuar nga "Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet" dhe partnerët e tij ndërkombëtarë, ku merite pjesë dhe Dr. Madhu Krishan, të shtunën më 11 maj 2024, personaliteti i drejtësisë shqiptare, Dr. Baftjar Rusi u vlerësua me motivacionin: "Për angazhimin e madh dhe kontributin e çmuar në fushën e Jurispudencës, Arsimit, Qytetërimit, Politikës, Administratës Publike, Paqes, Prosperitetit dhe Njerëzimit, për frymëzimin e bashkëjetesës shoqërore dhe paqes ndërkombëtare".

Ky vlerësim është plotësisht i motivuar për Baftjar Rusin si avokat i suksesshëm; si doktor i shkencave në jurispudencë; si autor i librave dhe artikujve kërkimor në fushën e drejtësisë, të shëndetit të jetës, shëndetit mendor dhe shkencave juridike; si pedagog mësimdhënës; si avokat përfaqësues në Gjykatën Evropiane të Drejtave të Njeriut; si avokat në Gjykatën e Strasburgut dhe Gjykatën Ndërkombëtare Penale në Hagë; si personalitet i nderuar me shumë çmime kombëtare dhe ndërkombëtare; si Misionar i Paqes Botërore; si aktivisti i njohur i Mbrojtjes së të Drejtave të Njeriut; si filantrop dhe Ambasador Nderi i DMPP; si prom-

ovues i Misioneve të Ardhshme që sjellin paqen dhe prosperitetin për mbarë njerëzimin etj.

Këto merita të Baftjar Rusit marrin vlerën dhe dimensionin e duhur, ku në një event të rëndësishëm si ky evidentohen edhe nga personalitetet të njohura të jurisprudence, si nga dy kryetarët e Gjykatës Kushtetuese, Fehmi Abdiu e Bashkim Dedja, nga kryetarja e bashkisë Bulqizë Festime Mjeshtri, apo dhe nga prof. dr. Sulejman Abazi Nesha.

Bashkim Dedja, një ndër përfaqësuesit dinjitozë të elitës dibrane në metropolin shqiptar e më gjerë, që i ka ngjitur me meritë shkallët e karrierës deri në krye të institucionit më të lartë të drejtësisë shqiptare, vlerëson se për z. Baftjar Rusi, nuk do mjaftonin artikuj, emisione televizive për të nxjerrë në pah të gjithë vlerat e tij shumëdimensionale.

"E vlerësoj shumë, në radhë të parë si një prind e familjar i mirë e i përkushtuar; si një shok e mik i rrallë e me vlera të padiskutueshme; si një profesionist drejtësie i përgatitur e këmbëngulës i pasqorë në arritjen e rezultateve; si një bamirës e filantrop, që rrallë e gjen në realitetin shqiptar, si një studiues e akademik në ngritjen e nivelit të tij profesional e intelektual dhe në përcimin e dijeve e njohurive të tij të tjerët, si një bashkëpunëtor e bashkëbisedues i palodhur me një durim deri në ekstrem, që i bën nder dhe krenari vendlindës së tij, Dibërës, Shqipërisë dhe shqiptarëve kudo që ndodhen e kujt do i ndodhet pranë", shprehet z. Dedja.

NJË EMËR I MADH NË RADHËT E DREJTËSISË

Prof. dr. Sulejman Abazi Nesha - Doctor Honosis Causa për Sigurinë dhe Paqen, Profesor Nderi i ABP dhe UBP, Neë York, që mban Medaljen e Artë "Gjenerali Paqes Ajzenhauer", në fillim të fjalës së tij u shprehu mirënjohje guvernatorit, dr. Shefki Hysa dhe dr. Madhu Krishan për zgjedhjen më të mirë për të akorduar këtë titull kaq të lartë ndërkombëtar, duke e dhënë për herë të parë në Shqipëri, pikërisht njeriut të merituar, dibranit dhe shqiptarit të mirë, dr. Baftjar Rusi. Sepse personaliteti



Në foto: Avokat Baftjar Rusi

i tij është një vlerë e shtuar e Misionit Diplomatik për Paqe e Zhvillim, e Korpusit të Madh të Njerëzve të Paqes në Botë, e atyre njerëzve që jetën e tyre ia kanë përkushtuar Drejtësisë, Lirisë, Paqes dhe Humanizmit njerëzor. Ai e konsideroi Baftjar Rusin një emër të madh në radhët e drejtësisë shqiptare, në fushën e Avokatisë.

Në një radhitje dhe rendje plotësisht e modesti, e cila na kujton se kemi shumë për të bërë dhe për të promovuar me merita të plota personalitete të veçantë të jetës shqiptare, prof. Sulejman Abazi Nesha nënvizoi vendosmërinë intelektuale që e ka shoqëruar personalitetin e Baftjarit nga moshë e re e deri më sot. Ai vjen në realitetin e kohës, duke pasur mbi supet e tij peshën e viteve të punës dhe të profesionit të vështirë.

"Përtej të zakonshmes, Doktor i Shkencave të Jurispudencës shqiptare, tashmë si një jurist-avokat me kulturë të ndërthurur evropiane, kaloi në rrugën e vështirë të aktivitetit shoqëror dhe politik në qarkun e Dibërës, të asimimit dhe kualifikimit në Universitetin e Tiranës, dhe më tej si mësimdhënës, për t'u vendosur përfundimisht në Tiranë, pa shkëputur asnjëherë lidhjet me vendlindjen. Nga viti 1995 e deri më sot, vazhdon të ushtrojë profesionin e Avokatit të dëgjuar dhe respektuar në Shqipëri. Autor i botimit "Mbi të Drejtën", ai ka treguar se është një studiues dhe mik i shtrenjtë për librin, duke rritur cilësinë e tij profesionale përmes mbrojtjes së qindra çështjeve për vepra penale e civile deri në gjykatat Ndërkombëtare në Hagë dhe Strasburg. Një rrugëtimin sfidant, përmes

shumë vështirësive, për të arritur majat, ku përveç seriozitetit, drejtësisë dhe aspërsisë së profesionit, ai ka gjetur rrugën e reflektimit të dashurisë njerëzore, larg urrejtjes, i mbështetur në optimizmin karakteristik të njerëzve të fortë, që jeta u ka mësuar të bëhen pjesë e të mirës dhe të distancohen nga ligësia, hipokrizia, duke formuar gradualisht një anë të tjerë të karakterit dhe personalitetit të tij, shpirtin human dhe paqësor", - tha ndër të tjera prof. Sulejman Abazi Nesha.

MISHËRUES DHE PËRÇUES I VLERAVE MË TË MIRA NJERËZORE DHE INTELLEKTUALE

Misioni Diplomatik Paqe dhe Prosperitet dhe partnerët e tij ndërkombëtarë kanë të drejtë në këtë vlerësim për njeriun atdhetar, që e do shumë atdheun e tij, Dibërën dhe Shqipërinë, që shfaqet me tabanin popullor, duke reflektuar fisnikërinë e origjinës prindërore, të njeriut modern dhe të civilizuar, juristin dhe avokatin e vendosur për të mbrojtur dhe për të dhënë drejtësi njerëzve të shantazhuar nga strukturat konjunkturale të drejtësisë.

Drejtësia në thellësi të shpirtit të tij njerëzor dhe human reflekton siguri, paqe dhe mbështetje, kundër komplekseve dhe paragjytimeve të jetës tonë të traumatizuar nga pasojat e kohës. Është kjo drejtësi e thellë brenda shpirtit të Avokatit, që kërkon në vijimësi zgjimin dhe rizgjimin e energji pozitive për të përcjellë në opinion një mesazh shprese dhe rilindje të vërtetë morale e shpirtërore. Të gjithë e ndiejmë se kemi shumë nevojë për këtë. Brenda një portreti

të thjeshtë në pamje, por shumë vital në vullnetin e tij të imponimit, komunikimit, të njohjes dhe të sjelljes, të vendimmarrjes mbi drejtësinë, shpaloset figura humane e paqësore e Dr. Baftjar Rusit. Luftëtari kundër së keqes, që po vazhdon të dhunohet dhe trishtohet jetën tonë, kundër padijes dhe korrupsionit, kundër pangopësisë dhe politikës memece, kur është fjala për drejtësinë e munguar, ky realiteti i dhimbshëm është objekt i qëndrimit të palëkundur të avokatit të nderuar, kundër klaneve, ndërhyrjeve, presioneve për shkak të konfliktit të interesave, për ta bërë atë pjesë të drejtësisë së munguar dhe të padrejtësisë.

"Nëse do të jesh në bisedë me Baftjarin, do të kuptosh menjëherë se në mendimet e tij dallon vlerësimi për jetën e njeriut të dominuar përherë nga barbaria, kaosi, dhuna, por dhe mirësia dhe dashuria. Gjithmonë kundër së keqes do të gjendjen hapësira për t'i dhënë formë shpresës", thonë shokët, miqtë dhe kolegët e tij.

"Kur flet me të, - thotë prof. dr. Sulejman Abazi Nesha, të krijohen imazhe të qarta mbi atë që ai mendon për traditat, realitetin e sotëm dhe pasojat e një ndryshimi të vonuar. Ai të jep përshtypjen e një interlokutori të pandalshëm midis vlerave të jetës në një pafundësi ngjarjesh si një vajtje - ardhje që të mban afër dhe të lidhur me realitetin që përjetojmë.

Ai mbetet si gjithmonë fisnik dhe i freskët në mendime, siç mund ta keni njohur në ditën e parë të miqësisë me të. Ai qëndron stoik në vitalitetin e dibranit, njeriut me vlera të larta morale të integruar në jetën moderne, të një njeriu që shpreh pa droje pozicionin e tij të pandarë nga historia jonë e përbashkët e një tranzicioni social - psikologjik ende të pambyllur.

Ky është personaliteti i njeriut që duam, që aq shumë e dëshirojmë në majat e drejtimit të piramidës së shtetit dhe të shoqërisë. Larg kompleksitetit të jetës, Baftjar Rusi shpalos ndjenjat e larta të humanizmit dhe të mirësisë njerëzore, duke mos harruar kurrë se i mjafton të ndihet qetë në vetëdijen e tij, kur përfshihet me kurajo në realizimin e gjërave të vogla, por me dashuri të madhe. Kjo është tipikja e personalitetit të Shenjtërisë së saj, Nënë Terezës Shqiptare. Këtë ka marrë përsipër të bëjë krenaria e Dibërës, miku dhe shoku ynë i mrekullueshëm, dr. Baftjar Rusi.

Ai ka marrë shumë lëndë dhe dekorime gjatë jetës dhe karrierës së tij, nga institucione dhe organizata e organizma kombëtarë dhe ndërkombëtarë, por titujt "Misionar i Paqes Botërore", "Ambasador Nderi", si dhe Medalja e Artë "Urdhëri i Misionarit të Paqes Mahatma Gandhi" e vendosin në hierarkinë e personaliteteve më me vlerë të kombit shqiptar. Personalitete të njohura të avokatisë, si Baftjar Rusi, kanë lajtmotiv dhënien sa më shumë lumturi të tjerëve. Ai ka qenë gjithmonë dhe është një prijës i së mirës shoqërore, i së mirës së përbashkët, një talent në fushën e jurisprudence. Baftjar Rusi është modeli i njeriut fisnik, autoritar, të çiltër, të dashur, bashkëpunues dhe të gjindshëm në çdo vështirësi. Si mishërues i urtësisë dhe mençurisë dibrane, ai kudo dhe kurdoherë përçon vlerat më të spikatura njerëzore dhe intelektuale.



Në foto: Avokat Baftjar Rusi (në mes) mes bordit drejtues të Misionit Diplomatik "Paqe dhe Prosperitet".

7 POEZI

Agron Tufa

fiton çmimin letrar "Vehxhi Buharaja" 2024

Poeti Agron Tufa u nderua me çmimin letrar "Vexhi Buharaja" 2024 në gjininë e poezisë. Ky ka qenë edicioni i pestë i këtij konkursi, i cili organizohet nga Bashkia e Beratit, në nderim të dijetarit, përkthyesit, studiuesit dhe poetit Vexhi Buharaja.

Njoftimi u shpall me 10 maj 2024 dhe autorit iu bë e ditur me një email.

Juria e këtij konkursi këtë vit ishte e përbërë nga Ymer Ciraku, Dok. Studiues i letërsisë; Olimbi Velaj, poete, përkthyes, gazetar, lektore; Aleksandër Çipa, publicist, gazetar dhe njëkohësisht edhe Kreu i Unionit të Gazetarëve Shqiptarë; poeti dhe përkthyesi Primo Shllaku dhe Yzedin Hima, poet, studiues, eseist, doktor në studimet letrare.

Njoftimi për ndarjen e çmimeve ishte pak konfuz, nëse Tufa e kishte fituar çmimin me poezitë apo me esetë, por këtë dilemë e zgjidhi ai vetë përmes një postimi në Facebook.

"Më gëzoi ky çmim që mban emrin e poetit, përkthyesit, studiuesit tejet të veçantë e të panjollë në letrat shqipe - shkruante Agron Tufa në profilin e tij në FB. - Faleminderit Jurisë për vlerësimin dhe departamentit të kulturës së Bashkisë së Beratit, që po e kthejnë në traditë të përvitshme gjithkombëtare çmimin letrar "Vexhi Buharaja"! Informacionet rreth çmimit duket se janë përcjellë me konfuzitet, duke më përmendur si fitues jo në poezi, por në ese. Gjithsesi, emaili që më bënte me dije se jam fitues në poezi, me të cilën kisha konkuruar, nuk lë dyshim".

Shtatë poezitë konkurose po i botojmë për kënaqësinë e lexuesve tanë.



Agron Tufa. Foto: © Rromir Imami

1. Bibliotekë ekzili

Bibliotekë ekzili, e një gjuhe që nuk e njoh.
Raftë të mbushna me libra të blemë lirë,
të falun, të qitun jashtë shtëpive.

U bana strehë në këto raftë, mes të cilëve tash,
netëve t'pagjuma, endem i përhumun,
si një shaman në kërkim të shpirtave;
u kall vështrimin pyetës shpinoreve, titujve,
me një dilemë të pezullt në mendje.
Po librat saorë ngjishen mbas njeni-tjetrit në raftë -
japin me kuptue: "nuk do të bahmi kurrë të tutë!"

Duhet kohë, them. Shmang vështrimin. Duhet kohë,
shestoj me vete, me folë, me u marrë vesh,
ashtu siç bajnë burrat me gratë e hueja,
të pashmangshme.

Më sëmbon sakaq ekzistenca
e braktisun e bibliotekës sime në Tiranë,
ndjesia ime, si e një anijeje të ankorueme
me spirancë në brigje të sigurta, të kuqërremta,
të veshuna me një vjeshtë të begatë dijesh
me fruta t'pamorta.

A s'asht njëmend kështu, o të ngjajshmit e mi?
Qiejt tanë janë biblioteka.

Do kisha dashtë me u shkimbë në prehnin
e Sofisë time qiellore në Tiranë, mbuluem
me vëllime të trasha klasike, enciklopedi,
fashikuj poezish e traktate, midis një kuvendimi
joshës, pambarim, tue u fikë kadalë
si kandili në përpëlitjen e mbrame.

Por tash më duhet me shpikë një vete tjetër,
një tjetër jetë, derikur ta zbus këtë grue të egër,
të panjohun e të ftohtë, që fati ma shtiu për short.

1 nëntor 2020

2. Baladë për kthimin në shtëpi

Lëpihet qelqesh han' e zbehtë.
Ç'po mih një kthetër në sepet.
Këtu, pa kthye tash sa vjet
në shpi të nanës mbetun shkretë,
kush paska hy? Kush do të jetë,
që mih kjo kthetër në sepet?

E hapa portën në mesnatë,
pa pipëtirë asnjë kanatë
me drojen se mos zgjoj ndokand
dhe mbajtja vesh heshtjen e randë,
nësa mësoj me terrin sytë
veç me pak dritë në superdritë.

Marrtaq shqova paksa muret,
mandej u shfaqen gjith' konturet
që syri im i veshi vetë
me plus-minus identitet
gjer u lëshova në divan:
erëmon përreth diç si temjan...

I mbylla sytë ma pa ma mirë
ç'më fshihnin motet bamun fir,
prejsë e ambla ime amë
doli pa kthim prej këtij pragu -
kur një gërrvimë e një rropamë
ia dhanë së larti nga çardaku.

Brofa vrik e mbajta vesh.
"Ç'të jetë?" – hamenda. Ban vaki
kësaj mesnate që të ndesh
të tjerë bujtës në shtëpi?
Marr shkallët ngjis e befaz step:
rrëmon një kthetër në sepet...

Përnën çardak, në kat të dytë,
në odën e së amblës amë,
qenë qitë speti parg stolitë
dhe kthetra mihte me rropamë,
sikur andej shkepte mëlçitë -
krejt rropullitë e s'nderës nanë.

Shituar mbeta mu në prag
me morsë ndërdyshje i mbërthyer -
mes frik' e mllefi zemërak
pashë gjithçka me sy të shqyer,
si fekste parg' i verdhë në cep
dhe mihte kthetra në sepet...

Me vite larg kësaj shtëpie
qëkur iu kthye qiellit nana,
si t'i besoj kësaj shajnie?
Mos t'i za besë çka ndriçon hana?
Dhe ndjej se as nuk iki dot
mbuluar prorë me turp e ndoht.

Do t'ketë qenë vrull prej pantere
mbi prenë e pyjeve mesvere
kërcimi im me thonjtë në fyt...
Dhe çjerrje, klithma gjer tek yjtë...
gjer kur një krismë përposh buçiti -
gjëmim i mbytnun dinamiti.

Pashë jetën të më hiqej osh...
I errët gjaku që përposh
rrodhi dhe veshi stolitë.
Tash nga tavani s'ua shqis sytë
tek ikin hapat nëpër shkallë...
Mbeç as i vdekun, as i gjallë.

16-17 prill 2020

3. Në cilën anë?

Tan natën e lume rrafshulta shfry borë...
Agsholi i kjaruem me qiej kristalinë
na gjeti buzë lumit. Prej aty,
me sy t'paarmatosun,
nuk qe zor me dallue
matanë lumit
legjionet e kampit anmik,
t'rreshtuem n'centurione.

O ti, fli e qiellit,
rrafshultë e përborun -
na e beko gjakun e derdhun me sakica
për Patrie!

Me shëjin për sulm,
lumi ka me rrjedhë
dhe, anëpëranë,
bora ka me u ndezë prush,
e gatshme për penelin e piktorit.

Por në bunacën para ploje
dëgjohen shfletimet e blloqeve,
kërcitja e shpalosjes së hartave,
cijatja metalike e burmave
të kamerave, fotoaparateve,
provat e lidhjes direkte në mikrofon
me studiot televizive
dhe, mbi të gjitha, shtrëngimi nervoz
i rripave të pajimeve, çantave,
ngjeshjet dhe zhveshjet e shpatave prej milli,
me sy të fiksuem për qiell.

Vonohet shëji i msymjes.
Kush ka me sulmue i pari?
Dy fajkonj përleshën në qiellin
mbi lumë, midis dy ushtrive:
sytë e dy palëve janë mbërthye mbi ta
dhe fikthet në grykat tona tashma -
janë pistonë të çmendun ankthi:

Në cilën anë
ka me ra shyt përdhë
fajkoi i vdekun?

Janar, 2022

4. Ose jeta asht e shkurtë, ose zgjimi asht i vonë...

Ose jeta asht e shkurtë, ose zgjimi asht i vonë;
ose pengu i jetës në koma vjen e vret ma shumë -
zgjimi në mesmohë... keqardhja që sëmbon...
E kam një brinjë prej uji që natës rrjedh në gjumë -

Brinja ime prej lumi çan tejpertej mes territ,
ngarkue me andra të randa që rrjedha i mbyt në det:
ç'fat, të dliresh natën kurmin nga barra e misterit
dhe brinja tjetër e kaltër të digjet në zjarr të lehtë...!

Kësaj jete i ngjitesh në majë, veç me pak gjana, në kambë,
ashtu si alpinisti: një çantë, litar dhe kthetra dëbore...
Shkarkojeni vedin - këtë anije tonazhi të randë
dhe flakini andrrat e mëdha në rrjedhën pluskore -

pa grimë keqardhje! Nuk përmbushen kurrë!
Lumi i frymë i brinjës i merr të tana me vete,
si trenët e mëdhenj të krimbun e të kalbun,
kur shembet me rropamë një urë.

Kjo jetë don pesha të lehta dhe lyp shëndet atletik;
utopitë janë krrusma ndër hekatomba flijimi.
Që ndën vedi mos t'ju gorromisin andrrat e mëdha -
ruejeni njenën brinjë prej lumi, si valvul shkarkimi.

2023

5. Atdhe m'u banë idetë...

Atdhe m'u banë idetë që i ngrof ambël në kllloçkë
me kurmin e mërdhimë, në folenë ma të naltë
të kavakut dimënor, të zhveshun, pilirak -
si një klithmë me penel mes trishtimit fusharak.

Idetë m'u banë Atdhe, i dehun me vetmi
në folenë ma të naltë, ku nuk ngjitet asnjeri,
ku i kaltri gjak venoz mezi shtyhet pikë-pikë,
ku dhe kllloçka e pangrofun në fole, ka rrezik

mos me çelë zogj të gjallë. Për një stinë. Për një vit.
Për një jetë që përpëlitet me Atdheun-kockë në fyt.

2024

6. Në do diç me këndue...

Në do diç me këndue, kënaqu veç me motivin,
por mos shpreso që kënga jote t'ketë dhe fjalë...
Ka me na ardhë shurdhimi përdore me dimnin,
Me na kredhë në guvën tonë dalëkadalë...

Kështu, yllit të bjerrun zen e i ftofet magma,
gjer akullli t'ia ketë ngri zemrën e zjarrtë...
Kështu shtresë mbas shtrese, ndën kafkull, dhe fjala
vdes mes përpëlitjesh në vnerin e artë.

Na mbetet me ngroftë një ngushëllim të mbramë,
kangë tjetër me provue me kordat e mpime.
Muza zbret vërtik e ngulet si kamë
në zemrat e fjalëve, mes çerdhes së ngrime.

2024

7. Farë e ambël e pashpresueme shprese...

Farë e ambël e pashpresueme shprese!
Imcake, e padukë, ti pulson në tamtha -
zjarr përfytyrimesh mbi Mollën e Adamit,
që gjallë se kapërdika shukun e dëshpërimit.
Unë të ndjej farëz shprese, por s'të shquej,
as kur sytë e mi i zmadhoj me burma:
mes oqeanit qiellor - je fije pupulake reje,
apo farë sinapi diku, përreth meje?
T'kisha qenë kolibër sqepmprehtë,
me t'sqepue, me t'mbajtë ndën gjuhë,
e t'u jepsha forcë dragoi flatrave të mia,
sa me një vrull të dehun t'i shkapërceja
të tana degëzimet e Stiksit...!

8.5. 2022

LIRI RASHA: "Kënga ime" në pesëdhjetë vite

(Vijon nga faqja 19)



TË FTUARIT VIP NË "KËNGA IME"

Artisti shqiptar me famë botërore Ilir Shaqiri, i ftuar nga mikja e tij Liri Rasha, e flakëroi sallën e pallatit të kulturës "Dedë Ndue Lazri" të Lezhës, kur zëri i tij vetëtimë ushtoi me vargjet e këngës: "Poçari – sërish vjen pranvera". Kjo këngë, vargjet e saj mbresëlënëse të interpretuara aq mjeshtërisht nga një zë kumbues si i Ilir Shaqirit, ndez në zemrat e çdo shqiptari ndjenjën e madhe të shqiptarizmes.

Njëllor ndodhi edhe me Liri Rashën, teksa interpretoi këngën e bashkimit, vargjet e së cilës: "O shqiptar kudo ku jeni / Njëri-tjetrin mos urreni / Mos e lini mollën t' thahet /, mos e lini gurin t' çahet.../ se ma shumë vlen shqiptaria", janë jo vetëm mesazh, por edhe sintezë e qëndresës shumëshekullore të shqiptarëve në luftërat legjendare ndaj pushtuesve serbë.

Të kombinuara aq bukur, nënë e bijë, Liri Rasha e Ingrid Jushi, u mirëpritën nga spektatori në këtë koncert, jo vetëm në potpuritë dibrane, por edhe kur zëri i tyre tingëllon ëmbëlsisht në vargjet e këngëve qytetare "Nga sevdaja jote moj Xhemile", "Ç'është më e bukura në këtë botë..." etj.

Më të larmishëm e bënë këtë spektakël madhështor edhe humoristët Behar Mera dhe Genc Lleshi, me interpretimin mjeshtëror të grimcave humoristike "Alo policia e shtetit...", "N'klas t'pestë tuj pi cigare" etj.

Zëri brilant i Liri Rashës, që ka ngritur peshë plaketë e shumë vendeve të botës, kudo ku ka emigantë shqiptarë, në të katër anët e globit, kumboi fuqishëm edhe në këtë skenë të Pallatit të Kulturës, Lezhë. Një këngëtare e veçantë e traditës së këngës popullore dibrane e asaj qytetare, si edhe vetë emri që mbart, edhe në atë natë të 30 prillit 2024, la përshtypje të mira për publikun me këngët e saj, e lirë, e ëmbël, duke ruajtur me fanatizëm traditën, por duke hedhur dhe sytë drejt së resë përmes këngëve popullore shqiptare.

Gëzimi i saj më i madh, vajza Ingrid Jushi, u shfaq në këtë koncert si një këngëtare e afirmuar, me po atë dinamizëm, elegancë dhe përkushtim në rrugën e nënës, duke lënë hapur shtigjet e fluturimit brenda familjes në këtë profesion kaq të bukur dhe magjik.

Në këtë koncert ishin të pranishëm Pjerin Ndreu, kryetar i Bashkisë së Lezhës; Lavdrim Krashi, deputet i Dibrës; Ulsi Manja, Ministër i Drejtësisë; Nexhbedin Shehu, Prefekt i Dibrës; Bujar Kapexhiu, Kryetar i Shoqatës Bashkësia Dibrane etj.

Këtë koncert recital e mbështeti edhe Shoqata Lidhja e Intelektualëve Dibranë, anëtarët e së cilës ishin me shumicë në sallë, duke filluar nga Shpëtim Cami, kryetar i Shoqatës; Lidhja e Intelektualëve Dibranë, nënkryetarët Latif Miha, Musa Riçku dhe Elsa Bitri, si dhe anëtarët e kryesisë Nazmi Koçi, Elmaz Lala, Irfan Zebi e shumë të tjerë. / **H.RAMA**

Ahmet Prençi është sot një nga autorët shqiptarë më të lexuar të momentit.

“Brenga e prokurorit” vlerësohet si “Proza më e mirë” në panairin “Kamza Lexon”

AHMET PRENÇI pas befasisë që solli me romanin e parë “Anja”, i cili u botua tri herë brenda një kohe të shkurtër, erdhi sërish me një roman në ri, “Brenga e prokurorit” në tetor 2023, duke konfirmuar se sukcesi i “Anjës” nuk ishte rastësishëm. Tashmë Ahmet Prençi mund të thuhet pa frikë se është një nga autorët shqiptarë më të lexuar të momentit.

Gjatë Panairit të Librit në Tiranë në nëntor 2023, stenda e Mediaprint - botuesi i librit - ishte një nga më të vizituarat, edhe për shkak të romanit “Brenga e prokurorit”.

“Një ngjarje e pazakontë që zhytet thellë në skutat e një sistemi drejtësie sa të kalbur njëherësh edhe në përpjekje për të pastruar vetveten. Ndodhi të fshihura në skuta erësire që kur dalin në dritë, tronditin. Personazhe të vendosur në një mjedis social dhe në marrëdhënie që ngjajnë sa reale aq edhe imagjinare. Një prokuror që mishëron idealet gati gati utopike dhe forcën për të bërë drejtësi. Karaktere personazhesh, ndodhi, të papritura që e mbajnë lexuesin deri në faqen e fundit me kureshtjen se, cili do të jetë vendimi i Martin Gurit.”

Ky është shënimi i botuesit për librin, i cili shumë shpejt tërhoqi vëmendjen e lexuesit dhe kritikës letrare në vend.

Këtë sukses të romanit e dëshmuar edhe disa çmime që mori libri gjatë kësaj kohe.

Romani “Brenga e Prokurorit” mori çmimin PEN më 24 maj 2024, gjatë një veprimtarie të përbashkët të Pen Albania dhe Pen Kosova, të cilët janë pjesë e PEN International, një organizatë që bashkon shkrimtarë dhe poetë nga gjithë bota.

Në Panairin e Librit “Kamza Lexon”, i cili u zhvillua më 13-15 maj në Kamëz, romani “Brenga e prokurorit” i autorit Prençi vlerësua si “Proza më e Mirë”, me motivacionin – “Për sfidën ndaj natyrës “absolute” të drejtësisë, linjat e paqarta midis fajit dhe pafajësisë, si dhe rrëfimit linear përmes përshkrimit të dilemave të thella morale, “telasheve” etike dhe ndjenjës së zhbërjes së vetvetes, për të sjellë peizazhin bashkohor të individit mes të vërtetës dhe kompleksitetit të ligjit”.

Znj.Erenestina Gjergji Halili, kryetare e jurisë, një lexuese dhe njohëse e mirë e krijimtarisë së z.Prençi, tha në ceremoninë e ndarjes së çmimeve, se “ çmimi i jurisë ishte mëse i merituar dhe se jo vetëm kjo vepër, por dhe pjesa tjetër e krijimtarisë së Ahmet Prençit është mjaft e arrirë dhe meriton vëmendjen e lexuesit”.

Romani mori vëmendje edhe në konkursin letrar “At Zef Pllumi”-2024, që organizohet nga Bashkia e Lezhës. Në këtë konkurs Ahmet Prençi u vlerësua me Çmimin e Nderit me motivacionin “Për kontributin e dhënë në krijimtarinë letrare, lëvruar i prozës me tematikë të spikatur”.

“Çmimi i Nderit i dhënë në Lezhë për këtë roman, është një simbolikë shumë e çmuar për mua”, thotë autori Prençi në një falenderim në profilin e tij në Facebook.

“Përlusishtë mirënjohës jurisë së kryesuar nga studiuesi dhe shkrimtari Behar Gjoka dhe antarët, poeti i dashur për mua dhe gazetari Marash Mirashi dhe publicisti e tregimtari Agim Xhafka. Faleminderit Lezha e besëlidhjes, historisë, kulturës, turizmit dhe vlerave”.

■ Romani i Ahmet Prençit vlerësohet “Për sfidën ndaj natyrës “absolute” të drejtësisë, linjat e paqarta midis fajit dhe pafajësisë, si dhe rrëfimit linear përmes përshkrimit të dilemave të thella morale, “telasheve” etike dhe ndjenjës së zhbërjes së vetvetes, për të sjellë peizazhin bashkohor të individit mes të vërtetës dhe kompleksitetit të ligjit”.

Në konkursin letrar “At Zef Pllumi” morën pjesë mbi 28 shkrimtarë, mes të cilëve emra të njohur si Preç Zogaj, Bashkim Shehu, Shaban Murati, Pashk Përvathi, Thanas Medi, Namik Dokle, Frano Kulli e shumë të tjerë.

Që kur “Brenga e Prokurorit” ka dalë nga botimi, kritika letrare në vend i ka kushtuar një vëmendje të madhe, dhe për lexuesit tanë ne do të sjellim një pjesë prej tyre të shkurtuar, ndërsa kritikën e shkrimtarit dhe diplomatit Arben Çejku po e sjellim të plotë. / **Korresp. RrA.**

VLERËSIMET KRIKIKE PER ROMANIN “BRENGA E PROKURORIT”

Në romanin “Brenga e prokurorit”, ashtu si te romani “Anja”, duket se pika më e fortë e autorit është krijimi i karaktereve, metamorfizimi i tyre nga të qënurit real në një të vërtetë fiktive. Prokurori Martin Guri, grotesku Zambak Boja e sidomos vrasësi Marjan Boja – ky i fundit një karakter që nuk shqitet nga vëmendja e lexuesit, një ndër karakteret më të mirëgdhendur në veprat e botuara – krijojnë atmosferën e Sicilisë së romaneve të Leonardo Shasha-s. Vepra ka dy realitete: ky i përditshmërisë tonë dhe, ai i fqinjët adriatikas, që nuk duken shumë fort të largët, sidomos si realitete romaneske.

Rudolf Marku – Shkrimtar

Romani është dëshmi e epokës sonë në mjedisin social politik; ai vjen me mjeshtërinë e stilit, gjuhës dhe kompozimit. E veçanta më e madhe është se shkrimtari ka krijuar personazhin: Martin Guri që ndodhet në qendër të romanit, me dilemat dhe karakterin, të kujton personazhin e Franc Kafkës të “Procesi”, Jozef. K.

Entela Kasi - shkrimtare, poete

Ahmet Prençi në këtë roman skanon jetën e nëndheshme të tranzicionit shqiptar. Krimi, mafia, kulisat, miqësia, familja, dashuria, profesioni dhe brengat e një të shkuare, e cila rikthehet të trondisë të tashmen, janë elementë specifikë të këtij romani të shkruar me mjeshtëri dhe përgjegjësi. Romani shërben për të kuptuar ingranazhet e pushtetit dhe mafias, por dhe vetes në raport me tjetrin, me jetën, me të papriturat dhe fatin.

Liridon Mulaj -shkrimtar



Ahmet Prençi
BRENGA E PROKURORIT, Roman
Shtëpia Botuese: MediaPrint
ISBN: 9789928086600
Çmimi: 1200 lekë

Romani “Brenga e prokurorit” vjen në kohën e duhur dhe në vendin e duhur, kur kemi nevojë më shumë se kurrë për prokurorë si Martin Guri, i gëdhendur me mjeshtëri artistike. Personazhe të tilla janë sot në provën e shekullit, si heronj të heshtur. Jam i sigurt që ky roman do të ketë ndikimin e tij të madh tek shoqëria jonë e sidomos tek njerëzit e drejtësisë.

Arben Çejku - diplomat, shkrimtar

Një roman brilant i kësaj dekade, ku lexuesi përjeton emocionalisht rrëqethjen shqiptare. Prokurori Martin Guri, i skalitur mrekullisht nga autori, shndërrohet në një flakadan shprese. Ai ndeshet dhe nuk mposhtet. Lëkundet, por nuk bie dhe nuk dorëzohet. Autori ka një unazë misterioze, që bashkëlidh mjeshtërisht dy romanet “Anja” dhe “Brenga e prokurorit” në përjetime shokuese. Përmes turbulencash letrare, ky roman lexohet me një frymë.

Shefqet Meko- gazetar, shkrimtar

“Një libër që vetëm në lexim mund të hyhet në botën e tij, një roman realist dhe aventuresk, por vlera e tij lidhet me strukturën e kompozimit, e sidomos me narrativën, me atë gjetje autoriale, të vonesës narrative, të ngjizur si meditim i personazhit qendror dhe digresione me kohën tjetër, me ngjarje të tjera, me fatet e protagonistëve të pranishëm në faqet e romanit. “Brenga e Prokurorit” është pasqyra ku shohim kohën që po jetojmë, shohim veten ku jemi kredhur në kënetën e krimin, e shpëtimi, sipas mëtimin të autorit, mbi te gjitha, do të vijë nga drejtësia, e cila ka nevojë për prokuror dhe gjyqtar të guximshëm dhe po kaq njerëzor.

Behar Gjoka, studiues

Romani "Brenga e Prokurorit" si manifest për drejtësinë

Nga ARBEN ÇEJKU

Që prej promovimit zyrtar (11 nëntor 2023) të romanit "Brenga e Prokurorit", të shkrimtarit Ahmet Prençi, nuk kanë kaluar shumë kohë. Madje, në kornizën e aktualitetit tonë, ku një nga kryefjalët e lajmeve ditore është SPAK dhe puna e tij, na duket sikur romani në fjalë është promovuar dje. Kur drama letrare që luhet në romanin "Brenga e Prokurorit", del jashtë kapakëve të këtij libri dhe përditësohet prekshëm në zhvillimet e një vendi, natyrshëm shtrohet pyetja se; sa e ndihmon dhe sa e pengon suksesin letrar dhe artistik të romanit drama e gjallë, që zhvillohet sot në skenën shqiptare? Romani "Brenga e Prokurorit", padyshim një vepër e mirëfilltë me vlera të konsoliduara letrare, erdhi si prelude dhe nënvizim për zhvillimet në sistemin e drejtësisë në vendin tonë, duke parathënë një betejë të vështirë për drejtësinë në shoqërinë tonë. Martin Guri, prokurori dhe personazhi kryesor në roman, na shfaqet në dilemat e tij hamletiane mes botës morale dhe asaj profesionale, fiks gati 30 vjet pas nisjes së karrierës së tij në sistemin e drejtësisë. Po ashtu, prokurorë si Martini, që sot janë në sistemin e drejtësisë e sidomos në SPAK, janë shpesh të sfiduar në misionin e tyre për dhënie fund të pandëshkueshmërisë 30-vjeçare të tranzicionit shqiptar. Si në tryezën e punës të Martin Gurit, ashtu edhe në tryezën e prokurorëve të sotëm, që kanë përqafuar misionin për ndëshkimin e korrupsionit në nivelet e larta, janë dosje të rënda dhe që lidhen me njerëz të fuqishëm dhe me ndikim. Nga ky këndvështrim, mendoj se romani i shkrimtarit Ahmet Prençi nuk është thjeshtë një trillim letrar, por një manifest moralo-profesional për të kuptuar sfidën e drejtësisë sot. Ai vjen edhe si një mesazh inkurajimi për të gjithë ata, që ligjin dhe interesin publik e shohin më të rëndësishëm sesa sentimentalizmat e së kaluarës rinore dhe interesat e tyre personale.

Për të kuptuar atë që po ndodh sot në drejtësi, për të kuptuar atë që i ndodh çdo prokurori apo gjyqtari nën presion, mjafton leximi i romanit dramatik "Brenga e Prokurorit" dhe, anasjelltas, për të kuptuar më së miri thelbin e romanit të A. Prençit, merrni në konsideratë atë që shikoni përreth në përditshmërinë tuaj. Shkrimtari Ahmet Prençi, një intelektual i mirëfilltë i ditëve tona, profesionist i shkëlqyer i fushës së drejtësisë dhe zbatimit të ligjit, komisioner për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, ishte ndoshta personi më i duhur për ta "shpikur" romanin "Brenga e Prokurorit" dhe për ta sjellë në tryezën e debateve tona si një risi letrare, profesionale, morale dhe filozofike.

Ky roman, siç e kam thënë edhe në fjalën time të shkurtër në prezantimin e bërë në fundnëntorin e kaluar, erdhi në kohën e duhur, në vendin e duhur, nga autori i duhur dhe me mesazhin e duhur. Kam ndjekur me vëmendje të gjitha shënimet dhe komentet që i janë bërë romanit "Brenga e Prokurorit", duke vënë re se për këtë roman, është shkruar më shumë se për çdo libër të botuar gjatë vitit të kaluar. Unë nuk besoj se kanë qenë vetëm indiciet e lidhura me raportet personale mes lexuesve dhe autorit, më shumë sesa vetë mesazhi social i romanit, ai që ka nxitur shumë njerëz të thonë



Shkrimtari Ahmet Prençi duke firmosur librat e tij në Tiranë, 11 nëntor 2023.

Romani i shkrimtarit Ahmet Prençi nuk është thjeshtë një trillim letrar, por një manifest moralo-profesional për të kuptuar sfidën e drejtësisë sot. Ai vjen edhe si një mesazh inkurajimi për të gjithë ata, që ligjin dhe interesin publik e shohin më të rëndësishëm sesa sentimentalizmat e së kaluarës rinore dhe interesat e tyre personale.

fjalën e tyre të lirë. Përtej vlerësimeve të ndryshme letraro-artistike, në tërësinë e tyre, të gjithë komentuesit, janë bashkuar tek rëndësia e promovimit të një figure si Martin Guri, prokurori për të cilin ka nevojë drejtësia jonë sot. Pra, njerëzit, shprehën nevojën e tyre për drejtësi nga organet e drejtësisë, para se të kenë pretendimin për të dhënë një gjykim profesional për një libër, siç është romani në fjalë. Për vlerësimin arritjeve artistike të romanit, ka e do të ketë gjithnjë kritik profesionist arti, por për vlerësimin e këtij libri si traktat shoqëror, të gjithë mund ta thonë një fjalë, siç edhe e kanë thënë. Jehona e komenteve që kanë shoqëruar romanin e shkrimtarit A. Prençi, në një farë mënyre treguan se romani realisht erdhi në kohën e duhur dhe me mesazhin e duhur. Të gjithë e vlerësuan autorin jo vetëm për arritjen e tij artistike, por sidomos për guximin qytetar e profesional për të sjellë në skenë një vepër që ndihmon dhe inkurajon punëtorët e drejtësisë për të pastruar institucionet tona nga krimi e korrupsioni. Romani "Brenga e Prokurorit" ishte, kështu, kartolina më e mirë që A. Prençi mund t'u dërgonte prokurorëve dhe gjyqtarëve të ndershëm, të cilët po përballen me vështirësitë e kryerjes së detyrës së tyre. Gjithashtu edhe vetë vlerësimi që mori ky roman nga mesazhet e singqerta të audiencës publike, shprehën një inkurajim dhe mbështetje të gjerë sho-

qërore për drejtësinë e re. Romani "Brenga e Prokurorit", do të bashkëjetojë me historinë e drejtësisë së re shqiptare dhe do të mbetet për shumë vite një udhërrëfyes shpirtëror e moral për çdo prokuror e gjyqtar të ri. Me këtë roman, A. Prençi ka krijuar një guidë morale, të cilën duhet ta njohë çdo student në juridik, i cili nesër do të ballafaqohet me sfidat e profesionit. Në thelb, romani na tregon se puna e një prokurori apo gjyqtari nuk është e lehtë – madje në ndonjë rast shkon deri në kufijtë e vërtetë të sakrificimit! Beteja me krimin nuk është njësoj si të ndjekësh nga kolltuku një serial televiziv për mafian, por është shumë më tepër; është një operacion kirurgjikal nga më të vështirët, siç na tregon autori. Ai e shikon në kompleks dhe me realizëm, më mirë se askush tjetër botën e njerëzve të drejtësisë dhe atë që përfaqëson krimin. Ai hedh dritë në ato skuta të errëta ku Krimi dhe Drejtësia (Ndëshkimi i krimin), janë në një luftë të vazhdueshme, duke na treguar se, sa më e ashpër të jetë kjo luftë, aq më të forta do të jenë institucionet publike dhe aq më e sigurtë do të jetë shoqëria. Nëse krimi dhe drejtësia ulen e pijnë kafë bashkë, atëherë, siguria publike është e burgosur dhe e shkelur me këmbë! Prandaj unë mendoj se romani "Brenga e Prokurorit", është më shumë se një roman, është më shumë se një këmbanë alarmi për njerëzit e drejtësisë dhe për të gjithë shoqërinë, e cila duhet të shkundet nga letargjia e tranzicionit 30-vjeçar për të kuptuar se sot është momenti për të hapur një kapitull të ri për të ardhmen tonë, duke mos qenë peng të së kaluarës qoftë emocionale-shpirtërore, qoftë moralo-politike! Ash-tu si Martin Guri, që me shpatën e arsyes dhe të ndërgjegjes profesionale, preu fijen e tij me të kaluarën që erdhi ta këncënon-te në zyrë në formën e një gruaje, apo në autor, i cili hyri në letërsinë shqiptare pa shumë bujë, nëpërmjet librit poetik "Udhë në pasqyrë", romanit "Anja" dhe së fundi "Brenga e Prokurorit". Nuk është numri i librave ai që të siguron statusin e "shkrimtarit", por cilësia e veprave që boton dhe, në këtë drejtim Ahmet Prençi meriton të konsiderohet shkrimtar me "SH" të madhe.

Kur një vepër letrare si romani "Brenga e Prokurorit" e tejkalon vetveten dhe bëhet udhërrëfyes për një kategori të caktuar shoqërore, siç janë prokurorët, gjyqtarët, avokatët, gazetarët etj., atëherë, kjo vepër e ka kryer misionin e saj utilitar në dobi të shoqërisë. Kjo vepër nuk mund të rreshtohet tek ato vepra që konsiderohen "letërsi për letërsinë", por letërsi për shoqërinë. Kjo, për mendim tim është arritja më e madhe për një autor, i cili hyri në letërsinë shqiptare pa shumë bujë, nëpërmjet librit poetik "Udhë në pasqyrë", romanit "Anja" dhe së fundi "Brenga e Prokurorit".

përbushje të objektivave shoqëror dhe ekonomikë. Romani "Brenga e Prokurorit" ka vlerë për trajtimin letrar të gjendjes së rënduar emocionale e shpirtërore të Martin Gurit gjatë trajtimit të një dosjeje të rëndë kriminale, e cila në realitetin e sotëm është edhe brenga e secilit njeri që sot apo nesër do të merret me punët e drejtësisë.

Në rastet kur zhvillimet dramatike në terren janë më të forta dhe më emocionale sesa ato në libra, duket se ato i mbivendosen dhe e lënë në hije fuqinë e romanit "Brenga e Prokurorit". Por kjo, është vetëm në pamje të parë. E vërteta është, se ironikisht, "brenga" e A. Prençit do ta ndjekë këmba – këmbës punën e prokurorëve dhe gjyqtarëve shqiptarë në këto kohë të vështira për to, si një bekim dhe inkurajim. Por, edhe ajo çfarë prodhohet nga institucionet e reja të drejtësisë, indirekt, shkon si aset vlerësues për koherencën e mesazheve të romanit "Brenga e Prokurorit", i cili erdhi mes nesh si tingujt e një këmbane që na zgjon nga letargjia. Ne nuk e dimë se cili është apo cilët do të jenë Martin Guri në sistemin e drejtësisë, por ne dimë se të tillë i duhen sot shoqërisë, më shumë se kurrë. Ky është edhe mesazhi i një romanit, që e ka kapërcyer veten si vepër letrare, duke u konsideruar si manifest udhëzues për vlerat morale e profesionale të njerëzve të drejtësisë. Kur një vepër letrare si romani "Brenga e Prokurorit" e tejkalon vetveten dhe bëhet udhërrëfyes për një kategori të caktuar shoqërore, siç janë prokurorët, gjyqtarët, avokatët, gazetarët etj., atëherë, kjo vepër e ka kryer misionin e saj utilitar në dobi të shoqërisë. Kjo vepër nuk mund të rreshtohet tek ato vepra që konsiderohen "letërsi për letërsinë", por letërsi për shoqërinë. Kjo, për mendim tim është arritja më e madhe për një autor, i cili hyri në letërsinë shqiptare pa shumë bujë, nëpërmjet librit poetik "Udhë në pasqyrë", romanit "Anja" dhe së fundi "Brenga e Prokurorit". Nuk është numri i librave ai që të siguron statusin e "shkrimtarit", por cilësia e veprave që boton dhe, në këtë drejtim Ahmet Prençi meriton të konsiderohet shkrimtar me "SH" të madhe.

Esat Ruka si etnomuzikolog, artist, është i lidhur ngushtë me tabanin popullor, me tokën amë. Këto lidhje të autorit me tokën dhe kulturën tonë popullore, i japin pa dyshim veprës së tij dimensionin e trazuar të kohës.

“Dukuri, fenomene kulturore, profile krijuese” - disa nga risitë e librit rë Esat Rukës

Nga SHAQIR SKARRA

Vite ma parë, artistin, këngëtarin, muzikologun, studiuesin Esat Ruka e kisha njohur thjeshtë si këngëtar, ku kënga e Isa Boletinit, një këngë epike, u bë himn në ato vite dhe ishte e pranishme kudo në odat tona.

Pas viteve dymijë e njoha nga afër, e njoha kudo në aktivitete të mëdha artistike e kulturore, në veprimtari të ndryshme, në sesione e studime folklori, në biseda të lira me miq e shokë, në promovime librash e koncerte recitale të këngëtarëve të njohur të muzikës popullore.

Në periudhën kur Esati drejtonte QKVF, e njoha më mirë nga afër, bisedonim më shpesh për probleme nga më të ndryshme në fushën e muzikës dhe folklorit. E mori QKVF të shkatërruar, të boshatisur dhe shumë shpejt e ktheu në identitet. Esati ishte kërkues ndaj vetes dhe vartësve, ndaj realizoj atë që kishin shkatërruar paraardhësit e tij.

Para pak kohësh, një mëngjes më fton për një kafe, ku bashkë me të ishte edhe mjeku dibran Dritan Koruni, të cilët të dy së bashku, të njohur më herët, pasi valltari virtuoz, i ndjeri Shaban Xhajku, ishte daja i Dritanit dhe shoku i ngushtë i Esatit. Biseda kryesore ishte rreth librit, pasi Dritani, pas dashurisë që ka për profesionin e mjekut, dashuria për librin është shumë e madhe.

Esati sapo kishte botuar një libër të ri, me një titull mjaft ngacmues: “Dukuri, fenomene kulturore, profile krijuese”, një libër mbi 330 faqe dhe me një kopertinë dhe art grafik krejt ndryshe sa ishim mësuar të shikonim në stendat e librarive të shumta të kryeqytetit.

Unë me librin në dorë, dhuratë nga Esati, nuk qëndrova gjatë në tavolinë me to. Sapo arrita në shtëpi, fillova ta shfletoj librin nga e para. Libri ndahet në gjashtë pjesë: portrete artistësh, këngëtarësh, muzikologësh, intervista, refleksione, opinione e analiza. Aty gjendeshin të gjitha çfarë duhej të dinim për artin, kulturën dhe muzikën. Kishte gjuhësi, se autori jo vetëm artist, jo vetëm muzikolog, por ishte edhe gjuhëtar. Kishte shkruar vërtetë bukur, me një gjuhë të pastër, me fjalë të rralla e shprehje frazeologjike, me ertësi popullore dhe thënie nga shkrimtarë dhe filozofë të mëdhenj të botës.

Libri “Dukuri, fenomene kulturore, profile krijuese” i Esat Rukës shoqërohet me një parathënie nga akademik Gjovalin Shkurtaj, ku bëhet një analizë e mirëfilltë shkencore dhe gjuhësore librit

Esat Ruka, pas një rrugëtimi të gjatë profesional në fushën e etnomuzikës shqiptare, arriti të na jap me sukses një enciklopedi të plotë të kulturës, etnosit, folklorit tonë, na sjell dukuri e personazhe të njohura ndër vite që vërtet e kanë skalitur emrin e tyre në kujtesën tonë kombëtare.

Autori kishte marrë përsipër të realizonte vërtet më të vështirën, ku nga faqja në faqe gjejmë portrete artistësh dhe krijuesish, analiza e opinione, refleksione e studime.

Autori i këtij libri ka qëndruar me këmbë në tokë dhe në hullinë e tij, pikërisht në art, kulturë, folklor.

Të realizosh një libër me më shumë se tri-dhjetë e tre portrete krijuesish, studiuesish, këngëtarësh, muzikologësh, rapsodësh, nuk është aspak e lehtë.

Portreti është një ndër gjinitë më të vështira, sidomos kur flasim e shkruajmë për portrete artistësh dhe krijuesish, se në pak faqe, je i detyruar të plotësosh komplet karrierën artistike të tij, por shpreh bindjen se Esat Ruka ia ka dalë më së miri, ia ka dalë se i ka njohur të gjithë nga afër, ka

Esat Ruka është munduar me mjaft kujdes, t’ju jap vëmendjen e kujdesshme të gjithëve, ndaj duke lexuar këtë libër nga fjala në fjalë, nga faqja në faqe do të kujtojmë e rikujtojmë gjithmonë emrat e mëdhenj studiuesish, themeluesish të folklorit dhe etnomuzikologjisë shqiptare, veprimtarë mjaft të zellshëm e punëtorë të pa lodhur të kulturës tonë kombëtare, drejtues kulture, amatorë e profesionist nga jugu në veri, veprimtarë mjaft të zellshëm, që kanë lënë ndër vite vërtet një emër të ndritur. Ato vërtet fituan admirimin, nderin, respektin dhe duartrokitjet e zjarra të spektatorëve të shumtë, por nuk duhet harruar netët pa gjumë e intensiteti i punës së madhe për të dalë sa më dinjitoz në skenë.

qenë në kontakt të vazhdueshëm me secilin prej tyre, dhe profesioni i tij i ka dhënë mundësi të gërmojë me kujdes e ta heq atë pluhurin e kohës që mund të ketë rënë mbi secilin artist.

Esat Ruka ka arritur të prek gjatë rrugëtimin të tij profesional, disa prej tipareve njerëzore e botëkuptimore, veçanësisht krijuese e ndikimit në shoqëri, pa pretenduar në shterimin përmasor të kontributit të secilit prej tyre.

Përzgjedhja e tyre nga hapësira gjithëshqiptare, nuk lidhet vetëm me bashkëpunimin institucional. Mbi gjithçka, ka qenë shtysa e formimit të brendshëm të vetë autorit, pa të cilën nuk do të ndihej i plotë, dhe as i qetë.

Esati e nis librin me portretin e muzikologut të njohur shqiptar, me etnologun, studiuesin dhe njeriun që i dha jetë kulturës shqiptare brenda dhe jashtë kufijve shqiptar, Ramadan Sokoli.

Studimi që na jep autori në librin e tij, mbi veprimtarinë hulumtuese të Ramadan Sokolit, ia shton edhe më shumë vlerat këtij libri. Kanë shkruar shumë për jetën dhe veprën, veprimtarinë hulumtuese e shkencore të Ramadan Sokolit, pasi ai në vetvete është një institucion më vete për problemet etnomuzikologjike, por Esat Ruka, duke e njohur nga afër, duke patur kontakte të shpeshta me të, falë punës e profesionit të tij si muzikolog, na e paraqet Ramadan Sokolin vërtet një personalitet të pa tjetërsueshëm në kulturën shqiptare. Esati, përpiqet të na jap përmasat e këtij vigani, duke u ndalur veçanërisht në synimin e përhershëm të tij, që dëshmojnë shtresimin tonë kulturor, të cilin vetëm me punë dhe angazhim të këtitill si Ramadan Sokoli, mund ta qartësojë, argumentojë atë në identitetin tonë.

Në mënyrë kronologjike, në studimin që ka bërë autori na jepet veprimtaria e shumanshme e Ramadan Sokolit, për ngritjen dhe afirmimin e kulturës tonë, dhe kon-


tributi i pa diskutueshëm i tij si nismëtar i gjurmëve dhe studimeve folklorike dhe etnomuzikologjike. Sipas vetë autorit, etnomuzikologu Ramadan Sokoli depërton qartë në mjegullat e kohës, duke ndriçuar kështu edhe në skutat më të errëta.

Me plot të drejtë autori nuk e mbaron studimin për figurën e madhe të Ramadan Sokolit, e le një derë të hapur, duke pretenduar kështu se do ti mjaftojë koha të ndalet më gjatë tek kjo figurë e madhe e etnokulturës shqiptare. Dhe ne le të presim, ia vlen të ndalesh më gjatë, të tregosh dhe detajet më të vogla se Ramadan Sokoli para se të ishte shkencëtar, muzikolog, në radhë të parë ishte dhe mbeti njeri, dhe Esati, falë kontakteve të gjata e të vazhdueshme, besojmë se ka ende për të na treguar për një figurë madhore siç është Ramadan Sokoli.

Gjeografia e Esat Rukës, nëpërmjet librit të tij është e madhe se vetë lista me miq, shokë, koleg, artistë, etnokulturolog, folklorist, rapsodë, lahutarë është mjaft e madhe. Ajo shtrihet nga jugu në veri, nga Kosova e në Çamëri, kudo ku flitet, shkruhet e këndohet shqip.

Esat Ruka shkruan edhe për Mathieu Aref, studiuesin, historianin, profesorin e universitetit të Sorbonës, që zgjidhi përfundimisht enigmën pellazgjike. Mathieu Aref nuk gjeti mbështetje tek studiuesit, arkeologët, akademikët e gjuhëtarët tanë, por ama të vërtetën historike e tha me kompetencë në librin e tij “Shqipëria, odiseja e pa besueshme e një populli para helen”. Dhe pikërisht autori Esat Ruka nuk mund të qëndronte në heshtje përballë të vërtetës historike mijëra vjeçare që na solli ne, shqiptarëve, Mathieu Aref.

Duke qëndruar gjithmonë në fushën e tij, autori do të shkruaj për poetët Lefter Çipa, Gjok Beci e Naim Plaku, për folkloristin dhe muzikologun e njohur Munir Shehu, për arkeologun Dilaver Kurti dhe artistin Haziz Ndreu, për Dervish Shaqa e Ndue Shyti,



Imer Neli e Mark Gjoka, për Frok Haxhia e Viktor Paloka, për Liri Rasha e Sedat Kuqi, Safete Toska e Rexhep Çeliku, Xhevat Fana e Riza Hoxha, Maksim Kulla e Ilmi Kolgjegja, Xhelal Çerpja e Dashnor Xerxa.

Shumë artistë të njohur, poet, studiues, këngëtar, instrumentistë, lahutarë, valltar, janë pjesë e studimit të tij në këtë libër duke u marrë gjerësisht për të gjithë këto personalitete të artit, kulturës dhe folklorit shqiptar.

Portreti, edhe pse një gjini e vështirë, Esati ka ditur të depërtojë bukur në jetën e veprën e secilit, ka skalitur dhe derdhur fjalët e shpirtit se vetë autori është pjesë e jetës së secilit artist, ka punuar me secilin, ka bashkëbiseduar, bashkëpunuar dhe takuar nga afër secilin. Esat Ruka ka çfarë tregon për të gjithë artistët, rapsodët, këngëtarët, muzikologët, lahutarët, instrumentistët, sepse njëherë në jetë i ka takuar të gjithë, i ka njohur nga afër, i ka parë dhe ndjekur në skenat brenda dhe jashtë vendit, pasi profesioni i tij ia ka dhënë këtë mundësi.

Portretet janë njëra pjesë e librit, por autori nuk qëndron vetëm brenda kornizave të portretit, por del dhe jashtë tij. Në libër kemi analiza për artin dhe kulturën, recenca për botime të ndryshme të kësaj fushe, kumtesa shkencore, opinione e intervista.

Autori, me të drejtë, shqetësohet sot për muzikën tonë popullore, e cila po kalon përmes një krize identiteti. Sipas tij, në këtë zbrazësi emocionale dhe për përfitime komerciale, filluan të qarkullojnë këngë jashtë tabanit tonë popullor.

Esat Ruka si etnomuzikolog, artist, është i lidhur ngushtë me tabanin popullor, me tokën amë. Këto lidhje të autorit me tokën dhe kulturën tonë popullore, i japin pa dyshim veprës së tij dimensionin e trazuar të kohës.

Ky libër është, pa dyshim, një libër për të gjitha shoqërinë dhe kursesi vetëm për artistët, këngëtarët, valltarët, instrumentistët, muzikologët.

Edhe pse pena e autorit merret gjatë me figura të njohura të artit dhe kulturës, libri u shërben të gjithëve. Esat Ruka është munduar me mjaft kujdes, t’ju jap vëmendjen e kujdesshme të gjithëve, e ndaj duke lexuar këtë libër nga fjala në fjalë, nga faqja në faqe do të kujtojmë e rikujtojmë gjithmonë emrat e mëdhenj studiuesish, themeluesish të folklorit dhe etnomuzikologjisë shqiptare, veprimtarë mjaft të zellshëm e punëtorë të pa lodhur të kulturës tonë kombëtare, drejtues kulture, amatorë e profesionist nga jugu në veri, veprimtarë mjaft të zellshëm, që kanë lënë ndër vite vërtet një emër të ndritur. Ato vërtet fituan admirimin, nderin, respektin dhe duartrokitjet e zjarra të spektatorëve të shumtë, por nuk duhet harruar netët pa gjumë e intensiteti i punës së madhe për të dalë sa më dinjitoz në skenë.

BOTIMET M&B

mbootime@gmail.com

Tel. +355 69 20 68 603 / +355 68 65 08 441 (WhatsApp)

Të gjitha botimet tona mund ti gjeni pranë librarisë sonë në Tiranë në rrugën “Isa Boletini”, pranë kryqëzimit të Selvia; rrjetit të librarive “ADRION”; librari “Art’s” të Stacioni i Trenit në Tiranë; FletaXXI në Peshkopi ose mund ti porosisni përmes agjencive të shpërndarjes së librit ose online në www.bukinist.al

Parmenda, roli i saj në jetën e njeriut

Nga Marjo KACA

Bujqësia ose agrikultura është një praktikë, proces i vazhdueshëm, një rutinë e përditshme e njeriut që kujdeset për bimët dhe kafshët. Kjo fushë ka pasur, ka dhe do të vazhdojë të ketë një rëndësi të madhe dhe të veçantë në jetën e njeriut.

Njeriu, që nga i parë i quajtur Australoptiku (4 – 1 milion vite me parë) e deri në arritjen e tij në Homo Sapiens (40000 – 35000 vite me parë) ka kaluar një sërë procesesh dhe zhvillimesh, të cilin e kanë ndihmuar të arrijë të bëhet gjallesë e arsyeshme.

Në mënyra të ndryshme njeriu vazhdimisht e ka shfrytëzuar natyrën për t'u ushqyer në epokën më të vjetër të historisë së njerëzimit në Paleolit (3 milionë – 12 mijë vjet me parë), kur njeriu ishte plotësisht primitiv, jetonte jashtë, ushqehet me çfarë të gjente, kryesisht fruta të egra, lëvore pemësh etj., ku këto i siguronin në mënyrë të drejtpërdrejtë nga natyra, pa bërë asnjë ndërhyrje të tij.

Zotërimi i plotë i natyrës nga njeriu u arrit vetëm me lindjen e bujqësisë. Para se bujqësia të lindte, njeriu kishte mësuar të përgadisë armë të thjeshta prej guri, kocke, druri, dhe ushtronte gjuetinë dhe peshkimin. Gjatë epokës së Paleolitit, specifikisht në fund të paleolitit të hershëm (3 milion – 100 mijë vite me parë) ka edhe një ftohje të kohës, që është edhe periudha e akullnajave dhe njeriu detyrohet të futet nëpër shpella, të shpikë zjarin - i cili u dha një ndihmë të madhe në zhvillim, për t'u ngrohur dhe për dritë, por edhe për ushqim dhe mbrojtje. Të gjitha këto zotërime, por edhe shumë të tjera, njeriu i kishte arritur përpara lindjes së bujqësisë, por me lindjen e bujqësisë ai filloi të shfrytëzonte natyrën.

Në fillim të Neolitit (6 mijë – 3 mijë vite para erës sonë), njeriu filloi të kultivojë bimët, të zbusë kafshët, një veprimtari që njeriu u lidh shumë me të, për ta trashëguar deri në ditët e sotme. Në këtë periudhë kohore lindi edhe bujqësia, dhe studiuesit e quajnë periudha e Neolitit (6 – 3 mijë p.e.s.). Ka mendime dhe studiues që lindjen e bujqësisë e çojnë edhe më herët, rreth 9 mijë vite p.e.s., por e rëndësishme është se, në neolit, bujqësia ishte e lindur dhe se njeriu tashmë kishte filluar të ndikojë mbi botën që e rrethonte.

Bujqësia pati fazat e zhvillimit të saj. Në fillim ishte bujqësi e lagësht që do të thotë se toka nuk punohej, por farat hidheshin në toka ku kishte ujë, pra toka si kënetë dhe fara mbinte vet. Pas bujqësisë së lagësht, lind bujqësia e thatë. Tashmë njeriu fillon ta zotëroj dhe ta punojë akoma edhe më shumë tokën. Tokën e zhvishite nga barërat e padobishëm dhe shkurret, kështu lindi dhe shpyllëzimi, gërmohej, fara hidhej në tokën e punuar dhe mbulohej me dhë. Punimi i tokës ishte i thjeshtë dhe i zgripët. Ky punim bëhej me shat, që është edhe vegla e parë e përdorur nga njeriu. Shati fillimisht ishte prej druri në formë shkopi, kërrabe me pas shat prej guri me bishte druri. Kjo bujqësi ishte e quajtur bujqësia me shat. Lindja e bujqësisë i shtyn njerëzit të zgjerojnë territoret dhe

tokat. Në aspektin social, bujqësia dhe blegtoaria duan një organizim dhe forcë punëtore. Kështu, filloi të fuqizoheshin dhe të rriteshin grupet shoqërore, ku në neolit gjinitë rriten deri në 200 veta dhe si rrjedhojë duke krijuar edhe fshatra më vete.

Në mijëvjeçarin IV p.e.s. njeriu arrin të shpikë rrotën, një shpikje shumë me vlerë dhe madhështore, që vinte në ndihmë në shumë aspekte si në transport, tërheqje dhe për përgatitje të enëve prej qeramike edhe për shumë procese të tjera me vlerë. Bujqësia arrin të marrë rrugën e drejtë të zhvillimit të madh, kur njeriu arrin të shpikë dhe të përdorë parmendën.

Me shpikjen dhe përdorimin e parmendës, bujqësia, kjo degë e rëndësishme ekonomike, kthehet nga bujqësi me shat në bujqësi me parmendë. Parmenda ishte një vegël e rëndë për t'u përdorur. Ajo, në fillim tërhiqej nga njerëzit dhe, po ashtu, nga mbrapa parmenda drejtohej po nga njeriu. Ky proces punë ishte i vështirë dhe si rrjedhojë kishte nevojë për forcën e burrit. Në këtë mënyrë, roli i burrit filloi të rritet në familje. Përpara përdorimit të parmendës kemi të bëjmë me familje matriarkale, ku në martesë me çifte, burri shkonte në shtëpinë e gruas dhe lejohej tradhtia bashkëshortore. Pas përdorimit të parmendës dhe pak më vonë zbutet edhe kali, një kafshë e fuqishme, që zëvendësoi burrin në tërheqjen e parmendës.

Shpikja dhe përdorimi i parmendës bëri një zhvillim të madh bujqësor dhe si rrjedhojë, u bë edhe një zhvillim i madh ekonomik. Ky zhvillim ndikoi në shumë aspekte të tjera jetësore si: përmirësimi i jetesës, rritja e vullnetit për të punuar dhe për të zgjeruar tokat bujqësore dhe kullotat; përhapjen e kulturave të ndryshëm bujqësore në vende të tjera dhe në formimin e kulturave të reja; në rritjen e shëndetit të njeriut dhe, përveç këtyre, ndërroi një sistem social nga familje matriarkale në atë patriarkale.

Veglat për punimin e tokës janë të shumta dhe të kategorive të ndryshme, janë vegla që vihen në lëvizje me fuqinë e njeriut, që quhen vegla dore dhe janë veglat që vihen në funksion nga tërheqja e kafshëve dhe quhen vegla për kafshe pune. Të dy kategoritë e veglave janë përdorur dhe vazhdojnë të përdoren në mënyrë të vazhdueshme edhe sot. Veglat që vihen në lëvizje me fuqinë e njeriut janë me të vjetra në përdorim se veglat që vihen në lëvizje nëpërmjet tërheqjes së kafshëve. Parmenda, kjo vegël e rëndësishme revolucionare, bën pjesë në kategorinë e veglave që vihen në lëvizje nga tërheqja e kafshëve.

Parmenda është përdorur shumë nga Ilirët dhe kjo shihet nga zhvillimi i bujqësisë në fiset Ilire. Përdorimin e parmendës nga Ilirët e dëshmojnë edhe burimet arkeologjike. Në shumë vende si në Mirditë, Elbasan, Kolojnë, Butrint etj., janë gjetur copa dhe plore hekuri, që dëshmojnë përdorimin e parmendës. Dëshmitë e tjera që trego-

jnë përdorimin e parmendës i përkasin shek. III p.e.s.. Përdorimi i parmendës nga ilirët, të paktën që në shek. III p.e.s, tregon se bujqësia ilire tashmë në këto shekuj kishte kaluar një bujqësi me larim të mirëfilltë të tokës.

Klasifikimin shkencor të parmendës e ka bërë Rrok Zajmi. Ai e klasifikon në tri kategori ose tipe si: parmenda me lidhje, parmenda me lidhje trekëndëshe dhe parmenda me lidhje katërkëndëshe. Zhvillimi dhe format e ndryshme të parmendës në territorin tonë kanë ardhë si rezultat i përshtatjes së tokës në zonën ku është përdorur parmenda. Kategoritë e ndryshme të tokës e kanë detyruar bujqun që t'i përshtatë edhe parmendën, si për shembull në tokat e forta dhe me shumë rrënjë bimësh është deshtë të bëjë një parmendë rezistuese dhe të fuqishme, si në lidhje ashtu edhe në vet veglën që është vazhdimisht në kontakte me tokën, përdhësi. Parmendën e kemi në dy lloje: me veshëza dhe me llapar. Parmenda Veshëza përdoret në toka të forta dhe në toka me shumë lagështirë dhe, për shpërndarjen e dheut të çarë nga plori, përdoret një dru në formën e gërmës V. Parmenda e dytë, me llapar, përdoret në toka të lehta dhe të shkrufta dhe për shpërndarjen e dheut shërben një pjesë druri që ngjason me kurizin e një peshku, ku kjo pjesë e parmendës quhet llapar.

Në parmendën me veshëza dallohen tri lloj variantesh: parmenda e malit, parmenda e Shkodrës dhe ajo e Korçës. Parmenda e malit është përdorur kryesisht në Çamëri e deri në rrjedhën e majte të lumit Mat dhe është përdor masivisht edhe në zonën e Dibrës. Vetë nga emri, Parmenda e Malit nënkupton se është përdorur në zona malore, ku toka është e fortë dhe është përdorur në toka me sipërfaqe të vogla, si një tipi i fuqishëm dhe i mirëmanovrueshëm parmende.

Varianti i dytë, parmenda e Shkodrës, përfshinte veriun e lumit Mat dhe fise të tjera shqiptare që jetonin në Mal të Zi. Tipi i tretë, Parmenda e Korçës është përdorur në një territor më të ngushtë se dy të tjerat. Ajo është përdorur në luginat e Devollit dhe në Korçë.

Tipi i parmendës me llapar, dhe duke u nisur pikërisht nga forma e llaparit dhe pjesëve të tjera të parmendës, dallohen tre tipe të tjera: tipit që është përdorur në luginën e Shalës, tipi në Nikaj – Mërtur e në Bajram Curr, varianti i përdorur në Fushë të Kosovës e në Dukagjin dhe ai i fshatrave të Kaçanikut dhe Podrimës.

Të gjithë tipat e parmendave të shpjeguara më sipër, si numër pjesësh kanë pasë gjashtë, me përjashtim të parmendës të përdorur në Korçë dhe Devoll, që kishte pesë, pasi i mungonte shpatëza, por rolin e saj e luante doreza. Tipet tjera kishin gjashtë si: doreza, përdhësi, shtiza, shpatëza, veshëzat dhe plori.

Parmenda ishte prej druri. Të gjithë pjesët ishin druri, përveç plorit që ishte nga metali. Druri me i përdorur ishte lisi, akacia, rrapë e të tjerë dru që ishin të fortë e të qëndrueshëm. Kjo vegël krijohej nga vet bujku për nevojë të punës dhe nuk është se kishte një treg apo specialist të krijimit dhe tregtimit të parmendës. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore u fillua të bëheshin parmenda edhe nga metali. Kjo bëhej për rezistencë të parmendës më gjatë, për punim të tokës më mirë dhe ishte më e thjeshtë për të bërë një parmendë prej metali se sa prej druri. Këtu lindi dhe tregtia e parmendës, pasi parmendat nga metali i bënin kovaçët, që ishin mjeshtër të punimit të metalit, që kryesisht ishin në Korçë. Ashtu si edhe në antikitet, ku parmenda përdorej nga burri, po ashtu edhe në vazhdim filloi kjo traditë, me përjashtim kur burri mund të kishte ndërruar jetë apo ishte në emigrim, atëherë përdorej nga gratë, por rezultati i punës nuk ishte i njëjtë, pasi parmenda kërkon forcë të madhe për përdorim dhe rezistencë ndaj lodhjes.

Kjo vegël tërhiqej nga qetë dhe kuajt, që në shumicën e rasteve ishin çift. Tek mund ta tërhiqte vetëm kali, kurse qetë vazhdimisht duhej të ishin çift. Qetë, po ashtu edhe kuajt, që mbarështoheshin për punimin e tokës, trajtoheshin mirë, ushqeheshin mirë gjatë gjithë vitit, që në periudhën e punimit të tokës të ishin të fuqishëm për të tërhequr parmendën dhe për të lëruar tokën. Më vonë filloi të përdorej plugu, që ishte i gjithi nga metali dhe, ashtu si parmenda, tërhiqet nga qetë ose kuajt dhe mbahet nga një njeri. Plugu është më i rëndë, dhe ndryshe nga parmenda që dheun e çan dhe e ndanë në mënyrë simetrike në të dyja anët, plugu e çanë tokën më thellë se parmenda me anë të thikave që ngulen në tokë dhe dheun e hedh nga krahu i djathtë, me anë të pjesës së tij që vjen direkt pas thikës e quajtur korit, që është pjesë metalike e kthyer në formë të lugët. Në një farë mënyre, plugu bëri zëvendësimin e parmendës, duke e bërë parmendën më pak të përdorshme.

Parmenda, si një vegël me shumë rëndësi në bujqësi që nga antikiteti e deri sot, duke qenë që njeriu e përdorte shumë dhe po ashtu, parmenda i jepte shumë rezultat si vegël pune në prodhueshmëri, duke u kthyer për shumë bujq si hambar i familjes. Një punim i mirë i tokës do të japë më shumë bollëk për bujqit, që i kishin kush-

tuar jetën tokës dhe bujqësisë dhe që parmenda ishte krahu i djathtë i tyre. Duke qenë se njeriu e përdorte aq shumë parmendën, në një farë mënyre ai u familjarizua dhe u bë mik me këtë vegël. Kjo afërsi e madhe njeri-parmendë, bëri që njerëzit t'i thurnin edhe legjenda, përralla, të fillojnë të besojnë në të, t'i krijojnë mite, duke i rritur kështu vlerën e parmendës.

Krijimi i këtyre legjendave, miteve etj., janë të hershme që fillojnë që në periudhën e Neolitit e deri në mesjetën e hershme. Këto legjenda e mite pagane nuk janë krijuar më vonë, por janë transmetuar nga brezi në brez dhe kanë arritur deri në ditët e sotme. Kjo tregon për rëndësinë që kjo vegël ka pasur për njeriun dhe se bujqësia ka qenë dega kryesore e ekonomisë.

Një element i besimit pagan, që ka të bëjë me parmendën është edhe koha se kur duhet prerë druri që do bëhet parmenda, me qëllim që të shkojë mbarë e mirë parmenda gjatë punimit. Bujku drurin e parmendës e priste vazhdimisht në vjeshtën e dytë, por edhe në këtë kohë, sërish duhej kujdes, pasi hëna duhet të ishte "e re", që do të thotë të kishte filluar duke u mbushur, pra duke u plotësuar për të dalë e plotë.

Parmenda, në shumë zona, kishte arritur të bëhej e shenjtë. Nuk lejohej të mallkohej. Po mallkove parmendën, arat që do të punoheshin me të nuk do të jepnin aspak prodhim. Në kohën kur parmenda prishej, drurin nuk e digjnin, por e linin të kalbëzohej vet. Kur punohej me parmendë, duhej të ishte shumë i pastër dhe nuk duhej të pështyhej duart. Bujku duhej të lahej dhe të vishte një këmishë të bardhë. Shumë vende parmendën e kanë trajtuar edhe si një element shërues. Janë bërë shumë magji me parmendën. Kur një nuse nuk lindte fëmijë, atëherë asaj i duhet të zbrërthejë parmendën. Për këtë vegël janë bërë edhe flijime nga më të ndryshmet, si jug ashtu edhe në veri.

Parmenda, me karakteristikat e shumta të saj dhe me ndikimin në shumë aspekte, që nga antikiteti e deri më sot, është bërë një element i rëndësishëm shpirtëror dhe punë në jetën e njeriut. Ajo u ngulit në identitetin e çdo personi që e përdori, duke u lidhur përjetësisht me të. Parmenda është një element bazë i identitetit të Shqipërisë, që tregon lashtësinë e përdorimit dhe të zhvillimit të bujqësisë. Kjo vegël unike u skalit përjetësisht në historinë e zhvillimit bujqësor të qyteteve antike, në mesjetë e duke ardhur deri në ditët tona, si një flori që nuk priset kurrë.

Një rrëfim për Shaqir Kaloshin (1920-1993) përmes kujtimeve të autorit dhe rrëfimit të vëllait, Fehmi Kaloshi, në librin e tij "Përplasje me egërsinë e jetës"

Shaqir Kaloshi, një njeri heroik dhe besnik


Nga XHAFFER MARTINI

Për Shaqir Kaloshin nga Sina e Dibrës së Poshtme, gjithnjë kam pasur një mendim të përveçëm si burrë trim e besnik, me karakter të fortë. E kam njohur personalisht në një mexhelis burrash. Fliste ngadalë e qetë, por fjala i zinte vend, prandaj burrat e dëgjonin me shumë vëmendje dhe i jepnin rëndësi fjalës së tij. Pozita e tij politike ishte fort e lëkundur, madje fare në zgrip, por populli në përgjithësi dinte t'i nderonte figura të tilla dhe i mbështeste sa kishte mundësi. Populli e kishte konceptin e të qenurit opozitar me sistemin, sadoqë që fjala opozitar nuk njihej e nuk përdorej. Shaqir Kaloshi ishte djali më i madh i Selim Sulë Kaloshit të Sinës; ky kishte edhe dy djem të tjerë, Eminin dhe Fehmiun. Të tre vëllezërit ishin, si thotë ajo fjala e urtë: "bamë babë të të ngjajë".

Selim Sulë Kaloshi u vra nga komunistët pas një gjyqi qesharak dhe të nxituar. Vendimi gjyqit që e dënoi me vdekje, u ekzekutua të nesërmen. Nuk bëhej fjalë për apelim dhe dukuri të kësaj natyre, se ajo ishte një drejtësi plotësisht e komanduar. Vendimi ishte marrë para se të fillohej gjyqi. Arsyeja e vërtetë pse e dënuan ishte kjo: e dinin që ai ishte antikomunist, patriot i vërtetë, ihtar i Shqipërisë Etnike. Por si shkak i nxorën "pjesëmarrjen në Luftën e Gjormit bashkë me Halil Alinë", në dhjetor – janar 1941-42, ku Halil Alia vrau Qazim Koculin. Selim nuk kishte qenë me Halil Alinë asnjë ditë. Kishte qenë Selim Xhetan Kaloshi i Kandrrit. Për këtë dënim dëshmitarë gjithë dibranët që e dinin fort mirë ngjarjen. Por trupi gjykues nuk pranoi asnjë dëshmitar: *ti ke qenë me Halil Alinë dhe mbaroi kjo punë*. Ndryshe si do ta dënonin me vdekje?! Për vrasjen e Qazim Koculit, të afërmit e tij, në Tiranë u bënë atentat më 29 maj 1943 Halil Alisë dhe Seilm Xhetan Kaloshit. Atentati konfirmohet edhe nga ministria e Drejtësisë, e cila bën me dijeni Kryeministrinë, për shak se në përplasje me armë mbeti i vrarë edhe një karabinier italian dhe u plagosën disa persona të tjerë. (AQSH, fondi 249, viti 1944, dosja I-450, f. 355)

Po le të shkojmë tek ngjarjet e Luftës. Kaloshët qenë në fillim me Lëvizjen Nacionalçlirimtare. Ata në saj të trimërisë arritën pozita komanduese në ushtrinë nacionalçlirimtare. Por, kur mbaroi lufta "u divorcuan" nga PKSH dhe komunistët dhe dolën në mal. Arsyeja kryesore qëndron në faktin se e panë qartë që Enver Hoxha nuk do ta ndante pushtetin me askënd, pra, nuk do të kishte as pluralizëm, as demokraci. I pari doli në mal Cen Elezi, pastaj djemtë dhe nipat e tij. Por Kaloshët e Ndrëtë ishin të lidhur me njeri-tjetrin me nipa dhe mbesa të shumtë. Disa prej Kaloshëve, si: Murat Kaloshi, Selim Sulë Kaloshi, Haziz Kaloshi gratë i kishin bija të Ndreve. Ndër Kaloshët e Sinës që u arratisën e dolën në mal, ishin edhe Selim Sulë Kaloshi me të bijtë. Shaqir Kaloshi bashkë me të atin, Selimin, qëndroi disa vjet në mal. Në vitin 1946 u dorëzua. E dënuan me dy vjet burg. Kur doli nga burgu, iu nënshtrua një persekutimi të gjatë dhe të vazhdueshëm, por natyrë stoike dhe punëtor i madh, i bëri ballë jetës me nder dhe krenari.

Por puna e do që të hidhemi në të kaluarën. Zogu, me të marrë pushtetin në Shqipëri, filloi të ndikojë tek paria, sidomos tek paria e Veriut që ata t'i linin hakmarrjet e gjakmarrjet, karshillëkun dhe rebelimin dhe t'i kanalizonin energjitë në dobi të shtetit të ri. Për këtë qëllim Zogu në vitin 1925, organizoi në Tiranë një kongres ku morën pjesë 350 bajraktarë dhe përfaqësues të malësisë së Dibrës, të Shkodrës, Kukësit. Nga paria e Dibrës në këtë kongres morën pjesë Murat Kaloshi, Tafë Kaziu, Se-



Kopertina e librit

lim Xhetan Kaloshi, Selim Sulë Kaloshi dhe të tjerë. Për këtë veprim të zgjuar të Zogut ka pasur vlerësim të mira. Mit'hat Frashëri kapi esencën e veprimit të Zogut, i cili bëri që "Lokalizma dhe kantonizma t'i lënë vendin patriotizmit, tendenca ndarëse dhe mërgonjëse filloi të peshojë drejt një pike të vetme; krahinat dhe elementët që kishin kujtuar vehtësinë e tyre malore të huaj për njeri-tjetrin, nisën të mësohen dhe të ndjehen solidarë, me një fjalë, fiset të bëhen komb". (Kthimi i Mit'hat Frashërit, Tiranë 1997, f. 24). Njeri prej atyre që i shërbeu me devotshmëri mbretit Zog ishte edhe Tafë Kaziu nga Katër Grykët e Dibrës. Ky u caktua me shërbim në Vlorë në krye të forcave dibrane për të vendosur rregull dhe qetësi fill pasi Revolucionin i Qershorit i Nolit (1924), dështoi dhe Zogu erdhi papë në pushtet. Ishte viti 1925. Ngjarjet kishin qenë tronditëse sidomos në Vlorë ku revolucioni pati fillimet e tij. Fshatarët, të mashtruar nga ideali fallco i propagandistëve nolistë, u ngritën kundër bejlerëve, kundër atyre që i kishin mbajtur me bukë. Ndër këta kishte vërtet figura të spikatura kombëtare; njeri prej tyre ishte Syrja bej Vlora, që në kujtime e tij ka folur për vendosjen e rregullit dhe të qetësisë nga oficerët e Zogut, konkretisht nga Tafë Kaziu, i dërguar në Vlorë në krye të shumës dibraneve. Syrja bej Vlora tregon se Tafë Kaziu nuk ishte rebel e injorat, "malok", siç i quanin veriorët, por njeri i kulturuar që vepronte në bazë të ligjit duke hyrë edhe në marrëveshje me autoritet lokale, si një mjet që do t'ia lehtësonte kryemjen e detyrës. "Një ditë të bukur dimri, - kujton Syrja bej Vlora, - më 12 janar 1925, po rrija në peristilin e hyrjes së shtëpisë sime dhe po pija cigare. Befas hapet dera e kopshtit dhe sulen brenda, në dukje shumë të tronditur dhe të trembur, rreth 100 fshatarë të rrethinave. Disa kishin dalë përpara dhe më thanë se kanë ardhur disa mijëra dibranë të armatosur, me qëllim që të plaçkitin dhe të djegin Vlorën dhe të vrasin të gjithë përkrahësit e Revolucionit të Qershorit. Edhe unë e dija se një ekspeditë e tillë po përgatitej në Tiranë. Gjysmë ore më vonë lajmi ishte përhapur gjithandej. Qindra njerëz vrapuan në shtëpinë time, mbushën kopshtin dhe oborrin duke kërkuar mbrojtje dhe siguri. Sapo kisha zënë vend në zyrë, së bashku me disa miq, vjen me nxitim një shërbëtor dhe më lajmëron ardhjen e komandantit dibran. Shkova atëherë në sallë dhe u gjeta përballë Tafë Kaziut. Ne u përshëndetëm dhe

Tafë Kaziu tha me zë të lartë (që ta dëgjonin edhe ata në kopsht): "Beu (Ahmet Zogu) më dërgoi mua dhe njerëzit e mi në Vlorë për të ndëshkuar ata që të kanë fyer dhe ata që nuk të janë bindur."

Unë vështrova buzëgaz në sytë pyetës përreth dhe kapa kuturu për jake një nga fshatarët e mi të Llakatundit, i cili qëlloi të ishte "borizani i kryengritjes", e tërhoqa atë pranë vetës dhe e përqafova.

"Shumë faleminderit beut dhe ty, or Tafë, që menduat për mua dhe për shqetësimet e mia të vogla gjatë trazirave. Shkaktarët kryesorë të kësaj lëvizjeje të paturpshme sot nuk janë këtu dhe tani unë nuk kam më asnjë mosmarrëveshje me bashkëfshatarët dhe bashkëqytetarët e mi, të cilët në këtë ngjarje kanë lojtur vetëm një rol të dytë. Unë i kam falur të gjithë, e, në radhë të parë këta fshatarë të gjorë, të ndërsyer nga propaganda e krerëve, u sollën pakëz keq me mua." (Syrja bej Vlora, Kujtime, Tiranë 2003)

Pasi Italia e pushtoi Shqipërinë, ajo kërkonte për të arrestuar dhe burgosur oficerët më të talentuar që i kishin sjellë shërbime Zogut. Njeri prej tyre, nga më të parët në listë, ishte edhe Tafë Kaziu. Ky, për t'i shpëtuar arrestimit dhe persekutimit të italianëve u detyrua të fshihet. Në gjithë Dibrën nuk gjeti njeri më të përshtatshëm se Selim Kaloshin e Sinës, burrë trim dhe i besës që nuk shitej për flori. Hide Kaloshi, e bija e Elez Isufit, martuar me Selim Sulë Kaloshin e Sinës, tregon për Tafë Kaziun:

"Tafa kishte qenë i detyruem me u fshehtë herë këtu e herë atje, mbasi kishte qenë oficer i Zogut e kishte kundërshtue me armë hymjen e Italisë në vendin tonë. Italianët donin me e burgosë. Ai kishte besim tek Selimi, prandaj vinte shpesh në shtëpinë tonë. E dinte se e ndiqte jo vetëm Italia, por ene krenët e parisë që donin me e heq qafe. Tafë Kaziu mësoi se çfarë u kishte punue Selim Kaloshi atyne që kishin dashtë me e çue drejt turpit me flori për me vramë patriotët e ndershëm. Tafa ishte i bindun se ma i sigurtë se në shtëpinë tonë nuk ishte kërkund. Erdhi me ndejtë në shtëpinë tonë, jo ma një natë, si mik, por me muez, se Italia e ndiqte kamba-kambës. Tafa ruhej shumë, saqë edhe familja e tij nuk e dinte se ku ndodhej. Selimi i çon fjalë djalit të madh të Tafës, Llan Kaziut, në Selishtë, e i thotë: "Mos bahi marak për Tafën, se asht shëndoshë e mirë në shtëpinë time".

Kur Italia kapitulloi, Tafa shkoi në shtëpinë e vet dhe aty qëndroi pa u marrë ma me politikë. U sëmur dhe ra në dyshek. Kur e pa se ishte tue vdekë, i thotë djalit të vet, Hajredinit:

- Ma gjejë Llanin të vijë këtu.

Vjen Llanin dhe i qëndron te koka. E kuptoi se Tafa kishte një amant me i lanë. Tafa i tha:

- Ma ban hallall, or Llan, se kaq e pat Tafë Kaziu. Më ka ardhë fundi. Po të la një amanet. Po u baj mik burrin ma të mirë, ma bujar e ma besnik që ka Dibra. Ky asht Selim Sulë Kaloshi i Sinës. Nuk them kështu pse më ka mbajtur me bukë, por ai asht burrë - burrash e due mue ua lanë mik. Kur unë të vdesë, çoi njeri Selim Kaloshit e t'i thuesh këto fjalë prej meje: "Ke selam prej Tafë Kaziut: Të kam ba mik sot e sa të jetë jeta. Për djalin tand të madh Shaqirin, të kam dhanë vajzën time, Vlorën (më vonë e quajtën Flora). Ata e gëzofshin njani-tjetrin e miqësia qoftë e gjatë".

- Babë, mos u baj merak se këtë porosi do ta çoj në vend, - i tha Llanin.

Atë natë Tafë Kaziu vdiq. Nesër, pa zbardhë drita mirë, Llan Kaziu çon te Selim Kaloshi, vëllain, Hajredinin, vetë i treti. Hajredin Kaziu i tha Selimit:

- Ke selam prej babës me na pranue si miq, se baba ta ka dhanë Vlorën për Shaqi-

rin.

- Pastë faqen e bardhë Tafë Kaziu. Si nuk e pranoi për mik?! A mund të gjejë mik ma të mirë se Tafë Kaziu?!

Selimi e njihte mirë Tafë Kaziun. Ai kishte qanë përherë atdhetar, ene pse komunistët kishin hapun fjalë sikur gjoja ai kishte bashkëpunue me serbët kundra Shqipërisë. Po çfarë të keqe i bani Shqipërisë Tafë Kaziu? Asnji të keqe. Veç i bani një të mirë të madhe që nuk e ka ba kush: kur ushtria serbe deshi me rrafshue Dibrën e me dalë në Mirditë, me i shkue në ndihmë kapidanit të Mirditës, që kishte ngrej krye sipas porosive dhe interesave të serbëve, ai u doli para oficerëve e u tha: "Mos kaloni nëpër Katër Grykë se asht' krahina eme. Me ba të kundërtën, mue ma nxini faqen". Serbët ia ndigjuen fjalën e Katër Grykët nuk u prekën. Ushtria Serbe ia mbajti përmënjatë e doli në Arras. Kaq mund të bante Tafa në atë kohë.

Por le të shkojmë tek ajo që ndodhi mbasi Selim Sulë Kaloshi pranoi miqësinë me Tafë Kaziun. Hajredini i tregoi Selimit se Tafë Kaziu kishte vdekë. Selimi shkoi në mort vetë i shtati, me një ka përpara. Shkoi si mik i derës. Kështu u lidh miqësia jonë me Kaziet".

Shaqir Kaloshi pati me Vlora (Flora) Kaziun dy djem: Tomorrin dhe Munirin. Tomorri Kaloshi ndërroi jetë herët. Qe një djalë i mrekullueshëm që i erdhi keq për të drurit dhe gurit, si thotë populli. Po japim pak strofa të elegjisë së nipit të tyre, që jeton në Amerikë, Ilir Spata, kushtuar Tomorri Kaloshit:

"Kot nuk e kishe emrin nga një mal Mal me dashuri Zoti të kishte falë.

Kujt s'iu gjete pranë: n'të mirë e n'të keq Rrugëve të botës tue u rropat e heq

Hidja* ku pushon do të shohë me habi Shaqirin ta zgjojë të të presë ty.

Mes lotësh e britmash këtu na le ne Në këtë mes qershori prehesh nën dhe.

Flora t'mbet te kryet, mbledhur sa një grusht Qan hallet e jetës që s'ja hoqi kush

Ky çast kaq i hidhur sa shumë paska lot Vdekja - mal me dhimbje që s'u mbajta dot.

Mbledhë i madh e i vogël t'prekin edhe qajnë Gazi ka ngrirë e lotët do s'i mbajnë..."

Unë kam qenë tek shtëpia e Shaqir Kaloshit. Prej duarve të Flora Kaziut kam hëngër bukë e kam pirë kafe. Vitet e kishin rënduar, por nuk ia kishin prekur aspak fisnikërinë dhe bukurinë e shpirtit. Nuk kam njohur grua më dinjitoze se ajo. Ajo i bënte nder shtëpisë ku kishte le dhe shtëpisë ku u plak dhe ndërroi jetë.

Për Tafë Kaziun kam dashur të shkruaj një monografi të plotë, por rrethanat e sollën që kjo punë e nisur, të mos shkonte më tej. Por, ndërkohë, isha takuar me ish-shokun tim të shkollës së mesme, Nazif Bodinin, arsimtar në Katër Grykë dhe me përgjegjësi të tjera në krahinë, njohës i mirë i saj. Ai më dha fjalën se do të më ndihmonte me kujtime dhe me dokumente që provonin se Tafë Kaziu nuk kishte qenë kolaboracionist, siç shpjegohet kjo fjalë në diktaturë, por patriot i ndershëm që i kishte sjellë veç të mira Shqipërisë. Por kjo punë, si thashë, nuk u krye dhe unë për Tafë Kaziun po mjaftohem me këto radhë.

Në fokus të këtij shkrimi është Shaqir Kaloshi. Ka treguar një qëndresë të madhe, të jashtëzakonshme ndaj komunizmit dhe diktaturës. Por këtë varet si e kupton, më shumë varet si e bën. Shaqir Kaloshi, por edhe vëllezërit e tij, Eminin dhe Fehmiun,

Saga e familjes Kaloshi, nga koha e Mbretërisë së Zogut deri në rënien e komunizmit, një kalvar i gjatë luftërash dhe përpjekjesh për drejtësi dhe mbijetesë.

kanë jetuar kryelart, plot dinjitet. Qëndresa e Shaqir Kaloshit ngrihet në një parim filozofik, prandaj dua ta shpjegoj ashtu si e gjykoj dhe kuptoj unë. Kjo ka lidhje me filozofinë e të mundurit në luftë. Ky është një lloj Gandizmi shqiptar që mendoj se tek Shaqir Kaloshi pati udhëheqësin shpirtëror. "Kur mundesh në luftë, rri i mundur", thotë populli, i cili është realist dhe në pikëpamjet e tij filozofike. Por të rrisht i mundur nuk do të thotë aspak të nënshtrohesh, nuk do të thotë aspak të ulësh qafën, të turpërohesh për të kaluarën tënde dhe për luftën që bërë kundër diktaturës, nuk do të thotë aspak t'i lëpihesh diktaturës dhe ca më keq të përdoresh prej saj. Të "pranosh humbjen" do të thotë të mos i japësh asnjë mundësi diktaturës që të të godasë; të qëndrosh i heshtur dhe krenar në heshtjen tënde, ta përballosh jetesën me punën tënde, qoftë edhe shumë të rëndë, duke bërë ato punë që të tjerët, nuk i bëjnë; të shkollohesh, edhe pse e di mirë që ajo shkollë nuk do të hyjë në punë, të mos harrosh miqtë dhe dashamirët edhe kur ata janë bërë objekt i luftës së klasave dhe veçimit sikur të ishin të prekur nga kolera. Ka edhe të tjera karakteristika për të treguar "se si mund të qëndrohet" i mundur në kuptimin filozofik. Se si vepruan dhe qëndruan Shaqiri, Emni, Fehmiu (por edhe Kaloshët e tjerë), këtë mund ta shikojmë mirë dhe "ta prekim" në librin e rëndësishëm që Fehmi Kaloshi ka shkruar për periudhën që kaloi nën diktaturë ai, vëllezërit, miqtë e dashamirët e tij. Është fjala për librin: "Përplasje me egërsinë", kujtime, Tiranë 2023, shtëpia botuese M&B. Ky nuk është libër thjesht për Fehmiun, as vetëm për Kaloshët. Është libër për inteligjencën shqiptare, për atë pjesë të saj që nuk iu nënshtroa diktaturës; për atë pjesë të inteligjencës që sakrifikoi shumë, gjithçka, për t'u arsimuar, sepse, pavarësisht se ç'thuhej nga propaganda komuniste, konkretisht ata ishin të përjashtuar nga arsimit, u lejohej veç fillorja, arsim i detyruar i asaj kohe që kishte të bëjë me zhdukjen e alfabetizimit. Shkallët e tjera të arsimit ishin si të ngjiteshe në majën e Korabit.

Në pasazhin që do të japim më poshtë nga libri i Fehmiut do të shikojmë sakrificat e tij dhe të shokëve të tij për t'u arsimuar. Libri është shkruar me realizëm dhe vërtetësi të madhe, pa lajle e pa lule, me stil energjik dhe të fuqishëm duke krijuar tablo të rënda dhe emocionuese se në art edhe e keqja, e pështirosura, e tmerrshme janë burim emocionesh. Kjo është karakteristika e artistit. Kur gjermanët në Luftën e Dytë Botërore pushtuan Parisin, hynë edhe në një studio të një piktori të famshëm dhe ia ngulën sytë një tabloje ku shikohej skuadra e pushkatimit përballë patriotëve. Në fokus ishte vënë skuadra e pushkatimit që kishte qëndruar shumë afër atyre që do të pushkatoheshin saqë flakët e pushkëve preknin pothuaj gjokset e të ekzekutuarëve. "Kjo është tabloja juaj?" - e pyetën piktorin gjermanët. "Jo, kjo është tabloja juaj", - u tha piktori gjermanëve.

Fehmiu është treguar mjeshtër duke dhënë tablo rrëqethëse, imtësi dhe detaje që të emocionojnë përmes llahtarës që shprehin. Një prej këtyre tablove ai e jep me paraqitjen e dhomës ku jetonin. Kishte të tjerë që jetonin në kasolle me kashtë nëpër rrugë të ndryshme të Peshkopisë për të ndjekur pedagogjken, e vetmja shkollë e mesme në qytet në atë kohë. Unë këtë e kam dhënë me dhimbje dhe vërtetësi në librin tim "Pedagogjikasit", Tiranë 2008. Fehmiu dhe shokët e tij, nga kjo anë, ishin "të privilegjuar" se u kishin dhënë një dhomë. Po si ishte dhoma që u kishin liru- ar? Këtë e tregon Fehmiu:

"Kur isha në vitin e tretë (të shkollës pedagogjike) na dhanë gjoja një dhomë për të jetuar aty. Dhoma ishte në katin përdhës, por kishte lidhje hidraulike, tubacionesh dhe ku di unë se çfarë me banjot e shkollës që i kishim ngjitur. Dhoma ishte e vogël,

por aty ne ishim rrasur gjashtë vetë me krevat marinari, një poshtë e një lart. Përveç meje në atë dhomë flinin dhe jetonin edhe Aqif Kaloshi e Muharrem Kaloshi, nga Sina; Ajete Mahmut Ndreu, Petrit Xhetan Ndreu nga Slllova; Hamit Hoxha nga Arrasi. U thye vija e spitalit dhe dhoma jonë u mbush një metër me ujë. Por uji kishte pushtuar edhe nevojtoret e shkollës dhe në dyshemenë tonë dhe në gjithë korridorin e nevojtoreve notonin fekalet që me t'u pështirosë. U dyndëm duke vjellë. Unë kisha vënë një stol të lart gati një metër dhe mbi të një darrasë pesëpuntshe si një urë ajrore që lidhte krevatin me derën. Por më në fund edhe kjo nuk funksioni se uji vinte duke u shtuar dhe kakat e thata, më falnin për shprehjen, notonin në dhomën tonë. U ngujuam nëpër krevat lart duke qenë të sigurt që uji e pislleku nuk do të na arrinin. Kur vija e thyer u rregullua, uji filloi të pakësohej. U pakësua aq shumë sa mbeti vetë llumi i ndyrë sa kujtoje që nuk je në një dhomë ku jetonin ata që do të bëheshin mësues, por në një nevojtoje që nuk është pastruar kurrë. Gratë e konviktit dhe disa punëtorë të komunales kishin filluar punën për pastrimin e korridorit dhe nuk pushonin duke hedhur kova me ujë të pastër që ta shtynin ujët e ndotur drejt nevojtoreve të shkollës. Odës sonë do t'i vinte radha e fundit dhe këtë duhej ta bënim ne vet. Na e mbyllën derën që uji i pastër të mos vinte në dhomën tonë. Në këtë kohë (dhjetor 1956), troket dera dhe hapet ngadalë. Kush ishte? - do të thoni ju. Ishte Ramiz Alia, atëherë ministër i arsimit, shoqëruar nga drejtori i shkollës Astrit Hoxha dhe nga shefi i arsimit të rrethit, Selim Alliu. Ramiz Alia ishte një burrë i gjatë, i ri, simpatik, veshur me një pallto të gjatë të zezë. Në dorë mbante një çantë të zezë. Kishte vënë kollare të kuqe dhe këmbishën e kishte borë të bardhë. Kur pa dhomën tonë, iu mrrrolën sytë sikur t'ia kishte veshur dikush me një shuplakë të fortë, rrudhi ballin dhe u thartua në fytyrë. Tiparet iu shformësuan.

- Ku jemi këtu, ku jemi këtu? - pyeti me zë të ulët, por të egër.

Po dukej mirë se ku ishim, në një dhomë konvikti mbushur me baltë dhe muta. Unë, edhe pse drejtori i shkollës dhe shefi i arsimit ishim shkaktarë të mjerimit tonë, për t'i lehtësuar disi nga përgjegjësia, thashë:

- Shoku Ramiz, ne jemi nxënës të jashtëm, nuk jemi konviktorë.

- Si kafshët, si kafshët, si kafshët, - tha ai tri herë dhe pastaj shtoi: - Kështu nuk jetojnë as kafshët.

Shoqëruarve të tij u ra gjaku në fund të këmbëve dhe nuk e deshën veten për të gjallë.

Ramiz Alia nuk qëndroi as gjysmë minuti por bëri nga dera për të qenë sa më larg asaj skëterre. Kur ne, fakirat, mbetëm vetëm si gjela të lagur majë gardhit, thamë:

- Më në fund do të na japin një dhomë në katin e dytë.

Por dhomë në katin e dytë nuk na dhanë as atë vit dhe as vitin tjetër."

Nuk është një tablo realiste dhe aq: është një tmerr, ndonëse pa gjak dhe pa kufoma. Ajo më e bukura dhe më e çuditshmeja qëndron në faktin se Fehmiu e gjen shkaktarin e vërtetë të këtij (Ramiza Alia), që u bë dhe kryetar shteti dhe që mbeti si "sulltani i fundit" i diktaturës Hoxhiste. Në atë dhomë brenda një minuti pati një shfaqje dhe ballafaqim epokal. Fehmi Kaloshi e pru atje Ramiz Alinë që ai ta shikonte me sytë e vet tmerrin që kishte krijuar partia e tij dhe i t'i thoshte ashtu si piktori u tha gjermanëve: "Kjo është vepra juaj, jo imja". Varet çfarë zgjedhe nga realiteti për ta pasqyruar në vepër. Zgjedhja siguron suksesin. Jo çdo gjë që shikojmë dhe përjetojmë bën për librin. Çdo libër është një përzgjedhje, një seleksionim, një filtrim.

Tablo emocionuese ka plot në këtë libër. Fehmi Kaloshi, mbasi përjashtohet nga ar-

simi, ku pati punuar me përkushtim dhe dijeni, shkon të nxjerrë bukën e gojës në tmerrin e tmerreve, në minierën e Spaçit, ku sëmuret dhe e sjellin gati të vdekur në spital.

"Mbasi shkova i shëruar në fshat, kuptova se jeta për ne Kaloshët ishte rënduar më shumë. Na ndiqnin dhe na survejonin. Por, edhe ne nuk i duronim më këta komunistë që ishin bërë si bisha. Vendosëm të largohemi nga fshati, po ku të shkonim? Nuk na mbeti rrugë tjetër veçse të bëheshim druvarë. Dëgjuam se në ndërmarrjen pyjore në Skuraj, në Milot, kërkoheshin punëtorë. Atje puna ishte shumë e vështirë dhe nuk i dilte njeri për zot. Duhej të punonim 16 orë në ditë, duhej t'i ngjiteshim malit përpjetë, rrugë pa rrugë, në pikën e vapës, por edhe në borë e në shi, të prisnim lisat shekullorë me sopatë, t'i shkurtonim sa duhej, pastaj t'i ngarkonim nëpër kuaj dhe t'i zbrisnim poshtë në zhur të Pllajut ku vinin makinat dhe i merrnin. Bënim dru për zjarr dhe degë voze për prodhimin e letrës. Në këtë punë nuk isha vetëm. U organizuam si Kaloshë dhe vendosëm të instaloheshim në male, ku na dukej sikur merrim frymë lirisht dhe jo si në fshatin tonë me komunistët në qafë. Në atë ndërmarrje erdhën edhe vëllezërit e mi: Emini dhe Shaqiri; kushërinjtë, Mediu, Lazami, Mersimi, Saliu dhe Besimi. Kishin ardhur dhe të pakënaqur dhe të përndjekur të tjerë, si Isuf Miha nga Qafë Murra. Kishin ardhur aty edhe miqtë tanë nga Mati: Nazmi Tafë Kadiu, Allamanët, Valterët e të tjerë. Formonim pothuaj një brigadë, shkonim shumë mirë me njeri-tjetrin. Ne, Kaloshët, ishim vëllezër dhe kushërinj, matjanët i kishim miq. Mbi të gjitha na bashkonte urrejtja që kishin kundër komunizmit. Kishim fituar lirinë për të folur se i besonim njeri-tjetrit. Kur ia hap zemrën dikujt, dhe ai ta hap ty, sikur ndihesh më mirë. Ne morëm me vete edhe fëmijët; djemtë e rritur na ndihmonin për të prerë drurë dhe për t'i zbritur poshtë në xhade, kurse më të vegjlit ruanin bagëtinë në mal, se, siç do ta shikojmë më poshtë, nga Sina u shpërngulëm "Me mace dhe me mi", si thuhet. Nga fëmijët e mi kisha me vete Melihanë dhe Bekimin, më vonë erdhi dhe gruaja ime, zonja Merjeme. Emini kishte Agronin, Naimin dhe Velin, tre djem të mrekullueshëm. Shaqiri kishte dy djemtë: Tomorin dhe Munirin. Më kryesorja ishte Hidja - nëna ime, - që në të vërtetë ishte nëna e të gjithëve, që, ashtu si në shtëpi, merrej edhe këtu me organizimin e jetës dhe ia doli aq mirë sa thoshe se kishim vite që jetonim në malet e Milotit dhe të Pllajut. Kjo ishte një jetë çobani dhe jetë druvari, tepër e vështirë, por njëqind herë më e mirë se ajo që bënim në fshat ku sytë prej ujërve të komunistëve nuk na ndaheshin as ditë, as natë. Gjatë muajit të dimrit punonim në zonën e Milotit, ku klima ishte më e butë, gjashtë muajt e tjerë punonim në Mbasdejë. Kishim ndërtuar stane, siç veprohesh në male, për verimin e bagëtive. Në këto stane flinin, hanim dhe përgatisim bulmetin. Ushqimi ynë kryesor në këto kushte ishin produktet e qumështit: kosi, gjiza, dhallë, gjalpi. Zienim edhe fasule. Bagëtia ishte tufa laramane me dhi, dele dhe lopë.

Dimrit, ndërsa ne burrat vazhdonim punën në male, gratë dhe fëmijët ktheheshin në fshat për të ardhur sërish në pranverë. Kjo mënyrë jetese që më e bukura, por nuk zgjati më shumë se pesë vjetë. Ishte më e bukura se jetonim bashkë, përveç familjes tënde të vogël, kishte edhe një familje të madhe, me njerëz që i doje dhe të donin, besnikë dhe të ndershëm. Por organizata bazë e partisë e fshatit kujtoi që ne Kaloshët dhe miqtë tanë, kishim zbuluar një minierë floriri dhe vazhdonim shfrytëzimin e saj sa një ditë do të bëheshim pasanikët e botës. Filluan letrat nga organizata bazë për në qeverinë e vendit, por edhe në atë qendrore. Përmbajtja e letrave ishte kjo: Kaloshët që duhet të jetonin në fshat, nën syrin vigjilent të popullit dhe të komunistëve,

kanë ngritur një jetë të re jashtë e larg fshatit, ku po pasurohen se paguhen me rrogë shteti. Lutemi qeverisë dhe partisë që këta njerëz urgjentisht të kthehen në fshat, të punojnë në kooperativë, sepse ndërmarrjet shtetërore i kemi për njerëz nevojtarë, por që nuk janë nga radhët e tyre. U shkruan shumë letra, shumica e tyre shkoi kot, pa ndonjë përgjigje dhe pa ndonjë reagim në dëm të Kaloshëve. Por njëra nga letrat i ra në dorë Mehmet Shehut, i cili urdhëroi të zbatoheshin kërkesa e organizatës - bazë të partisë në fshat dhe Kaloshët të ktheheshin menjëherë. Shkurt, na detyruan të ktheheshim. Ndërmarrja ku punonim do të na kishte larguar me kohë, se edhe asaj i shkollonin letra, por na donte dhe na respektonte se e dinte se nuk do të kishte më punëtorë të ndershëm, të aftë dhe të përkushtuar ndaj punës si ne. Më në fund, me shumë keqardhje, siç u shpreh drejtori, duhet të largoheshim..."

Kaloshët i futën përsëri në darën e kooperativës. Organizata - bazë u tregua shumë mizore ndaj tyre. U jepnin punët më të vështira dhe i survejonin ditë-natë. Kaloshët u larguan përsëri prej fshatit, kësaj here vetëm burrat. I ndihmoi fati. Ngjarja që kjo: organizata bazë e partisë, kishte dërguar një komunist për të kryer stazhin e partisë në frontin më të vështirë, në minierën e Bulqizës. Ky komunist u vra në minierë, siç vriteshin shumë të tjerë, por mbaheshin të fshehur. Nuk doli askush nga organizata e fshatit të Sinës që të zinte vendin e komunistit të vdekur që të ripërtrihej makabriteti heroik i komunistëve: një bije, mijëra ngrihen. Nuk po ngrihej askush për të shkuar drejt vdekjes. Atëherë organizata - bazë u dha leje burrave të Kaloshëve të shkonin dhe të punonin në Bulqizë. "Shkofshi e mos ardhshi", ishte "urimi" i saj. Nga miniera u larguan vetëm kur ndërroi sistemi.

Respekti për Shaqir Kaloshin është shtuar kohët e fundit, për arsyen që do ta tregoj më poshtë. Ka dy - tri vjet që jam njohur me Zyber Ndreun, të birin e Beshir Sufës, dhe nipin e Isuf Xhelilit. Zyberi është 95 vjeç, megjithatë mbahet i fortë dhe përveçse është rënduar pak nga të dëgjuarit, pothuaj të gjitha lidhjet me jetën i ka ruajtur. Ka kaluar si shumë Ndre të tjerë, periudhën më të mirë të moshës, në internim, në Shtyllas të Fierit. Tregon shumë për atë periudhë. Unë i bëj shumë pyetje, njëra prej të cilave ishte kjo: *a u vinin njerëzit e afërt për t'u parë?* Kjo pyetje sikur e lëndoi Zyberin. Këtë e pashë në mimikën e tij, që, për çudi, e ka mjaft shprehëse. Pyetja ime nuk ishte pa vend sepse të internuarit në atë kohë shikoheshin si të sëmure nga kolera ose një sëmundje tjetër shumë ngjitëse. Kur shkuam për herë të parë në Gradishtë, (viti 1966), si fakultet Filologjie për ndërtimin e hekurudhës Rrogzhinë - Fier, e para fjalë që na thanë ata që drejtonin sektorin tonë, ishte paralajmërimi që na bënë pak a shumë në këtë mënyrë: këtu, afër vendit ku ju do të punoni, jetojnë të internuarit politikë. Të keni kujdes që t'u qëndronin sa më larg atyre njerëzve. Unë e dija se në Gradishtë ishin të internuar një pjesë e Kaloshëve, në Shtyllas një pjesë e Ndreve, sepse kështu, pak këtu e pak aty, i kishin shpërndarë nëpër kampe të ndryshme përqendrimi që të mos i kishin të gjithë bashkë.

Po le të shikojmë tek pyetja që i bëra Zyberit. Ai u prish në fytyrë dhe ata sytë që edhe sot i kanë mbetur të kaltër, të patrubulluar, nga ajo pyetje u hirmosën. Tha:

- Na kanë ardhur për të mirë dhe për të keq vetëm miqtë e mi, Uket në Pollozhan ku kisha marrë gruan. Na ka ardhur vetëm një nip prej dhjetrave që kishim. Ky ishte Shaqir Kaloshi. Vetëm ai na bëri për dajallare, kur të tjerët nuk e dinin ku jetonin e si jetonim. Shaqir Kaloshi ishte njeri heroik dhe besnik.

Janar 2024.

* Hidja - këtu është fjala për drurin e hives që lëshon një aromë të këndshme.



Çeta partizane e Gollobordës

Nga: ZABIT LLESHI

(Vijon nga numri i kaluar)

Luftimet u bënë të ashpra megjithëse iniciativa kaloi në favor të partizanëve. Për një kohë të gjatë i ruajtën pozicionet mercenarët e Halil Alisë e Selim Kaloshit. Më shumë dëme pësoi çeta e Gollobordës mbasi komandanti i saj u plagos, ndërsa partizanët e saj u tërhoqën mbi katundin Staravec për t'u riorganizuar. Ahmet Cami pasi mori ndihmën e parë mjekësore, u dërgua në Dibër të Madhe e prej aty në Tiranë. Me gjithë kujdesin e Irfan Pustinës (si mjek i kishte bërë një shërbim të madh lëvizjes Nçl)7, me 24 tetor Ahmet Cami ndërroi jetë. Ditën e fundit të luftimeve më 19 tetor u kapën shumë robër nga mercenarët e parë që deklarorin se janë gënjer e mashtruar.

Vetë Haxhi Lleshi pohon se "Paria e Dibrës në dallim nga reaksionarët e tjerë, kishte me vete njerëz të gabuar, por trima: Megjithatë kundër nesh nuk e tregonin këtë trimëri sepse nuk kishin bindje se duhej luftuar kundër partizanëve, të cilët ishin vëllezërit e tyre të një gjaku". Dhanë jetën dëshmorët Aqif Zeneli, Halil Hasa, Idriz Kaba, Nesim Kaza, u plagosën Riza Doda, Sadik Hazizi, Bajram Toçi, Esat Cami, Hidër Manjani, Mersim Mura, Murat Zezi dhe Qazim Xheleshi. Atë ditë u vra partizani Vllado Rakoceviç i çetës së Sharrit. Më 28 tetor me qëllim që të përkujtohet komandanti i çetës së Gollobordës iu dha emri çeta "Ahmet Cami"8.

Fitorja e forcave partizane në Peshkopi është e një rëndësie të veçantë Jehona ishte e madhe në Dibër e jashtë saj. Ajo tregoi se forcat tradhtarë e reaksionare punonin prapa krahëve dhe nën rrogos kundër lëvizjes Nacionalçlirimtare. Ata bashkëpunonin me qeverinë kuislinge shqiptare dhe pushtuesit gjermanë. Për këtë Abas Kupi u përjashtua nga Këshilli i Përgjithshëm dhe Shtabi i Përgjithshëm i UNÇL.

Goditje të pakorrigjueshme mori Balli Kombëtar. Krerët e tij ishin ndër faktorët kryesorë dhe nxitës të reaksionit. Ata mendonin se në Dibër mund të krijonin

një bashkim të fuqishëm të frontit të Ballit Kombëtar me Lumën, Kosovën, Tropojën në Shqipërinë Verilindore. Dështoi përfundimisht organizimi dhe zgjedhja e organeve udhëheqëse. Influenca e parisë u venit në sytë e popullit, u demaskuan bashkë me propagandën për qëndrimin ndaj pushtuesve italo-gjermanë.

Disa oficerë të misionit ushtarak anglez jo vetëm dështuan, por edhe u zhgënjyen mbasi bënë shumë përpjekje për të ndarë pushtetet me imponim ndërmjet Lëvizjes Nacionalçlirimtare dhe parisë e cila nuk kishte hedhur asnjë pushkë kundër pushtuesve, përkundrazi e nxitën parinë për t'u vënë në shërbim të nazistëve gjermanë.

Çeta e Gollobordës pas luftës së Peshkopisë luftoi në Radostushë e Kërçovë, kundër forcave gjermane dhe atyre të Xhem Hasës, Ali Maliqit e Ukë Camit, prej aty erdhën në Dibër të Madhe. Epopeja e luftës (31 tetor – 3 nëntor) në Dibër të Madhe ishte një fitore tjetër e rëndësishme ku çeta e Gollobordës dhe luftëtarët e saj të mbështetur nga qytetarët luftuan rrugë më rrugë, derë më derë e dritare më dritare 4 ditë rresht, krahas çetës Grykës së Madhe dhe Batalionit të Martaneshit. U shquan me skuadrën e tij, Thoma Harito me grupin e Zerqanit, të cilët mbrojtën me heroizëm ndërtesën e ish Federatës. Gafur Mehmeti me mortajën e lehtë nxori jashtë luftimit një pjesë të forcave gjermane bashkë me ato të Xhem Hasës.

Komanda gjermane u bind se me reparte të kufizuara në mbështetje të forcave të reaksionit të brendshëm nuk merrej Dibra e Madhe që mbrohej nga Ushtria Nacionalçlirimtare. Prandaj vendosi të grumbullojë forca të mëdha nga Tirana, Struga, Gostivari, Qaf-Murra, rreth 7000 forca ushtarë oficerë e Teknikë luftarake. Reaksioni përsëri u gjallërua, filloi përgatitjet për bashkëpunim me parinë e Kërçovës, Tetovës-Gostivarit etj. Ndërlidhës mes tyre dhe ushtrisë gjermane ishte Hysni Dema. Filloi lufta e dytë e Dibrës së Madhe.

Gjermanët më 16 nëntor përsëri bashkë me parinë si Ali Maliqi, Fiqiri Dinja, Miftar

Kaloshi, Cen Elezi, Xhem Gostivari, Mefail Ajazi, Uke Cami etj., me forcat e tyre sulmuan Dibërën e Madhe në shumë drejtime: Çeta e Gollobordës me atë të Grykës së Vogël mbronin frontin nga Lagjja Vakuf deri në Varosh. Në drejtim të Urës së Spiles sulmoi me autobind Hamdi Lleshi, Mete Duka, Irfan Qylafku bashkë me një partizan italian që drejtonte autobindën. Hamdiu përdorte me mjeshtri shumë lloj armësh.

Në afërsi të varrezave italiane në pjesën jugore të qytetit, tre mitralozë i korrën forcat gjermane nga frëngjitë e autobindës, por një top e goditi autobindën e cila mori zjarr. Ra heroikisht Hamdi Lleshi dhe ushtari italian, u plagos Irfani, ndërsa Mete Duka nën breshërinë e plumbave mundi të bashkohet me shokët. Në kullën e Dacit luftonte i ati i Metes, Çup Duka. Rreth mesnatës së 3 nëntorit, ritmi i luftimeve nga ana e gjermanëve ra. Komanda e batalionit mendonte se gjermanët nuk mund të pajtoheshin me humbjen, me bindjen se do të grumbullonin forca të reja të freskëta.

Duhej shpëtuar qyteti nga masakrat gjermane, por edhe vetë forcat partizane, për këtë arsye ato u tërhoqën nga Kazemat (Kërshilla) në Tabakhane gjatë luginës që del në Sollokiç, nën mbrojtjen e forcave të Aqif Lleshit. Tërheqja kësaj rruge u bë pa shqetësime. Gjermanët mendonin se forcat partizane, ishin futur në rrethim. Drini ishte një pengesë për shkak të shirave, por u kalua me sukses. Grumbullimi u bë në Kovashicë të Grykës së Vogël, prej këtu në Grykë të Madhe në Vorre të Vrame (Tërnovë). Përgatitja për mësymjen e madhe prej nazistëve gjermanë në Dibër të Madhe e Qarkun e Dibrës ishte pragu i fillimit të operacionit të Dimrit. Emergjente ishte riorganizimi i forcave partizane, sepse në luftime kishin rënë dëshmorë disa partizanë, ishin plagosur disa të tejrë, një pjesë kishin nevojë për pak pushime. Vullnetarë të rinj partizanë kishin shprehur dëshirë për të ardhur në formacionet partizane. Çeta e Gollobordës humbi komandantin, zv.komandantin, komisari Spiro Velko u shtrua në spitalin e Tiranës,

doli në ilegalitet, u arrestua dhe u dërgua në kampin e Prishtinës, në moshën 23-vjeçare u pushkatua, Heroi i Popullit.

Gafur Korça u caktua komandant i Çetës së Gollobordës, zv.komandant Lutfi Skuka, Komisar Prokop Murra. Ajo vazhdoi luftën për çlirimin e tokave të banuara prej shqiptarëve në Maqedoni. Dëshmorë të çetës së Gollobordës janë Ahmet Cami, Halil Hasa, Hamdi Lleshi, Spiro Velko.

Ndër faktorët e fitores së luftës Nacionalçlirimtare ishte mbështetja e grave dhe përkushtimi për pritjen, përgatitjen e ushqimit, fjetjes, veshmbathjes, shërbimi ndaj partizanëve të plagosur, kryerja e detyrave si korrierë e deri pjesëmarrja direkte në formacionet e ushtrisë partizane. Gratë e Okshtunit pritën e strehuan Shtabin e Përgjithshëm të UNÇL Enver Hoxhën, Mehmet Shehun, Haxhi Lleshin, Baba Fajën, Haki Stërmillin. Mund të përmendim, Fatime Koçi, Gjyle Alla, Qamile Koçi, Hajrie Koçi, Zoje Koçi, Laje Lika, Hava Lika; në Ostren: Hajrie Isaku, në Trebisht: Hajrie Kasa, në Viçisht: Bejaze Cami, Nazmiye Cami, Peme Cami, Raziye Cami bashkë me gratë e familjes Uruq Karasani, Hysen Koçi, Hoxhë Murgu, Maliq Qazimi, Haxhi Hoxha, Ibrahim Radoveshi, Ibrahim Hysa, Zylfi Hasani etj.

Gjatë vitit 1944 në Dibër erdhën brigada I, dhe brigada IV Sulmuese. Ato kaluan nëpër Gollobordë. Shumë vullnetarë nga fshatrat e Gollobordës u bashkuan në radhët e brigadave partizane deri në çlirimin e Shqipërisë. Kështu nga Trebishti u bashkuan 200 partizanë, Gjinoveci 12, Stebleva 70, Okshtuni 40, Ostreni 60 etj.

Referenca:

1. Lleshi, H., Tiranë 1996, f.117-118;
2. Kristo Frashëri 2014, faqe 142;
3. Bendo, R. Tiranë 2014, "Ballëndriturit VII", f. 72;
4. Agolli E., grup autorësh 2009, faqe 110;
5. Agolli E., grup autorësh 2009, faqe 110;
6. Lleshi H., Tiranë 1996, faqe 81;
7. Lleshi H., Tiranë 1996, faqe 181;
8. Stërmilli H., Tiranë 1979, faqe 100.

LETËR NË REDAKSI / Tefta Cami: Ahmet Cami e kishte kthyer Çetën e tij Antifashiste në Çetë Partizane në maj të 1943

Letër drejtuar, z.Zabit Lleshi e z. Xhevat Jella!

E lexova shkrimin tuaj për "Çetën Partizane të Gollobordës", që përkujtoni 80 vjetorin e krijimit të saj në gusht të këtij. Në gusht të 1943 është krijuar Batalioni i Rinisë "Nazmi Rushiti" me përbërje shqiptarë e maqedonas dhe disa çeta të tjera me Urdhër të Shtabit të Serbisë, zotërinj. Tempo, Jankoviç e Kolishevski e kanë cilësuar Ahmet Camin si nacionalistë të thekur. Edhe Haxhi Lleshi kështu e ka cilësuar. Prandaj nuk i është dhënë titulli "Hero i Popullit" që Dibra e ka pas propozuar dy vite para vitit 1970.

Ju i jeni përmbajtur informacionit për krijimin e Batalionit Partizan të Dibrës, që Pali Carapuli ka futur në AQSH në vitin 1980, ku mohohet prania e Çetës Partizane të Gollobordës në krijimin e Batalionit. Ky veprim është manipulim i mëvonshëm, i bërë me urdhër të shefit të tij, H.Lleshi.

Ahmet Cami e kishte kthyer Çetën e tij Antifashiste në Çetë Partizane në maj të 1943.

Ahmet Cami, pasi përcjell mbretin Zog, kthehet ne Elbasan e jep dorëheqjen dhe merr familjen e vjen në Viçisht.

Në janar të 1940 krijon Çetën Antifashiste të Gollobordës së bashku me Uke Dan Camin, që ishte kryetar i Malit të Gollobordës. Prandaj edhe Çetës i vendosën atë emër. Anëtarë të Çetës vetëm 3 kanë qenë nga Golloborda, ndërsa të tjerët nga Gryka e Vogël e Gryka e Madhe.

Moisi Cami shkruan pas një viti të krijimit të Çetës Antifashiste të Gollobordës bën dy aksione, një në fund të marsit e një me 2-3 prill të 1941 dhe armatos gjithë Çetën. Për këto aksione arrestojnë me 5 prill 1941 Ejup Shahin Camin, se italianet i shohin revolen me inicialet e oficerit italian të Batalionit të Divizionit "Firencia" i dislllokuar në Krivarek, që kishin vlarë gjatë aksionit në depot e armatimit dy netë më parë. Arrestojnë edhe 7 të tjerë, ku 7 vetë ishin burra e djem Cami dhe një nga Luznia. Me 12 prill i fusin në pushkatim natën tek varret e Tërbaçit. Meqë ishin të palidhur e natën, kur i vendosin në rrjesht, ata shpërndahen nga të gjitha anët dhe arritën të pushkatonin vetëm 3 vetë, Ejup Camin, Musa Camin e Mexhit Lezin nga Luznia.

Sipas Ditarit të Ahmet Camit me 7 prill 1941 vjen Haxhi Lleshi me disa civil. Ahmeti shkruan, se po takohej për herë të parë me të.

Haxhiu i kërkon, që të takohen me majorin serb, që ndodhej në Krivarek të Tërbaçit, për t'i ndihmuar Ahmeti me forcat e tij.

Haxhi Lleshi me një major serb kishin ardhur në Viçisht me 300 forca jugosllave për të penguar sulmin e Italisë ndaj Mbretërisë së Jugosllavisë. Por Ahmeti i thotë, se nuk bashkëpunoj me ju, se hasmi i vjetër nuk bëhet mik. Unë me forcat e mija do të luftoj më vete. Dërgon një grup në Gjoricë me kryetar Fasli Camin, për t'i udhëzuar, që të luftojnë më vete. Por gjatë kthimit natën vritet Fasli Cami, si mësuasi i parë dëshmorë në Shqipëri nga pararoja italiane apo serbe.

Të nesërmen e varrimin me 8 prill, Lut Lleshi e njofton Ahmetin, se Haxhiu e Ymer Lleshi janë nisur për në Pogradec dhe nuk marrin pjesë në varrim.

Deri me 27 prill arrestojnë 19 burra e djem Cami si antifashistë me Ahmet Camin si organizatorë dhe i çojnë në burgun e Tiranës e të Burrelit nga muaji prill 1941-gusht 1942. Ahmeti ka dhënë 300 apo 600 napolona flori, siç shkruan gjykatave të korruptuara dhe kanë dalë me një vendim të rremë të firmosur nga z/ministri i MPB, Beqir Valteri, që ishte kunati i mbesës tonë. Pra, Haxhi Lleshi s'ka ndihmuar në lirin e tyre.

Ahmet Cami më maj 1943, sipas Fjalorit Enciklopedik, botim i ASHSH në vitin 1985, shënohet se Çeta Partizane e Gollobordës me 25 maj 1943.

Ahmet Cami, sipas kujtimeve të Esat Camit, qe ngarkuar në maj të vitit 1943 nga Zoi Themeli e Njazi Islami (dy përfaqësues të KQ të PK) të takojë parinë Dibrës e të Matit deri edhe Muharrem Bajraktarin, që të bashkohen me Frontin Antifashistë. Të gjithë kanë pranuar, por pa Haxhi Lleshin, sepse është i lidhur me Jugosllavët si paraardhësit e tij.

Sipas kujtimeve të Uke Camit, Esat Cami, Ibrahim Lecit, Ahmet Cami qe ngarkuar nga Zoi Themeli e Njazi Islami të organizonte krijimin e Batalionit Partizan të Dibrës. Ahmeti zgjodhi

fshatin Gjoricë e Epërme, se ishte vend i sigurtë, sepse shumica e popullsisë ishin farefisi e lidhje miqësore të tij.

Ibrahim Leci thotë: Më dha letër Ahmeti t'ia çoj Haxhiut, që ishte me Çetën e tij në Zogje, që të vijë me 26 korrik në Gjoricë për krijimin e Batalionit. Çoi të tjerë për Çetën e Grykës së Madhe dhe Çetën e Slovës. Kur ne u bashkëm vjen Tempo me Miladin Popoviçin dhe thonë komandanti e komisari duhet të jenë komunistë, kështu emrojnë komandant Haxhi Lleshin dhe komisar Esat Ndreun.

Në informacionin e Pali Carapulit e në kujtimet e Haxhi Lleshit hiqet e mohohet organizatori i organizimit të krijimit të Batalionit Ahmet Cami e Çeta e tij Partizane.

Ju besoj, e keni lexuar bisedën e Haxhi Lleshit me profesorin e nderuar Kristo Frashëri në vitin 1982, që ka publikuar gazeta "Panorama", ku Haxhi Lleshi, përveç të tjerave, e urdhëron profesorin, që t'i heqë Camet nga historia dhe të mos i përmendë as për mirë e as për keq, se të gjithë ishin tradhtarë, sipas tij. Në atë bisedë e përbalt, e akuzon, e denigron, e mohon dhe shpreh urrejtje për Ahmet Camin. Urrejtja është shprehje e primitivizmit dhe nuk mund të merren si burime objektive historike. Në festën e krijimit të Batalionit në vitin 1973, foli Haxhi Lleshi në meeting kundër Cameve e Ahmet Camit dhe e mori përgjigjen, se ju shpernda metingu e u shqetësua Aparati i KQ për ndodhinë. Në vitin 1992, në takimin me zgjedhësit, Haxhi Lleshi e ka cilësuar Ahmet Camin tradhtarë e armik. Ndërsa Latif Dema i është përgjigjur: "Për ne Ahmet Cami ka qenë një komandant hero. Por ty të paska ardhur pleqëria nga koka e jo nga këmbët. E ka botuar gazeta RD.

Është e çuditshme në Shqipëri, që historikisht tradhtarët i kanë etiketuar patriotët, tradhtarë dhe veten e kanë quajtur si patriotë.

Ju ftoj, që të merrni pjesë në Sesionin Shkencor që do të zhvillohet në fund të shtatorit 2023 në orë 11-14 në Sallën e Madhe të Muzeut Historik Kombëtarë për Çetën Antifashiste-Partizane të Gollobordës, ku do të referojnë historianët.

Tefta Cami, Pogradec, e mërkurë, 30 gusht, 2023

"Hasan Leka" do të mbetet përherë mësues

Nga **SHAQIR SKARRA**

Dhjetë vjet ma parë erdhëm tek shkolla nëntëvjeçare "Hasan Leka" në Shumbat, erdhëm një grup ish-nxënësish të kësaj shkolle, kuadro e intelektualë të fushave të ndryshme, anëtarë të kryesisë së shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë". Erdhëm se atëherë me një vendim të Këshillit të Komunës Sllovë nga data 29 maj i vitit 2013 e në vazhdim kjo shkollë mban emrin e ish drejtorit të parë të kësaj shkolle, birit të fshatit Shumbat Hasan Leka, si dhe po me vendim të Këshillit të Komunës Hasan Leka shpallej "Qyetar Nderi" i komunës (pas vdekjes).

Shkolla e Shumbatit nuk kishte emër atëherë, nuk i hoqëm emër dhe i vendosëm një emër tjetër. Kishte një histori gati 70 vjeçare në fushën e arsimit shqip, por që Shumbati, si një fshat i madh dhe mjaft arsimdashës, që në fakt kishte bërë një revolucion në fushën e arsimit ku të gjitha këto aritje me meritë ia dedikon Hasan Lekës. Ai ishte dhe mbeti zanafilja, abetarja, etaloni, përmendorja e arsimit në Shumbat, ai që nxitte djemtë dhe vajzat, ai që punoi shtëpi me shtëpi për ti arsimuar fëmijët e Shumbatit, ai që nuk përtoi kurrë por me vullnet dhe këmbëngulje punoi shumë që në Shumbat të sillte sa më shumë të drejta studimi, ishte dhe mbeti pikërisht djali i Shumbatit, universitari i parë i tij, Hasan Leka.

Dhe ne nuk e lamë me kaq, nuk mjaftoi thjeshtë emri që i vendosëm shkollës, por përkundrazi u lidhëm edhe me shumë tashmë me shkollën nëntëvjeçare "Hasan Leka" Nëpërmjet shkollës, ne ish nxënësit e saj, djem dhe vajza të Shumbatit sikur na thërriste edhe më shumë zëri i vendlindjes, dhe vazhduam të vijmë shpesh në fshat, të vinin tek shkolla, të ishim të pranishëm në aktivitete të ndryshme...

PAS DHJETË VJETËSH

Sot u kthëm përsëri në Shumbat, tek shkolla jonë, tek shkolla nëntëvjeçare "Hasan Leka". Data shënon 21 shtator 2023. Dielli i ka hedhur rrezet e argjendta në horizont. Cicërimat e zogjve bashkohen me zërat gazmorë të nxënësve që kanë mbushur plot për plot oborrin e shkollës. Ka festë tek shkolla, ka festë në Shumbat ndaj të gjithë janë mbledhur këtu sa nëpër shtëpi nuk paska mbetur askush.

Nga Tirana vargu i makinave i gjatë, aq i gjatë sa duket rreshti që nga diga e liqenit e deri tek oborri i shkollës.

Kanë ardhur anëtarët e kryesisë së shoqatës Lidhja Intelektualëve Dibranë: Latif Miha nënkryetar, Musa Riçku nënkryetar, Liri Rasha, Defrim Methasani, Shaqir Skarra, Jahe Delia, Fariz Cibaku, Osman Xhili antar të kryesisë. Kanë ardhur ish nxënës të kësaj shkolle Prof. Selami Xhepa, avokat Neshat Fana, Ajet Mandri, Besim Mandri, Agim Mandri, Nuh Murati, Sabri Skarra, Defrim Mandri,



Leka, në Kinën e largët.

ELONA

Ndihma dhe kontributi për mirëmbajtjen e shkollës është i të gjithëve, i bashkisë, i vetë drejtorisë së shkollës, por që të arrihej në këtë model që u bë sivjet shkolla nëntëvjeçare "Hasan Leka" në Shumbat, merita e madhe i takon vajzës së vogël të Hasanit, Elona Leka (Turdiu).

Ajo dhe vetëm ajo me nismën, ndihmën dhe kontributin e madh arriti në pak kohë të bëjë një ndryshim rrënjësor të shkollës së Shumbatit.

Elona nuk u mërzi kurrë, duke e shtrirë dorën të kërkojë qoftë një libër, një dritare, një pemë, një vazo, një lule, e të gjitha këto për shkollën. Jo vetëm kaq por edhe puna e madhe këmbëngulëse, duke u qëndruar vetë punëve mbi krye, arriti atë që dëshironte dhe ëndërronte. Sot Elona, në këtë dhjetë vjetor të emrit që mbart shkolla ka të drejtë me plot meritë të krenohet, të krenohet se ka bërë vërtet shumë që emrin e babait që mban shkolla ta lartësojë edhe më shumë.

"Elona, - siç thotë me shaka drejtori i shkollës - është bërë si e shtëpisë në shkollën tonë, është bërë pjesë e pa ndarë e kolektivit tonë dhe sa herë që vjen duar plot, si mali me borë ngarkuar. Edhe vetë nxënësit janë mësuar tashmë me Elonën, e presin dhe e respektojnë sikur ta kenë mësuese në shkollë. E sa herë që vjen ajo do sjellë pako e dhurata të ndryshme për nxënësit".

FESTA VAZHDON

Nuk mjaftoi vetëm me aktivitetin tek shkolla. Pjesa e dytë vazhdoi në qytetin e Peshkopisë ku në një nga sallat e hotel "Veri" për të pranishmit do të shfaqej një dokumentar, përgatitur nga Defrim Methasani, për jetën dhe veprën e Hasan Lekës. Në sallë kishte mbi njëqind veta, ku Elona së bashku me bashkëshortin e saj, mjekun Artur Turdiu, për të pranishmit shtruan një drekë, dhe nuk ishin pak, por mbi njëqind veta.

Pas dokumentarit këngët e bukura popullore dhe vallet vazhduan deri vonë, megjithatë aktivitetit po i vinte fundit, askush nuk kishte dëshirë të largohej, as vetë nxënësit. Të gjithë shprehnin dëshirën e ndonjë fotografie së bashku. Pas shkrëpjeve të fundit të fotove, shtrëngimit të duarve u ndanë të gjithë. Vargu i gjatë i makinave nisi udhëtimin drejt Tiranës.

Poezia që pati shkruar Naim Plaku për Hasan Lekën, dukej sikur jehonte brenda kabinës së makinës:

"Në letra e shkrime, flet e vërteta, / Në rrjedhë të jetës" / Shkëlqen talenti, si diell mbi shkrepë, / i Hasan Lekës. / Ti erde dhe ike, sikur pranvera, / Sjell dallëndyshe. / Ndaj do të mbetesh, ti për ngahera, / Lule që s'vyskhet. / Ja, sot ka ardhur, tek shkolla e dashur / Emri i tij. / Ai do të mbetet, për herë mësues, / Për çdo fëmijë....".

Ajet Skarra, Petrit Rama, Ramazan Kaza, Selman Skarra. Kanë ardhur nga bashkia Dibër, kryetari i sapo zgjedhur Rahim Spahiu, prefekti i Qarkut të Dibrës Nexhbedin Shehu, kryetarja e Qarkut Alma Selami.

Kishte ardhur nga Tirana i moshuari Halil Robi, një ish kuadër i lartë për shumë vite në Sllovë, ku prania e tij në një veprimtari të tillë la mjaft mbresa të mira tek të pranishmit.

Të gjithë kanë ardhur, askush nuk e bojkotoi këtë festë të bukur të Shumbatit, këtë datë historike, por kanë ardhur se me propozim të shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" Këshilli bashkiak Dibër i ka akorduar titullin më të lartë Hasan Lekës: "Qyetar Nderi i Dibrës" (pas vdekjes).

Kaq shumë njerëz kjo shkollë nuk i ka patur kurrë. Kishin ardhur edhe nga fshatra të tjerë, Venishti, Dipjaka e Sllatina. Kishte ardhur edhe shkolla "Ajet Ndreu" Sllovë.

Duke bërë krahasimin e dhjetë viteve ma parë, dukej qartë se nuk ishte ajo shkollë që gjtëm. Jo, kishte ndryshuar e gjitha. Fasada e lyer bukur e në sfond një pikturë vaji e heroit tonë Gjergj Kastrioti Skënderbeu.

Oborri i pastër e rreth e qark gjelbërim i plotë me lule të ndryshme por mbjellë me plot gusto e shije. Pemë të ndryshme si blirë, rrape, plepa, mollë, arrë, mana, qersh, kumbull zburonin rreth e qark shkollën, një hapësirë kjo mjaft e madhe që në fakt edhe shkollat në metropolin shqiptar do ta kishin zili. Vërtet në shkollë ishte ngritur një bllok i tërë me drurë frutor dhe pemë zburonim, një mini-fermë sikur 60 vite ma parë kur drejtor në këtë shkollë ishte Hasan Leka e pemëtorja e saj ishte model në të gjitha shkollat e Dibrës.

Kudo kur hidhje sytë shkolla nga jashtë shkëlqente, një model ku vërtet aty merr dije e kulturë, përgatit fëmijët për jetën, të ardhmen, perspektivën.

Mysafirët nga Tirana i shoqëroi drejtori i shkollës Mario Fejza të vizitonin klasat e kabinetet brenda shkollës.

Në korridor, në një kënd të veçantë na pret një bust i Hasan Lekës i cili sikur na uron mirë se ardhjen në shkollën e tij. Në stendën kryesore këtu nxënësit njihen me jetën dhe veprën e tij dhe po të pyesësh nxënësit të gjithë të përgjigjen me hollësi për rrugëtimin e gjatë në fushën e mësimdhënies së Hasan Lekës.

Korridoret mbushur me stendat e letrarit të ri, biologut, fizikanit, kimistit, gjeografit, historianit. Çdo kabinet i pajisur më së miri. Na bëri përshtypje kabineti i gjeografisë ku një sasi e madhe hartash, jo vetëm të Shqipërisë por edhe të Europës, Azisë apo dhe botës vareshin në mur.

Në kat të dytë të shkollës vërtet u befasuam të gjithë. Një klasë e madhe, më e madhe se të tjerat, ndoshta ka qenë planifikuar për sallë të kabinetit pedagogjik por që ishte kthyer në bibliotekë. Një bibliotekë e pasur, me mjaft tituj librash të ndryshëm jashtë shkolle por për moshën e nxënësve të një shkolle nëntëvjeçare. Një bibliotekë që kalonte përmasat e një biblioteke në gjimnazet e Tiranës sot. Raftet mbushur plot, stivosur librat në rregull e të gjitha të inventarizuara. Salla me tavolina e karrige e përgatitur enkas si sallë leximi, jo vetëm për nxënësit por edhe për mësuesit.

NË OBORRIN E SHKOLLËS FESTA VAZHDON

Në ditë feste nuk kishte se si të ndodhte ndryshe. Tinguj të muzikës së bukur popullore i kishin shpërthyer muret rrethues të shkollës dhe dëgjoheshin deri tek shtëpia e fundit e fshatit. Në rrugë, shoferët makinat ndalonin dhe hidhnin vështrimin nga shkolla.

Shkolla këtë mëngjes shtatori ishte zburuar si për festë, kudo rregull e pastërti. Prisnin të vinin edhe ish nxënësit plangprishës pas gjashtëdhjetë vitesh, një kohë tepër e gjatë kjo por edhe një mesazh i bukur për brezat e rinj se malli për vendlindjen rri gjithmonë ndezur në zemrat e secilit.

Shkolla ato vite kur mësonim

ne nuk ndodhej këtu ku është sot, ishte poshtë digës së liqenit, një ndërtesë e vjetër, totalisht e amortizuar por nga ajo godinë e vjetër doli një elitë intelektuale dhe krijuese nga Shumbati ku mund të përmendim Hasan Leka, Shuaip Skarra, Jasim Mandri, Xhevat Fana, Xhavit Sulejmani, Besim Fejza, Ruzhdi Skarra, Gjuri Puci, Selami Xhepa, Hajri Mandri, Naim Mandri, Tofik Skera, Violeta Robi, Leme Visha etj.

Moderatorja e këtij aktiviteti, Megi Iskurti, një gazetare e afirmuar në metropolin shqiptar, ngjitet në podium dhe pasi bën një pasqyrë të shkurtër dhe mjaft të bukur mbi shkollën, emrin e Hasan Lekës por edhe fshatit Shumbat, fton të ngjitet lart, të zotin e shtëpisë, drejtorin e shkollës Mario Fejza të përshëndet dhe t'ju urojë të ftuarve "Mirë se ardhjen".

Kryetari i bashkisë, zoti Rahim Spahiu, përveç datës përkujtimore, përshëndeti nxënësit edhe për fillimin e vitit të ri shkolle, dhe premtori se vëmendja e bashkisë do të jetë e vazhdueshme në fushën e arsimit, në të gjitha shkollat e Dibrës. Këngëtar të njohur si Liri Rasha, Perlat Sheqeri, Mentor Topuzi, Dritan Jashari, Defrim Mandri, por edhe vetë nxënësit e shkollës i dhanë një tjetër larmi festës.

Përshëndeti edhe prefekti i Qarkut Nexhbedin Shehu. Në emër të shoqatës "Lidhja e Intelektualëve Dibranë" përshëndeti Fariz Cibaku, kryetar i degës Dibër. Në emër të ish nxënësve të kësaj shkolle foli Profesor Selami Xhepa, i cili, si President i Universitetit Europian të Tiranës, se për nxënësit ekselent që dalin nga kjo shkollë, do të planifikojmë edhe bursa studimi. Në fund, Elona, vajza ma e vogël e Hasanit, sivjet për këtë ditë feste dhe si fillim i vitit të ri arsimor kishte menduar krejt ndryshe. Kishte sjellë për çdo nxënës nga një çantë të re librash me të gjitha mjetet shkollore të kompletuara, si lapsa, ngjyra, bojëra, mjete të tjera shkollore sipas klasave, porosi enkas për nxënësit e shkollës nëntëvjeçare "Hasan

Grishja e autorit: Bëjeni rrugën për tek e Vërteta!
Sepse ky është qëndrim intelektual.
Dhe patriotik. Sidomos për rininë.


“Po Demokracisë, Jo Demokaturës”, libri publicistik i prof. dr. Ahmet Kamberit

Nga prof. HAJRI SHEHU

Shkrimet e prof. Ahmetit janë studime të mirëfillta social-politike. Shih, p.sh., te shkrimi “Mogulët e së keqes”. Ato janë edhe studime të mirëfillta historike. Shih, p.sh., po aty: *Shqipëria / Mbnretëria / Pushtimi dhe Lufta Nacionalçlirimtare / Çlirimi / Komunistët shqiptarë / Socializmi krijoi varmihësin e tij / Përmbyjsja e socializmit* etj. Dhe shkrime të tilla mund t’i bëjë vetëm një njeri me formim të gjithanshëm dituror.

Një shkrim shumë interesant e kureshtjendjellës për lexuesin është ai me titull “Ditët e vështira të tetor-nëntorit 1956 në Budapest”. Doktor Ahmeti ka qenë atëherë student në Universitetin Semmelweis (Zemelvais), Budapest. Ato që shkruhen aty janë më shumë se kujtime të një ish-studenti. Ja edhe përmbyllja e doktorit: “Ngjarjet e vitit 1991, 1997 dhe 1998 m’i freskuan kujtimet e tetorit 1956 në Hungari. Por ato ishin të ndryshme. Hungarezët e kishin kryesisht me të huajt dhe me ata që i mbështesnin. Kurse ne e kishim me vetveten. Regjimi i diktaturës së proletarietit, socializmi u përmbys. E megjithatë, si bariu që në mjegull kërkon delen e humbur, kemi 26 vjet (shkrimi është botuar më 2016 – në gazetën “Nacional” - H.Sh.) që vijmë rrotull në kërkim të demokracisë”.

Pjesa e dytë e librit mban titullin: “Shëndeti dhe, kalimthi dhe sot”. Libri është publicistik. Por, me shpjegimet, analizat, vlerësimet e rezultatet mjekësore, që na shpërfaq, ai është mirëfilli edhe shkencor-mjekësor. Aty mëson se si mund të revolucionarizohen mjekësia e shërbimi shëndetësor. Autori kërkon që “individët, bashkësitë dhe qeveritë mund të përmirësojnë rolet e tyre në vlerësimin, ruajtjen dhe administrimin e shëndetit individual dhe shoqëri të popullsisë, i cili është baza e mirëqenies njerëzore, e progresit dhe e begatisë”. Një postulat - ky. Ja edhe një postulat tjetër, që na vjen nga shkrimi “Doktor Gjilpëra, shëndeti dhe dituria e rregullave të shëndetit ose mjekësia parandaluese”: “Nuk mund të ketë shëndet pa mjekësi parandaluese”. Doktor Ahmeti, më pas, ministër i Shëndetësisë, e emancipoi mjekësinë. Lexoni më poshtë: “Jam i detyruar, gjithashtu t’u tregoj disa të panjohura atyre që rrahin gjoksin për demokracinë. Vepërimet e mia për demokratizimin e Shqipërisë dhe hapjen e saj me Perëndimin në kohën kur unë isha ministër i Shëndetësisë, as nuk guxuan dhe as u ka shkuar nëpër mend t’i ndërmerin. Unë nuk isha kundërshtar i regjimit, por mendoja se demokratizimi ishte në interes të vendit e të popullit tonë. Me cilësinë e ministrit dhe të kryetarit të Komisionit të Mbrojtjes së Mjedisit kam mbyllur fabrika që ndotnin mjedisin, kam mbyllur sektorë minierash që nuk zbatonin shpimin e lagur, kam mbyllur uzinën e antibiotikut si jorentable, kam penguar qeverinë të merrte vendim për depozitimin e mbetjeve të rrezikshme, kam propozuar duhan të importuar me ndotje radioaktive, kam qenë në mbrojtje të pakompromis të zbatimit të masave mbrojtëse në punë të punëtorëve, për të cilën fitova armiqësinë e Presidiumit të Bashkimeve Profesionale të Shqipërisë. Vendosa rregulla të rrepta në Ministri, që kërkoni të veprohej vetëm në përputhje me ligjin e rregullat. Kjo më vuri në përplasje me disa prej anëtarëve të Byrosë Politike dhe të një zëvendëskryeministri, i cili edhe i kërkoi Kryesisë së Këshillit të Ministrave shkarkimin tim të menjëhershëm, por nuk iu pranua. Ngula këmbë që të merrej shëndetësia në analizë nga Kuvendi Popullor dhe mbajta një fjalim në emër të Qeverisë me aq shumë kritika ndaj vetë asaj, sa sot mund të duken të paimagjinueshme. Hartova me dorën time vendimin e Kuvendit, i cili u miratua. Ai vendim më dha mundësinë të hartoja strategjinë shëndetësore në përputhje me strategjinë e Organizatës Botërore të Shëndetësisë - “Shëndet për të gjithë deri në vitin 2000”. Hartova rregulloret bazë të kujdesit shëndetësor e atij mjekësor që ishte e vështirë



të zbatoheshin në atë sistem, por që, po të zbatoheshin, sot kujdesi shëndetësor e ai mjekësor publik do të ishin shumë të lavdërueshëm nga qytetarët dhe nga vetë punonjësit. Mundësora rikrijimin e Kryqit të Kuq Shqiptar, të pezulluar prej vitesh. Mundësora krijimin e së parës Shoqatë Shqiptare të Mjekësisë, sipas modeleve të simotrave perëndimore. Organizova në Tiranë Konferencën e Shoqatës Mjekësore Ballkanike; organizova në Tiranë konferencën ndërkombëtare për onkologjinë, ku morën pjesë personalitete shkencore nga vendet kryesore të Europës Perëndimore; realizova për herë të parë dërgimin e një specialisti kardiolog në një nga komitetet e rëndësishme të OBSH-së, në Kopenhagen. Dërgova një numër të konsiderueshëm mjekësh për specializim në Perëndim dhe për pjesëmarrje në kongrese shkencore ndërkombëtare. Ftova plot autoritete profesionale e shkencore perëndimore për të vizituar Shqipërinë. Aktivitetet me jashtë u bënë aq të dendura, sa m’u lejua krijimi i Seksionit për marrëdhënie me jashtë. Marrëdhëniet me OBSH-në i afrova aq shumë, sa në vitin 1989 në Paris më zgjodhën zëvendëspresident i Komitetit të 39-të të OBSH-së për rajonin e Europës. Ishte hera e parë gjatë periudhës së socializmit që një zyrtar shqiptar drejtonte një forum ndërkombëtar. Në vitin 1990 unë nënshkrova një marrëveshje prej 1.000.000 dollarësh me Zyrën Rajonale të OBSH-së për Europën për mbështetje të ngritjes së kujdesit shëndetësor dhe të atij mjekësor; u mora vesh me Presidenten e UNFPA-së për një marrëveshje prej 3.000.000 dollarësh për të mbështetur rritjen e cilësisë së mbrojtjes së shëndetit të grave. Pas ikjes sime këto marrëveshje mbetën rrugës. U lirova nga detyra e ministrit sepse kritikova qeverinë për paafësinë në zgjidhjen e problemeve që kishin lindur nga mbarimi i vitit 1990 dhe sepse kërkova prerazi dorëheqjen e saj.

Më duhet të rrefej, gjithashtu se në kohën kur të tjerë, që mund të kenë pëshpëritur skutave dhe me veshët ngritur kundër regjimit, që në fillimet e vitit 1990, unë kisha vendosur lidhje me SHBA-të. Kisha mundësuar marrëveshjen për blerjen e dy aparateve skaner dhe 30 aparate pejsmejkëri (për zemrën). Atëherë nuk lejohej që pajisje të tilla t’i shiteshin Shqipërisë. Hapa, gjithashtu rrugë për marrëveshje të tjera, midis të cilave, një marrëveshje të propozuar nga Oklahoma për zgjerimin e modernizimin e portit të Vlorës, e cila mbeti, gjithashtu rrugës për arsye të rrethanave të atëhershme. Zyra ime ishte e vetmja dritare e hapur komunikimi të drejtpërdrejtë me Amerikën. Nga fundi i vitit 1990, kur vendi ndodhej në vështirësi të skajshme, mundësora blerjen me kushte të favorshme të një sasive gruri,

që gjithashtu ishte e ndaluar t’i shitej Shqipërisë. Të gjitha këto u bënë me lejen e Departamentit të Shtetit, në një kohë kur Shqipëria nuk kishte marrëdhënie diplomatike me SHBA-të. Për këto ka shkruar edhe gazeta “Eashington Post”. Por po citoj se çfarë shkruante gazeta “Dielli” në hyrje të publikimit të shkrimit tim të përkthyer në anglisht, “Ehen efforts ëere being made for opening to America: “In this retrospective essay, the former Albanian Minister of Health in the 1980s and ëell-knoën prof. Ahmet Kamberi sheds light on a little-knoën aspect of the Albanian-American relations in the healthcare sector during a period of dramatic change and before the diplomatic relations betëeen the tëo countries ëere re-established”, Dielli, 4 prill 2014. (“Në këtë ese retrospektive, ish-ministër i Shëndetësisë në vitet 1980 dhe mjek i mirënjohur, prof. Ahmet Kamberi hedh dritë mbi një aspekt pak të njohur të marrëdhënieve shqiptaro-amerikane në sektorin e shëndetësisë gjatë një periudhe ndryshimesh dramatike dhe përpara se të rivendoseshin marrëdhëniet diplomatike midis të dyja vendeve.” (Përkthimi im – A.K.).

Në kohë njeriu i kthehet gjykimit për punën që ka bërë. Sepse ka nevojë për një vetëvlerësim. Ja si e bën vetëvlerësimin prof. Ahmet Kamberi: “Zgjedha rrugën e mjekësisë, - thotë autori në *Parathënie* e tij, - me idenë time fikse se kur e do njeriu, ky është profesioni ku mund t’i shërbehej atij më së miri”. Dhe doktor Ahmeti i ka kushtuar 62 vjet të jetës së tij shërbimit të njerëzve. “Punova 10 vjet në Peshkopi, - thotë doktor. Së bashku me 4-5 kolegët e mi të asaj kohe vumë bazat e mjekësisë moderne në Dibër. Atje unë zbatova metoda të reja mjekimi, që nuk i kishte guxuar tjetërkush. Atje unë mjekova fshatarë, punëtorë, të deklasar, të burgosur e madje, edhe një diversant, i cili pasi e mori veten, arriti të arratisë nga spitali dhe Shqipëria. Punova me një intensitet të tillë që sot as nuk i shkon nëpër mend njeriut. Gëzova dashurinë dhe respektin e dibranëve të asaj kohe. Emri i mirë që fitova atje më largoi nga vendi që e desha, e dua dhe kam mall për të. Më çoi në Klinikën Speciale në Tiranë. Emri i mirë si profesionist më çoi edhe në ekipin mjekësor të Enver Hoxhës. Nuk më kishte shkuar ndonjëherë mendja. Të tjerë kolegë të mi të asaj kohe mund ta kishin ëndërruar atë. Nuk ishte një për zgjedhje politike e as nga ndonjë përkrashje miqësore. Unë u përfshiva në ekipin mjekësor të Enverit për të ruajtur e mbrojtur shëndetin e tij, jo për t’i shkurtuar atij jetën. Së bashku me kolegët e mi të ekipit e kryem shumë mirë detyrën tonë. Dhe, natyrisht jam krenar për këtë, sepse ka qenë një detyrë aspak e lehtë dhe jo pa shumë privacione vetjake e familjare. Për mua Enver Hoxha ishte pacient dhe unë isha mjeku i tij. Pas Enverit unë kam vazhduar të mjekoj plot qytetarë të zakonshëm, nevojtarë dhe kundërshtarë të Enverit e të socializmit. Unë jam ky që jam në saje të aftësive të mia profesionale dhe të dashurisë së veçantë për njeriun. Kështu më vlerësojnë të gjithë ata që më kanë njohur dhe që kanë pasur nevojë për kujdesin tim mjekësor, përfshirë dhe politikanë antienveristë”.

Shtesa ime e parë: Doktor Ahmet Kamberi ka ndjekur vetëm rrugën e përpjetë. Dhe vetëm rruga e përpjetë ta sjell suksesin. Shtesa ime e dytë: Kur ka bërë betimin si mjek, s’besojmë t’i ketë shkuar ndër mend profesor Ahmetit se do t’i shërbente Udhëheqësit të vendit. Sepse nuk mund të jetë e lehtë. Aty duhet dije më shumë. Edhe intuitë e talent më shumë. Edhe guxim e trimëri më shumë. Edhe vendosmëri më shumë. Edhe zotësi e ndezuri (zell) më shumë. Doktor Ahmeti i ka pasur të gjitha. Me shumë zotësi e zell doktor Ahmeti u ka shërbyer edhe njerëzve të thjeshtë. Në librin “Pacienti ynë i veçantë” doktorit thotë: “Shumë të moshuara të Bllokut ... më kishin vënë nofkën “doktori i plakave”. Mua nuk më mërzhiste kjo nofkë ... Si profesionist, ndihësha i kënaqur që mund t’i ndihmoja ato, me të

cilat të tjerët nuk kishin durimin të merreshin”.

Te mënyra se si shkruan prof. Ahmeti, domethënë, te stili i tij individual, përshfaqet krejt natyrshëm karakteri i tij, formimi i tij, botëkuptimi i tij. Ai është i ndershëm. Syri i tij nuk duron zhibla, lëmishhtë. As nderi nuk duron zhibla. Prandaj ai shkruan me objektivitet shembullor. Nga kreu deri në fund të librit. Një shembull: Kur shkruan për shokët e Ekipit Mjekësor, i vlerëson të gjithë dhe i ka lënë pas shpine mospajtimet e pathemelta, ndonjë kryemëvete të pavlefshme, ndonjë qejfmbetje etj.

Profesor Ahmeti nuk është polemist. Polemikat janë për të tjerët. Ai vëzhgon. Por vëzhgon me dhembje në zemër. Ai qorton. Por qorton me dhembje në zemër. Abraham Linkoln thotë: “E fiton të drejtën për të qortuar ai që ka zemrën për të ndihmuar”. Doktor Ahmeti e ka të fituar këtë të drejtë. Sepse e ka shkruar librin për të na ndihmuar. Pasi na qorton, ai thotë: “Për tridhjetë vjet, pas përmbysjes së socializmit, ndoqa me vëmendje zhvillimet në Shqipëri. Thelbi i asaj që kuptova ishte se në vend të demokracisë së aspiruar dhe të premtuar, në Shqipëri ... u vendos demokracia, maska më e shëmtuar dhe e rrezikshme e demokracisë, por e përshtatur që të mos bjerë në sy. Për një mijë arsye, fjala demokracia, pothuajse nuk zihet në gojë sot në Shqipëri. Por unë nuk munda t’i rezistoj kësaj maske të shëmtuar e të rrezikshme pa bërë përpjekje për t’ia nxjerrë sadopak bojën. Prandaj, - vijon autori, - në shumicën e shkrimeve të këtij libri do të gjeni rrënjë, zhvillimin dhe shfaqjet e shëmtuara e të rrezikshme të demokracisë për Shqipërinë dhe shqiptarët, por edhe ide se si mund të shkallmohet ajo”.

Profesor Ahmeti është burrë shteti. Lexoni në libër f. 273-299, “Kur bëheshin përpjekje për t’u hapur me Amerikën”. Përpjekje bëheshin nga ministri i Shëndetësisë, prof. Ahmet Kamberi. Ai guxoi sepse është Shqipëridashës. Prof. Ahmeti është burrë shteti edhe me librin: “Po demokracisë, jo demokaturës”.

Përmbajtja e librit është e spikatur. Edhe forma - mënyra e thënies dhe zgjedhja e fjalës - është e spikatur. Ato shkojnë një me një. Si puna e mjalit në qelq. Një prozë e shkëlqyer publicistike. Dhe dokumentare - për këdo që i do thëniet, faktet, shembujt, shtjellimet, argumentimet e përfundimet sipas radhës së gjërave. Profesor Ahmeti ka gjuhë të zhdërvjellët, mjaft të pasur. Me sinonime e ngjyime të holla mendimesh, që s’të hiqen nga mendja. Ai nuk përdor fjalë të huaja të panevojshme, që janë mish i huaj për gjuhën shqipe. Do të japim vetëm një shembull: Ai nuk e përdor sajësën absurde *dakordësohem*. As *dakordësi*. (Për fat të keq, këto hibride të neveritshme përdoren edhe në Kuvendin Popullor të Shqipërisë (!)). Ai ka gjetur e ka krijuar *njëmendësohem* e *njëmendësi*. Janë formime krejt sipas rregullave fjalëformuese të gjuhës shqipe e me përmbajtje krejt të qartë konceptore.

Libri është edhe për më të diturit, edhe për më pak të diturit. Cili mund të jetë më pak i dituri? Një brezatar i viteve 1990, 2000 etj. Për çfarë? Për çfarë u bë për mbi 50 vjet me radhë: 1945-1990. Dhe për çfarë u zhbë për 30 vjet me radhë.

Po të shkruanim ne të tjerët për prof. Ahmetin e për punën e tij vigane, thënia më e parë do të ishte: Profesor Ahmeti ka punuar me përkushtim përtej kufirit njerëzor. Si mjek. Si ministër. Si burrë shteti. Si qytetar. Si shok. Si familjar. Profesor Ahmeti i ka tejkaluar të gjitha përmasat e hapësirat e vendit të lindjes e të vendit të punës. Ai i përket gjithë kombit. Edhe me këtë libër. Por ngaqë e duam dhe e vlerësojmë shumë, na pëlqen ta mbajmë krejt për vete, krejt për Dibrën. Një fjalë e urtë arabe thotë: Vepra është e djalit, por djali është yni.

Shkrimin e plotë mund ta lexoni edhe në rrugaarberit.com ose skano kodin:



in memoriam

Nga NAZMI KOÇI

E prita me trishtim të thellë ndarjen nga jeta të Prof. dr. Ahmet Kamberit, për të cilin sot mund të them thjeshtë që ishte njeriu i "M"e" të mëdha.

Ishte i madh e shumë i veçantë në profesion e në shkencë ku me gjithë përpjekjet që mund të bëjë çdokush tjetër që ka zgjedhur këtë fushë në misionin e ruajtjes së jetës e përmirësimit të cilësisë së saj, është vështirë të rrokë nivele të tilla. Ishte i madh në vullnetin qytetar të realizimit të çdo detyre që iu ngarkua, të cilat i merrte me përgjegjësi të madhe e i kryente me përkushtim të pa konkureshëm nga çdo kush e po ashtu me një fisnikëri shembullore.

Ishte i madh e i pa arritshëm në virtytet e qënies njerëzore e të shërbyesit në dobi të shoqërisë, shembull i rrallë humanizmi, pastërtie e delirësie njerëzore, një personalitet pa asnjë njollë e ves, me një thjeshtësi të habitshme, ku thjeshtësia dhe madhështia ishin bashkë, ishin dy dhe një, por ai fshihte çdo tendencë për tu shfaqur dhe mbeti modest, i urtë e i thjeshtë, i ditur por i pa shfaqur, me plot kuptimin e fjalës NJERI.

Në çdo pamje që ta vëzhgojmë portretin dhe personalitetin e tij nuk gjendet asnjë hije a njollë e dyshim, në çdo anë që ta analizojmë atë ishte e pa mundur të mos e përdorje atë "M"e madhe, mbi të gjitha për fjalën NJERI që e mishëroi në të gjitha përmasat e saj. Ai nuk ishte një model, ishte një shkollë.

Kjo më bën sot të them ca gjëra që i ndjeva e i preka nga afër për një periudhë më se 50 vjeçare si një nga miqtë dhe bashkëpunëtorët e tij, por që nuk ia thashë ndonjë herë, pse ai nuk pëlqente biseda e vlerësime të tilla.

Do të paraqes disa grimca nga jeta jonë e përbashkët, në frontin e përbashkët ku shërbyem dhe ku ai ishte gjithmonë shembull i mirë për tu ndjekur e në mjaft raste drejtuesi im direkt.

Me Dr. Ahmetin pata rastin të njihesha për herë të parë në vitin 1969, kur u emërova mjek në qytetin e Peshkopisë. Korrekt e i pa përtuar ishte vërtetë i pa lodhur dhe që punonte me një këmbëngulje të habitshme që të ngjallte dashuri e respekt dhe dëshirën për ta ndjekur si një model, më mirë i mundshëm.

Në atë kohë kur ai megjithëse bëri të pamundurën, ishte një pacient i ri që bëri një ndërlikim të rëndë dhe humbi jetën. Doktorin punëtor e të pa epur e pashë atë ditë me sy të skuqur. Kjo është mjekësia më tha, mund të përipiqesh shumë por jo të fitosh gjithmonë. Ky pacient më dhimbset shumë dhe do të mbetet në kujtesën time, por dhe shkenca i ka mundësitë e kufizuara, ndoshta në të ardhmen mjeku do të jetë më i armatosur në luftën kundër sëmundjeve. Mjeku është një faktor i rëndësishëm, por në këtë ushtrim është edhe organizmi i njeriut dhe varet se si ai reagon në situata të veçanta. Ishte një leksion pasuniversitar për mua. Ky rast dhe shumë të tjerë të punës së përditshme ishin shembuj të çmuar nga ku një mjek i ri mund të mësonte. Bashkë me të atëherë punonin edhe personalitete të tjerë të rëndësishëm të mjekësisë dibrane e asaj shqiptare si Medi Cani, Mark Mirashi, Ahmet Alliu, Lahim Puca, Azis Ndregjoni e plot të tjerë, por Dr. Ahmeti dëgjohej me respekt e vlerësohej pa diskutim nga të gjithë.

Kur në Peshkopi organizoheshin aksione e ndërtohej me kontribut vullnetar një kompleks banesash në Kamen, ne ishim bashkë aty. Bënim punë të rënda fizike dhe mbanim gurë e tulla nëpër një rampë me dy dërrasa që ti ngjijnim ato me tezgë në katin e dytë. I kërkoja të ecte para, pasi më dukej se peshja rëndonte më shumë prapa kur ngjiteshim lart, por nuk e pashë të ankohej asnjë herë edhe kur kishte qenë mjek roje e nuk kishte pushuar mjaftueshëm.

Në spitalin e rrethit, nëpër zona, në ekipe që organizoheshin, mund të them se ai ishte i kudo ndodhur. Po ti paraqisje ndonjë rast, pa hezituar do të thoshte: Ku është i sëmurit, hajt ta shohim.

Dr. Ahmeti u bë shpejt i njohur e i respektuar në Dibër e përtej kufijve të saj dhe ra në sy të autoriteteve si një mjek i zoti e punëtor shumë serioz.

Kjo ishte koha që ai u përzgjedh dhe u mor në Tiranë në detyra të rëndësishme. Kur u emërua Ministër i Shëndetësisë, patëm rastin të punonim disa vjet bashkë, pasi atëherë unë

Ikja e një humanisti



Prof. dr. Ahmet Kamberi (1940-2023)

bëja detyrën e Shefit të shëndetësisë në Dibër. Ishte korrekt e me kërkesa të qarta. Edhe pse bashkë shkonim mirë dhe ishim si të thuasht të njëj, por ai nuk e pengonte të kërkonte llogari për detyrën si gjithë të tjerëve. Por edhe ndihma e asistencës e tij në vështirësitë që ne hasnim ishin bujare e shumë të kualifikuara. Eprori dhe miku ishin dy dhe një, detyra e para, shoqëria vinte pas saj. Me siguri ishte propozimi i tij që në atë kohë unë u zgjodha në Kolegjiun e Ministrisë së shëndetësisë, ku bënim pjesë figurat më të spikatura të mjekësisë shqiptare në Tiranë dhe 3 apo 4 të tjerë vinin nga rrethet. Unë e ndjenja respektin dhe besimin e tij e përipiqesha ta justifikoja në punë. I jam mirënjohës edhe sot.

Në një nga ato mbledhje të Kolegjiut të Ministrisë u diskutua detyra e projektimit për ndërtimin e maternitetit të ri të Tiranës (ai sot mban emrin "Koço Glliozheni). Detyra parashikonte ndërtimin me hapësira të bollshme dhe banja në çdo dhomë për pacientet. Orientimi nga lart ishte dhënë që të bëheshin kërkesa të matura pasi ishim në kohë kursimesh. Në këtë frymë dikush gjatë diskutimeve shprehu mendimin se ishin kërkuar shumë banjo dhe ato mund të reduktoheshin ca. Dr. Ahmet Kamberi që drejtonte mbledhjen bëri aty një pyetje: Më thoni, gratë shqiptare janë si të gjitha gratë e Evropës apo jo? Pa e zgjatur, theksoi: Qeveria le ta ndërtojë kur të ketë fonde, por materniteti do të ndërtohet sipas standardeve të Evropës, nuk do të shkurtohet asgjë nga kërkesat që kemi paraqitur. Në atë kohë një deklaratë e tillë ishte si të mateshe me luanin dhe të mbrohesh me thikën e kuzhinës. Por ai e kishte atë kurajë dhe e bëri. Le ta dinë personeli i sotëm dhe gratë që shtrohen aty se janë në ato kushte me që i mbrojti një drejtues me horizont dhe me trimëri.

Në një rast erdhi me familjen në Peshkopi dhe së bashku me Abdulla Hoxhën (në atë kohë Drejtor i Farmacive në Dibër), vendosëm ta dërgojmë një të dielë në Kastriot. I pëlqente shumë natyra dhe fshati, ishte stina e qershive. U ulëm në një lëndinë fantastike ku po sodisnim natyrën dhe qershitë e pjekura që krijonin një peizazh të mahnitshëm. Djemtë e tij, si fëmijë të vegjël nxituan të kapin ndonjë kokërr qershie, por ai reagoi prerë: shikoni, por mos i prekni. Nëse ju doni qershi, ato do ti blejmë në dyqan. Bashkë me Abdullain porositëm dikë, i dhamë paratë dhe blemë nja 3 apo 4 kg qershi dhe ja dhamë shoferit që ti fuste në bagazhin e makinës. Kur po iknim në drejtim të Bulqizës ai e mësoi këtë dhe i bëri namin shoferit. Me këto veprime ti nuk mund të jesh bashkëpunëtorim, i tha. Shoferi i tij (Luani) ishte një djalë i kulturuar e i sjellshëm sa nuk kishte shoq dhe ne na erdhi vërtetë keq për të. U ndodhëm ngushtë dhe i kërkuam ndihmë Shpresës, të shoqes. I thamë na ndihmo se këtë e kemi bërë ne e shoferi nuk ka faj. Ajo me maturi na u përgjigj: kësaj here do të them se i kam paguar

unë, por ju mos e bëni më, ju e njihni Ahmetin dhe dini se ai kështu është.

Bashkë ishim në një aksion kombëtar që u organizua për problemet e higjienës në Dibër. Dreka na zuri në Dovolani dhe Ahmeti (Ministri) këmbëngulte që të blinim diçka në dyqanin e fshatit, i cili sa mbaj mend, për të ngrënë kishte vetëm biskota. Me vështirësi e bindëm që të shkonim te një miku im që nuk kishte lidhje me detyrat që ne kryenim dhe se ndryshe kjo do të ishte fyerje për mikpritësin dhe fshatin plot tradita ku ne ndodheshim.

Në fillim të viteve 1990-të atë e shpallën për deputet të Kuvendit popullor në zonën e Grykës së madhe ku bënte pjesë edhe Oksh-tuni. Kërkoj ta shoqëronim dhe ne e bëmë me kënaqësi, unë edhe Abdulla Hoxha. Kaluam disa ditë atyre zonave dhe u takuam në çdo fshat me popullin, udhëtuam në këmbë dhe pushuam ku na zinte nata. Pashë një njeri të dimensioneve të pa arritshme. Erudit, i thjeshtë e i përmbajtur, që i kuptonte më së miri njerëzit dhe hallet e tyre. Nga do që kaluam, akujt thyeshin menjëherë, ai miqësohej shumë shpejt dhe merrte pjesë në diskutimin dhe zgjidhjen e problemeve, kur ishte e mundur pa humbur kohë. Thjeshtësia e tij më la pa mend, një babaxhan tipik i Grykës së Madhe, njohës i politikës dhe i traditës së vendit. Ai përshtatej në kushtet që ishin ato fshatra dhe këtë e bënte pa rënë në sy e pa lënduar askënd.

Nga të parët e mi kisha dëgjuar se "burrin e mirë e njih kurbeti, ndërsa e gruan e mirë e njih djepi". Në atë "kurbetin" tonë që zgjati rreth një javë pashë një njeri model që përshtatej në të gjitha situatat dhe ishte i barabartë me të gjithë.

Nga Oksh-tuni duke takuar njerëzit kaluam nëpër Ternovë, në Smollik dhe u futëm në zonën e Zerqanit. Një natë na mori me detyrim në shtëpinë e Mehmet Hysenit ku kishte të motrën, megjithëse unë e Abdullai deshëm të largoheshim pasi i kishim shtëpitë afër. Pashë një dimension tjetër njerëzor të tij, ku ne ishim miq e ai i radhitur me mikpritësit, shkëlqente edhe në këtë pozicion. Ajo natë që e mrekullueshme ku mikpritja e të zotit të shtëpisë dhe bisedat që u zhvilluan aty ishin subjekte për të shkruar libra. Ishte periudha e fillimit të ndryshimeve të mëdha dhe ne ishim kureshtar të dinim për rrugën tonë si shoqëri në të ardhmen, ndërsa ai fliste me qartësi e besim sikur kishte jetuar atje dhe vinte të na sqaronte edhe ne. Besimin për të ardhmen e kishte të pa lënduar.

Të nesërmen kishim takimin e fundit në Zerqan. Unë isha kureshtar se çfarë do të trajtonte ai atje, kur subjekti tjetër kishte shpallur si kandidat të vetin gjithashtu një djalë nga Zerqani, mjek mjaft i njohur në Tiranë, kardio-kirurgun e talentuar Veli Zogun. Në Zerqanin me tradita kishte një pjesëmarrje mjaft të gjerë të popullatës, pasi kishte edhe nga fshatrat e tjera të zonës dhe interesi që mjaft i madh. Ai mbajti një fjalim brilant aty. Foli me detaje për kandidatin tjetër, Dr. Veliun, për figurën dhe personalitetin e tij, a thua se kishte vajtur për të bërë fushatë për të. Ata ishin miq dhe ai do të thoshte të gjithë të vërtetën e tij në atë takim. Në fund tha: Ndërsa mua më njihni të gjithë, pasi jam bir i kësaj zone. Ne përfaqësojmë dy subjekte të ndryshme, por jemi njësoj produkt i kësaj zone. Cilindo që të votoni ju nuk do të jeni të humbur, ndryshojnë subjektet por jo kandidatët. Subjekti duhet ta zgjidhni ju. Të gjithë u befasuan. Edhe ata që mendonin ndryshe i dëgjoje duke thënë: Epo Dr. Ahmeti është vërtet njeri i madh. Më vonë u mësuam se edhe Dr. Veli Zogu kishte bërë të njëjtën gjë, standardi i mirëkuptimit midis dy kandidatëve kishte mbetur si më parë.

Ai u zgjodh në atë legjislaturë Deputet i Kuvendit Popullor dhe e kreu më së miri atë detyrë. Aty spikatën cilësitë e tij të veçanta si qartësia politike, pastërtia shpirtërore dhe dinjiteti i përfaqësuesit të popullit.

Kur doli në pension dikush tentoi të hidhte circa balte mbi të. Me të kishte ndodhur ai fenomeni kur dikujt i bie një monedhë floriri nga xhepi dhe atë e mbulon pluhuri. Mbi të kalojnë këmbësorë e qerre, mund të urinojnë

edhe qentë se ata vetëm të lehin e të dhjesin dinë. Por kur koha hapet e pluhuri shpërndahet, floriri në baltë shkëlqen përsëri se nuk është tunxh, por është flori. Ai u mbrojti siç dinë të mbrohen të diturit dhe trimat. Shkroi shumë artikuj publicistikë dhe dy libra të mrekullueshëm, ku është zor për njeriun e drejtë të lëvizë edhe një fjalë të vetme.

Ndërsa në shkencë ai hartoi 5 protokolle shkencore mjekimi, është autor e bashkautor i mbi 100 artikujve të botuara në revista shkencore kombëtare e ndërkombëtare, i 54 referimeve në konferenca shkencore brenda e jashtë vendit, i tekstit universitar mbi kardiologjinë, i projektligjeve dhe shumë dokumenteve të fushës së shëndetësisë etj.

Është pak të thuhet se ai kishte vullnet të hekurit dhe lexonte e studioje çdo ditë deri në fund të jetës së tij. Mësoi dy gjuhë të huaja, anglisht dhe frëngjisht, në nivel gati të përsosur dhe vetëm për disa muaj secilën. Këto i shërbyen kur e dërguan për specializim në Suedi dhe në Paris, prej nga u kthye i kompletuar në të gjitha disiplinat e specialitetit të tij. Dy gjuhë të huaja në atë nivel ishte si të kishte bërë dy fakultete te gjuhët e huaja. Kur ishte Ministër dhe përkthyes kishim një vajzë që kishte mbaruar studimet e larta tek gjuhët e huaja, konstatonim shpesh që ai i bënte vërejtje për gjuhën ku ajo ishte diplomuar. Ajo skuqej dhe i jepte të drejtë.

Kur ishte Ministër i Shëndetësisë u thirr në Organizatën botërore të shëndetësisë dhe iu propozua pozicioni i Drejtuesit të OBSH për Evropën. U përzgjedh si kandidat e përshtatshme ku kishte edhe përfaqësues të vendeve të mëdha, ishte edhe përfaqësuesi i Egjiptit. Asambleja votoi Dr. Ahmet Kamberin. Ishte përfaqësues i një vendi të vogël, por një kandidat i denjë për atë vend dhe që zotëronte në nivel të barabartë gjuhët anglisht e frëngjisht që përdorshin në OBSH.

Në një nga seancat e Asamblesë pas mbledhjes, kishte dalë me disa punonjës të tjerë që e shoqëronin dhe po hanin drekë në një vet shërbim në këmbë. Shoferi i tij, si për të ngarë muhabetin i kishte thënë: Jemi shtet i varfër pasi nuk ka kuptim që në mbledhje të jesh drejtuesi kryesor dhe pastaj të mos ulesh në drekë me kolegët e tu, portë shkosh në vetëshërbim. Pa humbur kohë kishte marrë përgjigjen: "Dëgjo djalë, kur populli është i varfër, Ministri duhet të hajë bukë në këmbë". Ky ishte morali dhe filozofia e tij në punë dhe në jetë. Këtë manifestoi në çdo detyrë, brenda e jashtë vendit, në spital, në popull e në parlament.

Për shkak të njohjes që ka zgjatur mbi 50 vjet dhe të detyrave që kemi kryer në një front, mund të sillja me dhjetëra e qindra shembuj të tillë, për një portret njerëzor e intelektual të pa përsëritshëm si Dr. Ahmet Kamberi.

Kur ai u sëmur e menaxhoi me kujdes mjekësor e dinjitet njerëzor këtë situatë. U takuam direkt dhe kemi folur disa herë në telefon. Ishte i qartë për situatën shëndetësore e perspektivën dhe e priste me qetësi e dinjitet. Këtë ma pat deklaruar edhe mua në një bisedë gjatë gushit të këtij viti. Edhe me organizimin e fundit të jetës së tij u mor vetë, parashikoi çuditërisht saktë çdo gjë, madje edhe ditën e fundit. Kur dikush erdhi për kafe gjatë ditës së lamtumirës dhe pyeti për fjalën që duhej mbajtur në varrim, mbesa i tha: Po, fjala është gati, gjyshi e ka përgatitur vetë edhe atë dhe dikush do ta lexojë.

Për nga mënyra si e jetoj jetën e tij, mesazhet dhe standardin e lartë njerëzor që la pas, ngjitet nga baza në lartësi që asnjë mjek tjetër shqiptar nuk ka arritur ti provojë, mënyra si e menaxhoi jetën dhe sëmundjen, madje edhe fundin e jetës, ai ishte padyshim një kombinim i rrallë midis njerëzores dhe hyjnore, ndoshta i të dyjave së bashku.

U varros me një ceremoni të thjeshtë por madhështore, me një përpikëri të rrallë, siç që e gjithë jeta e tij. Në Sharrë të Tiranës ku prehet u bë një mal me kurora lulesh sa nuk ishte parë ndonjëherë. Sidoqoftë mali me kurora nuk mund ta rrokë malin e madh të lavdisë që la pas.

Tirane, 5 tetor 2023

BIGmarket[®]

6 MAJ - 31 KORRIK 2024

40.000€

PUSHIME

Nga Big Market
dhe Agna Group



20x
Paketa
Pushimesh
Çift

10x Paketa
Çift në Turqi

5x Paketa
Çift në Sharm El Sheikh

5x Paketa
Çift në Shqipëri



5x
FSHESË DYSON



10x
FSHESA ROBOTIKE



10x
LAVATRICE

Bli një nga **brandet e mëposhtme partnere** në një **kupon me vlerë 2500 lekë** dhe behu pjesë



Datat kur hidhet shorteu **31 Maj, 21 Qershor, 31 Korrik**
Na ndiqni live ne Facebook dhe Instagram

Pusho BIG këtë verë!

Për të marrë pjesë në shorteun më të madh veror nga **Big Market** dhe **Agna Group**, mjafton të ndiqni këto rregulla:

- **Blini një nga brandet pjesëmarrëse në shorte**
- Shënoni **Emër/Mbiemër/ Numër tel** në kundrakupon
- **Kundrakuponin hidheni në kutinë e shorteut**

Shorteu i vlefshëm në çdo Big Market